




KËSHILLI  
I QARKUT  
KORÇË



Universiteti "Fan S. Noli"

## KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

**“KORÇA NË LUFTËN E PARË BOTËRORE:  
VETËQEVERIMI DHE ZHVILLIMET  
SOCIAL-EKONOMIKE”**



Korçë, 2024

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*



KËSHILLI  
I QARKUT  
KORÇË



## KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

***“KORÇA NË LUFTËN E PARË BOTËRORE:  
VETËQEVERIMI DHE ZHVILLIMET  
SOCIAL-EKONOMIKE”***

*(Përmbledhja e artikujve të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare  
në përkujtim të 110-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore  
dhe 108- vjetorit të Vetëqeverimit të Korçës)*

**KORÇË, 6-7 DHJETOR 2024**

## **BORDI SHKENCOR**

Prof. dr. Lorenc Ekonomi, Rektor, Universiteti “Fan S. Noli”

Prof. dr. Valentina Duka, Përgjegjëse e departamentit të Historisë,  
Universiteti i Tiranës

Prof. dr. Bujar Dugolli, Universiteti i Prishtinës

Prof. dr. Enver Bytyçi, Instituti i Studimeve të Evropës Juglindore

Prof. as. dr. Arsim Sinani, Universiteti i Prishtinës

Dr. Erjon Nexhipi, Kryetar, Këshilli i Qarkut Korçë

Dr. Aida Mosko, Zv. Rektor për shkencën dhe projektet, Universiteti  
“Fan S. Noli”

Prof. as. dr. Jonela Spaho, Dekan, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë

Dr. Orjon Ago, Zv. Dekan, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë

Prof. as. dr. Edlira Menkshi, Përgjegjëse e departamentit Histori-Gjeografi

Prof. as. dr. Alba Kreka, Universiteti “Fan S. Noli”

Ph.D. Metin Venxha, Universiteti “Fan S. Noli”

Dr. Ermira Jashiku, Universiteti “Fan S. Noli”

## **BORDI ORGANIZATOR**

Ph. D. Metin Venxha

Dr. Orjon Ago

Elona Mano

Eftiona Bylykbashi

Enela Bode

**Redaktor gjuhësor:** Msc. Lonora Hysolli

**Përgatiti për botim:** Msc. Eftiona Bylykbashi

*Përgatitur nga Universiteti “Fan S. Noli” me mbështetjen e Këshillit të Qarkut Korçë*

**TABELA E PËRMBAJTJES**

FJALË PËRSHËNDETËSE Prof. dr. Lorenc EKONOMI- Rektor i Universitetit “Fan S. Noli” .....	5
FJALË PËRSHËNDETËSE Dr. Erjon NEXHIPI- Kryetar i Këshillit të Qarkut të Korçës.....	7
FJALË PËRSHËNDETËSE Ph. D. Metin VENXHA- departamenti Histori- Gjeografi .....	9
KORÇA NË KONTEKSTIN E ZHVILLIMEVE POLITIKE PARA DHE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE Prof. dr. Valentina DUKA.....	11
SALI BUTKA DHE THEMISTOKLI GËRMENJI LUFTËTARË E DIPLOMATË: ROLI I TYRE NË PROTOKOLLIN E 10 DHJETORIT 1916 Dr. Orjon AGO.....	22
KORÇA DHE SHQIPËRIA NË LIDHJEN E ALEANCAVE TË SHTETEVE TË RAJONIT NË PRAG TË LUFTËS SË PARË BALLKANIKE Prof. dr. Enver BYTYÇI.....	38
TERRITORI I POGRADECIT GJATË ADMINISTIMIT FRANCEZ 1917-1920 Ledjan ZEQOLLARI.....	48
JETA DHE VEPRIMTARIA E MISIONARES PROTESTANTE VIOLET KENNEDY NË RAJONIN E KORÇËS Bertina SALLIU.....	56
NJË KËNDVËSHTRIM MBI ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK TË RAJONIT TË KORÇËS Ph. D. Metin VENXHA Ruela AGO .....	61
AVENTURA E KRAHINËS AUTONOME DHE DINAMIKAT E ADMINISTRIMIT TË RAJONIT TË KORÇËS, NËN PROTEKTORATIN FRANCEZ (1916-1920) Brendon SALIH .....	70
ROLI DHE NDIKIMI I GRAVE NË JETËN INTELEKTUALE DHE POLITIKE NË KORÇË GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE Dajana SARAÇI.....	87
SHOQËRITË KULTURORE NË KORÇË DHE SHKODËR NË VITET '20 - ROLI I HILË MOSIT NË LËVIZJET KULTURORE-PATRIOTIKE NË KORÇË E SHKODËR GJATË KËSAJ PERIUDHE Sereta KOPERAJ Erzen KOPERAJ.....	97

RUAJTJA DHE MBROJTJA E KUFIRIT NË RAJONIN E KORÇËS NË VITET 1912 – 1924 Dr. Jorgo QIRICI.....	102
FILLIMI I SHEKULLIT XX: KORÇA, PATRIOTIZMI DHE NDIKIMI PERËNDIMOR Fjoralba PRIFTI.....	107
RAJONI I KORÇËS: RËNDËSIA E POZICIONIT GJEOGRAFIK, RRUGËVE TREGTARE DHE USHTARAKE NË ZHVILLIMIN E TIJ Dr. Ermira JASHIKU.....	116
TIPARET E ZHVILLIMIT URBAN TË QYTETIT E KORÇËS DHE TRASHËGIMIA NË FIZIONOMINË E SOTME Prof. as. dr. Edlira MENKSHI Jorida TOLLKUÇI Dr. Ermiona BRAHOLLI.....	125
KORÇA MIDIS FRANCËS DHE GREQISË: NJË UDHËKRYQ I LUFTËS SË PARË BOTËRORE Ph. D. Marcela MELE.....	134
MIT'HA FRASHËRI DHE FILLESAT E MODERNIZMIT NË LETËRSINË SHQIPE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE Prof. as. dr. Eris RUSI.....	140
KRISTO FLOQI DHE KOMEDIA “VLLAZNI E INTERESË”- VLERË E ÇMUAR NË ZHVILLIMIN KULTUROR TË KORÇËS SË VITEVE 1910-1921 Lonora HYSOLLI, Prof. dr. Valter MEMISHA.....	151
KOHERENCA E PUBLICISTIKËS DHE PROZËS SË MIHAL GRAMENOS-SIMBOLIKË KOMBËTARE DHE PATRIOTIKE Dr. Ilir SHYTA.....	162

## **FJALË PËRSHËNDETËSE**

*Prof. dr. Lorenc EKONOMI- Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”*

*I nderuar kryetar i Këshillit të Qarkut z. Erjon Nexhipi!*

*E nderuar dekane e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë Prof.as.dr. Jonela Spaho;*

*E nderuar Prof. dr. Valentina Duka;*

*I nderuar Prof. dr. Bujar Dugolli;*

*Të nderuar përfaqësues të institucioneve vendore dhe fetare;*

*Të nderuar studentë e pedagogë;*

*Të nderuar pjesëmarrës!*

Në kuadrin e realizimit të aktiviteteve shkencore këtë vit kalendarik bashkë me Këshillin e Qarkut, ne zhvillojmë konferencën shkencore ndërkombëtare: “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

Korça ka prodhuar një histori të pasur me ngjarje, nëse përqëndrohemi në dy shekujt e fundit. Vetëm në qendrën e qytetit të Korçës gjen me radhë sipas rendit kronologjik të ngjarjeve objektet dhe monumentet kulturore të cilat lidhen me:

-Shkollën e Parë Shqipe, të hapur më 7 mars 1887;

-Shtëpinë e Mihal Gramenos, luftëtar me çetën e Çerçiz Topullit, veprimtar i çështjes kombëtare, botues dhe shkrimtar i vlerësuar kryesisht si publicist e pamfletist i jetës politike;

-Monumentin e Luftëtarit Kombëtar (Ushtari i Panjohur);

-Shtëpinë e Themistokli Gërmenjit, një figurë nacionaliste shqiptare dhe një luftëtar i paepur, burrë shteti, diplomat;

-Një lapidar jo shumë i madh, por me shumë sakrificë e gjak të derdhur në përkujtim të demonstratës antifashiste të 9 shtatorit të vitit 1943, që rezultoi me 59 të vrarë dhe mbi 120 të plagosur, kryesisht gra e vajza.

Lufta e Parë Botërore e vuri në rrezik ekzistencën e Shqipërisë. Fuqitë e Mëdha dhe shtetet balkanike u përpoqën të copëtonin përsëri vendin tonë. Përpjekjet e popullit dhe udhëheqësit e tyre, Themistokli Gërmenji dhe Sali Butka nuk lejuan copëtimin e territoreve juglinodore të Shqipërisë. Këto ngjarje historike së bashku me zhvillimet social-ekonomike do të trajtojnë dhe analizojë konferenca e sotme.

Veprimtaria e Themistokliut është unike, ashtu si Vetëqeverimi i Korçës i nënshkruar në protokollin e 10 dhjetorit 1916, ashtu si letra që ai i dërgoi gruas së tij në ditët e fundit të jetës së tij, ashtu si edhe fjalët e fundit të tij para pushkatimit.

Mbaj mend në fëmijërinë time gruan e tij, një grua e urtë, e qetë e gojëëmbël, që sillej shumë mirë me ne fëmijët e lagjes, duke na ftuar në shtëpinë e saj për të vizituar muzeun dedikuar Themistokliut.

Karriera dhe veprimtaria patriotike e tij u ndërpre nga intrigat e stisura nga të gjitha palët. Theksoj jo vetëm fundin tragjik të tij, por edhe burgimin shembullor në burgun famëkeq të Guajanës Franceze, në veri të Amerikës së Jugut, të bashkëpunëtorëve më të afërt të tij, burg në të cilin fundi ishte i sigurt. Këtij burgu të tmerrshëm i dedikohet edhe filmi emblemë kandidat për çmimin Oscar, “Papillon”, me Steve McQueen e Dustin Hofman.

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Por shkaqet, arsyet dhe të gjitha detajet e lidhura me ngjarjet e këtyre kohërave tua lemë historianëve dhe shkencëtarëve.

Falenderoj Këshillin e Qarkut dhe kryetarin e tij si nismëtari i kësaj konference shkencore ndëkombëtare, Fakultetin e Edukimit dhe të Filologjisë, në veçanti Departamentin e Historisë dhe Gjeografisë si mbështetësin kryesor të konferencës, si dhe të gjithë kumtuesit dinjitozë në këtë konferencë.

Ju faleminderit!

## FJALË PËRSHËNDETËSE

*Dr. Erjon NEXHIPI- Kryetar i Këshillit të Qarkut të Korçës*

### VETËQEVERIMI I KORÇËS NË KONTEKSTIN E LUFTËS SË PARË BOTËRORE: NJË PËRVOJË UNIKE E REZISTENCËS DHE DIPLOMACISË

Ky botim shkencor, që përmbledh kumtesat dhe diskutimet e mbajtura në konferencën për 110-vjetorin e Luftës së Parë Botërore dhe 108-vjetorin e Vetëqeverimit të Korçës, paraqet një kontribut të çmuar në studimet historike shqiptare. Ai shërben si një platformë për të reflektuar mbi sfidat e ekzistencës së shtetit shqiptar në fillim të shekullit XX dhe mbi rolin e Korçës si një qendër kyçe e qëndresës dhe vetëorganizimit kombëtar.

Lufta e Parë Botërore, me përmasat e saj shkatërruese dhe ndikimin e gjerë gjeopolitik, solli një krizë të thellë për Shqipërinë, e cila ndodhej në një fazë delikate të formësimit të saj si shtet. Në këtë kontekst, rajoni i Korçës dëshmoi një prej eksperiencave më të rëndësishme të autonomisë administrative shqiptare nëpërmjet **Vetëqeverimit të Korçës (1916-1918)**, një model unik i ruajtjes së identitetit kombëtar dhe integritetit territorial përballë sfidave të mëdha ndërkombëtare.

Vetëqeverimi i Korçës nuk ishte thjesht një akt politik i kohës, por një dëshmi e zgjuarsisë dhe diplomacisë shqiptare në një periudhë kaosi dhe lufte. Në dhjetor të vitit 1916, falë përpjekjeve të patriotëve korçarë dhe bashkëpunimit me autoritetet franceze, u arrit krijimi i një administrate autonome shqiptare, e cila mbrojti stabilitetin e krahinës dhe shmangu copëtimin e saj nga forcat e huaja.

Ky model qeverisjeje, ndonëse i përkohshëm, pasqyrore një ndër përvojat më të hershme të shtetformimit shqiptar, duke shërbyer si një përvojë e vlefshme për zhvillimet e mëvonshme politike dhe administrative të vendit. Në këtë kuadër, **Themistokli Gërmenji** spikat si një figurë kyçe e rezistencës dhe organizimit politik të Korçës në këtë periudhë, duke treguar aftësi të jashtëzakonshme për të manovruar në një kontekst të ndërlikuar ndërkombëtar.

Korça nuk është vetëm një shembull i organizimit politik të shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore, por edhe një vatër e rëndësishme e ndërgjegjes kombëtare, e formësuar përmes veprës së Rilindasve. **Naum Veqilharxhi, Thimi Mitko, Petro Nini Luarasi** dhe shumë figura të tjera nga ky rajon dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në ndërtimin e një identiteti kombëtar të fortë, duke promovuar arsimin shqip dhe duke mbrojtur të drejtat e shqiptarëve në kohë të vështira.

Sikurse e thekson edhe historiani **Neritan Ceka**, Korça ka qenë dhe mbetet një element kyç i historisë shqiptare. Ai shpreh bindjen se “nuk mund ta imagjinojmë dot Shqipërinë pa Korçën dhe historinë e saj, pa veprën e rilindasve të kësaj treve.” Ky vlerësim nuk është vetëm një përmbledhje e rolit të saj në historinë kombëtare, por një thirrje për të kuptuar dhe vlerësuar më tej kontributin e kësaj krahine në ndërtimin e Shqipërisë moderne.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj konference është edhe nderimi i atyre që sakrifkuan për lirinë dhe dinjitetin kombëtar. Në këtë frymë, gjatë punimeve të konferencës u



dorëzuan **Certifikatat e Dëshmorit të Atdheut**, akorduar nga Ministria e Mbrojtjes dhe të dorëzuara pranë Këshillit të Qarkut Korçë për **dëshmorët Odhise Nikolla Kota (1880-1911) dhe Nikolla Aleksandër Kota (1858-1914)**, duke shprehur mirënjohjen tonë për kontributin e tyre sublim në mbrojtjen e kombit shqiptar.

Konferenca dhe ky botim, përmes studimeve dhe analizave të përfshira, ndihmojnë në ndriçimin e një periudhe kyçe të historisë shqiptare. Rëndësia e Vetëqeverimit të Korçës dhe roli i Luftës së Parë Botërore në Shqipëri nuk mund të trajtohen thjesht si pjesë e së kaluarës, por duhet të shërbejnë si një bazë e fortë për të kuptuar sfidat e sotme dhe për të ndërtuar të ardhmen mbi vlerat e unitetit dhe vizionit kombëtar. Dëshiroj të falënderoj të gjithë studiuesit dhe organizatorët për kontributin e tyre të çmuar në këtë nismë shkencore dhe shpresoj që ky botim të shërbejë si një burim i vlefshëm për kërkimet e ardhshme në fushën e historisë shqiptare.

## FJALË PËRSHËNDETËSE

*Ph. D. Metin VENXHA- departamenti Histori-Gjeografi, Universiteti “Fan S. Noli”*

*I nderuar Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”, Prof. dr. Lorenc Ekonomi,*

*I nderuar kryetar i Qarkut Korçë, Z. Erion Nexhipi,*

*E nderuar dekane e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, Prof. as. dr. Jonela Spaho,*

*I nderuar zv. dekan i Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës, profesor Arsim Sinani,*

*Të nderuar pasardhës të familjeve të atdhetarëve korçarë që hodhën themelet e Krahinës Autonome të Korçës,*

*Të nderuar kolegë,*

*Të dashur studentë!*

Kjo konferencë është realizimi konkret i idesë që dha një vit më parë z. Nexhipi, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Korçë, si dhe dëshirës së pedagogëve të Departamentit të Histori-Gjeografisë, në Fakultetin e Edukimit dhe të Filologjisë në universitetin tonë.

Konferenca shkencore ndërkombëtare **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**, ka një rëndësi të veçantë për vlerat që sjell dhe për momentin kur mbahet, pikërisht në vigjilje të 10 dhjetorit, datë që shënon shpalljen e Vetëqeverimit të Korçës, si një homazh nderimi për të gjithë ata patriotë korçarë, që megjithëse nën presionin e Luftës së Parë Botërore, kishin guximin dhe kthjelltësinë të ndërmerrnin një akt historik që do të shënonte dhe jetën e rajonit përgjatë gjithë shekullit XX.

Në mënyrë që të kuptojmë më mirë rëndësinë e këtyre momenteve, le të kujtojmë se cilat ishin rrethanat historike në rajonin e Korçës, nga Shpallja e Pavarësisë deri në Vetëqeverim. Lufta e Parë Botërore i zhbëri të gjitha përpjekjet e shqiptarëve për ndërtimin e shtetit të pavarur shqiptar. Asnjansësia e shpallur nga Princ Vidi nuk u respektua nga Fuqitë e Mëdha dhe vendet fqinje, të cilët nxituan të përfitonin nga situata për të përmbushur ambiciet e tyre të vjetra. Në këtë situatë, Shqipëria u shndërrua në një arenë përplasjesh mes palëve ndërluftuese, por edhe mes tyre e çetave shqiptare. Fatkeqësisht Korça ishte rajoni që rrezikonte më shumë për t'u shkëputur nga trupi i Shqipërisë mëmë. Kjo, sepse ishte një ambicie e vjetër e fqinjëve tanë për ta pushtuar dhe për ta bërë të vetin këtë rajon.

Në këtë kontekst vetëqeverimi nuk ishte rastësi. Ai ishte pasojë e ndërgjegjes dhe vetëdijes kombëtare të popullsisë së rajonit të Korçës, e cila, me luftën që zhvilloi, u bë pjesë e ngjarjeve të rëndësishme gjatë Luftës së Parë Botërore.

Gjithashtu, vetëqeverimi nuk ishte dhuratë, por u arrit si pasojë e kërkesës dhe presionit të popullsisë vendase, që kërkonte ta vazhdonte e pavarur jetën politike brenda një shteti shqiptar. Çetat e armatosura nuk e pranuan pushtimin e rajonit nga Greqia, e cila përgjatë disa viteve kishte ndërmarrë veprime arbitrare dhe kishte kryer masakra ndaj popullsisë lokale. Figurat e shquara kombëtare si Themistokli Gërmenji, Sali Butka, Qamil Panariti, Dr. Haki Mborja, duke mos njohur rrezik dhe duke mos pranuar kompromis, ishin në krye të lëvizjes për vetëqeverim dhe luftuan

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

deri ditën e fundit për çështjen kombëtare.

Është e vështirë të radhitësh dhe të kujtosh në një konferencë të vetme atë se çfarë i kanë dhënë kombit dhe vendit këto personalitete. Të sjellësh në retrospektivë vlerat historike, patriotike, arsimore, kulturore, letrare të një rajoni që ka nxjerrë kaq shumë njerëz të shquar në atdhedashuri, kulturë, art, dije është përgjegjësi dhe obligim që duhet ta kemi ne, intelektualët dhe studiuesit, institucionet dhe universiteti, për t'i njohur, ruajtur dhe transmetuar këto vlera brez pas brezi, për të na shërbyer sa më gjatë me dëshmitë dhe mesazhet tashmë më shumë se njëshekullore.

Kjo është dhe sfida e kësaj konference, që rrok një sërë çështjesh të natyrës historike, socioekonomike, demografike, letrare e më gjerë, që do të trajtohen nga 32 profesorë dhe studiues. Në këtë kontekst, falënderoj për pjesëmarrjen Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e Tiranës, Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Shkodrës, Universitetin e Elbasanit, Albanian University, Institutin për studime Shqiptare dhe Protestante, si dhe Institutin e studimeve të Europës Juglindore.

Faleminderit të gjithëve!

## **KORÇA NË KONTEKSTIN E ZHVILLIMEVE POLITIKE PARA DHE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE**

**Prof. dr. Valentina DUKA**  
Universiteti i Tiranës  
duka.valentina@yahoo.com

### **Abstrakt**

*Lufta e Parë Botërore e ndërpreu rrugën e konsolidimit të shtetit të pavarur shqiptar. Princ Vidi u detyrua të largohet dhe vendi u përfshi nga kaosi. Fuqitë e Mëdha dhe fqinjët ballkanikë nuk e respektuan integritetin territorial të vendit. Këto shtete futën ushtritë e tyre në Shqipëri duke pushtuar pjesë të ndryshme të vendit, sipas interesave të tyre gjeopolitike. Greqia pushtoi prefekturat e Jugut, Italia zbarkoi në Vlorë, ndërkohë që Austro-Hungaria pasi mposhti Serbinë, pushtoi pjesën më të madhe të Shqipërisë. Si pasojë edhe Franca futi trupat në Korçë dhe rrethinat e saj.*

*Pushtimi francez i Korçës, dhe ngjarjet që ndodhën aty më pas, përbën një nga aspektet më të veçantë të kësaj lufte në historinë e Shqipërisë. Grupet nacionaliste arritën një marrëveshje politike me Francën për vetëqeverimin e krahinës së Korçës. Vetëqeverimi dhe masat e komandës franceze patën një impakt pozitiv në zhvillimin social-ekonomik të rajonit. Edhe pse vetëqeverimi u suprimua qeverisja e rajonit nga autoritetet franceze pati efekte pozitive në zhvillimin e rajonit.*

**Fjalë kyçe: Franca, Vetëqeverimi, Korça, ekonomi.**

### **Abstract**

*The First World War interrupted the path of consolidation of the independent Albanian state. Prince Vidi was forced to leave and the country descended into chaos. The Great Powers and the Balkan neighbors did not respect the country's territorial integrity. These states introduced their armies into Albania, occupying different parts of the country, according to their geopolitical interests. Greece occupied the southern prefectures, Italy landed in Vlorë, while Austria-Hungary, after defeating Serbia, occupied most of Albania. As a result, France also sent troops to Korça and its surroundings.*

*The French occupation of Korça region, and the events that took place there afterwards, constitutes one of the most special aspects of this war in the history of Albania. The nationalist groups reached a political agreement with France for the self-governance of the province of Korça. Self-government and the measures of the French command had a positive impact on the socio-economic development of the region. Although self-government was suppressed, the governance of the region by the French authorities had positive effects on the development of the region.*

**Keywords: France, Self-Government, Korça, economy.**

## Hyrje

Në Korçë, një qytet i bukur i juglindjes së Shqipërisë, epoka e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që shtrihet prej viteve 30–40 të shek XIX e deri në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, shënoi një zhvillim të madh politik dhe kulturor lokal me rrezatim kombëtar, por bashkimi kombëtar shqiptar nuk mund të arrihej pa arsim e ndriçim. Popujt e tjerë ballkanikë kishin punuar gjatë për emancipimin kulturor, më përpara se të arrinin çlirimin e tyre kombëtar. Për shqiptarët kjo qe një detyrë e vështirë. Adriatiku nuk i lidhte me perëndimin, por i ndante prej tij. Rrymat e mendimit perëndimor mezi arrinin tek ata dhe ndriçimi i mendjeve intelektuale u krye me ngadalë, sepse shkollat shqipe ndaloheshin prej Portës së Lartë dhe ky ndalim përkrahej edhe nga Patriarkana e Stambollit. Të dyja këto Fuqi u përpoqën t'i pengonin shqiptarët të kuptonin individualitetin e tyre kombëtar<sup>1</sup>.

Megjithë pengesat e shumta, ky ndriçim mendor u krye në radhë të parë tek shqiptarët që jetonin jashtë kufirit të Perandorisë Otomane. Pikërisht, kolonitë shqiptare luajtën një rol të rëndësishëm.<sup>2</sup> Koloni aktive ishin ato të Bukureshtit, Egjiptit, Lozanës, Amerikës, por dhe të Stambollit. Në lëvizjen për zhvillimin e vetëdijes kombëtare shqiptare, një kontribut të rëndësishëm ka luajtur edhe komuniteti i patriotëve korçarë, sidomos i atyre që jetonin në kolonitë shqiptare të lartpërmendura. Ata spikatën në formatimin e një dukurie të re nga përmbajtja dhe objektivat e saj të nacionalizmit, që ishte një lëvizje karakteristike për historinë moderne të të gjithë popujve e cila, si në çdo vend, edhe në Shqipëri kishte si synim të formonte shtetin e pavarur kombëtar.<sup>3</sup>

Patriotët korçarë krijuan klube kulturore, hapën shkollën e parë kombëtare laike në gjuhën shqipe për djem më 1887 dhe për vajza më 1891, botuan gazeta në gjuhën shqipe dhe pavarësisht se qyteti i tyre u pushtua nga ushtria greke, në kuadër të luftimeve të Luftës së Parë Ballkanike, ata patën përfaqësuesit e tyre dinjitozë në Kuvendin e Vlorës. Sipas procesverbalit të Kuvendit të Vlorës mbajtur nga Luigj Gurakuqi,<sup>4</sup> në pamundësi për të dërguar delegatë nga qyteti i Korçës në Vlorë, se Korça ishte e rrethuar nga ushtria greke, Kuvendi ra dakord që këtë qytet ta përfaqësonin: Pandeli Cale, Athanas Floqi dhe Spiro Iloja. Këta patriotë nga Korça ishin të tre firmëtarë të pavarësisë sonë kombëtare. Pandeli Cale u zgjodh edhe ministër në kabinetin e parë shqiptar të drejtuar nga Ismail Qemali. Por Korça nuk mundi të vendosej nën juridiksionin e qeverisë së Vlorës, pasi ajo vazhdoi të qëndronte e pushtuar nga ushtria greke në pritje të vendimeve të Fuqive të Mëdha.

Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913, gjatë diskutimeve për kufirin greko-shqiptar, Korça me Gjirokastrën ishin dy qytete për të cilat u debatua shumë në tavolinat e hapura dhe të mbyllura të kësaj konference. Franca mbështeti Greqinë, e cila përdori ç'mundi për të vërtetuar se Epiri i Veriut, ku sipas tyre bënte pjesë edhe Korça me rrethinë, ishte greke nga feja, nga ndjenjat dhe nga kombësia. Sipas historianit anglez, Joseph Sëire, në monografinë e tij tejet interesante *“Shqipëria, ngritja e një mbretërie”*, përveç paaftësisë së Fuqive të Mëdha për të rënë dakord për kufijtë jugorë të Shqipërisë, çështja ndërlikohej edhe më shumë nga

<sup>1</sup> Stavro Skendi, *Zgjidhimi Kombëtar Shqiptar 1878-1912*, (Tiranë: Phoenix&ShLK, 2000), 420

<sup>2</sup> Nikola Guy, *Lindja e Shqipërisë*, (Tiranë: Botime Pegi, 2012), 15-16

<sup>3</sup> Shaban Demiraj, Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, (Tiranë: 2004, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë), 14

<sup>4</sup> *Përlindja e Shqipërisë*, Vlorë, 18/31 janar 1914, n.6, f.5

lidhja e elementit të krishterë shqiptar me kishën ortodokse greke; nga ekzistenca e shkollave greke në zone; nga padituria e thellë e Europës në lidhje me racën shqiptare dhe nga lidhja e saj sentimentale me Greqinë e Homerit. Europa, sipas tij, as nuk mundej, as nuk donte ta kuptonte se një ortodoks greqishtfolës i Shqipërisë së jugut nuk ishte aspekt domosdoshmërisht grek nga kombësia apo nga ndjenjat. Që kishte shqiptarë ortodoksë, europiani i mesëm nuk arrinte ta vlerësonte apo ta besonte dhe, si rrjedhim, diplomati i çliruar nga trysnia e opinionit publik ishte i lirë ta injoronte. Diplomacia greke deklaronte se Korça dhe i gjithë Epiri i Veriut ishin grekë nga kombësia dhe nga ndjenjat dhe se përfshirja e tyre në Shqipëri do të ishte një fyerje për qytetërimin helen. Ata pretendonin se e gjithë kultura që mund të rrezatonte rajoni ishte rezultat i qytetërimit grek<sup>5</sup>.

Pavarësisht këtyre pretendimeve të qeverisë greke, A-H dhe Italia, për shkak të interesave të tyre strategjike, mbështetën fuqishëm çështjen shqiptare dhe për pasojë, më 11 gusht 1913, Fuqitë e Mëdha të Konferencës së Londrës përcaktuan kufijtë jugorë të Shqipërisë dhe vendosën që Korça t’i mbetej Shqipërisë. Por përpos kësaj, qeveria greke nuk ra dakord me vendimin e “Koncertit” të Londrës dhe e detyroi ushtrinë e saj të qëndronte në qytet deri në fund të marsit 1914, pra, edhe pas ardhjes në Durrës të princ Vedit, të caktuar nga Europa.

Korça iu bashkua qeverisë shqiptare të Turan Pashë Përmetit të Durrësit në fund të marsit të vitit 1914, por qeveria greke, që e lëshoi qytetin me dhimbje të mëdha, u përpoq të organizojë një puç ushtarak më 2 prill të atij viti, për të rimarrë qytetin. Banorët e Korçës, të krishterë dhe myslimanë, burra dhe gra, trupa vullnetare nga veriu, të dërguara nga Preng Bib Doda, por sidomos ata të jugut të vendit, nën drejtimin e Sali Butkës, mbështetën xhandarmërinë e Vedit, të drejtuar nga oficerë hollandezë dhe luftuan trimërisht për vendin që kishin pranuar t’i shërbenin. Së bashku larguan forcat ushtarake epirote. Vidi kishte shprehur dëshirën për t’i komanduar vetë forcat ushtarake shqiptare në jug të Shqipërisë, por ky diskurs i tij u hodh poshtë nga Fuqitë e Mëdha që e mbështesnin vetëm se përbënte rrezik për fillimin e një lufte shqiptaro-greke.

Më 17 maj të vitit 1914, si rezultat i nënshkrimit të asaj që në histori njihet si Protokollin e Korfuzit, një marrëveshje e arritur midis qeverisë greke dhe KNK, prefekturave të Korçës dhe Gjirokastrës, të cilat, sipas qeverisë greke, formonin Epirin e Veriut, u jepte atyre një autonomi vetëqeverisëse, fetare, arsimore, politike dhe kulturore më të gjerë brenda principatës së pavarur shqiptare, nën sovranitetin e Vedit. Ky protokoll tronditi nacionalistët korçarë dhe jo vetëm.

*Një ditë shkova në zyrën telegrafike në Durrës, në emër të Turhan Pashës. Me qindra nacionalistë korçarë ishin mbledhur atje, - do të shkruante në kujtimet e tij Syrja bej Vlora, një kronikan ekselent i kohës, ambasadori i parë shqiptar në Vjenë, i caktuar nga princ Vidi, - të cilët protestonin e thoshin se pranimi i vendimeve të Korfuzit do të përbënte një tradhti. Duke i këshilluar të ishin më të përmbajtur e të kujdesshëm, i sigurova se kërkesat e parashtruara prej tyre do të shqyrtoheshin me vëmendje nga ana e qeverisë. Pas pesë-gjashtë ditësh qarkullonin fjalë se protokollin do të refuzohej i tëri. Këto thashetheme që jehonin nga të gjitha anët i entuziazmonin tanët, kurse grekëve u jepnin shkak për të sulmuar. Shqiptarët e Korçës dhe Gjirokastrës, përveç*

<sup>5</sup> Joseph Swire, *Shqipëria Ngritja e një mbretërie*, (Tiranë: Dituria, 2005), 143

armëve e minicioneve, filluan të kërkojnë edhe forca ndihmëse. Por trupat që mund të dërgoheshin nga Durrësi ishin shumë të pakta. Armët nuk kishin mbërritur akoma të gjitha. Shumë njerëz, shumica nga Shqipëria e Jugut, të cilët kishin ardhur në Durrës nga Amerika dhe u ishin bashkuar nacionalistëve, flisnin kundër vendimeve në fjalë dhe duke u mbështetur në lirinë e mendimit e në ndjenjat kombëtare, kritikonin haptazi qeverinë. Mes shkaktarëve të këtij vlmi përmendej emri i njërit praj ministrave të Vidit, i Turtullit, për të cilin thuhej se i qe bashkuar revoltës së bashkëqytetarëve të tij.<sup>6</sup> Por, pavarësisht reagimit të nacionalistëve korçarë, qeveria e Turhan Pashës e aprovoi Protokollin e Korfuzit me këmbënguljen e Fuqive të Mëdha, më 23 qershor të vitit 1914 pasi nuk kishte alternativë tjetër. Ajo e pafuqishme të luftonte ushtarakisht me Greqinë kurse qeveria greke e shikonte protokollin si një mjet të përkohshëm deri sa të paraqitej një mundësi për aneksimin e plotë të rajonit.<sup>7</sup>

### **1. Pushtimi grek i Korçës**

Pas fillimit zyrtarisht të konfliktit të parë botëror, në qershor të 1914-ës, grekët u rikthyen me ushtri të rregullt, ripushtuan zyrtarisht Shqipërinë jugore, duke përfshirë qytetet e Korçës, të Gjirokastrës dhe të Tepelenës dhe vendosën atje një administratë ushtarake. Qeveria greke, për vendosjen e pushtetit në këtë rajon dhe realizimin e synimeve të veta aneksioniste, që në fillim, vendosi në të gjitha postet kryesore të qytetit të Korçës funksionarë grekë. Vendosja prej tyre e një regjimi të ashpër pushtimi para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, si dhe synimet historikisht të njohura të Greqisë ndaj qytetit të Korçës dhe krahinave përreth tij, shkaktuan precipitim të madh pakënaqësie në radhët e popullsisë korçare.

*Të privuar nga çdo mundësi qëndrese, një pjesë e qytetarëve të qytetit të Korçës i nënshtroheshin fatit në shtëpitë e tyre, kurse të tjerë rrekeshin t'ia mbanin për në Vlorë, për të cilën mendonin se, duke qenë djepi i pavarësisë kombëtare, ishte e mbrojtur nga agresioni, - shkruante në kujtimet e tij Syrja bej Vlora<sup>8</sup>. Kësisoj, grupe prej mijëra vetash, me gra e fëmijë, vinin në Vlorë nga kasabaja me rrethina, duke marrë një pamje të frikshme nga dita në ditë, e cila të kujtonte sheshtubimin e ditës së gjykimit. Këta fatkeqë, të mbetur në nevojë, pa ushqim e ilaçe, në mes të lloj-lloj rreziqesh e të ftohtit, përpiqeshin të zinin vend nën ullinj e nëpër barraka të bëra me hunj. Këto banesa prej letre bëheshin edhe varre për qindra të pafajshëm. Ankimet e përvuajtura e rënkimet e dëshpëruara, që dëgjoheshin përditë nga refugjatët, i trembën shumë vlonjatët. Një grup njerëzish prej prijësve fetarë, së pari iu drejtua konsullit austriak me lutjen që të ndërhynte për mbrojtjen e tyre. Por, konsulli austriak, për të mos shkaktuar ndonjë problem me Italinë, u detyrua t'i dërgonte tek konsulli italian. Sipas fjalëve të përhapura në qytet, konsulli italian u propozoi të adresuarve t'i paraqisnin me shkrim kërkesat e lutjet e tyre. Këta, pas shumë debatesh e diskutimesh, i dorëzuan një dokument të firmosur prej tyre me titullin: “Kërkesë Publike”.<sup>9</sup> Sipas kujtimeve të Syrja bej Vlorës, mbrojtja dhe ndihma humanitare për këta refugjatë korçarë e për një grusht shtetasish italianë, që jetonin*

<sup>6</sup> Syrja bej Vlora, *Shqipëria pasosmane*, (Shkup: Logos, 2015), 217

<sup>7</sup> J. Swire, *Shqipëria*.173

<sup>8</sup> S. Vlora, *Shqipëria pasosmane*, 302

<sup>9</sup> *Po aty*, 302

në Vlorë, ishte alibia që Italia përdori për pushtimin e Vlorës më 25 tetor të vitit 1914. Ndërsa francezët, si pjesë e rëndësishme e Antantës, të nisur nga interesat e tyre strategjike, politike dhe ekonomike në Ballkan, e kishin gjykuar të dëmshëm prej kohësh, para se të fillonte konflikti i parë botëror, krijimin e Shqipërisë së pavarur. Ata vazhdonin të dëshironin Greqi të madhe në jug, në Mal të Zi dhe Serbi, me shtrirje më të madhe në veri e, si rrjedhojë, rritje të koncesioneve për veten në këtë rajon europian. Pas luhatjeve të ndryshme, me fillimin e Luftës së Parë Botërore, me sa duket politika franceze kishte vendosur të përcaktohej qartë. Ajo dëshironte përfundimisht anulimin e vendimeve të marra nga Konferenca e Ambasadorëve në vitin 1913 dhe vendosjen e shqiptarëve katolikë të veriut nën sllavët ortodoksë, kurse shqiptarët e jugut nën Greqi. Duke i qëndruar besnike politikës së saj të vjetër, e nisur nga kjo filozofi politike, në kuadër të luftimeve ushtarake midis dy blloqeve ndërluftuese, Antantës (pjesë e së cilës ishte) dhe Bllokut Qendror, në vjeshtë të vitit 1916, pushtoi juglindjen e Shqipërisë.

## **2. Administrimi i Korçës gjatë kohës së pushtimit francez**

Zona e pushtimit francez ishte më e vogël se zona e pushtimit austro-hungarez dhe ajo e pushtimit italian. Megjithatë, në këtë zonë ndodhej një nga qytetet më të rëndësishme të Shqipërisë, Korça. Sapo ushtria franceze u vendos në qytet (tetor 1916), një komision korçarësh, në emër të popullsisë së krahinës u kërkoi atyre largimin e menjëhershëm të trupave greke dhe ngritjen e një administrate shqiptare<sup>10</sup>. Komanda franceze, jo vetëm nuk i mori parasysh këto kërkesa, por e kaloi administratën e qytetit nga duart e grekëve kostandinistë, idhtarët e mbretit që mbështesnin Bllokun Qendror, në duart e aleatëve të tyre, të grekëve venizellistë, idhtarëve të kryeministrit grek të kohës, i pozicionuar pro Antantës. Në rrethana të tilla, patriotët shqiptarë i drejtuan armët e tyre edhe kundër pushtuesve francezë. Lëvizja patriotike korçare i detyroi ata që më 10 dhjetor 1916, të nënshkruanin një protokoll me përfaqësues të qytetit, sipas të cilit ky qytet, së bashku me Kolonjën, Gorën e Oparin, do të formonte një krahinë autonome, e cila do të administrohej prej shqiptarëve nën mbrojtjen e autoriteve ushtarake franceze. *Ky regjim ishte mjaft kuptimplotë për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në tërësi dhe ishte tregues për rilindjen e nacionalizmit shqiptar në një prej zonave ku edhe para luftës kishte qënë i fuqishëm*, - do të shprehej historiania angleze Nikola Guy, në librin e saj *Lindja e Shqipërisë*.<sup>11</sup>

Sipas këtij protokollit, administrimi i krahinës iu besua një këshilli të përbërë prej 14 vetash, i cili do të kishte në dispozicion të tij xhandarmërinë dhe policinë për mbrojtjen e rregullit. Sipas oficerit francez Andre Ordioni, i cili ndodhej në Korçë si pjesë e Komandës franceze të pushtimit, zgjedhja e anëtarëve të këshillit nuk rezultoi të ishte punë e vështirë. Qyteti i Korçës, sipas tij, pavarësisht se ishte i varfër, kishte mbi 30 milionerë dhe profesionistë të zotë, sidomos doktorë, farmacistë, avokatë, pjesa më e madhe e shkolluar në Itali dhe Francë. Nga ky kontigjent njerëzish u zgjodhën edhe anëtarët e Këshillit të Qarkut. Ky organizëm pati rëndësi të madhe, sepse kontribuoi për mbarëvajtjen ekonomike, financiare si dhe të rendit

<sup>10</sup> Valentina Duka. *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924*, (Tiranë: TOENA, 1997), 62

<sup>11</sup> N. Guy, *Lindja e Shqipërisë*, 165



në zonë.<sup>12</sup> Kjo republikë u dha rastin korçarëve për t`u vetëqeverisur nën francezët. Ai ishte një eksperiment i sukseshëm ku myslimanët dhe të krishterët punuan bashkarisht nën të njëjtën administratë. Gjuha zyrtare do të ishte shqipja dhe flamuri i Krahinës Autonome do të ishte ai shqiptar. Themistokli Gërmenji, figura qendrore e krahinës, pavarësisht se mbajti detyrën e prefektit të policisë, luajti rolin kryesor në këtë administratë.

Administrata e re shqiptare që u vendos në krye të krahinës autonome, që në fillim veprroi me seriozitet. Ajo organizoi menjëherë zgjedhjet e reja të bashkisë së qytetit<sup>13</sup> dhe u kushtoi rëndësi të gjitha problemeve politike, ekonomike dhe arsimore të krahinës së Korçës, por që në fillim u përball me vështirësi të mëdha.

Uria dhe skamja vepronin gjerësisht në qytet. Drithi mungonte. Madje, ai ekzistuesi mbahej i fshehur prej elementëve spekulatorë. Kjo gjendje kishte goditur gjerësisht shtresat e ulëta dhe të mesme qytetare. Përpara të korrave të vitit 1917, drithi i fshehur prej spekulatorëve arriti të shitej me çmime shumë të larta: 5-6 franga ari oka e grurit dhe 4-5 franga ari, oka e misrit.

Në këtë situatë të vështirë, Këshilla Qeveritare (organ ekzekutiv për qeverisjen e krahinës autonome), mori menjëherë masat për furnizimin e popullsisë me bukë. Me iniciativën direkte të Themistokli Gërmjenit, u formua në Korçë një shoqëri tregtare me kapital prej rreth 300.000 frangash ari. Kjo shoqëri solli nga Greqia drithë, që iu shpërnda me çmim të arsyeshëm fillimisht lagjeve të Varoshit, Kasabasë e Çarshisë.<sup>14</sup> Këshilla Qeveritare vendosi njëkohësisht edhe sistemin e triskëtitimit në ndarjen e bukës. Të gjitha këto masa patën rëndësi dhe përmirësuan disi gjendjen e qytetit të Korçës, megjithëse elementët spekulatorë gjetën mënyra e mjete që pengonin në mjaft raste zbatimin e tyre.

Administrata e re u mor gjerësisht edhe me problemet financiare të krahinës. Drejtoria shqiptare e financave, e atashuar pranë Këshillit të Qarkut, e filloi veprimtarinë e saj më 16 dhjetor 1916, domethënë 6 ditë pas shpalljes së Krahinës Autonome të Korçës. Kjo drejtori nuk trashëgoi asnjë dokument financiar prej administratës të mëparshme, përkundrazi, burokratët grekë, me largimin nga qyteti, kishin marrë me vete çdo gjë që ata kishin patur në zyrat e tyre në Korçë. Gjithashtu, Komisioni shqiptar i Financave, pas kontrollit të parë që i bëri arkës, menjëherë pas krijimit të tij, gjeti vetëm rreth 4000 franga ar,<sup>15</sup> sepse pjesa dërrmuese e të ardhurave të kësaj arke, ishte tërhequr prej trupave greke kur u larguan prej këtej.

Në këto kushte të vështira financiare, në të cilat ndodhej Krahina e Korçës, si dhe duke u nisur nga varfëria e madhe që sundonte në radhët e popullit të kësaj krahine, Këshilla Qeveritare hartoi një rregullore të re, ku përcaktoheshin parimet në të cilat do të mbështetej procedura e vjeljes së taksave.

Sipas kësaj rregulloreje, suprimoheshin taksat e vjetra të temetusë (patentës) dhe të vergjisë. Vendin e tyre e zinte një taksë e re, e cila do të llogaritej në përqindje, duke u nisur nga të gjitha të ardhurat e qytetarit. Kështu p.sh. qytetarët që zotëronin të ardhura të llogaritura në më pak se 5 mijë franga, do të paguanin 2% të të ardhurave të tyre; ata që zotëronin të ardhura nga 10 mijë deri në 20 mijë do të paguanin 3%;

<sup>12</sup> *Një officer francez në Ballkan*, (Tiranë: Papyrus 2014), f.362

<sup>13</sup> *Adriatiku*, Korçë, 23 janar 1917, nr.38, f.1.

<sup>14</sup> Petro Harizi, *Histori kronologjike e Qarkut të Korçës që në luftën e Ballkanit deri sot*, (Boston mass: 1919), f.141.

<sup>15</sup> AMAE, Albanie, vëll. 19, f. 179.

ata nga 20 mijë-40 mijë do të paguanin 4%; ata nga 40 mijë deri në 80 mijë - 5%; kurse mbi 80 mijë franga do të paguanin 6% të tyre<sup>16</sup>. Sipas kësaj rregulloreje, problemet financiare përqendroheshin në duart e Këshillës dhe asnjë pagesë nuk do të bëhej pa lejen e saj. Gjithashtu, të ardhurat e qytetarëve e si rrjedhim edhe taksat që ata duhej të paguanin, do të përcaktoheshin prej kryetarit të Bashkisë së bashku me Drejtorinë e Financave dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Prefekturës së Policisë. Këshilla Qeveritare bëri përpjekje edhe për stabilizimin e gjendjes valutore në qytetin e Korçës, sepse dhrahmia, kartëmonedha kryesore, ishte zhvleftësuar mjaft. Me vendim të saj, u hodhën në qarkullim 500.000 franga bankënota shqiptare prej 0.50 dhe 1 frangë-ar. Këto bankënota, fillimisht ishin të kompozuar me një shkabë në qendër dhe me mbishkrimin “Shqipëria vetëqeverisëse”, e cila më vonë u zëvendësua me mbishkrimin “Republika Shqiptare”.<sup>17</sup> Këto bankënota të hedhura në qarkullim rishtazi, qëndruan në fuqi aq kohë sa funksionoi Krahina Autonome e Korçës. Pas kësaj, ato u zëvendësuan nga një tip i ri bankënotash të cilat nga njëra anë kishin xhaminë e qytetit, kurse nga ana tjetër kishin kishën e mitropolisë dhe mbishkrimin “Korça”.

Kujdes të veçantë administrata e krahinës u kushtoi edhe problemeve të arsimit kombëtar që, sipas Sëires, ishte përparimi më fenomenal që bëri Republika e Korçës.<sup>18</sup> Ajo mbylli shkollat në gjuhën greke dhe hapi në qytet, në të njëjtat godina, shkolla shqipe. Kështu, u hapën 3 shkolla fillore për djem, 2 për vajza dhe një shkollë 8-vjeçare (superiore). Në këto shkolla punuan gjithsej 39 mësues dhe mësorin 1776 nxënës<sup>19</sup>. Gjithashtu, në fillim të jetës së Krahinës Autonome lindi ideja për themelimin e një Liceu Kombëtar, ide e cila u arrit të realizohej në vitin shkollor 1917-1918. Në këtë vit shkollor liceu kishte rreth 36 nxënës. Arsimi fillor ishte falas dhe i detyrueshëm gjatë gjithë kohës së pushtimit francez. Gjithashtu, gjatë pushtimit francez të Korçës u hapën shkolla edhe në të gjitha fshatrat e zonës. Nga Komanda Franceze u prodhua me shpejtësi një fjalor i thjeshtë frëngjisht-shqip, i cili iu dërgua të gjitha shkollave. Pothuajse të gjithë nxënësit e shkollave filluan të flisnin shpejt frëngjisht.

Oficerët francezë u habitën me dëshirën e madhe të shqiptarëve për shkollim. *Doja të zgjidhja midis elitës shkollore*, - shkruante Andre Ordioni, kolonel francez në detyrë, - *disa qindra nxënës, ose të paktën disa dhjetëra, për t’i dërguar në shkollat e Francës. Adolehentë inteligjentë kishin shumë, mund të zgjidhje me lehtësi, por mungonin burimet financiare.*<sup>20</sup>

Francezët, krahas kujdesit për vijën e frontit dhe luftimeve të ashpra të zhvilluara përreth saj, sidomos me bullgarët, bënë përpjekje të mëdha edhe për përhapjen e kulturës së tyre në zonë. Familjet e pasura korçare nxiteshin t’i dërgonin fëmijët e tyre në universitete franceze. Nga ana tjetër, vetë ata kishin grumbulluar edhe disa fëmijë jetimë, të cilët qëndronin pranë Komandës Franceze, për të realizuar punëra të prapavijës si: sjellja e ujit, përgatitja e kafes etj, të cilët e mësuan shumë mirë gjuhën frënge dhe u lidhën shumë edhe shpirtërisht me francezët.<sup>21</sup>

<sup>16</sup> *Gazet’ e Korçës*, Korçë, 30 janar 1917, nr.14, f.2.

<sup>17</sup> P. Harizi. *Histori kronologjike...* f.174.

<sup>18</sup> J. Swire, *Shqipëria*, 223

<sup>19</sup> *Gazet’ e Korçës*, Korçë, 7 shkurt 1917, nr.38. f.2.

<sup>20</sup> *Një oficer*. f.364.

<sup>21</sup> *Po aty.....* f. 374

Gjatë ekzistencës së Krahinës Autonome u krijuan edhe trupa ushtarake shqiptare, të cilat morën pjesë në disa operacione ushtarake duke mbajtur flamurin shqiptar. Disa oficerë dhe ushtarë shqiptarë u dekoruan me Kryqin e Luftës, kurse disa të tjerë me Legjionin e Nderit. Themistokli Gërmenji fitoi Kryqin e Luftës për shërbimet e tij gjatë operacioneve ushtarake në Pogradec<sup>22</sup>.

Në periudhën e veprimtarisë së Krahinës Autonome, si dhe në vitet e pushtimit francez që e pasuan atë, përveç disa sharrave mekanike të montuara prej tyre, nuk pati në qytetin e Korçës ndonjë ndërtim të ri industrial. Njësitë kryesore ekzistuese, si mullinjtë e blojës me motor (2 njësi), u shfrytëzuan kryesisht për nevojat e frontit. Kjo bëhet e qartë po të kemi parasysh rastin kur pronari i një mulliri me motor në Korçë i kërkonte bashkisë së qytetit, që të merrte masa për furnizimin me qymyrguri të mullirit të tij, për të përballuar vëllimin e madh të punës, sepse komanda ushtarake franceze kishte çuar për të blotur rreth 700 thasë grurë e misër<sup>23</sup>.

Angazhimi i këtyre mullinjve për nevojat e frontit shkaktoi një shtrenjtësim të madh të procesit të blojës për qytetarët e thjeshtë korçarë, sepse kapaciteti i mullinjve ishte më i vogël sesa ishin nevojat e frontit dhe të qytetit për to.

Gjatë viteve të luftës, në Korçë vazhduan të funksiononin tri shtypshkronja të trashëguara që nga vitet e para që pasuan Shpalljen e Pavarësisë. Këto ishin: shtypshkronja “Korça” ku në këto vite u shtypën revista “Kalendari Korça”, gazeta “Koha” dhe gazeta “Adriatiku”; shtypshkronja “Kostë Skënderi” ku u shtyp gazeta në gjuhën greke “Pellazgu” (doli gjatë viteve 1910-1916); shtypshkronja “Arqimidhi Vangjeli”, në të cilën gjatë këtyre viteve u shtyp gazeta në gjuhën greke “Korça”. Ndërsa, duke filluar që nga viti 1916 e në vazhdim në këtë shtypshkronjë u shtyp gazeta më e madhe e Korçës me emrin “Gazet’ e Korçës”.

Krahina Autonome e Korçës pati jetë të shkurtër. Masat me rëndësi të madhe të marra prej saj nuk arritën të thelloheshin. Me to nuk mund të pajtoheshin edhe vetë pushtuesit francezë, të cilët pas një periudhe të shkurtër, filluan të shkelnin të drejtat që u shkëputi atyre lëvizja patriotike korçare. Komanda e ushtrisë franceze, më 16 shkurt të vitit 1917, abrogoi protokollin e 10 dhjetorit dhe e vuri krahinën e Korçës nën administrimin e drejtpërdrejtë të saj. Me kërkesën e qeverisë greke të Venizellosit, e cila kishte ardhur në pushtet në qershor të vitit 1917 me orientim pro Antantës, pushtuesit francezë filluan të ndiqnin dhe të arrestonin patriotët kryesorë korçarë. Ata arrestuan edhe udhëheqësin kryesor të lëvizjes patriotike të Korçës, Themistokli Gërmenjin, të cilin, me dëshmitarë të rremë, gjyqi ushtarak i Armatës së Lindjes në Selanik e dënoi me vdekje dhe e ekzekutoi në nëntor 1917.

### **3. Suprimimi i Krahinës Autonome të Korçës**

Me suprimimin e Krahinës Autonome të Korçës, francezët bënë një riorganizim administrativ të qytetit dhe të zonës përreth tij. Këshillin e Qarkut e zëvendësuan me Këshillin e Parësisë, i cili përbëhej prej 12 anëtarësh (pra, 2 më pak se këshilla e mëparshme). Në Këshillin e Parësisë qëndruan 7 ish-anëtarë të Këshillës së vjetër dhe 5 të tjerë u zgjodhën rishtas. Por ndryshimi thelbësor midis këtyre dy organeve qëndronte në faktin se, ndërsa Këshilla e Qarkut ishte organ shqiptar, jo vetëm nga forma, por edhe nga përmbajtja, Këshilla e Parësisë ishte organ i vënë në shërbim të

<sup>22</sup> J. Swire, *Shqipëria*, 222

<sup>23</sup> AQSH, Fondi 617, 3.11.1917, dosja 46, dok. 5.

pushtuesve francezë. Gjithë veprimtarinë e saj e dirigjonte një zyrtar i lartë ushtarak francez. U bë gjithashtu organizimi i ri i bashkisë së qytetit, që filloi me ndryshimin e kryetarit të saj (vendin e Aristidh Xheraut e zuri Sotir Kota). Ndryshime u bënë edhe në sistemin arsimor të qytetit.

Nga mesi i vitit 1918, duke mos marrë fare parasysh dëshirat e popullsisë korçare, Komanda franceze e Selanikut riçeli shkollat në gjuhën greke në Korçë dhe në periferi të saj. Patriotët korçarë, nën udhëheqjen e klubit “Përparimi”, shpërthyen në një valë protestash kundër politikës arsimore të pushtuesve francezë të cilët, për t’i prerë hovin kësaj lëvizjeje, burgosën disa prej tyre, me Qamil Panaritin në krye, duke u lënë kështu fushë të lirë veprimi mësuesve grekë, në krye të të cilëve qëndronte drejtori i gjimnazit grek të qytetit.<sup>24</sup>

Francezët bënë ndryshime edhe në sistemin tatimor. Ata hodhën poshtë rregulloren e re të taksave të aprovuar nga Këshilla e mëparshme qeveritare dhe i detyruan tregtarët korçarë të paguanin një taksë të lartë (oktrovën) për të gjitha mallrat që do të futeshin në qytetin e Korçës. Kjo taksë filloi të merrej pas 1 qershorit 1918 dhe sipas artikujve të ndryshëm, ajo merrte vlera të cilat shpesh arrinin deri në 50 % të vlerës së mallit.<sup>25</sup>

Vendosja e këtyre taksave të larta, ekzistenca e një numri të madh konsumatorësh, kërkesat e të cilëve nuk i përballonte dot vëllimi i prodhimit, sollën rritjen e çmimeve të mallrave, në kurriz të popullsisë qytetare korçare. Kishte raste kur çmimet e mallrave u rritën në masën 100-120%. Ishte e pamundur për masat e varfra qytetare të blinin një palë këpucë me çmim 100-120 franga, apo rroba të gatshme me çmim 350 – 400 franga. Edhe në këtë rast, fitime nxorën tregtarët e mëdhenj, të cilët morën përsipër furnizimin me ushqime të ushtrisë franceze.

Në fakt, për të patur sa më nën kontroll të ardhurat e zonës, administrata lokale, me vendim të francezëve, u përqendrua në një numër të vogël njerëzish. Komanda franceze nuk lejonte të bëheshin shpenzime të tepërta. Situata financiare ishte kështu nën kontrollin e plotë të Këshillit të Parësisë.<sup>26</sup>

Është me rëndësi të theksohet fakti se, autoritetet ushtarake franceze kryen disa vepra me rëndësi në fushën e infrastrukturës lokale. Ata ndërtuan dhjetëra kilometra rrugë automobilistike si, Korçë-Voskopojë, Korçë-Ersekë<sup>27</sup>. Ata ndërtuan edhe një rrjet telefonik, të cilin e lidhën me rrjetin qendror të Vlorës<sup>28</sup>. Gjithashtu: u ndërtuan ura të shumta; u riparuan ose u ngritën ndërtesa të mëdha me dobi të përgjithshme për zonën; u realizuan disa punime të rëndësishme bonifikuese, sidomos në fushën e Maliqit.<sup>29</sup>

Francezët i kushtuan kujdes edhe zbulimit dhe shfrytëzimit të vendburimeve minerale të Qarkut të Korçës. Për nevojat e frontit ata shfrytëzuan qymyrgurin e Mborje-Drenovës, nga ku, që nga 1 dhjetori 1917 deri pothuajse në mbarim të luftës, nxorën rreth 2 milion okë qymyr. Për këtë qëllim punonin 12 punëtorë në ditë nën mbikqyrjen e ushtarëve francezë. Eksplorime me vlerë u bënë gjithashtu edhe në

<sup>24</sup> S. Shaplo, *Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri*, (Tiranë: Naim Frashëri, 1975), 92.

<sup>25</sup> P. Harizi, *Histori kronologjike.*, f.190.

<sup>26</sup> *Një oficer*..... f. 368

<sup>27</sup> J. Bourcart, *L’Albanie et les Albanais*. Paris 1921, f.161.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> *Një oficer*..... f.366

Vithkuq e Boboshticë<sup>30</sup>.

Në qendrat e rëndësishme, ushtria franceze ndërtoi edhe spitale apo infermieri, për t’u ofruar kujdesin e saj jo vetëm ushtarëve, por edhe popullsisë civile. Gjithashtu, shërbimi postar funksiononte rregullisht. Për nevojat e frontit, pothuajse të gjitha tokat pjellore të zonës u mbollën dhe u sistemua regjimi i ujërave.<sup>31</sup> Gjithashtu, pati përmirësime të dukshme edhe nga pikëpamja e higjienës në qytet. Duke respektuar pjesën e brendshme të shtëpive, francezët kërkuan që çdo familje të pastronte para derës së shtëpisë së tyre dhe t’i vendoste mbeturinat në një arkë të vogël. Çdo mëngjes, një karrocë e shërbimit bashkiak kalonte para shtëpive dhe mbledhte mbeturinat<sup>32</sup>.

Për ruajtjen e punimeve franceze dhe për mbikëqyrjen e territorit, Komanda franceze kishte caktuar një batalion senegalezësh. Madje, ky batalion u përdor edhe për punimin e tokave, duke i bërë shërbime edhe popullsisë lokale. Qyteti u mbush me kosha mbeturinash.<sup>33</sup> Madje u hartuan edhe projekte zbulimi për Korçën dhe Pogradecin, por nuk u arrit të zbatoheshin.

Francezët e mbajtën qytetin e Korçës të pushtuar edhe përgjatë vitit 1919, madje deri në maj të vitit 1920. Duke e parë pushtimin e juglindjes shqiptare nga perspektiva e kolonelit francez Andre Ordioni, ata ndiheshin me fat, sepse pushtuan pjesën më të pasur të vendit. *Përpyjekjet e bëra për të ngulitur zakonet administrative të Francës, - kujton koloneli francez, - për të përhapur idetë tona dhe kulturën tonë, për të dhënë shijen e higjienës dhe për ta pajisur vendin me një fillesë legjislacioni në përputhje me qytetërimin e kësaj kohe, u pranua nga i gjithë populli*<sup>34</sup>

Në muajt shtator-tetor ndodhi një çoroditje e madhe në qytetin e Korçës, sepse qeveritari francez i qarkut përhapi lajmin se administrata e Korçës do të ndryshohej dhe se qyteti do të kalonte nën sundimin grek. Në pjesë e mirë e qytetarëve shitën gjithë pasurinë e tyre (dyqanet, orenditë shtëpiake) dhe u larguan prej qytetit, për t’u strehuar në qytetet e tjera larg rrezikut të paralajmëruar. Në muajt e parë të vitit 1919 nxirreshin 3-400 pasaporta në ditë për njerëzit që kërkonin të largoheshin nga qyteti<sup>35</sup>. Dëmtimet që pësuan qytetarët e larguar arritën në 2 milion franga-ar. Vetëm disa elementë grekomanë grumbulluan pasuri të mëdha, sepse blinin me çmime të ulëta orenditë e shitura prej qytetarëve të mësipërm dhe prisnin me padurim të zinin poste me rëndësi administrative. Por, pavarësisht nga paniku që u përhap në qytet dhe pavarësisht nga dëshira e qeverisë greke, komanda ushtarake franceze, për aq kohë sa vazhduan tratativat në Konferencën e Paqes, e mbajti të pushtuar qytetin e Korçës, i cili në maj të 1920-ës u lidh me qeverinë e Tiranës. Si homazh për të, pas vdekjes së presidentit në shkurt të vitit 1924, për kontributin e Uillonit lidhur me çështjen shqiptare, tek gazeta e diasporës shqiptare të Amerikës në Shqipëri, “Shqiptari i Amerikës” që botohej në qytetin e Korçës, Faik Konica botoi një shkrim të shkurtër por brilant me titull: “Ca fjalë të vogla përpara një monumenti të madh”<sup>36</sup>: *Një ditë dimri, më 1920, shtypi i Evropës bëri të njohur se guvernat e*

<sup>30</sup> P. Harizi, *Histori Kronologjike...*, f.110.

<sup>31</sup> *Një officer...*, f.365.

<sup>32</sup> *Po aty.*

<sup>33</sup> *Po aty.*

<sup>34</sup> *Një officer* f..374-375

<sup>35</sup> “Kuvendi”, Romë, 8 shkurt 1919, nr.27, f.3.

<sup>36</sup> *Shqipëtar i Amerikës*, Korçë, 15 mars 1924, 2

Anglisë, të Francës dhe të Italisë, kishin arritur në një marrëveshje për Shqipërinë dhe kishin përfunduar që ky vend të ndahet në mes të Italianëve, të Grekëve e të Serbëve. Dëshpërimi më i rëndë kish mbuluar zemrat dhe fytyrat e Shqipëtarëve të mirë. Ah sikur të mos ish i sëmurë Uillsoni! Ky mendim, kjo fjalë, dilte nga shpirti ynë. Po Presidenti i madh, zëri i lartë i të cilit e kish shpëtuar një tjetër herë Shqipërinë, lëngonte në shtrat, i thyer dhe i mbaruar. Shqipëria ish e dënuar për vdekje, dënimi do të zbatohej doemos, as një rreze shprese s'ndritte prej gjëkund. Po e papritura ngjau. Ra rrufeja mu në tryezë, ku vjedhësit e lirive dhe mundonjësit e popujve të vegjël bënë planet e tyre. Kjo rrufe ish zëri, atë kohë i pushuar, i Uillsonit. Presidenti i sëmurë, i mbërthyer në shtrat të lëngimit, u ngrit për gjysmë dhe e para fjalë që tha ish për të kundërshtuar copëtimin e Shqipërisë. Është padrejtësi ajo që doni të bëni, ka edhe Shqipëria të drejtën të rrojë! Fjalë monumentale, të larta e të pavdekura. Ndërgjegjja e njerëzisë e njohu përsëri zërin e madh edhe u drodh nga gëzimi se Uillsoni, duke mbrojtur Shqipërinë, nuk mbronte një popull të vetëm, mbronte gjithë popujt, se mbronte parimin që edhe popujt e vegjël e të pafuqishëm kanë të drejta si popujt e mëdhenj e të fortë. Politikanët zvarranikë të Evropës qëndruan, hoqën duart nga plaçka, ca nga turpi, më tepër nga frika, u penduan, planin e tyre e hodhën në shportë dhe Shqipëria mbeti e pa copëtuar.<sup>37</sup>

## **Bibliografi**

- “Kuvendi”, Romë, 8 shkurt 1919, nr.27, f.3.  
Adriatiku, Korçë, 23 janar 1917, nr.38, f.1.  
AMAE, Albanie, vëll. 19, f. 179.  
AQSH, Fondi 617, 3.11.1917, dosja 46, dok.5.  
Gazet' e Korçës, Korçë, 30 janar 1917, nr.14, f.2. nr.38. f.2.  
J. Bourcart, *L'Albanie et les Albanais*. Paris 1921, f. 161.  
Joseph Sëire, *Shqipëria Ngritja e një mbretërie*, (Tiranë: Dituria, 2005), 1.  
Nikola Guy, *Lindja e Shqipërisë*, (Tiranë: Botime Pegi, 2012).  
*Një oficer francez në Ballkan*, (Tiranë: Papirus, 2014).  
*Përlindja e Shqipënisë*, Vlorë, 18/31 janar 1914, n.6, f. 5.  
P. Harizi, *Histori kronologjike e Qarkut të Korçës që në luftën e Ballkanit deri sot*, (Boston mass: 1919).  
S. Shaplo, *Nga historiku i zhvillimit të arsimit në Shqipëri*, (Tiranë: Naim Frashëri, 1975).  
Sh. Demiraj, K. Prifti, *Kongresi i Manastirit*, (Tiranë: 2004, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë).  
*Shqipëtar i Amerikës*, Korçë, 15 mars 1924, 2.  
Stavro Skëndi, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar 1878-1912*, (Tiranë: Phoenix&Shtëpia e Librit dhe komunikimit, 2000).  
Syrja bej Vlora, *Shqipëria pasosmane*, (Shkup: Logos, 2015).  
V. Duka, *Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924*, (Tiranë: TOENA, 1997).

---

<sup>37</sup> *Shqipëtar i Amerikës*.2

## **SALI BUTKA DHE THEMISTOKLI GËRMENJI LUFTËTARË E DIPLOMATË: ROLI I TYRE NË PROTOKOLLIN E 10 DHJETORIT 1916**

**Dr. Orjon AGO**

*Departamenti Histori-Gjeografi  
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë  
oago@unkorce.edu.al*

### **Abstrakt**

*Për ngjarjet që çuan në nënshkrimin e Protokollit të 10 dhjetorit 1916 në Korçë, kanë shkruar bashkëkohës, studiues e historianë të shumtë. Ato janë trajtuar si ngjarje, ku ndikimi i vendimeve të Fuqive të Mëdha kanë përcaktuar rrjedhën e tyre. Ky punim ka si qëllim të nxjerrë në pah, rolin e aktorëve lokalë, popullsisë shqiptarë, çetave të armatosura, por sidomos rolin e Sali Butkës dhe Themistoki Gërmenjit. Punimi trajton me hollësi të gjitha veprimet e aktorëve të mësipërm duke u munduar të vërë në dukje rolin ushtarak e diplomatik të dy udhëheqësve, në shpalljen e vetëqeverimit të Korçës.*

*Përballë interesave të Fuqive të Mëdha dhe intrigave të Greqisë, e cila, për të arritur objektivat e veta, përdori të gjitha mjetet: diplomacinë, veprimet ushtarake dhe dhunën ndaj popullsisë locale, u vëndosën patriotët shqiptarë, të cilët e mundën atë si në aspektin ushtarak edhe në atë diplomatik. Pa përpjekjet dhe sakrificat e dy udhëheqësve të ndritur, fati i rajonit të Korçës nuk do të kishte qenë i njëjti.*

**Fjalë kyçe:** *vetëqeverim, Korçë, çetë, francezë, grekë, nacionalistë, luftë, diplomaci.*

### **Abstract**

*Numerous contemporaries, scholars, and historians have extensively documented the events leading to the signing of the Protocol on December 10 1916, in Korça. These events have often been analyzed as instances where the decisions of the Great Powers significantly influenced the course of subsequent developments. The aim of this paper is to illuminate the role of local actors, the Albanian population, the armed bands, and particularly the roles of Sali Butka and Themistokli Gërmenji. The paper provides a detailed examination of the actions of these key actors, focusing on the military and diplomatic contributions of both leaders in the declaration of Korça's self-governance.*

*In the face of the competing interests of the Great Powers and the machinations of Greece, which pursued its objectives through all available means-diplomacy, military operations, and violence against the local population-the Albanian patriots ultimately prevailed, both militarily and diplomatically. Absent the efforts and sacrifices of these two eminent leaders, the fate of the Korça region would have unfolded quite differently.*

**Keywords:** *self-governance, Korça, militias, french, greek, nationalists, war, diplomacy.*

### **1. Sali Butka e Themistokli Gërmenji në lëvizjen kombëtare.**

Sali Butka e Themistokli Gërmenji përfaqësojnë dy nga figurat më të rëndësishme të Shqipërisë juglindore në fillim të shek. XX. Ata u përfshinë në lëvizjen kombëtare që në moshë të re dhe vazhduan të ishin pjesë e saj deri në fund të jetës së tyre.

Sali Butka ra në kontakt me veprat e Veqilharxhit, Naimit, Samiut, Petro Nini Luarasi<sup>38</sup> dhe u bë mbrojtës i gjuhës shqipe në gjithë Rajonin Korçës. Si pjesë e lëvizjes kombëtare ai vendosi lidhje me të gjithë nacionalistët shqiptarë që vepronin në Shqipërinë e Jugut: Bajo e Çerçiz Topullin, Qamil Panaritin, Selim Pojanin, Papa Kristo Negovanin, Spiro Ballkamenin, Themistokli Gërmenjin etj. Në vitin 1905 ai vizitoi Manastirin dhe u bë anëtar i Komitetit për Lirinë e Shqipërisë.<sup>39</sup> Në 1908 Sali Butka me një pjesë të çetës së tij shkoi dhe ndoqi Kongresin e Manastirit. Ai u bë pjesë e Komitetit të Fshehtë të Manastirit.

Në vitin 1910 ishte një nga organizatorët e Mitingut të Shkronjave<sup>40</sup> që la përshtypje të thella në Korçë.<sup>41</sup> Me zgjerimin e lëvizjes kombëtare në juglindje të Shqipërisë, çeta e Sali Butkës u rrit. Ai u bë figura më e rëndësishme ndër komandantët e çetave e jugut. Gjatë viteve 1911-1912 çeta e plakut të Butkës zhvilloi luftime ndaj ushtrive osmane. Si pasojë e këtij aktiviteti figura e tij u bë shumë e njohur. Ai tashmë ishte pjesë e ngjarjeve që kalonin kufijtë e krahinës së Korçës. Në maj të vitit 1912 u ftua nga Hasan Prishtina për të marrë pjesë në Kuvendin e Junikut.<sup>42</sup> Një muaj më vonë, mori pjesë edhe në mbledhjen e Frashërit, ku u mblodh komiteti kryengritës i Shqipërisë jugore<sup>43</sup>.

Në ngjarjen e madhe, Sali Butka së bashku me çetën e tij u nisën në drejtim të Vlorës, por nuk arritën në ceremoninë e Shpalljes së Pavarësisë, sepse çeta u përfshi në luftime për mbrojtjen e Vlorës nga taboret turke të Xhavit Pashës. Çeta e tij, nga dhjetori 1912 e deri më mars 1913, zhvilloi dhjetëra luftime me trupat greke që kishin arritur deri në Gramoz dhe sulmonin fshatrat e Kolonjës. Ishte koha, kur populli i Kolonjës shikonte tek figura e Sali Butkës mbrojtësin e tij të vetëm. Sali Butka u bë udhëheqësi kryesor në mbrojtjen e kufijve dhe të jetës së popullsisë së Shqipërisë juglindore nga pushtuesit grekë dhe masakrat e andartëve (1912- 1914), në betejat e Butkës, Shtikës, Nikolicës (ku u plagos në syrin e majtë), në Qarr, Luaras, Qesarakë, Skrapar, Panarit, Opar, Korçë e gjetkë. Mihal Grameno shkruante në gazetën “Koha”, më 19 gusht 1912 për çlirimin e Korçës: “Në ballë të çetës së dytë ishte kapedani dhe trimi i Shqipërisë, i dëgjuari patriot Sali Butka, burrë thjesht shqipëtar me zemër mëmë dhjetari. Shokët e tij ishin veshur me rroba hajdutçe dhe t’armatosur me malierka”<sup>44</sup>.

Themistokli Gërmenji rridhte nga një familje patriotike. I ati kishte qenë themelues i shoqërisë “Drita” të Stambollit më 1881. Edhe Themistokliu u angazhua herët në lëvizjen kombëtare. Në moshë të re ai u përfshi në aktivitete patriotike në koloninë

<sup>38</sup> Alfred Uçi, *Petro Nini Luarasi. 1865-1911*, (Tiranë: shblu, 2011), f. 30-31

<sup>39</sup> Hysen Butka, *Sali Butka në kujtimet e mia, 95* (Kujtimet e Hysen Butkës janë botuar në ShBA), f. 16

<sup>40</sup> *Po aty*, f. 19

<sup>41</sup> Gazeta “Lidhja Ortodokse” E hënë 22 shkurt 1910

<sup>42</sup> H. Butka, *Sali Butka*, f. 25

<sup>43</sup> *Po aty*, f. 26

<sup>44</sup> A. Uçi, *Petro Nini Luarasi*, 30-31 shih edhe: Hysen Butka, Sali Butka në kujtimet e mia, f. 95 (Kujtimet e Hysen Butkës janë botuar në ShBA), f. 28, shih edhe: Gazeta “Lidhja Ortodokse”, E hënë 22 shkurt 1910



shqiptare të Bukureshtit.<sup>45</sup> Aty vendosi kontakte me atdhetarët më të shquar të kësaj kolonie si: Mihal Grameno, Aleksandër S. Drenova, kryetarin e “Dritës”- Nikolla Naço, Dervish Himën etj.<sup>46</sup>

Pas themelimit të “Komitetit për Lirinë e Shqipërisë”, Themistokli Gërmenji bëhet pjesë e tij dhe përhap idetë e qëllimet e Komitetit në jug të Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe ai vendosi kontakte me Kajo Babienin, Malkë Zvarishtin, Fehim Zboqin etj. Këta njerëz do ta përkrahnin Themistokliun në rrugën e tij për mbrojtjen e territoreve shqiptare.

Hotel “Liria” i vëllezërve Gërmenji në Manastir u bë qendër e mbledhjeve, bisedimeve, vendimeve dhe bashkimit të shqiptarëve për çështjen kombëtare. Aty ishte qendra nga ku niseshin drejt Shqipërisë idetë, udhëzimet dhe materialet e shtypura. Hoteli shërbente njëkohësisht edhe si depo armësh, të cilat niseshin po në Shqipëri.<sup>47</sup>

Viti 1908 e gjeti Themistokliun në Bukuresht. Revolucioni xhonturk dhe shpresat që ngjalli nuk rezultuan të vërteta. Gjithsesi ato pak mundësi që u krijuan, u shfrytëzuan nga atdhetarët shqiptarë. Në nëntor të vitit 1908 u organizua Kongresi i Manastririt. Themistokliu dhe i vëllai Telemaku morën pjesë në organizimin e tij, ndërsa hotel “Liria” ishte vendtakimi i shumë figurave që morën pjesë në kongres.<sup>48</sup>

Në vitin 1909 Themistokliu u caktua drejtues i përgjithshëm i të gjitha lëvizjeve kryengritëse në Toskëri, të cilat i drejtoi për 4 vjet me radhë. Gjatë viteve 1910-1912, ai ishte pjesë e të gjitha ngjarjeve që lidhen më çështjen kombëtare.<sup>49</sup> Rrjeti i tij i bashkëpunëtorëve ishte zgjeruar dhe përmes veprimtarisë së tij fitoi rolin udhëheqës ndër grupet nacionale që zhvillonin veprimtarinë e tyre në Shqipërinë e jugut. Pas Shpalljes së Pavarësisë, për shkak të kontributit të tij të njohur, Ismail Qemali e ngarkoi nënprefekt të Skraparit.<sup>50</sup>

Rrugët e Sali Butkës dhe Themistokli Gërmenjit kryqëzohen gjatë vitit 1913. Themistokliu u caktua nënprefekt i Skraparit, ndërsa Sali Butka u caktua kryekomunar i krahinës së Skraparit nga qeveria e Vlorës. Në këtë kohë lindi një bashkëpunim i ngushtë mes dy burrave të shquar.

## **2. Korça nga 28 nëntori 1912 deri në tetor 1916**

Shqipëria u shpall e pavarur më 28 nëntor 1912. Pavarësia e Shqipërisë u sanksionua nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe dy vendimet e Fuqive të Mëdha: ai i 17 dhjetorit 1912 dhe i 29 korrikut 1913, por krijimi i shtetit hasi në vështirësi të shumta. Së pari, ishin këndvështrimet e ndryshme që ekzistonin në gjirin e Fuqive të Mëdha dhe, së dyti, vështirësisë vinin nga kërkesat territoriale të fqinjëve të Shqipërisë.

Çështja e shtrirjes territoriale dhe e kufijve të Shqipërisë shkaktoi përplasje mes Fuqive të Mëdha. Dy ishin kriteret ku u mbështet problemi i kufijve në konferencë: kriteri “etnik” dhe kriteri i së “drejtës së fituesit në luftë”. Sipas kriterit të dytë kërkesat territoriale të fqinjëve nuk merrnin parasysh kriterin e parë. Kjo pati mjaft

<sup>45</sup> AQSH. F 170, Viti 1937, Dosja 50 fl 1

<sup>46</sup> Pirro Tako, *Themistokli Gërmenji*, (Tiranë: 8 nëntori, 1998), f. 32

<sup>47</sup> AQSH. F 170, Viti 1937, Dosja 50 fl 1

<sup>48</sup> P. Tako, *Themistokli*, f. 54

<sup>49</sup> AQSH. F. 440. D 1-11. Themistokli Gërmenji, fl 12, Biografia e Themistokli Gërmenjit

<sup>50</sup> AQSH. F 170, Viti 1937, Dosja 50 fl. 2

pasoja për fatin e ardhshëm të Shqipërisë.

Kërkesave territoriale ndaj Shqipërisë u dha fund Traktatit i Paqes i 30 majit 1913, i cili përcaktonte se Perandoria Osmane lëshonte territoret në kontinentin evropian në përfundim të vijës Enos-Midia me përjashtim të Shqipërisë. Neni 3 i traktatit angazhonte Perandorinë Osmane dhe vendet ballkanike të deklaronin, se ia linin Fuqive të Mëdha të drejtën për përcaktimin e kufijve të Shqipërisë.<sup>51</sup> Si pasojë e ndryshimeve në terren, pas Luftës së Dytë Ballkanike, Austro-Hungaria dhe Italia kërkuan shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Kështu më 29 korrik 1913, Konferenca e Ambasadorëve mori vendimin që: Shqipëria të formohej si principatë autonome, sovrane, e trashëgueshme pa asnjë lidhje suzereniteti me Turqinë.<sup>52</sup>

Në Shqipëri situata paraqitej ndryshe dhe nuk përputhej me vendimet e diplomacisë. Në turravrapin për të aneksuar sa më shumë territore shqiptare, ushtritë greke më 7 dhjetor 1912 pushtuan Bilishtin dhe më 20 dhjetor Korçën.<sup>53</sup> Diskutimet për çështjen e kufijve vazhduan për një kohë të gjatë. Gjithsesi, më 11 gusht 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër mori vendim për kufijtë jugorë të Shqipërisë. Korça t'i jepej Shqipërisë, ndërkohë që parashikohej ngritja e një komisioni ndërkombëtar për përcaktimin e kufirit në terren.<sup>54</sup>

Pas vendimit të 11 gushtit, qeveria greke u hodh në veprim për të kundërshtuar vendimet e Fuqive të Mëdha, për t'u tërhequr nga territoret që i ishin caktuar shtetit shqiptar. Së pari, ajo ndërmori një veprimtari diplomatike në krye të së cilës u vendosën dy udhëheqësit e shtetit grek, mbreti Kostandin dhe kryeministri Venizellos. Ata nuk pranuan që të njihnin vendimet e 11 gushtit, por shpeshuan takimet me përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha. Në qendër të takimeve ishte çështja e Korçës.<sup>55</sup> Së dyti, pas organizimit administrativ të territoreve të pushtuara, qeveria greke dërgoi në Korçë si guvernator politik Petro Kampsabelis dhe komandant ushtarak Aleksandros Kondulis.<sup>56</sup> Krahas këtyre masave Greqia, shtoi numrin e trupave ushtarake që vepronin në territoret e pushtuara. Pas zbarkimit të trupave të rregullta, Greqia filloi organizimin në Epir të të ashtuquajturave “Legjione të Shenjta”. Batalioni i parë u krijua në Korçë në maj të vitit 1913. Këto batalione u pajisën me armatime dhe qëllim kryesor kishin që të ndalonin popullsinë shqiptare të dëshmonte përkatësinë e vet kombëtare para Komisionit të Kufirit që do vinte në terren.<sup>57</sup> Ato u paraqitën si forca lokale të krijuara nga banorët vendas, por pjesë e tyre u bënë edhe kriminelët greke të liruar nga burgjet e Kretës. Në fakt, ata u përdorën për të parandaluar përfshirjen e popullsisë shqiptare në ndonjë lëvizje kundër pushtimit grek.<sup>58</sup>

Pasi nuk mundën të ndalonin ardhjen e Komisionit të Kufirit dhe të shqetësuar ngaqë masat e marra nga qeveria greke nuk kishin sjellë ndonjë rritje të përkrahjes nga popullsia shqiptare, autoritetet civile, fetare dhe ushtria greke filluan terrorin ndaj

<sup>51</sup> Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*, (Tiranë: UET/Press, 2012), f.527

<sup>52</sup> Thoma Murrzaku, *Kur u caktuan kufijtë e Shqipërisë (1912-1914)*, (Tiranë: Kristalina: KH, 2017), f. 226

<sup>53</sup> Ledia Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia më 1912-1914*, (Tiranë: QSA, 2012), f. 186

<sup>54</sup> Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, (Tiranë: albin, 2003), f. 161

<sup>55</sup> Th. Murrzaku, *Kur u caktuan kufijtë*, f. 226

<sup>56</sup> L. Dushku, *Kur historia*, f. 197

<sup>57</sup> Th. Murrzaku, *Kur u caktuan kufijtë*, f. 524

<sup>58</sup> *Po aty*, f. 523

popullsisë shqiptare, me qëllim që të ndryshonin përbërjen etnike, sidomos aty ku pritej të kalonte komisioni.<sup>59</sup> Në fund të vitit 1912, në fshatrat matanë Gramozit grekët filluan masakrat ndaj popullsisë shqiptare. Sali Butka mbodhi forcat e tij për t’u shkuar në ndihmë, por kur luftëtarët arritën, u përballën me skena makabre. Pas këtyre veprimeve trupat greke kaluan Gramozin. Për disa muaj çetat e Sali Butkës u përfshinë në beteja të ashpra me trupat greke.<sup>60</sup> Forcat greke hynë në Kolonjë vetëm në mars 1913.

Pas disa muajsh pune në terren dhe ndërhyrjeve të vazhdueshme nga ana e autoriteteve greke, Komisioni i Kufijve, i mbledhur në Firence, më 17 dhjetor 1913 mori vendimin për kufijtë jugorë të Shqipërisë. Në vendimet e Protokollit të Firences u përcaktua se krahinat e Korçës i përkasin Shqipërisë, por se kjo duhej sanksionuar nga vendimet e dy qeverive.<sup>61</sup> Pas këtij momenti të dy qeveritë nisën të marrin masat, njëra për të plotësuar vendimet e Firences, kjo ishte qeveria shqiptare dhe tjetra, për t’iu shmangur atyre, pra qeveria greke.

Ndërkaq, pas Protokollit të Firences Themistokli Gërmenji u urdhërua nga qeveria e Ismail Qemalit që të merrte nën kontroll Korçën dhe Kolonjën. Duke u nisur nga Berati së bashku me Qamil Panaritin dhe trupat që i shoqëronin, ata hynë më 12 janar në krahinën e Korçës nga ana e Panaritit.<sup>62</sup> Ndërkohë, më 11 janar 1914 forcat e udhëhequra nga Sali Butka dhe Dajlan Panariti kishin hyrë në Panarit. Atë ditë, ata ngritën për herë të parë flamurin kombëtar shqiptar në zonat e Shqipërisë juglindore të pushtuara nga Greqia.<sup>63</sup> Themistokli Gërmenji u prit me entuziazëm nga të rinjtë nacionalistë të zonës të cilët iu bashkuan trupave të tij. Të dy udhëheqësit nisën ofensivën për largimin e trupave dhe andartëve grekë nga zona e Vakëfeve dhe nga fshatrat fqinjë të Kolonjës. Luftime të ashpra u zhvilluan në fshatrat e Korçës e të Kolonjës në rrugën për të marrë Korçën. Ata çliruan Panaritin, Grabockën, Katundin, Stratobërdën, Selenicën e Pishës, Kaltanjin e Qesarakën, ku më 16 janar 1914 u zhvilluan luftime të ashpra.<sup>64</sup>

Masat e qeverisë shqiptare për të vënë nën kontroll territorin e përcaktuar nga vendimi i protokollit të Firencës shkaktuan një valë dhune të ushtarëve dhe andartëve grekë që ndodheshin në Shqipëri. Njoftimet për masakra erdhën nga të gjitha krahinat shqiptare. Këto sjellje mizore shqetësuan edhe konsujt e huaj që raportuan tek qeveritë e tyre.<sup>65</sup> Nga dhjetori 1913, e në vazhdim qeveria greke riaktivizoi përpjekjet diplomatike për të kundërshtuar Protokollin e Firences. Këto përpjekje nuk patën sukses, madje 6 Fuqitë e Mëdha, më 13 shkurt 1914, i paraqitën qeverisë greke një notë të përbashkët ku i kërkuan ratifikimin e protokollit. Qeveria greke i pranoi vendimet e Fuqive të Mëdha që brenda 31 marsit të largonte trupat nga Shqipëria, por deklaroi se tërheqja do të ishte graduale.<sup>66</sup>

Në mars të vitit 1914, pas presionit të Fuqive të Mëdha, Greqia deklaroi se do të

<sup>59</sup> *Po aty*, f. 538

<sup>60</sup> H. Butka, *Sali Butka*, f. 25

<sup>61</sup> Th. Murrzaku, *Kur u caktuan kufijtë*, f. 604-605

<sup>62</sup> Sotir Dh. Treska “Nisja e Zjarrit në Toskëri, Volumi I, 1917, Boston Mass SHBA, f. 94

<sup>63</sup> *Po aty*, Volumi I, 1917, Boston Mass SHBA, f. 54

<sup>64</sup> *Po aty*, shiko edhe: Valentina Duka, Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar–dhjetor 1914), Vëllimi II, Dok 119, shiko edhe: Demetre Kolovani, Question de Koritza, (Paris: imperiere Henri Dieval, Ru de Siene 57)

<sup>65</sup> V. Duka, Dokumente britanike (janar–dhjetor 1914), Vëllimi II, dok 109, dok 118, dok 119

<sup>66</sup> Th. Murrzaku, *Kur u caktuan kufijtë*, f. 618-619

tërhiqte trupat e saj ushtarake nga jugu i Shqipërisë, por jo pa nxitur edhe një ngjarje të fundit. Më 28 shkurt 1914 u shpall “autonomia e Epirit të Veriut”. Lëvizja Vorio-Epiriote u shpall nga Zografosi, kryeministër i qeverisë së Epirit të Veriut, si një lëvizje jashtë ndikimit grek. Ajo e paraqiti atë si një lëvizje të vetë banorëve, por në fakt solli nga Kreta çetat e andartëve, të cilët filluan masakrat ndaj popullsisë civile. Zona të tëra u dogjën, popullsia u masakrua dhe u detyrua të largohej. Kërkesave për të tërhequr trupat e armatosura Greqia u përgjigjej duke përdorur manovra të ndryshme si:

- a) Kërkonte që të krishterët (duke mos e bërë dallimin të krishterë shqiptarë me ata grekë), të kishin të drejtat e besimit dhe të shkollave.<sup>67</sup>
- b) Nxiste grupe të ndryshme të kërkonin të drejta për popullin e Epirit.<sup>68</sup>
- c) Organizoi shpalljen e autonomisë së Epirit.<sup>69</sup>
- d) Deklaronte se trupat greke do të largoheshin, por në fakt ato qëndronin duke terrorizuar popullsinë vendase, duke kryer masakra.<sup>70</sup>

Nën presionin ndërkombehtar, qeveria greke më në fund pranoi të largonte ushtritë nga qarku i Korçës. Forcat e xhandarmërisë shqiptare, nën drejtimin e oficerëve hollandezë, hynë në Korçë më 2 mars 1914. Në qytet u vendos një administratë shqiptare nën vartësinë e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe një trupë vullnetarësh shqiptarë nën komandën e Themistokli Gërmenjit.<sup>71</sup> Pavarësisht hyrjes së trupave shqiptare, qyteti i Korçës nuk ishte i qetë. Themistokliu filloi të merrte masa për çdo të papritur. Shtoi numrin e patrullave dhe nisi përpjekjet për të rritur numrin e trupave të korpusit të vullnetarëve. Veprimet e tij ishin përcaktuese në ngjarjet e mëpasshme.

Pa kaluar një muaj Greqia organizoi atë që njihet si kryengritja e 2 prillit. Sevasti Qirjazi kujton se: *në orën 2 të natës së 2 prillit 1914, Korça u zgjua nga të shtënat e armëve, rënia e këmbanave dhe thirrjet për Greqinë. Ato këmbana që egzistonin për të thirrur besimtarët për adhurim, tani po thërritnin njerëzit për vdekje.*<sup>72</sup> Gjatë 2-4 prillit pati luftime të ashpra midis dy palëve. Patriotët i **rezistuan sulmit të forcave greke. Forcat e xhandarmërisë, të drejtuara nga ushtarakët hollandezë, të ndihmuar nga Themistokli Gërmenji me njerëzit e tij, organizuan mbrojtjen. Në vazhdim erdhën ndihma edhe nga fshatrat rrëzë Korçës. Të parët mbërritën vullnetarët e udhëhequr nga Abdyl Ypi. Ditën e nesërme arritën çetat e Kajo Babienit dhe Malkë Zvarishtit.**<sup>73</sup> Nga veriu, çeta e Haki Mborjes mbronte qytetin nga sulmet e ushtrive greke. Në ndihmë të qytetit, Sali Butka dërgoi djalin e tij **Gani Butka dhe të vëllanë Myftarin në krye të luftëtarëve.**<sup>74</sup> **Qamil Panariti, së bashku me ndjekësit e tij, mori pjesë në luftime edhe pse i plagosur.**<sup>75</sup>

<sup>67</sup> Akademia e Studimeve Albanologjike. Instituti i Historisë. Historia e shqiptarëve gjatë shek të XX. Vëllimi I, (Tiranë: Botimet albanologjike, 2017), f. 311-318

<sup>68</sup> V. Duka, Dokumente britanike, (janar-dhjetor 1914), Vëllimi II, Dok 17, 107

<sup>69</sup> *Po aty*, f. 208

<sup>70</sup> *Po aty*, f. 2020-2021

<sup>71</sup> Uran Butka, në “100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës”, “Kontributi i çetave të Sali Butkës për shpalljen dhe mbrojtjen e vetëqeverimit shqiptar të Korçës” (Korçë: Promo Print, 2016), f. 192

<sup>72</sup> Sevasti Qirjazi-Dako, “*Jeta ime*”, (Tiranë: Vernon Publishing, 2016), f. 210.

<sup>73</sup> P. Tako, *Themistokliu*, f. 166

<sup>74</sup> Petraq Katro, *Kush ishte Sali Butka*. (Tiranë: Helga's Secret 2020), f. 71-72

<sup>75</sup> AQSH. F 170, Viti 1937, Dosja 50 fl 2.

Pas dështimit të puçit të dy prillit, ushtria greke hyri nga ana e Leskovikut dhe iu drejtua Korçës. Në qafën e Badrit, një çetë kolonjare e udhëhequr nga Qani Ypi u përpoq të ndalonte avancimin e ushtrisë greke, por çeta u vra deri në luftëtarin e fundit. Pas kësaj, Sali Butka shpalli kushtrimin duke bashkuar forcat e udhëhequra prej tij, me çetat e Devollit që kishin në krye Hasan Bitinckën, çetën e Jashar bej Starovës etj. Çetat e udhëhequra nga Sali Butka luftuan dhe thyen trupat greke në Qafën e Qarrit, në Shtikë, në Butkë dhe në Nikolicë në datat 19, 20 e 21 prill të vitit 1914.<sup>76</sup>

Ndërsa qeveria shqiptare përpieq të zgjidhte mosmarrëveshjet me Greqinë, KNK, duke e mënjanuar qeverinë shqiptare, hyri në bisedime me përfaqësues të qeverisë vorioepiriote, që drejtohej nga Zografi dhe nënshkroi më 17 maj 1914 një marrëveshje që njihet si Protokolli i Korfuzit. Sipas tij, prefekturat e Gjirokastrës dhe Korçës do të kishin një administratë gjysmë autonome. Pas kësaj, Greqia deklaroi përsëri se do të largonte trupat e saj nga Shqipëria e jugut.<sup>77</sup> Edhe këtë herë Greqia nuk i përmbushi angazhimet e marra, sepse nisi kryengritja e Shqipërisë së Mesme që ishte një goditje ndaj shtetit shqiptar.

Më 25 qershor 1914, ushtria shqiptare prej 500 vetësh u dërgua kundër kryengritësve esadistë në Pogradec, nën komandën e Zalo Prodanit dhe Gani Butkës, që fatkeqësisht përfundoi me vrasjen e komandantëve dhe 60 trimave të tjerë kolonjarë.<sup>78</sup> Largimi i çetave patriotike drejt Pogradecit e më pas Beratit për t'u përballur me forcat haxhiqamiliste krijoi mungesë trupash në Korçë, Kolonjë, Vakëfe e Skrapar. Kjo i dha mundësi Greqisë të pushtonte Korçën e Kolonjën. Rikthimi i trupave ushtarake greke u shoqërua me masakra mbi popullsinë e Shqipërisë së Jugut.<sup>79</sup> Disa ditë pas rënies së Korçës, filloi hakmarrja dhe u kryen masakrat në Krahinën e Vakëfeve, si zona që i kishte shkaktuar kaq shumë probleme ushtrive greke.<sup>80</sup> Si pasojë e këtyre masakrave, me mijëra shqiptarë u detyruan të largohen në drejtim të Vlorës. Bashkë me popullsinë u larguan edhe figurat e njohura, të cilat kishin kontribuar për çështjen kombëtare. Ushtria shqiptare dhe nacionalistët korçarë u tërhoqën për në Voskopojë dhe që andej në Berat.

### **3. Roli i Sali Butkës dhe Themistokli Gërmenjit si luftëtarë, në protokollin e 10 dhjetorit 1916.**

Thyerja e ushtrisë serbe në dhjetor 1915 bëri që në Shqipëri të futeshin trupat austro-hungareze. Futja e trupave austro-hungareze dhe dëbimi i forcave të shteteve fqinje Serbi e Mali i Zi nga territori shqiptar u mirëprit nga popullsia shqiptare. Ushtria bullgare pushtoi Pogradecin dhe Gorën deri në Maliq e Zvezdë. Në Pogradec ishte edhe Themistokli Gërmenji, i cili kishte ardhur bashkë me shokët e tij që ishin në bashkëpunim me autoritetet bullgare dhe me oficerët austriakë të shërbimit informativ të instaluar në Pogradec.

Kujtimi i perandorisë Austro-Hungareze në krijimin e Shqipërisë nuk ishte fashitur ende. Për këtë arsye, një pjesë e mirë e elitës shqiptare të kohës e pa hyrjen e trupave

<sup>76</sup> Uran Butka në “100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës”, “Kontributi i çetave”, f. 192

<sup>77</sup> Th. Murrzaku. *Kur u caktuan kufijtë*, f. 623

<sup>78</sup> U. Butka në “100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës”, “Kontributi i çetave”, f. 194

<sup>79</sup> Për këtë shiko: Kosta Papa Tomorri, “Barbaritë greke në Shqipëri”, (Tiranë: Naimi, 2012),

<sup>80</sup> Petrit Zeneli. *Masakra e Panaritit*, (Tiranë: DDS, 2004), f. 25-91


ushtarake të këtij shteti si një mundësi për të rifituar pavarësinë. Pas gati dy vjetësh të pranisë së ushtrisë greke dhe sjelljes së tyre, atdhetarët panë si një mundësi çlirim e krahinës së Korçës, në vjeshtën e vitit 1916.

Gjithsesi, në Shqipëri autoritetet ushtarake austro-hungareze vepruan në përputhje me planet e veta. Në fillim të shtatorit të vitit 1916, në Elbasan u organizua një mbledhje me autoritetet austriake, ku morën pjesë Aqif pashë Elbasani, Hajdar Kolonja, Izet Zavalani, etj. Aty u vendos formimi i çetave shqiptare me qëllim çlirim e qarkut të Korçës nga pushtimi grek. U propozua që komandant i çetave të ishte Sali Butka, i cili fillimisht nuk e pranoi propozimin. Atij iu mundësua një takim me oficerët austriakë të cilët ishin dhe organizatorë të mbledhjes. Në bisedimet që zhvilloi me ta, Saliu vendosi 2 kushtet që kërkonte: 1) Komandant mbi vete nuk pranoi; 2) Të na jepen armë, municione, veshmbathje, ushqim i rregullt dhe kafshë për transport.<sup>81</sup>

Më 5 tetor 1916, forcat e organizuara shqiptare, të komanduara nga Sali Butka, u nisën nga Tomorrica në drejtim të Korçës. Qëllimi final ishte të çlirohej krahina nga pushtimi grek. Në mbrëmjen e 5 tetorit 1916 çetat hynë në Backë, ndërsa në mëngjesin e 6 tetorit, pas një përpjekjeje me postën greke të Qafës së Martës të cilën e shpartalluan, ato hynë në Panarit. Pas Panaritit u çlirua edhe Vithkuqi. Në 11 tetor, Sali Butka u drejtua në drejtim të zonës së Oparit duke larguar postat greke dhe duke organizuar xhandarmërinë shqiptare.<sup>82</sup> Pas kësaj, ofensiva e çetave shqiptare të

udhëhequra nga Sali Butka vijoi në drejtim të Voskopojës\*, për ta çliruar atë, por pas ngjarjeve që ndodhën në Voskopojë, aty nuk u ndërmor ndonjë sulm për të çliruar Korçën. Megjithatë, çetat qëndruan në vijën Melçan, Voskop, Dvoran, Boboshticë. Si qendër të veprimeve luftarake, Sali Butka caktoi Voskopin.

Përballë avancimit austriak edhe Antanta bëri lëvizjet e veta. Italianët e zgjatën vijën e luftimit të Vjosës deri në Selenicë të Kolonjës dhe në trekëndëshin grek Kakavijë- Kalibaq-Perat. Francezët, mbasi okupuan Manastirin, zbritën deri në Kostur dhe iu afruan kufirit shqiptar. Trupat franceze të “Armatës së Lindjes” që e kishin qendrën në Selanik, avancuan në drejtim



<sup>81</sup> P. Katro, *Kush ishte Sali Butka*, f. 90-91.

<sup>82</sup> Orjon Ago, *Alba Kreka në “100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës”, Situata ushtarake në Krahinën e Korçës në vitet 1916-1918 dhe roli i Qamil Panaritit në vetëqeverimin e krahinës së Korçës*, (Korçë: Promo Print: 2016), f. 30.

\* Në të gjithë fshatrat që çliroi, Sali Butka njoftonte banorët për qëllimin e mirë që kishin: “Çetat për çlirim e Korçës do të vijin së shpejti aty. Të mos bëhet asnjë kundërshtim dhe të mos trembet njeri. Qëllimi ynë është të ngremë flamurin kombëtar. Në rast se kini të huaj, i lajmëroni të largohen ose të dorëzohen dhe të mos shkaktojnë turbullira që na shpiten në vëllavrasje”. Në Voskopojë në këtë kohë ndodheshin 60 ushtarë grekë që kishin ardhur prej Kosturit disa ditë më parë. Kështu që çetat shqiptare që ishin nisur për të çliruar Korçën u pritën me armë. Situata doli jashtë kontrollit dhe luftimet që pasuan rezultuan me djegien e Voskopojës. Sali Butka nuk mundi ta ndalte rrëmujën që nisi. Sipas gazetës “Gazet’ e Korçës”, ai siguroi që asnjë banor të mos keqtrajtohej ose humbte jetën. Shiko AQSH. F. 440. 1-21. Themistokli Gërmenji, fl. 156. Shiko edhe: “Gazet’ e Korçës”, “Kujtime istorike të Korçës”, kronika e datës 24 nëntor 1916.

të Shqipërisë dhe u futën në Korçë në 22 tetor 1916.\*

Sapo hynë në qytet, trupat franceze e morën atë nën kontroll. Ata urdhëruan largimin e trupave mbretërore, (komandantin, prefektin dhe xhandarmërinë greke), të cilët u larguan nga qyteti më 24 tetor.<sup>83</sup> Popullsia e Korçës e përshëndeti hyrjen e trupave franceze në qytet dhe një komision i kërkoi të nesërmen kolonelit De Burnazel njohjen e të drejtave të popullit shqiptar.<sup>84</sup> Populli mirëpriti masën që mori komanda franceze, e cila largoi fillimisht administratën greke të mbretit Kostandin, por ardhja e trupave venizellite bëri përshtypje të keqe. U kuptua se autoritetet franceze nuk do të hiqnin dorë nga politika e tyre pro-greke.<sup>85</sup> Në fakt, ngjarjet po rridhnin me shpejtësi dhe askush nuk e kishte të qartë se çfarë do të ndodhte.

Në këtë kohë, aty nga fundit i tetorit të vitit 1916, çeta të tjera shqiptare që komandoheshin nga Themistokli Gërmenji dhe Kajo Babieni u shtrinë në linjën Podgorie-Zvirinë-Maliq-Lumalas deri në teqenë e Melçanit.<sup>86</sup> Në realitet, Themistokli Gërmenji ishte larguar nga Korça që në vitin 1914. Ai kishte qenë një kohë në Bukuresht të Rumanisë e më pas në Sofje të Bullgarisë. Si pjesë e Komitetit Shqiptar, ai priste rastin për t'u kthyer në Shqipëri. U nis për në Shqipëri që nga Sofja më 27 dhjetor 1915 dhe arriti në Pogradec më 16 janar 1916. Nga Pogradeci, në krye të një trupe ushtarake, u nis për në Berat duke u takuar më oficerët austriakë që gjendeshin aty. Në emër të Komitetit, u kërkoi austriakëve që të lejohej qeverimi i vendit prej shqiptarëve.<sup>87</sup> Nuk gjeti miratim dhe prej andej u drejtua për në Elbasan, e përsëri në Pogradec. Nga Pogradeci, në krye të dhjetëra trupave shqiptare, u nis drejt Korçës.

Largimi i trupave kostandiniste nga Korça u shoqërua me fillimin e një aktiviteti patriotik brenda dhe jashtë qytetit për krijimin e një qeverie shqiptare dhe ngritjen e flamurit kombëtar.<sup>88</sup> Të dy udhëheqësit u takuan në Teqenë e Melçanit më 29 tetor. Ata vendosën të mbanin të rrethuar Korçën dhe të ushtronin presion mbi trupat franceze që ndodheshin në qytet.<sup>89</sup> Teqeja u caktua si vend i komandës dhe aty u ngrit flamuri shqiptar. Në këtë vend të shenjtë ata do të bashkëpunonin dhe bashkërendonin veprimet e tyre duke i dhënë besën njëri-tjetrit.<sup>90\*</sup>

Nga Polena, më 5 nëntor 1916, Sali Butka i dërgoi një letër komandantit francez De

---

\* Për hartën shiko. [https://en.wikipedia.org/wiki/World\\_War\\_I\\_in\\_Albania](https://en.wikipedia.org/wiki/World_War_I_in_Albania). Kjo hartë tregon pozicionimin e ushtrive ndërluftuese gjatë Luftës së Parë Botërore

<sup>83</sup> “Gazet” e Korçës”, “Kujtime istorike të Korçës”, Kronikat e datës 20 nëntor 1916.

<sup>84</sup> AQSH. F. 440. D. 1-21. Themistokli Gërmenji, fl. 221

<sup>85</sup> Muin Çami, *Shqiptarë dhe francezët në Korçë*, (Tiranë: Dituria: 1999), f. 9

<sup>86</sup> P. Tako, *Themistokli*, f. 227-228

<sup>87</sup> AQSH. F. 440. D1-9. Themistokli Gërmenji, fl. 6. Disa shënime nga Historia Kombëtare Shqiptare.

<sup>88</sup> “Gazet” e Korçës”, “Kujtime istorike të Korçës”, Kronikat e datës 20 nëntor 1920.

<sup>89</sup> P. Katro, *Kush ishte Sali*, f. 120.

\* Që udhëheqësit e shquar kishin rënë dakord që të bashkëpunonin me njëri-tjetrin, këtë e dëshmojnë edhe të dhëna të tjera. Në një letër të Kozma Trebickës, shef i zyrës së policisë së Vithkuqit, dërguar prefekturës së policisë Korçë, aty nga fundi i prillit 1917, njoftohet për një mbledhje që u mbajt nga Gjilardi me komandanët e çetave shqiptare që vepronin në zonën austro-hungareze. Në këtë mbledhje Sali Butka nuk ishte i pranishëm. Gjiraldi i kërkoi komandantëve të pranishëm Hasan Qinami e Qazim Panariti që të sulmoheshin trupat franceze, por përgjigja që mori ishte: “*ne e kemi bërë me njëri-tjetrin që të mos i godasim*”, këtu është fjala për trupat shqiptare që ishin në krah të francezëve. Shiko: O. Ago, A. Kreka në “100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës”, *Situata ushtarake në Krahinën e Korçës në vitet 1916-1918*, fq. 34. Madje ka patur raste kur njerëzit e Themistokliut dhe Saliut janë hasur ballë për ballë. Për shembull, mbi Boboshticë ose kur u bë sulmi kundër A-H për të marrë Pogradecin në shtator të 1917. Shqiptarë më shqiptarë shtinin në ajër dhe jo kundër njëri-tjetrit dhe për këtë, flitej se ishin marrë vesh Themistokliu me Salinë. Shiko: Nepsi Kerenxhi, *Kujtime nga Lëvizja për çlirimin Kombëtar*, (Tiranë: Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë:1962), f.39.

<sup>90</sup> “Gazet” e Korçës”, “Kujtime istorike të Korçës”, Kronikat e datës 20 nëntor 1920.

Burnazel. Kjo letër ishte fillesa e negociatave, diplomacisë dhe presionit ushtarak të Sali Butkës për shpalljen e vetëqeverimit të qarkut të Korçës, për shkak të rrezikut të pushtimit grek të Korçës: *“Neve s’jemi as Bullgarë as Austriakë, lëftojmë vetëm për lirin e e kombit vet... Zotëri, duhet të dini që ne shqiptarët nga vuajtjet e shumta sot jemi të lidhur me mish e me shpirt dhe do të lëftojmë kontra andarëve deri sa të mos mbetemi as një, sa të na prishin e të na çnderojnë bota e huaj, më mire t’u vëmë zjarrin shtëpive me dorën tonë”*.<sup>91</sup> Në këtë letër Sali Butka zbulon qartë synimet atdhetare të forcave të tij se nuk ishin për luftë kundër Francës, apo autoritetit francez në Korçë, por që të përzinin andartët grekë dhe qeverinë venizelliste nga Korça dhe të lejonin shqiptarët të formonin qeverinë kombëtare. *“Juve, pra, në doni sikundër shkruani, që të rrojë Shqipëria, u lutemi të na i lini neve të formojmë qeverinë kombëtare. Neve në Korçë do të vimë që të përzëmë andartët dhe qeverinë venizelliste”*.<sup>92</sup>

Në të njëjtën kohë u aktivizuan edhe elementët progrekë në qytet, të cilët filluan të propagandonin qeverinë venizelliste. Për të dhënë prova se forcat venizelliste kishin përkrahje në popullsinë e qytetit, Argjiropulos mori një sërë masash. Si përfaqësues i qeverisë së Venizellosit, ai emëroi njerëz të rinj në prefekturë, polici, gjykatore, financa etj. Ai u caktoi atyre roga të mëdha, me qëllim që të bënte sa më shumë njerëz për vete. Madje u përpoq që të ngrinte edhe një komision prej 12 vetësh, që të bashkëqeveriste me të, por nuk gjeti përkrahje.<sup>93</sup>

Për të dhënë prova force, më 7 nëntor ushtria franko-venizelliste doli nga Korça në dy kolona. Njëra mori drejtimin Korçë-Maliq dhe tjetra drejtimin Korçë-Turan, me qëllim që të realizohej një operacion spastrimi kundër “bandave”, siç i quanin francezët trupat shqiptare. Në luftimet e asaj dite trupat franceze dhe venizelliste nuk mundën të përparonin, por pas luftimesh u detyruan të tërhiqen.<sup>94</sup> Këto operacione treguan mungesën e mbështetjes ndaj forcave greke, të cilat e kishin kontrolluar rajonin vetëm në sajë të pranisë së ushtrisë së rregullt greke.

Pas tri ditësh, në 10 nëntor 1916, u ndërmor një goditje tjetër kundër çetave shqiptare, duke menduar se këtë radhë do t’i thyenin dhe do t’i largonin nga fusha e Korçës. Këtë radhë sulmi ishte në drejtim të Boboshticës, aty ku vepronin çetat e Sali Butkës, por edhe ky sulm nuk pati sukses.<sup>95</sup> Luftimet rifilluan më datën 13, me një sulm të ri kundër pozicioneve të çetave të udhëhequra nga Themistokli Gërmenji. Sulmi u përqendrua mbi Lumalas dhe mbi Teqenë e Melçanit, ku valonte flamuri kombëtar, por ushtria franceze nuk mundi të largojë çetat shqiptare nga pozicionet e saj.<sup>96</sup>

Duke zotëruar pjesën më të madhe të fushës së Korçës, çetat i detyruan francezët që të hynin në kontakt me ta për zgjidhjen e kësaj situatë. Si pasojë e luftimeve dhe vendosmërisë së çetave, francezët u ndërgjegjësuam se kishin të bënë me forca të shumta shqiptare dhe se ato i kishin rrëmbyer armët, jo për t’u shërbyer Fuqive Qendrore, por në radhë të parë për mbrojtjen e vendit të tyre. Në të njëjtën kohë, francezët konstatuan se aty grekët ishin të huaj, prandaj ata nuk mund t’i mobilizonin

<sup>91</sup> AQSH, Fondi 746, dosja 2 viti 1916. Letra origjinale e Sali Butkës datë 5.11.1916.

<sup>92</sup> AQSH, Fondi 746, dosja 2 viti 1916. Letra origjinale e Sali Butkës datë 5.11.1916.

<sup>93</sup> Kronikat e datës 8 dhjetor 1920.

<sup>94</sup> P. Tako, *Themistokli Gërmenji*, f. 229.

<sup>95</sup> Gazeta e Korçës, “Kujtime historike të Korçës”, Kronika e datës 18, dhjetor 1920.

<sup>96</sup> *Po aty*, Kronika e datës 18, dhjetor 1920



vendasit.<sup>97</sup> Luftimet që u zhvilluan dhe ndryshimi që ndodhi në komandën franceze në 15 nëntor, kur koloneli Dekoin u dërgua në Korçë, bënë që palët të futen në negociata.

#### **4. Sali Butka dhe Themistokli Gërmenji si diplomatë në arritjen e marrëveshjes**

Për arritjen e qëllimeve në një konflikt të caktuar shpesh nuk mjafton vetëm forca dhe lufta. Janë të domosdoshme edhe mjetet e tjera, siç janë marrëveshjet dhe diplomacia. Asnjë nga të dy protagonistët nuk ishte diplomat në profesionin e vet. Madje ata nuk ishin as zyrtarë të emëruar nga shtetet e tyre, por ishin ndjenjat e tyre të larta atdhedashëse ato që i udhëhiqnin në veprimtarinë e tyre. Ata, si dy atdhetarë të vjetër, kërkonin të mbronin atdheun e tyre. Qëllimi kryesor i tyre ishte: të mos lejohej Greqia që të vazhdonte të mbante të pushtuar Korçën dhe ta përdorte në Konferencën e Paqes qenien e saj atje, si argument se Korça ishte pjesë e Greqisë. Të bindur se interesi i Shqipërisë dhe krahinës së Korçës ishte largimi i trupave greke, ata zgjodhën të bashkëpunojnë me Austro-Hungarinë dhe Bullgarinë, në funksion të arritjes së këtij qëllimi. Luftimet me trupat franceze kishin si qëllim që të bindnin Francën se ky ishte një territor shqiptar. Për të arritur këtë qëllim ata përdorën luftën.

Korrespondenti francez i luftës Robert Vaucher, në reportazhin e bërë nga Korça, më 28 shkurt 1917 e përshkruan kështu perceptimin që shqiptarët kishin për Francën para dhe pas krijimit të Krahinës Autonome të Korçës: Në sytë e nacionalistëve shqiptarë, Franca njihej si pro-helene. Kur një oficer francez diskutoi me Sali Butkën, duke i thënë se përse luftonte kundër francezëve, ai i ishte përgjigjur: *“Në Konferencën e Londrës, Franca ishte kundër vendit tim. Ajo kërkoi t’i jepeshin Greqisë sa më shumë territore të Shqipërisë Jugore”*.<sup>98</sup>

Pasi francezët u bindën se ky ishte një territor shqiptar dhe se popullsia shqiptare nuk e pranonte pushtimin grek, kishte ardhur koha për të përdorur diplomacinë, për përmbushjen e qëllimit. Bertige shprehet se: *Bisedimet e mirëfillta mbeten funksioni më i rëndësishëm i diplomacisë në kuptimin më të gjerë të saj*.<sup>99</sup> Ky ishte një moment delikat i gjithë lëvizjes së tyre. Në bisedimet e pritshme, ata do të përballeshin me ushtarakë dhe diplomatë të rafinuar. Nga ana tjetër duhej të tregoheshin të kujdesshëm edhe me austro-hungarezët. Në fund të tetorit, oficerët austriakët që ndodheshin në Voskop kërkuan nga Sali Butka që të rritej numri i çetave dhe të sulmohej Korça. Në të njëjtën kohë, edhe Themistokliu lajmëroi se komanda gjermane kishte urdhëruar për një sulm në drejtim të Korçës.<sup>100</sup>

Eksperienca e gjatë që ata kishin në çështjen kombëtare i kishte bërë të kujdesshëm në hapat që ndërmerinin. Sali Butka në marrëveshjen që kishte bërë me oficerët austriakë kishte shpalosuar aftësitë e tij diplomatike. Ai kishte arritur të merrte përkrahjen e tyre pa dhënë asnjë premtim mbrapsht. Me diplomaci dhe me forcë kishte kundërshtuar idenë e oficerëve austriakë për të vendosur në qeleshet e

<sup>97</sup> M. Çami, *Shqiptarët*, f. 43

<sup>98</sup> L. Dushku., *Nga “armike” në “mike dhe burim qytetërimi”*: Dualizmi në perceptimin e shqiptarëve të Korçës për Francën (1913-1920). Studime Historike Nr. 3-4, 2017, f. 68.

<sup>99</sup> G. R. Berridge *Diplomacia. Teoria dhe praktika*, (Tiranë: DIIS), f. 15.

<sup>100</sup> P. Katro, *Kush ishte Sali Butka*, f. 122.

luftëtarëve shqiptarë mbishkrimin “Vetëqeverimi i Epirit”.<sup>101</sup> Themistokliu, nga ana e tij, kishte patur vështirësitë e veta. Ai ishte nisur me ushtritë bullgare, drejt Shqipërisë, por gjermanët përkrahnin hapur interesat e mbretit të Greqisë. Madje, i ngarkuari Gjermanisë në Athinë ishte nisur në drejtim të Pogradecit dhe mbështeste interesat e Greqisë.<sup>102</sup> Duhej patur gjithmonë kujdes. Çdo dyshim i vështirësonte planet.

Gjatë muajit nëntor Themistokliu kishte mundur të futej në Korçë, duke aktivizuar të gjithë patriotët e saj. Ata e përkrahën financiarisht Themistokliun, në mënyrë që ai të shkëputej nga influenca bullgare.<sup>103</sup> Në këtë kohë u vendosën edhe kontaktet me ushtarakët francezë. Në bisedimet që pasuan, Themistokli Gërmenji ua bëri të qarta kërkesat e palës shqiptare. Siç u shpreh ai: *“Shqiptarët duan të jenë të lirë dhe autonomë, ata nuk pranojnë asnjë qeveri greke qoftë venizelliste, qoftë mbretërore. Me këto kushte shqiptarët janë gati të merren vesh me francezët në qoftë se këta “mbajnë rregullin dhe u sigurojnë shqiptarëve autonominë”.*<sup>104</sup>

Ardhja e kolonelit Dekoins i riaktivizoi bisedimet. Në 23 nëntor Themistokliu hyri përsëri në Korçë. Duke u njoftuar për këtë, Sali Butka ndaloi trupat e tij që të godisnin trupat franceze të cilat lëviznin në rrugën Korçë-Maliq. Saliut i paraqitet patrioti Vasil Tromara me një letër nga Themistokliu. Në këtë letër ai e njoftonte kështu: *“Nuk pata kohë të lajmëronja, ngjarjet u zhvilluan në fshehtësi dhe shpejtësi të madhe. Puna qëndron mirë, interesat e Shqipërisë i kemi siguruar. Këto ditë dërgoj Sabrinë t’ju japë shkoqitje të plota”.*<sup>105</sup> Dy komandanët duket se i kuptonin lëvizjet e njëri-tjetrit. Themistokliu vepronte në qytet, Saliu i ruante krahët me forcat e tij.

Prania e Dekoins në Korçë ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve, sepse, pas ardhjes së tij, Themistokliu iu drejtua popullit të Korçës me një letër të hapur, ku sqaronte pozicionin e Francës, e cila ishte detyruar të hynte në Korçë për të luftuar Fuqitë Qendrore dhe nuk ishte në luftë me shqiptarët. *“Franca e njihte Korçën si vend të Shqipërisë dhe i njihte të gjitha të drejtat e popullit shqiptar. Ai porosiste popullsinë që të mos gënjehej dhe se çdo kundërshtim që i bëhej ushtrisë franceze ishte në dëmin e Shqipërisë”.*<sup>106</sup>

Të shqetësuar nga largimi i Themistokliut, austriakët dërguan pranë Saliut një oficer të tyre, i quajtur Semereja. Ai kishte sjellë me vete armatime dhe urdhurin: Të sulmohet Korça. Saliu, si duket, për t’i dhënë kohë Themistokliut, por edhe për të qetësuar austriakët, riorganizoi çetat e tij. Për të kundërshtuar sulmin, ai përdori aftësitë e tij diplomatike. Bisedoi me Shefqet Korçën dhe e bindi atë të dërgonte një raport pranë komandës austriake, ku ajo të “informohej” se francezët kishin sjellë një numër të madh ushtarësh në Korçë.<sup>107</sup> Kjo manovër funksionoi, sepse urdhri i sulmit u anulua.

Në 1 dhjetor Sabri Panariti, i dërguar prej Themistokliut, mbërriti pranë Sali Butkës

<sup>101</sup> P. Katro, *Kush ishte Sali Butka*. (Tiranë: Helga’s Secret 2020), f. 94-95. Sipas oficerëve austriakë, një gjë e tillë do të kënaqte mbretin Kostandin dhe do ta ndihmonte atë në luftën e brendshme që zhvillohej në Greqi. Madje, sipas tyre, po të shikonte këtë shenjë ai do të largonte trupat nga Korça pa luftë. Shënimi, - kishin vazhduar me diplomaci oficerët, -është vetëm për oportunitet. Kjo nuk e tundi plakun, i cili kundërshtoi në mënyrë kategorike.

<sup>102</sup> AQSH. F.440. D. 1-21. Themistokli Gërmenji, fl. 126.

<sup>103</sup> AQSH. F. 440. D 1-4, Zotit prefekt të Korçës, fl. 1.

<sup>104</sup> P. Tako, *Themistokli Gërmenji*, f. 228.

<sup>105</sup> P. Katro: *Kush ishte Sali Butka*, f. 130.

<sup>106</sup> AQSH. F. 477. D. 1-12. Koleksion i Organizatave dhe Shoqërive. *Popullit të Korçës dhe Kazasë së saj*, fl. 1.

<sup>107</sup> P. Katro: *Kush ishte Sali Butka*, f.133.

dhe e informoi për lëvizjet e Themistokliut. Sipas kësaj bisede, Themistokliu kishte 3 muaj që kishte hyrë në kontakt me komandën aleate.<sup>108</sup> Ai hyri në qytet pasi kishte marrë garanci të plotë nga aleatët se do të shpallnin vetëqeverimin në Korçë.<sup>109</sup> Ai kishte vepruar në fshehtësi, duke i përdorur bullgarët për përmbushjen e qëllimit të tij. Themistokliu ishte i mendimit që ky veprim ishte i dobishëm dhe se kështu Korça do të shpëtonte nga pushtimi grek. Në të ardhmen Konferenca e Paqes duhej të mos e gjente Korçën të okupuar prej grekëve.

Sabri Panariti e njoftoi Saliun se një komision i përbërë nga patriotë korçarë\*, së bashku me një oficer francez kërkon që të vijë të bisedojë këto çështje me rëndësi kombëtare me të. Plaku e pranoi takimin, por jo pa bërë përgatitjet e duhura. Së pari, ai shtoi numrin e patrullave për çdo të papritur. Së dyti, përgatiti një trupë ushtarësh prej 20 vetash, duke i veshur me robat më të mira. Pse gjithë këto masa? Ja si shkruan në poezinë e vet me këtë rast.

*Ndaj erdhi dërgat' e tyre  
Majori Masjet në krye  
erdhi veç për bisedime  
po, ama dhe për hetime<sup>110</sup>*

Të gjitha përgatitjet e Saliut të kujtojnë perandorët bizantinë, të cilët, për të fshehur dobësinë e shtetit të tyre, në rastet e ceremonialeve ose vizitave të delegacioneve të huaja organizonin parada ushtarake. Të njëjtët ushtarë i vishnin me rroba të ndryshme duke parakaluar disa herë. Kështu ata fshihnin dobësitë para përfaqësuesve diplomatikë dhe i zgjatnin jetën perandorisë.<sup>111</sup> A thua se Plaku i Butkës kishte lexuar për ta? Bisedimet mes palëve shkuan më së miri. Majori francez mbeti i mahnitur me mënyrën sesi ishte organizuar pritja. Në bisedimet që u zhvilluan, secila palë dha garancitë e veta se do të zbatonte marrëveshjen dhe se mbi të gjitha interesat ishte fati i Shqipërisë. Në fund, Sali Butka e njoftoi komisionin se ai do të paraqiste kërkesat e veta,<sup>112</sup> në formë të shkruar. Në datën 3 dhjetor kërkesat e tij u bënë të ditura.\*

Kërkesat e tij iu dërguan kryekomandantit të ushtrive Aleate të Lindjes, Gjeneralit Sarrej. Përgjigjen për pranimin e kërkesave e solli koloneli Dekoan, i cili njoftoi Sali Butkën: “Kam nderin të vë në dijeninë tuaj se komanda aleate e sheh me sy të mirë dhe e çmon lëvizjen tuaj patriotike për të drejtat e popullit shqiptar për liri dhe

<sup>108</sup> P. Katro, *Kush ishte Sali Butka*, f.135.

<sup>109</sup> AQSH. F. 440. *Themistokli Gërmenji*, fl. 142.

\* Komisioni përbëhej nga: Tefik Panariti, Qani Dëshnica, Mina Frashëri, Emin Rakip, Llazo Progri, Ahmet Fazlli, Spiro Xega, Dhosi Havjari, Efthim Çekozi, Thimaq Cale, Refat Shtylla, Andrea Katundi dhe Sabri Panariti.

<sup>110</sup> S. Butka, *Ndjenja për atdhenë*. (Tiranë: Tirana&Times, 2016), 145.

<sup>111</sup> P. Nathanailli, *Marrëdhëniet ndërkombëtare nga origjina deri më sot*. (Tiranë: shblu, 2006), f. 62.

<sup>112</sup> P. Katro: *Kush ishte Sali Butka*, f.137-141.

\* Kërkesat e Sali Butkës, datë 3 dhjetor 1916:

1. Vetëqeverimi i kazasë së Korçës do të përmbledhë provizorisht Bilishtin, Kolonjën, Oparin dhe Gorën, gjersa të çlirohen krahinat e tjera. 2. Flamuri zyrtar do të jetë flamuri i Skënderbeut me shqiponjën dykrenare. 3.Gjuha zyrtare do të jetë shqipja. 4. Do të formohet një komision prej pesë patriotësh i zgjedhur nga luftëtarë të lëvizjes kombëtare. Komisioni do të përmbushë detyrat e një qeverie me të drejtë të bëjë ligje, të emërojë e të pushojë nëpunës, të ndryshojë e të rregulojë çdo gjë që sheh të dobishme e të arsyeshme. 5. Administrata do të përbëhet nga elementë patriotë të sprovuar. 6. Gjykatoret do të veprojnë në gjuhën shqipe dhe me personel të aftë për plotësimin e detyrës. 7. Arsimi do të jetë krejt shqiptar, me baza të shëndosha kombëtare. 8. Të mbyllën gjithë shkollat propagandistike greke. 9.Postat dhe telegrafat do të varen nga administrata shqiptare.10. Të formohet një polici për të mbajtur qetësinë e qytetit. 11. Të formohet një gjindarmëri shqiptare me komandantë shqiptarë për të mbrojtur vendin. 12.Komanda franceze detyrohet të mbrojë vetëqeverimin e kazasë së Korçës nga çdo kërcënim 13. Qeveria franceze merr detyrimin moral të përkrahë të drejtat e Shqipërisë dhe veçanërisht të Kazasë së Korçës në konferencën që do të mbledhet, kur të mbarojë lufta.

independencë. Gjithashtu, mori parasysh dëshirat e shfaqura në letrën tuaj të datës 3 të këtij muaji, të cilat i gjeti të arsyeshme dhe jam i autorizuar t’ju komunikoj pëlqimin dhe aprovimin”.<sup>113</sup>

Pas pranimit të kushteve Themistokli Gërmenji dhe koloneli Dekuan përgatitën protokollin e 10 dhjetorit 1916. Në datën 10 përpara gjithë popullit u bë shpallja. Pas kësaj koloneli Dekuan urdhëroi të ngrihej flamuri Kombëtar.<sup>114</sup>

Ja sesi e kujton ai këtë ngjarje: “Ky evolucion do të kishte mundur të bëhej shkallë-shkallë, sikur një përçapje personale e Sali Butkës, i cili nga teqeja e Melçanit vëzhgonte dhe ndiente edhe vetë aspiratat e bashkatdhetarëve të vet, të mos kishte ardhur e shkaktuar rrëkëllyerjen e përshpejtuar të ngjarjeve. Në mbrëmjen e 3 dhjetorit mora nga ai një letër, në të cilën ai më shpallte se ishte krejt i disponuar të linte armët, në qoftë se komanda proklamonte pavarësinë e Kazasë së Korçës, nën mbrojtjen ushtarake të Francës. Kuptohet vetiu, se unë nuk isha kompetent për të marrë vendimin që dëshironte Sali Butka, por ishte detyra ime të studioja në mënyrë sa më të plotë çështjen e t’i jepja Gjeneralit Kryekomandues të gjithë elementet e vendimit që do të mirrte në këtë mes”.<sup>115</sup>

## **Përfundim**

Nuk vonoi dhe kërkesat e Sali Butkës u miratuan nga komanda franceze në Korçë. Mbi bazën e tyre u hartua dhe u shpall edhe Protokollin e 10 dhjetorit 1916. Kjo ishte një fitore sa ushtarake, aq edhe diplomatike. Në një mjedis ku francezët nuk dispononin njerëz dhe mjete për të kontrolluar rajonin e Korçës, nën presionin e çetave shqiptare dhe kërkesave të popullsisë, më 10 dhjetor 1916 u nënshkrua protokollin që shpallte krahinën e “vetëqeverisur” të Korçës, e cila pati një rëndësi të madhe dhe ishte sukses i forcave shqiptare. Ja si e vlerësonte atdhetari i shquar Mihal Grameno Sali Butkën, pak kohë pas shpalljes së vetëqeverimit. “*Cili shqiptar nuk mburret me emrin e këtij patrioti? Cili nuk ia ka dëgjuar emrin.... Shërbimet dhe teororitë që Saliu i ka sjellë atdheut janë kaq të mëdha saqë nuk tregojnë përveç atëherë kur do të dalë në dritë historia kombëtare e të zbukurojë faqet e saj me veprat e këtij të “patunduri”*”.<sup>116</sup>

Rrethanat ndërkombëtare dhe diplomacia e madhe donin që Franca të ndiqte një politikë pro Greqisë venizelliste, me qëllim futjen e saj në luftë krah aleatëve, por situata në terren nuk e lejoi komandën franceze të vepronte në këtë mënyrë. Ky akt diplomatik, që u nënshkrua gjatë Luftës së Parë Botërore, përcaktoi të ardhmen e Korçës.

Për të kuptuar më mirë atë që ndodhi në muajt tetor-dhjetor 1916, i referohemi mendimit të dy figurave franceze që luajtën rolin kryesor në shpalljen e vetëqeverimit. Koloneli Dekuan, për arritjen e marrëveshjes së 10 dhjetorit, është shprehur i befasuar nga kjo maturi politike e rrallë për një popull, i cili nuk kishte patur kohë për t’u mësuar me lirinë. “*Gjë unike në historinë e bërë nga vullneti i lirë i një populli, energjitë e të cilit bashkoheshin në të njëjtin ideal lirie. Revolucioni u*

<sup>113</sup> P. Katro: *Kush ishte Sali Butka*, f.153.

<sup>114</sup> Petro Dh. Harizi, *Historia Kronografike e Korçës*, (Tiranë: Helga’s Secret.), f. 172

<sup>115</sup> Gjeneral Dekuan, *Gjashtë muaj Histori të Shqipërisë*.

<sup>116</sup> M. Grameno, *Antikat kombëtare*, (Tiranë: Naim Frashëri, 1994), f. 176

*krye pa dhunë. Ky popull i vogël po i jepte botës një mësim të madh.*”<sup>117</sup> Gjenerali Sarraj, në letërkëmbimin me Ministrinë e Jashtme franceze, pas nënshkrimit të protokollit të 10 dhjetorit, shprehet: “Unë kam lënë gjithmonë popullsinë të bëjë atë që dëshiron dhe për këtë ju kam vënë në dijeni, nuk më takon mua të përzihem në çështjet politike greke dhe ballkanike. Korça deshi të bëhej e pavarur dhe e tillë u bë.”<sup>118</sup> Përpjekjet e Greqisë për mbajtjen e Korçës me anë të manovrave politike dhe ushtarake ndeshën në rezistencën e popullsisë shqiptare të udhëhequr nga Sali Butka e Themistokli Gërmenji.

## **Bibliografi**

### **Materiale Arkivore**

AQSH. Fondi. 170, Viti 1937, Dosja 50.

AQSH. F. 440. Themistokli Gërmenji, D. 1-9.

AQSH. F. 440. Themistokli Gërmenji, D. 1-21.

AQSH, F. 767 *Sali Butka*, Komandantit të kalorësisë franceze.

AQSH. F. 477. Koleksion i Organizatave dhe Shoqërive.

### **Gazeta**

Gazet’ e Korçës, “*Kujtime istorike të Korçës*”, Kronikat e datës 20 nëntor 1916.

Gazeta “Lidhja Ortodokse”, e hënë 22 shkurt 1910.

## **Literaturë**

Ago, O. Kreka, A. *100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës*, “Situata ushtarake në krahinën e Korçës në vitet 1916-1918 dhe roli i Qamil Panaritit në vetëqeverimin e krahinës së Korçës”. (Korçë: Promo Print, 2016).

ASA. *Historia e shqiptarëve gjatë shek të XX*, vëllimi I. (Tiranë, Botimet albanologjike: 2017).

Butka, H. *Sali Butka në kujtimet e mia*, 95 (Kujtimet e Hysen Butkës janë botuar në ShBA).

Butka, S. *Ndjenja për atdhenë*. (Tiranë: Tirana & Times, 2016).

Butka, U. *100 vjet nga vetëqeverimi i Korçës*, “Kontributi i çetave të Sali Butkës për shpalljen dhe mbrojtjen e vetëqeverimit shqiptar të Korçës” (Korçë: Promo Print, 2016).

Çami, M. *Shqiptarë dhe francezët në Korçë*, (Tiranë: Dituria, 1999).

Duka, V. *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar–dhjetor 1914)*. Vëllimi II, (Tiranë: TOENA, 2012).

Dushku, L. *Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia*. (Tiranë: QSA, 2012).

Dushku, L. *Nga “armike” në “mike dhe burim qytetërimi”*: Dualizmi në perceptimin e shqiptarëve të Korçës për Francën (1913-1920). Studime Historike, Nr. 3-4, 2017.

G. R. *Berridge diplomacia Teoria dhe Praktika*, Tiranë: DIIS.

---

<sup>117</sup> N. Kotta, *Shqipëria dhe çështja e kufijve shqiptaro-grekë*, (Tiranë: Bota shqiptare, 2016), f. 50

<sup>118</sup> M. Çami, *Shqiptarë dhe francezët në Korçë*. f. 171. Letër e komandantit të armatës së lindjes, Gjenerali Sarrej, Ministrisë franceze të Luftës.

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

- Grameno, M. *“Antikat kombëtare”* (Tiranë: Naim Frashëri, 1994).
- Gurakuqi, R. *Shqipëria 1911-1914*, (Tiranë: UET/Press, 2012).
- Harizi, P. Dh. *Historia Kronografike e Korçës*, (Tiranë: Helga’s Secret).
- Katro, P. *Kush ishte Sali Butka*, (Tiranë: Helga’s Secret, 2020).
- Kotta, N. *Shqipëria dhe çështja e kufijve shqiptaro grekë*, (Tiranë: Bota shqiptare, 2016).
- Murrzaku, T. *Kur u caktuan kufijtë e Shqipërisë (1912-1914)*, (Tiranë: Kristalina, 2017).
- Nathanaili, P. *Marrëdhëniet ndërkombëtare nga orgjina deri më sot*. (Tiranë: ShBLU, 2006).
- Petraç, K. *Kush ishte Sali Butka*. (Tiranë: Helga’s Secret 2020).
- Puto, A. *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, (Tiranë: Albin, 2003).
- Qirjazi-Dako, S. *“Jeta ime”*, (Tiranë: Vernon Publishing, 2016).
- Tako, P. *Themistokli Gërmenji*, (Tiranë: 8 nëntori, 1998).
- Treska, Sotir Dh. *“Nisja e Zjarrit në Toskëri”*, Volumi I, 1917, Boston Mass SHBA.
- Uçi, A. *Petro Nini Luarasi (1865-1911)*, (Tiranë: ShBLU, 2011).
- Zeneli, P. *Masakra e Panaritit*, (Tiranë: DDS, 2004).

**KORÇA DHE SHQIPËRIA NË LIDHJEN E ALEANCAVE TË SHTETEVE  
TË RAJONIT  
NË PRAG TË LUFTËS SË PARË BALLKANIKE**

*Prof. dr. Enver BYTYÇI*

**Abstrakt**

*Lufta e Parë Ballkanike u parapri me lidhjen e aleancës së shteteve të rajonit: Serbi – Greqi, Greqi-Bullgari, Serbi – Bullgari dhe Serbi – Mali i Zi. U projektua si përballje me ushtrinë osmane dhe përfundoi si një luftë për ndarje terriroresh midis shteteve në aleancë. Marrëveshjet që u lidhën në pranverë dhe verën e vitit 1912 kishin për qëllim ndarjen e territorit të Shqipërisë dhe Maqedonisë midis shteteve ballkanike në aleancë.*

*Megjithatë në ato marrëveshje sekrete kishte mbivendosje në ndarjen e territoreve. Psh Serbia i premtoi ndarjen e Maqedonisë dy shteteve ballkanike, Greqisë e njëkohësisht Bullgarisë. Për këtë arsye këto marrëveshje u bënë midis Serbisë dhe secilit shtet ballkanik, veç e veç. Serbia për të tërhequr në anën e saj Bullgarinë, pranoi që Maqedonia të ndahej midis saj dhe shtetit bullgar. Ndërkohë që të njëjtin territor do ta ndante edhe me Greqinë. Ndaj dhe secilën prej këtyre marrëveshjeve e mbajti të fshehur, së paku pjesën e mirëkuptimit për ndarjen e territoreve.*

*Shqipëria ishte objektivi kryesor i plaçkës që do të përfitohej nga kjo aleancë. Territorret shqiptare u ndanë midis Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi. Aleanca serbo-greke e gushtit 1912 u bazua në të drejtën e secilit shtet për ndarjen e territorit të Shqipërisë në vijën ndarëse të lumit Shkumbin. Greqia realizonte pretendimet e saj territoriale në jug të vendit, përfshirë dhe Korçën. Ndërsa Shqipëria e Veriut, së bashku me Kosovën do të ishin pjesë e sovranitetit serb. Kësisoj Beogradi siguronte daljen në Detin Adriatik përmes Durrësit dhe Shëngjinit, një aspiratë e vazhdueshme kjo edhe për Rusinë cariste.*

*Greqia nga ana e saj u mobilizua në Luftën e Parë Ballkanike me qëllim zgjerimin e territoreve të saj me Korçën, Gjirokastrën, Beratin, Vlorën dhe Fierin. Por interesant është se Korça nuk u bë objektivi kryesor i politikës greke për aneksim. Madje më e lakmuar sesa Saranda dhe Gjirokastra. Kjo dëshmohet me përpjekjet greke për demarkimin e kufirit shqiptaro-grek në fund të vitit 1913 dhe fillim të atij 1914 dhe tentativat për ta përfshirë Korçën brenda territorit të Greqisë. Kjo, sepse fillesat e levizjes kombëtare shqiptare gjëndeshin në Korçë.*

**Fjalë kyçe:** *Korça, Shqipëria, Serbia, Greqia, Aleancë, Ballkan.*

## **Rrethanat historike**

Në fillimin e dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit XX Shqipëria nisi përpjekjet e saj për shtetformim. Korça ishte bërë tashmë epiqendra e përpjekjeve nacionaliste për t'i dhënë vendit shtetin e ri. Patriotët korçarë qenë ata që u dhanë shqiptarëve dritën e parë të dijes në gjuhën shqipe. Rilindasit tanë më tëshquar qenë nga Korça e Përmeti, ndaj dhe Korça u bë qendra e patriotizmit shqiptarë.

Sipas historianit amerikan, Edwin Jaques, Korça është treva e gjetjeve më të hershme arkeologjike të periudhës para, gjatë e post ilire. Megjithatë në prag të Luftërave Ballkanike e të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Korça dhe Shqipëria u vunë në rrezik për shkak të ambicjeve të fqinjëve veriorë dhe jugorë për territore. Greqia dhe Serbia kishin përpunuar prej kohësh platformat e tyre ideologjike për zgjerimin e territorit të shteteve të tyre. Në Serbi ishte hartuar ajo që quhej Naçertania, ndërsa në Greqi Megaliideja. Të dy këto dokumente politike, ideologjike, fetare dhe akademike shpallnin hapur pretendimet e tyre për zgjerimin e të dy vendeve në të gjithë territorin e Shqipërisë. Greqia në Jug, duke zhvendosur kufirin e saj në Shkumbin. Serbia në veri, duke patur fqinjë të saj Greqinë, sërishmi me kufi Shkumbinin.

Në planet serbe dhe greke asokohe nuk ekzistonte Shqipëria. Dhe duket qartë se në këto projekte Korça, edhe pse ishte së bashku me Shkodrën bërthama e nacionalizmit shqiptar dhe e civilizimit të tij, gjendej brenda projekteve greke, Ndërsa Shkodra brenda planeve serbe e malazeze. Por të dyja këto qytete tipikisht shqiptare në traditë, gjuhë, kulturë, zakone e bashkëjetesë fetare të ndryshme nga Serbia dhe Greqia, u pretenduan pikërisht nga këto vende fqinjë. Pretendimet dhe zgjerimet territoriale janë shkaku kryesor i konflikteve shumë të gjata midis shqiptarëve dhe politikave serbe e greke në Ballkan. Fatmirësisht Greqia ka ndryshuar prej disa dekadash politikat e saj zyrtare ndaj Shqipërisë, deri në atë pikë sa kryeministri grek, Kostas Simitis, përkrahu në mars të vitit 1999 bombardimet e NATO-s kundër Serbisë. Ky akt është edhe momenti i ndarjes përfundimtare serbo-greke kundër shqiptarëve.

Rrethanat gjeopolitike dhe zhvillimet në terrenin e luftërave dhe konflikteve këso kohe ishin në favor të fqinjëve tanë në jug dhe në veri të vendit. Perandoria Osmane prej dekadash ishte në krizë institucionale midis trashëgimisë osmane të Sulltanatit dhe krijimit të sistemit parlamentar. Kriza osmane nisi në fillimin e shekullit XIX dhe prej gati 100 vitesh vetëm se thellohej, duke shkaktuar rënien e pashmangshme të perandorisë. Në vitin 1908 u bënë zgjedhjet parlamentare. Kjo shkaktoi lindjen e faksioneve politike kundërshtare edhe me vetë Sulltanin. Ndërkaq korrupsioni dhe provokimet etnike ishin zgjeruar e thelluar. Porta e Lartë ishte në rënien e lirë të saj. Shqiptarët, megjithë kontributin e rilindasve, ende nuk kishin gjet gjuhën e përbashkët për ta përcaktuar ardhmërinë e shtetësisë dhe lirisë së tyre. Ata prej vitit 1876-1877 me krizën lindore turko-ruse, kuptuan se një armik tjetër i rrezikshëm i kërcënonte ata, tashmë në veri. Serbia asokohe shfrytëzoi rastin dhe dëboi nga trojet e tyre 200-300 mijë shqiptarë nga rajonet e Prekuples, Varnës dhe Nishit, si dhe masakroi me mijëra të tjerë. Ishte ky ballafaqimi i parë me politikën e shfaqrosjes dhe asgjësimit për shkaqe etnike që do të ndiqte Serbia kundër tyre. Ndërkohë që



Fuqitë e Mëdha të kësaj kohe mbanin anën e fqinjëve tanë, për shkak se ato u treguan më të vendosura në luftën e tyre për pavarësi e shtetësi. Greqia ishte pavarësuar nga Stambolli në vitin 1821 dhe Serbia e Mali i Zi u njohën si shtete të pavarura në Kongresin e Berlinit më 1878. Më vonë edhe Bullgaria fitoi pavarësinë. Mbeteshin vetëm shqiptarët, ata që në katër vilajetet e tyre (Shkodër, Kosovë (Shkup), Manastir e Janinë) ende nuk dinin se çfarë donin, autonomi nga Stambolli, apo pavarësi prej tij?!

Vonesa në organizimin politik dhe për kryengritje kundër Perandorisë Osmane ishte pasojë e “besnikërisë” së shqiptarëve ndaj kësaj perandorie dhe e besimit se nën Portën e Lartë mund të parandalohet copëtimi i territoreve shqiptare. Ndërkaq kjo bëri që Fuqitë e Mëdha të Europës, përveç Austro-Hungarisë dhe deri diku Gjermanisë, të merrnin anën e Greqisë (Anglia) dhe të Serbisë (Franca dhe Rusia). Parimi sipas të cilit kush popull reagon dhe kundërshton Perandorinë Osmane ishte përcaktues në përkrahjen që këto Fuqi do jepnin për popujt e Ballkanit.

### **Aleanca Ballkanike**

Greqia dhe Serbia shfaqën interes para Kongresit të Berlinit për një marrëveshje të përbashkët, me qëllim koordinimin e veprimeve midis tyre pas rënies së perandorisë. Përpjekjet e para për një marrëveshje midis Athinës dhe Beogradit qenë bërë në vitin 1861, kur kryeministri dhe ministër i Jashtëm i Serbisë, Ilija Garashanin, zhvilloi bisedime në Stamboll me përfaqësuesin e Greqisë pranë Portës së Lartë, Marco Konijeris. Garashanin ishte njëkohësisht autor i projektit të Serbisë së Madhe të vitit 1844, Naçertania”! Temë e bisedës midis dy autoriteteve greke e serbe ishte hartimi dhe nënshkrimi i një marrëveshjeje midis dy vendeve, me të cilën Serbia dhe Greqia të merreshin vesh për ndarjen e territoreve ballkanike pas rënies së Perandorisë Osmane.

Interesant është fakti se që prej kësaj kohe palët u morën vesh për të nxit shqiptarët në kryngritje kundër Perandorisë Osmane dhe Portës së Lartë, me qëllim që kjo perandori të dobësohej gjithnjë e më shumë dhe në finalen e agonisë së saj ato të përdornin forcën e tyre jo vetëm kundër Stambollit, por edhe kundër territoreve shqiptare. Marrëveshja parprake e arritur atë kohë në Stamboll parashikoi që vijat ndarëse të territorit midis Serbisë dhe Greqisë të ishin Durrësi, Elbasani, Ohri, Manastiri e deri në Prilep të Maqedonisë së Veriut. Ndërkaq sipas Megaliidesë, Greqia do të shtrihej në territore të gjera në Turqi, nga Stambolli deri në Izmir, si dhe në pjesën europiane të saj me qendër Edirnenë. Kurse Serbia do të merrte territoret e Bosnjë-Hercegovinës, Sanxhakut, një pjesë të Kroacisë Lindore, të Maqedonisë dhe madje edhe të Bullgarisë e Rumanisë.

George Castellan në monografinë e tij “Histori e Ballkanit” shkruan se bisedimet midis Greqisë dhe Serbisë për ndarjen midis tyre të territoreve ballkanike zgjatën disa vite. Derisa në gusht 1867 dhe shkurt 1868 u nënshkruan dy marrëveshjet përkatëse, me të cilat të dy vendet e shtetet e krijuara (Serbia ishte shtet autonom), detyroheshin që së bashku të luftonin kundër Perandorisë Osmane dhe u angazhuan se “nuk do të lejonin copëtimin e territoreve osmane në kontinentin European. Këto territore do ndaheshin kryesisht midis Serbisë dhe Greqisë, por pjesë të veçanta mund t’i jepeshin edhe Malit të Zi. Bullgaria, e cila kishte marrë tashmë statusin e

një principate, asokohe nuk ishte në planet greke e serbe. (Castellan)

Serbia dhe Greqia në planet e projektet e tyre për zgjerim terriitoresh nuk ishin shumë larg njëra-tjetrës. Në fund të fundit ato të dyja do të ndanin terriitore, të cilat nuk u përkisnin atyre. Por megjithatë zgjatja e bisedimeve ndodhi për shkak të ndarjes së terriitoreve të Maqedonisë, terriitore të cilat i pretenduan të dy palët. Pavarësisht këtyre marrëveshjeve, në terren asgjë nuk ndodhi, përveçse spastrimit etnik të shqiptarëve në rrethinat e Nishit dhe dhënies nga ana e Kongresit të Berlinit, Tivarit dhe disa terriitoreve të banuara me shqiptarë. Ishin krijuar edhe organizata paramilitare si në Maqedoni, edhe në Kosovë, krzesisht në Shkup.

Kaluan 44 vite, kur ky projekt serbo-grek u riaktivizua. Në prag të Luftërave Ballkanike, pra gjatë vitit 1912, nisën përpjekjet për të arritur në një marrëveshje të përbashkët të katër shteteve ballkanike, përkatësisht Serbisë, Greqisë, Bullgarisë dhe Malit të Zi, për mobilizim të përgjithshëm ushtarak kundër Perandorisë Osmane. E para marrëveshje ndër katër shtetet ballkanike u nënshkrua më 13 mars 1912 midis Serbisë dhe Bullgarisë. Kjo marrëveshje u negocua disa muaj. Palët nuk binin dakord, sidomos për ndarjen e terriitoreve të Maqedonisë. Si Serbia, edhe Bullgaria e dëshironin sovranitetin mbi këtë terriitor. Por për nënshkrimin e saj ndërhyri vetë Cari i Ruisë, Nikolla II, dhe me ndërmjetësimin e garancitë e tij dy kryeministrat, ai serb, Millanoviç, dhe ai bullgar, Geshov, e nënshkruan marrëveshjen e parë ballkanike të angazhimit të përbashkët kundër Perandorisë Osmane. Sipas marrëveshjes në fjalë, Serbisë i liheshin në zotërim terrioret mbi Malin e Sharrit. (Malcolm).

Por marrëveshja linte pezull disa çështje, për të cilat palët nuk u pajtuan. Mospajtimi u shfaq sidomos për terrioret nga Prilepi, në Manastir e Ohër, të cilat u prtenduan nga të dy shtetet. Por edhe për hapërsirën terriitoriale që përfshinte Shkupin dhe Kumanovën, e një pjesë të madhe të Kosovës Lindore. Cari i Risisë, Nikolla II i garantoj palët se pas luftës këto çështje do të zgjidheshin me drejtësi dhe atou pajtuan që zgjidhja të vinte nga Car Nikolla II. Vendimi i tij do të ishte i detyrueshëm për të dy palët. Vetëm pas kësaj marrëveshjeje Bullgaria nënshkroi marrëveshjen e saj me Greqinë dhe me Malin e Zi.

Karakteristike është se secili vend nënshkroi marrëveshje aleance me vendet e tjera. Pra kjo nuk ishte një aleancë e bazuar në një samit të përbashkët të katër vendeve aleate. Ndodhi kjo, pasi që marrëveshjet ishin të fshehta dhe në to pati mbivendosje interesash e rivendikimesh në ndarjen e terriitoreve ballkanike e sidomos atyre shqiptare e maqedone. Synimi ishte që këto shtete të bëheshin bashkë për t'i dhënë fund sundimit osman në terrioret europiane të perandorisë. Më pas do të ndërhynte Rusia për sheshimin e konflikteve. Mashtrimi qëndronte kryesisht në anën e Serbisë, sepse ajo në marrëveshjet e saj të fshehta ra dakord që të njëjtin terriitor që e aspironte vetë t'ia prentonte edhe Bullgarisë, edhe Greqisë. Madje pati të tilla premtime edhe për Malin e Zi, veçmas për Sanxhakun dhe Novi Pazarin. Ndërkohë që projektet serbe ishin krejt tjetër.

Më pas vijuan bisedimet midis Greqisë dhe Serbisë, me synimin që të dy këto vende të ripërtërinin marrëbveshjet e viteve 1867-1868. Por në kushtet e reja të zhvillimeve europiane dhe rajonale. Serbia i përsëriti Greqisë gatishmërinë e saj për t'iu

përmbajtur kushteve të marrëveshjeve të para 44 viteve, pra që ajo të bëhej pjesë e përfitimeve territoriale jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Maqedoni. Kjo do të ndodhte pasi që të dy vendet do të mobilizonin ushtritë e tyre kundër Perandorisë Osmane dhe kësaj pasi të kishin çliruar territorin europian të kësaj perandorie. Lidhja e përbashkët Serbi-Greqi u nënshkrua në fund të muajit gusht 1912. Ndërsa në fillim të shtatorit të atij viti u nënshkrua marrëveshja e aleancës me Malin e Zi.

Konkluzioni është se Lidhja Ballkanike e vitit 1912 ishte produkt i ndërhyrjes dhe presionit të Rusisë dhe të Carit Nikolla II mbi katër shtetet ortodokse, përkatësisht Serbia, Bullgaria, Greqia dhe Mali i Zi, tri prej të cilave të banuara e të formuara nga popuj sllavë. Por duhet thënë se Greqia u nxit të nënshkruajë marrëveshjen e kësaj aleance edhe nga ana e Britanisë së Madhe, e cila synoi që përmes Athinës të ruajë ndikimin dhe prezencën e saj në Ballkan.

Konkluzioni i dytë ka të bëjë me interesat e këtyre katër shteteve. Ndonëse ato e formuan Aleancën Ballkanike për të luftuar kundër Perandorisë Osmane dhe çlirimin e territoreve që ajo sundonte në Rumeli, në fakt, të katër shtetet aleate synuan pushtimin dhe ndarjen e territoreve shqiptare në katër vilajetet e lartpërmendura, si dhe territore të tjera të Thrakës, Maqedonisë dhe Sanxhakut. Bosnjë-Hercegovina në këtë kohë ishte shpallur protektorat i Perandorisë Austro-Hungareze dhe për momentin nuk bënte pjesë në projektet e marrëveshjeve në kuadër të krijimit të kësaj aleance. Më së shumti pasojat e kësaj aleance dhe mobilizimit ushtarak të këtyre katër shteteve do t'i vuanin shqiptarët, sidomos ata të Kosovës, përfshirë Shkupin, Kumanovën dhe qytete të tjera, të cilat sot janë pjesë e Maqedonisë së Veriut.

### **Lufta e Parë Ballkanike**

Lufta e parë Ballkanike filloi më fillim të tetorit 1912. Mali i Zi ishte vendi i parë që i shpalli luftë Turqisë, duke i kërkuar lirinë e Shkodrës dhe aneksimin e saj. Më pas shpallën luftë kundër Turqisë edhe Serbia, Bullgaria dhe Greqia. Rumania ishte i vetmi vend neutral në këtë fazë të kësaj lufte. Sipas Noel Malcolm (Kosova Histori e Shkurtër), Serbia u ankua se “Ushtria osmane po mobilizohej”, edhe pse ishte e kundërta. Nuk kishte asnjë mobilizim ushtarak të osmanëve. Me 13 tetor Serbia, Bullgaria dhe Greqia i dorëzuan një ultimatum Perandorisë Osmane. Me këtë memorandum ato i kërkuan autonomi të përhershme territoreve europiane të banuara nga të krishterë. Pas kësaj, serbët, bullgarët dhe grekët mobilizuan rreth 550 mijë forca ushtarake. Numrin më të madh e pati Serbia e më pas Bullgaria. Bullgaria zhvilloi dhe pati sukses në më shumë beteja kundër ushtrisë osmane. Ndërsa serbët mobilizuan armatën e tretë të tyre dhe nisën pushtimin e Kosovës. Më 22 tetor (1912) ata mundën të hyjnë në Prishtinë, pasi kaluan nga Anamorava, ku Isa Boletini dhe Idriz Sefero rezistuan, por nuk mundën t'i pengojnë ushtritë serbe kundër Kosovës dhe Shqipërisë.

Më 3 nëntor 1912 Prizreni u dorëzua pa rezistencë. Ndërsa Peja kishte rënë në duart e malazezëve. Ushtria serbe marshoi më pas drejt Shqipërisë së Veriut me pikësynim të dilte në Durrës dhe të garantonte daljen e saj në Detin Adriatik. Gjatë marshimit të saj ajo hasi në rezistencën e Lumës. Në mesin e muajit nëntor të atij viti në këtë trevë u zhvillua Beteja e Lumës, ku u vranë ose u mbytën në lumejtë e rrëmbyeshëm,

Drini i Zi, Drini i Bardhë, Luma e Sheja mijëra ushtarë serbë. Në këtë betejë qenë mobilizuar qindra e mijëra lumjanë, hasjanë, banorë të zonës së Shëmrisë dhe dibranë. Elez Isufi me ushtrinë e tij kishte mbërritur në Kolesjan të Lumës. Betejën e komanduan udhëheqës të shquar të kohës në krahinat përkatëse, Islam Spahia, Ramadan Zaskoci e të tjerë patriotë të mëdhenj.

Krahas territorit të Kosovës së sotme, ushtria serbe pushtoi edhe territoret shqiptare në Maqedoni. Dhe në fund të nëntorit mbërriti në Durrës. Gjatë këtij inkursioni ajo shfaqti karakterin e saj mizor. Bëri masakra të padëgjua në mesin e shqiptarëve. Dëshmitarët dhe kronikanët e kohës i përshkruajnë ato maakra me saktësi dhe dëshmojnë tmerret e kësaj lufte kundër shqiptarëve. Në veçanti këto mizori i përshkruajnë kronikani dhe gazetari austriak, Aleksandër Leo Freundlich dhe Lev Bronstajni, i njohur si Leon Trocki, më vonë një nga udhëheqësit kryesorë të revolucionit bolshevik të vitit 1917. Por kundër atyre masakrave reagoan me kritika të ashpra edhe politikanë serbë të së majtës, si socialdemokrati Tucoviç. Ndërkohë gazeta të ndryshme europiane dhe sidomos amerikane i përshkruan ngjarjet dhe masakrat serbe kundër shqiptarëve si akte terrori.

Arqipeshkvi katolik i Shkupit, Lazër Mjeda, gjithashtu ka dokumentuar masakrat serbe në këto rajone. Ai ka shkruar raporte të shumta për Vatikanin, në të cilat jep dëshmi të pakundërshtueshme. Por punimi i Freundlich “Golgata Shqiptare” e botuar për herë të parë në Vjenë të Gjermanisë në vitin 1913, përmbledh dokumentacion të pakontestueshëm e të shumanshëm të ngjarjeve të viteve 1912-1913 në Kosovë, në Shqipërinë e Veriut dhe përshkruan në detaje masakrat serbë të Luftës së Parë Ballkanike kundër shqiptarëve. Në një farë mënyre ai i kundërvihet pikëpamjeve dhe elaborimeve të ish-kryeministrit të Serbisë, Vladan Gjergjeviç, i cili në të njëjtën periudhë kishte shkruar librin e tij racist “Shqiptarët dhe Fuqitë e Mëdha”, ku i paraqet shqiptarë si “njerëz me bisht” e “lëkurëkuqtë e Europës”, duke i fyer ata në identitetin europian të tyre.

Freundlich që në fillim të veprës së tij shkruan se “Në lindje të bregdetit Adriatik, pothuajse tri ditë udhëtimi larg Vjenës, jeton një popull autokton, i cili gjatë shekujve ka luftuar për lirinë dhe pavarësinë e tij – Shqiptarët. Në të vërtetë në përmbysken e madhe, e cila ndodhi në fillim të luftës ballkanike, duhej që ëndërra e këtij populli për liri e pavarësi të bëhej realitet. Por pushtuesit serbë kanë gjetur një metodë për ta shkatërruar dëshirën për liri të këtij populli, pak para realizimit të saj. – Me vrasje dhe zjarr janë shfaqur trupat e ushtrisë serbe në Shqipëri”. Më pas Leo Freundlich shkruan se dëshmitarët okularë do të shihnin në praktikë vrasjen masive të shqiptarëve dhe dënimin kolektiv të tyre me asgjësim fizik e djegjen e pamëshirshme të shtëpive dhe pasurive të tyre nga ana e ushtrisë së mbretit (serb) hipokrit. Këtë praktikë vrasjesh Aleksandër Leo Freundlich e përshkruan me hollësi, duke përshkruar masakrimin e mijërave shqiptarëve, burra, gra, pleq e fëmijë, si dhe djegjen e shtëpive dhe shkatërrimin masiv të fshatrave të banuara me shqiptarë. Ai shkruan se fshatra të panumërta shqiptarësh janë bërë rrafsh me tokën, se njerëz pa numërim theren dhe masakrohen si kafshët, dhe se “një popull i tërë gjakoset i kryqëzuar dhe Europa hesht”. (Ein ganzes Volk blutet am Kreuz – und Europa schweigt). Në përfundim Freundlich konkludon se në ato masakra gjetën vdekjen së

paku 25 mijë shqiptarë.

Këto të vërteta i paqsyron edhe Aleksandër Leon Trocki në kronikat e veta dhe i denoncon kreu i socialdemokratëve të Serbisë, Tucoviç. Ndërkohë që mediet perendimore pasqyrojnë jo pak kronika me vërtetësi dhe objektivitet për atë se çfarë po bënte ushria serbe kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, në territoret e sotme të Maqedonisë dhe Shqipërisë së Veriut, bazuar në marrëveshjen greko-serbe të zotërimit të territoreve shqiptare. P.sh korespondenti Pickhall i gazetës Neu Jork Times” i cili ishte gjithashtu dëshmitar e kronikan në këto ngjarje, shkruan se “Serbët kërkojnë zhdukjen e shqiptarëve. Sepse ata kanë qenë gjer më sot ndalim i përparimit serb në të vetëquajturën “Stara Serbi” (Kosovë). Dhe më poshtë: “Masakrat që bëjnë serbët në Kosovë nën kryqin e krishterë kapërcejnë cdo instikt gjakpirësie”! Një gjeneral francez shkruante gjithashtunë ditarin e tij se “Në masivin shqiptar masakrat e shumta që gjakosën këtë rajon e reduktuan popullsinë në përpjestime të forta. Shumë fshatra u shkatërruan dhe tokat kanë mbetur djerrë”!

Ka shumë dokumente dhe fakte me të cilat përshkruhen masakrat dhe përpjekjet e Serbië për eliminimin dhe asgjësimin e elementit shqiptar në atë kohë, politikë që ka vazhduar së paku deri në vitin 1999 dhe vijon edhe sot si doktrinë. Qëllimi ishte që të parandalohej krijimi i shtetit shqiptar. Nikolla Pashiq, asokohe kryeministër i Serbisë, i shkruante konsullit të tij në Petersburg dhe e këshillonte që t’i thoshte Carit të Rusisë, Nikolla II, që Rusia të bënte gjithçka të pengonte krijimin e një shteti shqiptar. Nëse kjo do të ishte e pumundur, Pashiq kërkonte që ky shtet shqiptar të ishte sa më i vogël, mundësisht në kufijtë nga Shkumbini deri në Mat. Arsyetimi i Pashiq ishte gjithashtu interesant: “Sa më i vogël një shtet shqiptar, aq më shumë do të ketë nevojë për mbikëqyerjen e Serbisë dhe do të varej prej saj”! Ndaj dhe ato që ndodhën në fillimet shtetit komunist shqiptar (1944-1948) dhe këto që ndodhin në marrëdhëniet miqësore Tiranë-Beograd në dhjetë vitet e fundit, nuk janë rastësi. Janë projekt serb i fillimit të shekullit XX.

### **Korça në sfondin e zhvillimeve të fillimshekullit XX**

Korça është vendlindja e letërsisë shqiptare dhe ajo shpesh konsiderohet si qendra e kulturës së shqiptarëve. Madje kultura e Korçës është unike, ashtu si edhe ajo e Shkodrës. Ndërsa Shkodra krahas kulturës dhe arkitekturës osmane mbart edhe ato veneciane dhe austro-hungareze, Korça hijeshohet me kulturën dhe arkitekturën franceze dhe osmane. Kjo lloj kulture është e gërshetuar sipas zhvillimeve kohore. Psh në Korçë më shumë se në qytete të tjera vihet re periudha bizantine e kishave dhe ajo osmane e xhamive. Kësisoj përmes kulturës së Korçës na përçohet në breza kultura dhe historia shqiptare.

Sipas historianit amerikan Edwin Jaques në trevën e Korçës gjenden dëshmitë më të vjetra të historisë dhe kulturës shqiptare, të asocuara jo vetëm me periudhën ilire, por edhe me atë parailire. Objektet arkeologjike të gjendura në trevat e Korçës deri në Pogradec e Lin i përkasin kohës së bronxit e të hekurit. Megjithatë emri i këtij qyteti përmendet për herë të parë në kohën e mesjetës rreth vitit 1280, thuajse në të njëjtën kohë kur përmendet edhe Voskopoja. Por Korça, si shumë qytete të tjera kishte kaluar nëpër tragjedi luftërash dhe fatkeqësish, për t’u rikthyer në shekullin e 15-të. Që prej kësaj kohe ajo u bë qendër e rëndësishme tregtare dhe administrative

e njëkohësisht kulturore e arsimore. Fillimisht nga viti 1723 në Korçë u hapën shkolla në gjuhën greke.

Megjithatë gjatë shekullit XIX dhe XX qyteti i Korçës u bë qendra kryesore e Lëvizjes Kombëtare të shqiptarëve. Në Korçë u hap e para shkollë laike në gjuhën shqipe më 7 mars 1887, në të cilën filluan mësimet nxënës të të dy besimeve. Po në Korçë u hap e para shkollë shqipe për vajzat shqiptare. Shumë prej personaliteteve të shquara të Rilindjes e patën origjinën e tyre nga Korçë. Dy mësuesit e shkollës së parë laike në gjuhën shqipe, përkatësisht Petro Nini Luarasi dhe Pandeli Sotiri, u flijuan për arsimin shqip dhe mbetën ikonat e lëvizjes kombëtare shqiptare për arsim e dituri, për idetë dhe ringjalljen kombëtare të shqiptarëve.

Në këto rrethana Korça erdhi në fillimin e shekullit XX si një trevë e parapërgatitur për t'i bërë ballë rreziqeve dhe zhvillimeve të vullshme të kësaj kohe. Aleanca e krijuar ballkanike e shihte Korçën si pjesë të pretendimeve territoriale të Greqisë në territorin e Shqipërisë. Por qyteti ishte i përgatitur më mirë se trevat e tjera të jugut të Shqipërisë për këtë situatë. Në vitin 1906 qytetarët e Korçës kishin luftuar për t'u çliruar nga bandat grabitëse të andartëve grekë, si dhe nga trupat pushtuese osmane. Ndërsa në vitin 1907 në Korçë u ekzekutua një prift grek ortodoks. Kësisoj Luftërat Ballkanike nuk e gjetën Korçën në të njëjtën situatë si edhe qytete të tjera të Shqipërisë në Jug apo në Veri të vendit. Vërtet ajo u pushtua gjatë kësaj periudhe nga ushtritë greke, por vetëdija kombëtare e korçarëve nuk do ta pranonte këtë pushtim. Fillimisht shumë korçarë u larguan nga vendlindja në drejtim të Amerikës. Por pas një ose dy vitesh Korça u gjend me vetëdije në situatën e Luftës së Parë Botërore e nën pushtimin francez.

Eshtë interesant fakti se ndonëse Franca nuk njihej për një Fuqi Europiane miqësore me shqiptarët e me Shqipërinë, përfaqësuesit e saj në Korçë, civilë dhe ushtarakë, mbajtën qëndrime pro vullnetit të korçarëve për të mos iu bashkuar në asnjë rrethanë territorit dhe sovranitetit të Greqisë, një pretendim ky i kahmotshtëm në kuadër të propagandës vorioepirote. Ishin patriotët korçarë ata që e mbrojtën qytetin dhe rrethinat e tij nga planet greke të aneksimit të saj. Ndërsa Gjirokastra, Saranda e Përmeti u ndjenë seriozisht të kërcënuar nga projektet greke të Vorioepirit, Korça ishte më e sigurt dhe ndihej më e mbrojtur. Kjo energji vinte nga vetë fryma kombëtare që ishte zhvilluar në këtë qytet.

Por për ta provuar këtë realitet po i përmbahem vetëm një momenti - Procesit të verifikimit të kufijve nga Komisioni Ndërkombëtar i ngritur prej gjashtë Fuqive të Mëdha Europiane në Konferencën e Londrës. Historia e caktimit të kufijve midis Shqipërisë dhe Greqisë është e dëshmuar në proceverbalet e Komisionit Ndërkombëtar. Duke iu referuar këtyre procesverbaleve, të sjella në një libër të Tahir Kolgjinit, ne mund të shohim se sa jetike ishte për banorët e Korçës, Kolonjës dhe fshatrave të këtyre dy zonave të identifikoheshin si shqiptarë dhe jo si grekë.

Komisioni provoi se banorët e Korçës dhe Kolonjës kishin vetëdije, gjuhë dhe kulturë shqiptare dhe se ata ishin krenarë për identitetin si shqiptarë. Në procesverbal shkruhet: “Komisioni shkoi në fshatin Prodan, me një popullsi të përzer. Në këtë fshat, sipas të dhënave, ka 50 muslimanë dhe 180 të krishterë. Bërja e kësaj vizite ishte vulosur në fshhehtësi të madhe. Megjithatë në krye të fshatit takojmë dy burra

të armatosur. Ata propozojnë që ta shoqërojnë komisionin në drejtim të fshatit. Por Komisioni hyri në shtëpinë që kishte treguar delegati italian. Në këtë shtëpi ndodheshin katër gra dhe tre fëmijë rreth gjashtë vjeç. U pyetën vazhdimisht disa herë dhe u kuptua se ata nuk dinin greqisht. Njëra nga këto gra deklaroi haptazi se ato nuk e kuptonin fare këtë gjuhë dhe se ato së bashku me fëmijët flisnin vetëm shqip.

Delegati rus (sigurisht për të provuar të kundërtën shën im) tregon një shtëpi, në pragun e së cilës ishin ulur dy gra të krishtera. U pyetën dhe këto gra dhe u kuptua së fundmi se edhe ato gra nuk dinin asnjë fjalë greqisht. Delegati gjerman tregon një shtëpi tjetër. Por Komisioni konstaton se dera e kësaj shtëpie ishte e mbyllur. Dyert e mbyllura i mbanin edhe disa shtëpi të tjera. Një nënoficer grek, i cili mbante me vete edhe disa ushtarë të armatosur thotë: “Gratë kanë frikë të dalin, sepse në kohën e pushtimit turk muslimanët duke hyrë në shtëpi kanë bërë të këqija nga më të mdryshmet.

Procesverbali i i Komisionit e përshkruan me realizëm edhe gjendjen në fshatin Borovë. “Borova ishte fshat i përzier. Fshati ka 35 muslimanë dhe 910 të krishterë. Në hyrje të fshatit u panë mjaft të krishterë të armatosur (Armata e Shenjtë). Ata, për të arritur në fshat më përpara se Komisioni, po vraponin. Njëri nga këta u njoh me anëtarët e Komisionit, sepse ai kishte qenë edhe në fshatin Prodan. Ai po pretendonte se ishte nga Borova. Kur Komisioni po hynte në fshat, iu afruan dy veta, njëri nga të cilët ishte i armatosur dhe propozuan që për të hyrë në fshat të shkonim pas tyre. Delegati gjerman, duke parë se një grua e moshuar e krishterë hyri në një shtëpi, tregoi atë shtëpi. Sapo Komisioni hyri në oborrin e kësaj shtëpie gruaja në fjalë së bashku me një grua tjetër hynë brenda dhe u zhdukën.

Më vonë vjen një burrë që mesa kuptohej nuk kishte asnjë lidhje me këtë shtëpi dhe plot emocion pyet: - Me ç’ të drejtë kërkohet të hyhet në këtë shtëpi?! Edhe njerëz të tjerë, dikush me armë e dikush pa armë, nuk lejojnë të hyjmë në këtë shtëpi. Ata kërkonin që Komisioni të dilte nga oborri i shtëpisë, duke bërë titur e fyer sa mundnin e duke përplasur kondakët e pushkëve në tokë. Kur po largohej Komisioni nga fshati sheh se ka përpara një grumbull njerëzish me flamurin grek në krye. Duke marrë mes tyre një fshatar të ri dhe një fshatare të re, Komisioni fillon t’i pyesë ata. Ata u përkisnin familjeve të veçanta dhe që të dy ishin nga fshati Borovë. U kuptua se i riu fshatar e fliste shqipen shumë në rregull, kurse greqishten e fliste keq. Fshatarja e re fliste vetëm shqip dhe nuk ishte në gjendje t’u jepte përgjigje në greqisht as pyetjeve më të thjeshta. Bile as që i kuptonte pyetjet që ia drejtuan”. (Kolgjini)

Procesverbali i Komisionit të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë me Greqinë dëshmon se e njëjta situatë u konstatua edhe në fshatra të tjerë, si në Qafëzëz, Shtikë, Gostivisht, Vidicë etj. Dhe ky procesverbal është dhe mbetet një dokument autentik i identitetit të Korçës, Kolonjës, korçarëve dhe kolonjarëve. Duhet theksuar se Komisioni ishte udhëzuar që kriter të përcaktimit të kufijve midis Shqipërisë dhe Greqisë të ishte përdorimi i gjuhës. Ndaj dhe ata provuan se në këto zona flitej gjuha shqipe. Me këtë kriter u mënjanau kërkesa e palës greke që për të përcaktuar kufijtë midis dy vendeve do të duhej që kriter të ishte përkatësia fetare ortodokse.

Prej kësaj kohe e deri në ditët e sotme Korça ka mbajtur peshën e një qyteti me

kontribute të jashtëzakonshme për shtetformimin dhe shtetndërtimin e Shqipërisë. Ajo i ka dhënë Shqipërisë jo vetëm personalitetet e para të Rilindjes Kombëtare Shqiptare si Naim Vegjilharxhi e Kostandin Kristoforidhi, por edhe figura të tjera të shqupara të mëvonshme pas shpalljes së pavarësisë si artistë, krijues, politikanë, të gjithë me frymë kombëtare dhe të përkushtuar për vendin e kombin.

Si përfundim mund të thuhet se periudha e fillimit të shekullit XX konsiderohet si ndër periudhat më intensive të zhvillimeve shqiptare në përpjekjet për shtetndërtimin. Ndërkohë edhe si goditja më e madhe për ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. Kjo falë pamundësisë për t’u organizuar dhe rezistuar ndaj fqinjëve, por edhe falë aleancës së shteteve ballkanike kundër Shqipërisë dhe shqiptarëve.

### **Bibliografia:**

1. Noel Malcolm: Kosova një Histori e Shkurtër. KOHA, Prishtinë – 2001.
2. Enver Bytyçi: Shqiptarët, Serbët dhe Grekët. KOHA, Tiranë – 2005.
3. Oliver Jens Schmitt: Ballkani në Shekullin XX – Një Histori Post-Imperiale. Botimet Artini, Prishtinë 2021.
4. Konrad Clewing, Oliver Jens Schmitt (Hg): Geschichte Suedosteuropas – Vom fruehen Mittelalter bis zur Gegenwart. Verlag Fridrich Pustet, Regensburg 2011
5. Georges Castellan: Histori e Ballkanit, Botimet MÇM, Tiranë 1991.
6. Robert Elsie: Fjalori Historik i Shqipërisë. EUGEN, Tiranë 2011.
7. Stavro Skendi: The Albanian national awakening, 1878–1912. Princeton University Press, 1967, S. 17 (online).
8. The History of Fan S. Noli University. In: Universiteti “Fan S. Noli”. Archiviert vom Original (nicht mehr online verfügbar) am 8. Dezember 2015; abgerufen am 1. Dezember 2015 (englisch).
9. Enver Bytyçi: E drejta e vetëvendosjes: Rasti i Kosovës. Koha, Tiranë 2007.
10. Aleksander Leo Freundlich; ”Albaniens Golgatha – Angeklagten gegen die Vernichter des Albanervolkes”, Vien 1913.
11. Wegweiser zur Geschichte – Kosovo. Herausgegeben vom Militaergeschitlichen Forschungsamt. Ferdinand Shoeningh Verlag Paderbon, Muenchen, Vien, Zuerich, 2006.
12. Richard C. Hall: The Balkan Wars 1912–1913. Prelude to the First World War. Routledge: London/New York (NY) 2000.
13. Edward C. Thaden: Russia and the Balkan Alliance of 1912. Pennsylvania State University Press: University Park (PA) 1965.
14. Wladimir P. Potjomkin (Hrsg.): Geschichte der Diplomatie. Band 2, Berlin 1948,.
15. Katrin Boeckh: Von den Balkankriegen zum Ersten Weltkrieg. Kleinstaatenpolitik und ethnische Selbstbestimmung auf dem Balkan. Verlag Oldenbourg, München 1996,
16. Stavro Skendi: The Albanian national aëakening, 1878–1912. Princeton University Press, 1967, S. 17 (online).
17. The History of Fan S. Noli University. In: Universiteti “Fan S. Noli”. Archiviert vom Original (nicht mehr online verfügbar) am 8. Dezember 2015; abgerufen am 1. Dezember 2015 (englisch).
18. Tahir Kolgjini: Të vërtetat shqiptaro-greke (“Albanian-Greek Realities”), originally published as Arnavutluk ve Yuninistan Gerçekleri in Turkish, Istanbul, 1968



**TERRITORI I POGRADECIT  
GJATË ADMINISTRIMIT FRANCEZ 1917-1920**

*Msc. Ledjan ZEQOLLARI*  
*zeqollariledjan@gmail.com*

**Abstrakt**

*Gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) territori i Shqipërisë u kthye në arenë luftimesh midis ushtrive të Antantës dhe Bllokut Tripalësh. Ndarja e Shqipërisë në territore të pushtuara nga ushtritë e huaja, nxirrte gjithnjë e me shumë në pah pretendimet territoriale të shteteve fqinje ndaj tokave shqiptare. Në situatën e krijuar, trupat greke pushtuan qytetin e Korçës dhe në të u vendos administrata venizelliste. Në tetor të vitit 1916 koloneli Decoins, me urdhrin e gjeneralit Sarrail, pushtoi qytetin e Korçës duke larguar trupat greke. Vendosja e ushtrisë franceze në Korçë bëri që krerët shqiptarë t’u kërkonin autoriteteve ushtarake franceze autonominë territoriale. Më 10 dhjetor të vitit 1916 u shpall Republika Autonome e Korçës.*

*Në Pogradec fillimisht u vendosen trupat serbe, më pas ato bullgare dhe austriake. Nga ana tjetër, territori i Pogradecit kërkohej gjithnjë e më shumë nga francezët të përfshihej brenda Krahinës Autonome të Korçës. Në 10 shtator 1917 trupat franceze u futën në Pogradec. Sipas Protokollit të Republikës Autonome të Korçës, ky territor administrohej nga një komandant i postkomandës franceze. Në Pogradec u caktua majori August Mortier, i cili kryente funksionin e komandantit të Qarkut. Gjatë administrimit francez u bënë përpjeke të mëdha për zhvillimin e arsimit dhe kulturës. Në këto vite në Pogradec u krijuan shoqëritë e para kulturore, arsimore edhe sportive. Kjo u arrit falë përpjekjeve të patriotëve shqiptarë me mbështetjen dhe kujdesin e autoriteteve franceze.*

*Në prill të vitit 1920 qeveria e Sulejman Delvinës u kërkoj autoriteteve franceze që Pogradeci t’i bashkohej qeverisë së Tiranës. Më 22 qershor të vitit 1920 detyra e administrimit francez në Pogradeci përfundoi. Duke lënë kështu një numër të madh shkollash shqipe të hapura, si dhe administratën me punonjës shqiptarë të përkushtuar të cilët dhanë kontribut të vyer në fusha të ndryshme të shoqërisë.*

**Fjalët kyçe:** *Administrimi francez, August Mortier, Republika Autonome e Korçës , territori i Pogradecit, trupi gjimnastikor*

## **POGRADEC TERRITORY DURING THE FRENCH ADMINISTRATION 1917 to 1920**

### **Abstract**

*During the First World War (1914-1918), the territory of Albania turned into an arena of fighting between the armies of the Antanta and the Tripartite Block. The division of Albania into territories occupied by foreign armies, increasingly highlighted the territorial claims of the neighboring states to the Albanian lands. In such a situation, Greek troops occupied the city of Korça and Venizelist administration was established there. On October 1916, Colonel Decoins, ordered by General Sarraill, occupied the city of Korça, thus, removing the Greek troops. The deployment of the French army in Korça led the Albanian leaders to request the French military authorities to grant them the territorial autonomy. On December 10, 1916, the Autonomous Republic of Korça was proclaimed.*

*Initially, Serbian troops were stationed in Pogradec, followed by Bulgarian and Austrian ones.*

*On the other hand, the territory of Pogradec was all the more requested by the French to be included within the Autonomous Province of Korça. On September 10, 1917, French troops entered Pogradec. According to the Protocol of the Autonomous Republic of Korça, this territory was administered by a commander of the French post-command. Major August Mortier was assigned to Pogradec. He performed the function of the District commander. During the French administration, great efforts were made to develop education and culture. During these years, the first cultural, educational and sports associations were created in Pogradec. This was achieved thanks to the efforts made by the Albanian patriots supported by and the care shown by the French authorities.*

*On April 1920, the government of Sulejman Delvina asked the French authorities that Pogradec become part of the government of Tirana. On June 22, 1920, the task of the French administration in Pogradec was completed, thus, leaving behind a large number of open Albanian schools, as well as the administration made up of dedicated Albanian employees who gave valuable contributions in various fields of society.*

### **1. Republika Autonome e Korçës**

Gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918) territori i Shqipërisë ishte kthyer në arenë luftimesh midis ushtrive të Antantës dhe Bllokut Tripalësh. Ndarja e Shqipërisë në territore të pushtuara nga ushtritë e huaja, nxirrte gjithnjë e me shumë në pah pretendimet territoriale të shteteve fqinje ndaj tokave shqiptare. Në situatën e krijuar, trupat greke pushtuan qytetin e Korçës dhe në të u vendos administrata venizelliste. Ushtria austro-hungareze dhe aleatët e tyre bullgarë mbanin të pushtuar Pogradecin dhe rrethinat.

Në tetor të vitit 1916 koloneli Decoins, me urdhrin e gjeneralit Sarraill, pushtoi qytetin e Korçës duke larguar trupat greke. Vendosja e ushtrisë franceze në Korçë bëri që krerët shqiptarë t’u kërkonin autoriteteve ushtarake franceze autonominë territoriale. Më 10 dhjetor të vitit 1916 u shpall Republika Autonome e Korçës. Qëllimi i krijimit të saj ishte sa politik aq edhe strategjik, pasi krijonte siguri në prapavijën e frontit. Përveçse sigurisë, ky rajon ishte nyje e rëndësishme ku

kryqëzoheshin rrugët kryesore me Follorinën, Janinën, Kosturin, por edhe me pjesën jugore të Shqipërisë. Gjithashtu krijonte hendek midis Greqisë dhe ushtrive të Bllokut Tripalësh si dhe vendoste lidhjet midis frontit italian në Shqipëri dhe frontit francez në Maqedoni.

Krijimi i Republikës Autonome të Korçës vendosi stabilitet në qeverisje midis palës shqiptare dhe asaj franceze. U ngrit administrata franko-shqiptare me dakordësinë e të gjithë krerëve shqiptarë. U krijua Këshilli Administrativ në të cilin u ruajt barazpesha e përfaqësuesve sipas besimeve fetare. Në të bënin pjesë anëtarë të besimit ortodoks dhe mysliman: Vasil Singelo, Vasil Kondi, Koço Noçka, Rafail Avrami, Nikollaq Evangjeli, Thimaq Cali, Llambro Mborja, Sali Babani, Emin Rakipi, Shaqir Shabani, Hysen Dishnica, Haki Shemshedini, Qani Dishnica, Tefik Rushiti.<sup>1</sup>

Për sa i përket mënyrës së administrimit, territori i Republikës Autonome u nda në krahina. Në krye qëndronte komandanti cili kishte selinë në Korçë dhe drejtonte me një administratë qendrore të vogël. Në çdo krahinë u vendosën administratorët të cilët ruanin autonomi vendore në qeverisje. Ata urdhëronin drejtuesit e shërbimeve dhe kishin buxhetin e vet. Administratori i territorit ndihmohej nga Këshilli i Administrimit si dhe nga drejtorët e emëruar prej tij: për financat, arsimin, policinë, nozullimin, punët botore, ndihmën shoqërore etj. Zëvendësit për postat, pyjet dhe doganat vareshin nga Drejtoria e Financave. Drejtorët e shërbimeve ishin ose francezë ose civilë shqiptarë. Për ruajtjen e rendit dhe qetësisë, u ngrit gjykata. Në krye të saj ishte kryetari dhe më pas vinte prokurori, kryesekretari, shkronjësit etj. U krijua xhandarmëria policore si dhe një xhandarmëri e lëvizshme që kontrollonte kufirin e krahinës. Xhandarmëria e lëvizshme përbëhej kryesisht nga trupa shqiptare të cilët drejtoheshin nga oficerët francezë. Ajo pati efektivitet për sa i përket ruajtjes, kontrollit të kufirit dhe integritetit territorial të Krahinës Autonome. Më vonë u quajt “Batalioni i gjuajtësve shqiptarë” i cili, nën komandën e kolonelit Andre Ordionit, u angazhua në mësymjet e kryera në pranverën e vitit 1918.<sup>2</sup>

## **2. Francezët në Pogradec**

Në Pogradec fillimisht u vendosen trupat serbe, më pas ato bullgare dhe austriake. Nga ana tjetër, territori i Pogradecit synohej nga francezët të përfshihej brenda Krahinës Autonome të Korçës. Kjo për arsyen se ishte një territor me popullsi tërësisht shqiptare, sigurohej kontrolli i rrugëve që e lidhnin me pjesën tjetër të frontit në Maqedoni si dhe kishte mjaft resurse natyrore. Kështu, në fillim të shtatorit të vitit 1917, ushtria franceze filloi mësymjen në zonën e Pogradecit. Pas disa ditë luftimesh, më 10 shtator 1917, ushtria franceze u fut në Pogradec.

Data e hyrjes së trupave franceze në Pogradec përmendet edhe në buletin "Le Burnous" nga "Shoqata Miqësore dhe Filantropike e ish-Spahinjve". Në të raportohet se Regjimenti i Spahinjve Marokenë, pas marrjes së Pogradecit (10 shtator 1917), organizoi pozicionet në rajonin malor, në perëndim të liqenit të Ohrit, ku kreu ofensiva të ndryshme zbuluese.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Kolovani, Dhimitër. 1919. *La Question De Koritza*. Paris.

<sup>2</sup> Ordioni, Andre. 2014. *Një Oficer Në Ballkan*. Papyrus.

<sup>3</sup> Biblioteka Digjitale “Gallica”, “Le Burnos”, 1924. Francë.




Fig.1. Marshimi i përgjithshëm i kolonave ushtarake franceze drejt Pogradecit, 7-11 shtator 1917.<sup>4</sup>

Ndërsa në telegramin e gjeneralit Sarrail, dërguar Ministrisë së Luftës në Francë më 12 shtator 1917, njoftohej marrja e Pogradecit nga francezët duke përkuruar me datën 10 shtator. Gjenerali Sarrail raportonte nga Selaniku se ushtria franceze pak ditë më parë, kishte kapur lartësitë që rrethonin Pogradecin deri në 8 km. Në të njëjtën kohë detashmentet kishin mësyre dhe ishin futur në Pogradec, duke pastruar afërsitë përreth ku armiku kishte vendosur bateritë e zjarrit.<sup>5</sup>

Pasi trupat franceze u vendosën në Pogradec, nën ndikimin e ushtrisë austriake dhe bullgare mbeti zona e Mokrës. Vija e frontit u zhvendos në pozicionet e tërhequra në fshatrat Losnik, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Rrodokal dhe Homezh. Në këtë sektor luftimet u zhvilluan mjaft të ashpra, aq sa popullsia u detyrua të shpërngulej në zonat më të sigurta. Fshatrat më të dëmtuar nga luftimet ishin Zëmça dhe Slabinja, pasi ndodheshin në vijën e parë të frontit. Përparimi i ushtrisë franceze bëri që territoret e kontrolluara të zgjeroheshin gjithë e më shumë. Epërsia e ushtrisë franceze, e cila e zhvendosi frontin në drejtim të Elbasanit, bëri që në fillim të marsit të vitit 1918 të krijohet “Territori i Pogradecit”. Bashkë me territorin e Korçës dhe zonën neutrale greko-shqiptare, u formua zona e quajtur “Kufijtë Shqiptarë”, kontrolli i së cilës u vu nën komandën e majorit Reynard Lespinasse.<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Biblioteka Digjitale “Gallica”, “Revue de Cavalerie”, 1923, Francë.

<sup>5</sup> Biblioteka Digjitale “Gallica”, “Ushtritë Franceze në Luftën e Madhe” 1924, Francë.

<sup>6</sup> Augris, Etine . “Korçë Dans La Grande Guerre”. *Balkanologie IV*, (2000).




Fig. 2.

Marshimi i përgjithshëm të kolonave ushtarake gjatë periudhës 18 gusht -22 tetor 1917.<sup>7</sup>

### 3. Administrimi i Pogradecit

Territori i Pogradecit gjatë administrimit francez u nda në katër krahina: Pogradecit, Pirgut, Lenijes dhe Quksit. Sipas Protokollit të Republikës Autonome të Korçës, ky territor administrohej nga një komandant i postkomandës franceze. Në Pogradec u caktua majori August Mortier, i cili kryente funksionin e komandantit të Qarkut. Gjatë qeverisjes së Mortierit në Pogradec u ndërmorën një sërë masash për rimëkëmbjen e ekonomisë, zhvillimin e arsimit si dhe jetës kulturore. Për komunikimin e popullsisë u ndërtua rrjet i ri rrugor si dhe u sistemua aksi kryesor nga Korça në Pogradec. U bë rehabilitimi jo vetëm i rrugëve dhe urave për nevoja ushtarake, të cilat u dëmtuan nga lufta, por edhe u organizua mirëmbajtja e rrugëve për karvanët. U ngrit rrjeti post-telegraf që lidhte Korçën me Pogradecin dhe më andej me qytetin e Vlorës. Filloi projektimi dhe ndërtimi një sërë veprash publike dhe private. Kontribut mjaft të madh në ndërtimin e tyre dha projektuesi dhe zbatuesi i ndërtimeve të ushtrisë franceze Albert Garik, i cili më vonë do të projektonte edhe planin e parë urbanistik të qytetit të Pogradecit. Po ashtu rëndësi e veçantë iu kushtua kujdesit shëndetësor sidomos në fshatra. Për këtë qëllim u ngritën spitale, infermieri si dhe grupe të lëvizshme të cilat punonin edhe në zonat e thella malore.

<sup>7</sup> Biblioteka Digjitale “Gallica”, “Revue de Cavalerie” 1923, Francë.



Fig. 3. “Pogradec (Shqipëri). Banorë dhe ushtarë në një shesh”.<sup>8</sup>

Aspekt të rëndësishëm përbënte dhe regjistrimi i popullsisë. Ky proces në territorin e administruar nga francezët u realizua me qëllim, jo vetëm të evidentonte numrin e banorëve dhe banesave, por edhe të shuante pretendimet e shteteve fqinje në lidhje me përkatësinë etnike të popullsisë së Krahinës Autonome të Korçës. Sipas regjistrimit të kryer asokohe, popullsia e Kazasë së Korçës dhe lokaliteteve në varësi, numëronte 122.315 banorë, prej të cilëve 40.070 të krishterë dhe 82.245 myslimanë. Popullsia e Pogradecit ishte 39.840 banorë, nga këta 3.690 të besimit të krishterë dhe 36.150 myslimanë. Në rajonin e Pogradecit theksohej se gjithë popullsia i përkiste nacionalitetit shqiptar.<sup>9</sup>

Gjatë administrimit francez në Pogradec u bënë përpjeke të mëdha për zhvillimin e arsimit dhe kulturës. Në këto vite në u krijuan shoqëritë e para kulturore, arsimore edhe sportive. Kjo u arrit falë përpjekjeve të patriotëve shqiptarë me mbështetjen dhe kujdesin e autoriteteve franceze. U krijua shoqëria sportive “Trupi Gjymnastikor” ku u angazhuan intelektualë, zanatçinj si dhe djalëria pogradecare. Shoqëria e parë sportive dhe kulturore e krijuar në Pogradec, kishte qëllim edukimin e brezit të ri me ndjenjën e atdhetarisë dhe zhvillimin e tyre fizik. Nën drejtimin e Mihal Bellkamenit ajo do të bëhej nismëtarja e jetës kulturore dhe sportive dhe në vitin 1919 do të merrte emrin “E Pritmja”. Gjatë kësaj kohe u rrit dukshëm numri i shkollave në Pogradec. Administrata franceze hapi mbi dyqind shkolla në Korçë dhe Pogradec, të financuara nga buxheti i Krahinës Autonome, por edhe nga emigrantët shqiptarë.

<sup>8</sup> Dubray, Paul. “Pogradec (Shqipëri). Banorë dhe ushtarë në një shesh”. 1918. Foto. *Stabilimenti i Komunikimit Dhe Prodhimit Audiovizual Të Mbrojtjes*. Francë.

<sup>9</sup> Kolovani, Dhimitër. 1919. *La Question De Koritza*. Paris. 38-39



Fig.4. “Pogradec (Shqipëri). Një muzikë ushtarake”<sup>10</sup>

Për përhapjen dhe rritjen e cilësisë së arsimit, krahas mësuesve pogradecarë, u emëruan edhe mësues nga qytete të tjera siç Persefoni Treni dhe Dhimitër Misha, të cilët dhanë kontribut mjaft të madh në hapjen e shkollave shqipe në Pogradec. Më 29 shtator 1919 u krijua shoqëria arsimore “Drita” e cila ishte një bashkim mësuesish. Po ashtu nën kujdesin e Komandantit të Qarkut August Mortierit dhe Mihal Bellakmenit, u hap kursi për kualifikimin e mësuesve si dhe u emëruan mësues në zonat e thella të Pogradecit. Më 10 shtator 1919 Pogradeci kishte 88 shkolla, 3687 nxënës, 90 mësues dhe 7 mësuese. U përcaktuan masa ligjore për prindërit që nuk dërgonin fëmijët 6-13 vjeç në shkollë, gjobë deri në 3 franga dhe deri në 3 ditë burg.<sup>11</sup>

Ndër aktivitetet kulturore, më të veçanta gjatë kësaj ishte vënia në skenë e dramës “Besa” e Sami Frashërit. Drama u shfaq më 15 shkurt të vitit 1919. Aktorët e parë amatorë që luajtën në të ishin: Nikolla Babu, Thanas Kërzhalli, Kleanthi Pasko, Koli Kycyku etj. Drama u cilësua ngjarje mjaft e rëndësishme në jetën kulturore të qytetit. Pogradeci gjithashtu shikohej nga francezët si një vend pushimi i cili duhet të kthehej në një stacion veror. Kjo për faktin sepse sipas tyre kishte gjithçka: liqeni i bukur, ujëra që rridhnin nëpër rrugë, pëmët e bukura të gështenjave, një vend jashtëzakonisht pjellor, pasuri hidrike etj.<sup>12</sup>

Në prill të vitit 1920 qeveria e Sulejman Delvinës u kërkoi autoriteteve franceze që Pogradeci t’i bashkohej qeverisë së Tiranës. Më 22 qershor të vitit 1920 detyra e

<sup>10</sup> Dubray, Paul . “Pogradec (Shqipëri). Në muzikë ushtarake”. 1918. Fotografi. *Stabilitenti i Komunikimit Dhe Prodhimit Audiovizual Të Mbrojtjes*. Francë.

<sup>11</sup> Çela, Florian. 2021. *Historia e arsimit në Pogradec*. EMAL.62-66

<sup>12</sup> Ordioni, Andre. 2014. *Një oficer në Ballkan*. Papyrus.365-366

administrimit francez në Pogradeci përfundoi. Duke lënë kështu një numër të madh shkollash shqipe të hapura si dhe administratën me punonjës shqiptarë të përkushtuar, të cilët dhanë kontribut të vyer në fusha të ndryshme të shoqërisë.



Fig.5. Pogradec (Shqipëri). Panorama.<sup>13</sup>

## **Bibliografia**

- Augris, Etine . *Korçë Dans La Grande Guerre. Balkanologie IV*, 2000.  
Bourcart , Jacques . *Kufijtë shqiptar të administruar nga Franca*. Paris. 1922  
Bourcart , Jacques . *Shqipëria dhe Shqiptarët*. Dituria. 2004  
Çela, Florian. *Historia e arsimit në Pogradec*. EMAL.2020  
Godart, Justin. *Shqipëria në vitin 1921*. Tiranë, FAN NOLI. 2019  
Kolovani , Dhimitër. *La Question De Koritza*. Paris. 1919  
Ordioni , Andre . *Një oficer në Ballkan*. Papirus. 2014

---

<sup>13</sup> Vouzelle, Jean . *Pogradec (Shqipëri). Panorama*. 1918. Foto. *Stabilimenti i Komunikimit dhe Prodhimit Audiovizual të Mbrojtjes*, Francë.



**JETA DHE VEPRIMTARIA E MISIONARES PROTESTANTE VIOLET  
KENNEDY NË RAJONIN E KORÇËS**

**Bertina SALLIU**

Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, Tiranë  
bertinasalliu@gmail.com

**Abstrakt**

*Phineas dhe Violet Kennedy ishin ndër misionarët e parë amerikanë në hapësirën shqiptare. Pikërisht në vitin 1908, çifti amerikan mbërriti në Korçë për të vazhduar punën e misionit, të ngarkuar nga Bordi Amerikan i Komisionerëve me qendër në Manastir. Ardhja e këtyre misionarëve në hapësirën shqiptare, shënoi një hap të rëndësishëm për Lëvizjen Protestante, por jo vetëm, edhe për qytetin e Korçës në të cilin ata punuan dhe jetuan.*

*Ky punim ka si qëllim nxjerrjen në pah të rolit të Violet Kennedy në Korçë përmes përshkrimit të jetës dhe veprimtarisë së saj misionare. Znj. Kennedy, siç referohet shpesh në literaturë, ishte shoqe e ngushtë me rilindësen shqiptare, Sevasti Qiriaz. Ajo ishte rritur me shqiptarët dhe bashkë me Sevastinë kishin studiuar në Manastir dhe në Kolegjin Amerikan për Vajza në Stamboll.*

*Në fokus të punimit është përshkrimi i jetës së Znj. Kennedy si një figurë amerikane që kontribuoi dhe jetoi mes shqiptarëve, por që njihet shumë pak ose aspak në historiografinë shqiptare. Për hartimin e këtij punimi, literaturë bazë janë shkrimet e saj të botuara në librin *Predikime*, me autor Phineas Kennedy (1912) dhe botime të ndryshme si raporte të Bordit Amerikan (burime primare) dhe histori të Lëvizjes Protestante.*

**Fjalë kyçe:** *Violet dhe Phineas Kennedy, Korça, misionarë amerikanë, Bordi Amerikan, Shkolla shqipe, mësuese, etj.*

**Abstract**

*Phineas and Violet Kennedy were among the first American missionaries in the Albanian territory. Precisely in 1908, the American couple arrived in Kortcha to continue the work of the mission, given by the American Board of Commissioners based in Monastir. The arrival of these missionaries in Albanian territory marked an important step for the Protestant Movement, but not only, also for the city of Kortcha in which they worked and lived for several years.*

*This paper aims to highlight the role of Violet Kennedy in Kortcha through the description of her life and missionary activity. Mrs. Kennedy, as is often referred to the literature, was a close friend of the Albanian woman reformer, Sevasti Kyrias. She had grown up with Albanians and together with Sevasti had studied in Monastir and the American College for Girls in Istanbul.*

*The focus of the paper is to describe Mrs. Kennedy' life as an American figure who contributed and lived among Albanians, but who is very little known or not at all in Albanian historiography. For the preparation of this paper, the main literature are her writings published at "*Predikime*" book, authored by Phineas Kennedy (1912) and various publications such as reports of the American Board (primary sources) and history of the Protestant Movement.*

**Keywords:** *Violet and Phineas Kennedy, Kortcha, American missionaries, American*

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

*Board, Albanian schools, teachers, etc.*

Phineas dhe Violet Kennedy ishin dy misionarë protestantë amerikanë që luajtën një rol të rëndësishëm në fillimin e shek. XX në hapësirën shqiptare, veçanërisht në qytetin e Korçës. Ata mbërritën në Korçë, më 26 mars 1908<sup>1</sup>, të dërguar nga Bordi Amerikan i Komisionerëve për Misionet e Huaja, një organizatë që kishte për qëllim përhapjen e krishterimit protestant dhe ndihmën në zhvillimin arsimor dhe shoqëror të popullsisë ku vepronin.

Më 1905 ABCFM-ja raportoi përpjekjet e qeverisë osmane për të ndaluar mësimin e gjuhës shqipe në Korçë. Në këto kushte, Kisha Ungjillore dhe Shkolla e Vashave rrezikoheshin. Ardhja e misionarëve amerikanë Kennedy dhe paraqitja e shkollës si amerikane, nën flamurin amerikan, mund t'a mbronte e t'a shpëtonte. Kjo ishte dhe një arsye e vendosjes së çiftit Kennedy pikërisht në qytetin e Korçës. Duke u nisur nga kjo nevojë për mbrojtjen e shkollës<sup>2</sup>, me mbështetjen e Sevastisë, ABFCM-ja filloi të bënte thirrje për misionarë për hapësirën shqiptare.

Violet Kennedy ishte e bija e Lewis Bond<sup>3</sup>, një misionar amerikan që kishte lindur në Plainfield, New Jersey (SHBA), kishte mbaruar kolegjin Princeton dhe u vendos me Eski Zagra më 1868. Më 1882 ai kaloi si misionar i Bordit Amerikan (ABCFM)<sup>4</sup> në Manastir, sekretar i Bordit më 1884 dhe u mor me lirimin e Gjerasimit që ishte kapur peng nga kaçakët. Gjatë gjashtë muajve që Gjerasimi mbahej peng, Ljuis Bond (Lewis Bond, ABCFM) mbikëqyri punën e tij në Manastir, si përgjegjës i BFBS-së<sup>5</sup>.

Violet Kennedy, ishte rritur me shqiptarë dhe ishte shoqe e ngushtë me Sevastinë, pasi së bashku kishin studiuar në Manastir dhe në Kolegjin Amerikan për Vajza në Stamboll. Në këtë kohë, Violeta ndodhej në Pensilvani, së bashku me bashkëshortin, Phineas Kennedy, një pastor i cili kishte studiuar në Kolegjin Princeton (diplomuar më 1891) dhe në Seminarin Princeton (diplomuar më 1894), në kohën kur aty jepte mësim Woodrow Wilson, përpara se të zgjidhej president i Amerikës (më 1913). Çifti Kennedy iu përgjigj thirrjes dhe, më 1907, ata u caktuan për veprimtarinë misionare.

Më 27 tetor 1907, Violet e Phineas Kennedy u nisën nga Amerika, por u mbajtën katër muaj në Selanik nga Hysen Hilmi pasha, i cili njihte mirë planet e tyre dhe kishte marrë urdhër t'i ndalonte, por vetëm pas ndërhyrjes së diplomacisë amerikane u lejuan të vazhdonin. Phineas dhe Violet mbërritën në Korçë, më 26 mars 1908<sup>6</sup>. Ja sesi e përshkruan Phineas në librin e tij “Predikimet”: *“Me gjithë që zoti Kennedy i shikoj mundimet që në fillim, prapë vendosi për të ardhur në Shqipëri, me bindje të fortë që Perëndija i-a pati ruajtur këtë rast që t'i shërbejë si me shkollë, si me predikimin e Fjalës së Perëndisë lartësimi dhe ndriçimi të një kombi të shtypur dhe*

<sup>1</sup> Hosaflook, David, Lloshi, Xhevat, *Shqipëria dhe shqiptarët në raportet vjetore të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet e Huaja (1820–1924)* (Tiranë: Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2017), 20.

<sup>2</sup> I referohemi Shkollës Shqipe për Vasha në Korçë.

<sup>3</sup> Hosaflook, *Lëvizja Protestante*, 378.

<sup>4</sup> Shkurtim: ABCFM, Amerikan Board of Commissions for Foreign Missions.

<sup>5</sup> Lloshi, Xhevat, Hosaflook, David & Quanrud, J, *Thesaret për gjuhën shqipe të Shoqërisë Biblike (1815-1883)* (Tiranë: Vernon Publishing, 2017), 520.

<sup>6</sup> Violet Kennedy, *Kortcha Bulletin* 5, 2 December 1908, ISSHP-EJ; Kennedy, *Predikime*, 224.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

të mbajtur n' e rë-irë”<sup>1</sup>.

Phineas thekson se mosnjohja e gjuhës dhe zakoneve të atij vendi ishin pengesa nëpër të cilat ata po haseshin.

“Mirpo të mos diturit e gjuhës së vëndit dhe të mos- njohurit e zakoneve dhe të rroitjes nuk ishin të vetëmet shkake që na e bënë punën të rëndë. Turqit e muarën vesh dhe neve akoma pa shkelur në tokën shqiptare na vunë pengime të mëdha. Katër muaj u shtrënguem të presim në Selanik, sepse autoritetet e atjeshmë nuk na jepnin lejtë të vazhdonim udhtimin t' onë gjer në Korçë. Pas këtij ndalimi, me përpjekjet e ambasadorit amerikan mezi na lejuan, të shkojmë në vendin e caktuar. Por vetëm si turistë. Ne arritëm më 26 Mars 1908. Këtu zyrtarët kishin marrë urdhër të na sjellin pengime. Një nga të vetëmit burra me të cilin mund të këshilloheshim ishte i nderuari z. Grigor M. Cilka. Këtë patriot të math e kishin bur- gosur që më parë dhe u-l'irua më 10 korrik me rastin e shpalljes së konstitucionit. Në vjeshtë arriti në Korçë zoti Telford C. Erickson dhe shkoj për në Tiranë me ato qëllime që ndiqnim dhe ne”<sup>2</sup>.

Ndër gjërat e para që bëri çifti Kenedi ishte mbështetja që ata dhanë për të rihapur shkollën e djemve, nën drejtimin e Petro Nini Luarasi<sup>3</sup>. Kjo shkollë u mbështet ekonomikisht nga Bordi Amerikan që e kishte qendrën në Manastir.

Phineas dhe Violet Kennedy punuan aktivisht për zhvillimin e arsimit shqip. Ata mbështetën dhe organizuan shkolla për vajzat dhe djemtë shqiptarë, duke u përqendruar në edukimin e komunitetit vendas. Violet Kennedy ishte veçanërisht e përkushtuar ndaj edukimit të vajzave, duke bashkëpunuar ngushtë me Sevasti Qiriazin, një nga figurat kryesore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Miqësia e saj me Sevasti Qiriazin tregon lidhjen e fortë që Violet krijoi me shqiptarët dhe përkushtimin e saj për përhapjen e dijes. Në artikullin e saj “Puna jonë në Shqipëri dhe Gruaja shqiptare”,<sup>4</sup> Violet Kennedy përshkruan dashurinë që ajo kishte për shqiptarët: “E dua Shqipërinë, pas atdheut tim, më shumë nga çdo komp tjetër, sepse populli i saj, sa m' i vogël e m' i varfër që është, aq më tepër ka nevojë për ndihmën njerzore.”

Çifti Kennedy përhapi mesazhin e Ungjillit përmes predikimeve, organizimit të takimeve fetare dhe shpërndarjes së literaturës protestante në gjuhën shqipe. Veç përhapjes së mesazhit fetar, çifti Kennedy u angazhua edhe në projekte humanitare. Ata ndihmuan në përmirësimin e kushteve të jetesës në Korçë, duke ofruar ndihmë për të varfrit dhe duke nxitur zhvillimin e arsimit dhe shërbimeve sociale.

Violet Kennedy, në veçanti, tregoi një aftësi të jashtëzakonshme për t'u integruar me komunitetin shqiptar. Ajo fliste shqip dhe e njihte mirë kulturën lokale, gjë që e ndihmoi të fitojë respekt dhe dashamirësi nga vendasit. Ajo nuk ishte vetëm një misionare, por edhe një mike e afërt e shqiptarëve. Miqësia e Violet Kennedy me Sevasti Qiriazin dhe përfshirja e saj në shkollat shqipe tregon lidhjen e çifti Kennedy me lëvizjen kombëtare shqiptare. Ata e kuptonin rëndësinë e arsimit në gjuhën amtare dhe kontribuan në forcimin e identitetit kombëtar përmes edukimit dhe botimeve shqipe.

<sup>1</sup> Kennedy, Phineas, *Predikime* (Korçë: Dhori Koti, 1929), 223.

<sup>2</sup> Kennedy, *Predikime*, 224.

<sup>3</sup> David Hosaflook, *Lëvizja Protestante te Shqiptarët (1816-1908)* (Tiranë: ISSHP, Vision Printing, 2021), 379.

<sup>4</sup> Shtojca në librin “*Predikime*”, 222.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Në shkrimet e saj, Violet i kushton një vend të rëndësishëm edhe gruas shqiptare me traditat tipike në rajonin e Korçës. Ja si i përshkruan familjet korçare: *“Gruaja shqiptare më hoqi vërejtjen më tepër se çdo gjë tjetër me rojtjen e saj ndë qoftë se jo të mirë fare, por të paktën fort interesante nga çdo pikpamje. Që në të parën vijitë q’u bëra familjeve të ndryshme në Korçë më ra në syt pastërtija dhe rregulli që të gëzon shpirtin. Hobori i shtëpis, i shtruar me ploça të vijjosura me këlqere i jep ajatit një pamje karakteristike dhe të këndëshme...”*<sup>1</sup>

Punës e çiftit Kennedy zë një vëmendje të kufizuar në historiografinë shqiptare, megjithëse ndikimi i tyre ishte domethënës. Ata lanë pas një trashëgimi të pasur në përhapjen e arsimit dhe vlerave protestante në Shqipëri, veçanërisht në Korçë, dhe ndihmuan në krijimin e një baze për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë shqiptare. Violet Kennedy ka luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e jetës kulturore, arsimore dhe fetare në Korçë, duke u bërë një figurë e rëndësishme, megjithëse pak e njohur në historinë shqiptare.

Violet Kennedy ishte shumë e përkushtuar ndaj edukimit të vajzave dhe luajti një rol kyç në mbështetjen dhe organizimin e shkollave shqipe. Ajo bashkëpunoi ngushtë me Sevasti Qiriazin, një nga figurat kryesore të arsimit shqiptar dhe Rilindjes Kombëtare. Ishte mësuese dhe mbështetëse e përhapjes së arsimit për të gjithë, veçanërisht për vajzat, duke ndihmuar në zhvillimin e shkollave që u bënë baza e edukimit kombëtar në Korçë.

Ajo ndihmoi në përgatitjen e materialeve edukative dhe shpërndarjen e literaturës në gjuhën shqipe, duke kontribuar në përhapjen e dijes. Aktivitetet e saj ndihmuan në krijimin e një fryme solidariteti dhe bashkëpunimi brenda komunitetit të Korçës. Në vitin 1913 ata punuan në Durrës me refugjatët deri në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore dhe u larguan kur u dorëhoq Princ Vidi. Çifti Kennedy u rikthye në vitin 1917 në kohën e “regjimit frënk”, siç i referohën në librin “Predikime”. Miku korçar që i mirëpriti ishte Themistokli Gërmenji. Gjatë vitit 1919 i dhanë mësim vajzave dhe djemve në gjuhën shqipe. Violet Kennedy e njihte mirë kulturën dhe gjuhën shqipe, duke fituar respektin e vendasve. Miqësia e saj me Sevasti Qiriazin ishte një shembull i përfshirjes së saj të thellë në jetën shqiptare. Ajo i përçoi vlerat perëndimore dhe fetare në mënyrë që të harmonizoheshin me traditat dhe kulturën shqiptare, duke krijuar ura midis dy botëve.

Kontributi i Violet Kennedy për Korçën ishte shumëdimensional: ajo ndihmoi në përhapjen e arsimit, mbështeti përhapjen e krishterimit protestant dhe u përfshi aktivisht në përmirësimin e jetës së përditshme të njerëzve. Ndikimi i saj nuk ishte vetëm fetar, por edhe kulturor, shoqëror dhe humanitar, duke lënë një gjurmë të rëndësishme në qytetin e Korçës. Violet Kennedy vlerësonte figurën e gruas shqiptare si elementin më të rëndësishëm për edukim në familje. *Ajo i referohej gruas në shkrimet e saj si “shtylla e familjes, nëna e brezit të ri”. “Dyke sjellë harmoni të plotë në këto ndryshime, dyke sjellë vepërimin e burrit dhe të gruas në drejtim të njëjtë jam e sigurtë që do të dalim prej labyrintit t’errët të padijës që t’a gëzonjë edhe ky komp i shumë-vojtur shijen e ëmbël të jetës që i ka dhuruar Perëndija”.*<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Kennedy, *Predikime*, 228.

<sup>2</sup> Kennedy, *Predikime*, 233.

**Bibliografia**

Hosaflook, David. *Lëvizja Protestante te Shqiptarët 1816-1908*. Tiranë: ISSHP, Vision Printing, 2021.

Hosaflook, David. Lloshi, Xhevat. *Shqipëria dhe shqiptarët në raportet vjetore të Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet e Huaja, 1820–1924*. Tiranë: Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante, 2017.

Kennedy, Violet Bond. “Puna jonë në Shqipëri dhe gruaja shqiptare”. *Predikime prej Rev. P. B. Kennedy (mbajtur në Shkollën Amerikane)* (Korçë: Dhorë Koti, 1929): 222–232.

Kennedy, Violet. *Kortcha Bulletin* 5, 2 December 1908. ISSHP-EJ.

Lloshi, Xhevat, Quanrud, John & Hosaflook, David. *Thesaret për gjuhën shqipe të Shoqërisë Biblike 1815-1883*. Tiranë: Vernon publishing, 2017.

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

**NJË KËNDVËSHTRIM MBI ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK  
TË RAJONIT TË KORÇËS**

**Ph. D. Metin VENXHA**  
Departamenti Histori-Gjeografi  
Universiteti “Fan S. Noli”  
mvenxha@unkorce.edu.al

**Msc Ruela AGO**  
ela.roen@hotmail.com

**Abstrakt**

*Korça, një qytet i rëndësishëm në juglindje të Shqipërisë, i cili ka pasur një rol të veçantë në zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale të vendit gjatë periudhës 1908-1920. Kjo është një periudhë kritike në historinë shqiptare, e karakterizuar nga ngjarje kërcënuese dhe transformuese që ndihmuan në formësimin e identitetit kombëtar shqiptar. Duke filluar nga viti 1908, ky qytet u bë një qendër e rëndësishme e lëvizjeve reformuese dhe intelektuale brenda Perandorisë Osmane, kur shqiptarët filluan të angazhohen më shumë në kërkesat për autonomi dhe pavarësi. Kontributet e intelektualëve dhe atdhetarëve të njohur nga Korça ndihmuan në shmangien e indiferencës ndaj çështjes kombëtare dhe forcimin e ndjenjës së identitetit kombëtar. Pas shpalljes së Pavarësisë më 28 nëntor 1912, Korça luajti një rol të rëndësishëm në ngjarjet e këtij procesi historik. Qyteti u bë një qendër e rëndësishme për organizatat politike dhe shoqërore shqiptare, ku formoheshin ide dhe strategji për të mbrojtur integritetin territorial dhe kombëtar të Shqipërisë. Kjo periudhë përfshin gjithashtu sfida të mëdha si: Lufta e Parë Botërore e cila pengoi përparimin socio-ekonomik, solli pasiguri dhe trazira. Korça ishte një qendër tregtare dhe artizanale, ku zhvillimi i bujqësisë dhe tregtisë ndikoi në jetesën e banorëve. Ndryshimet në politikat përkatëse, si dhe lidhjet tregtare me rajonet fqinje, ndihmuan në zhvillimin e një ekonomie aktive.*

**Fjalët kyçe:** autonomi, bujqësi, krahina autonome, pavarësi, tregti, Themistokli Gërmenji vetëqeverim,

**Abstract**

*Korça, an important city in the southeast of Albania, had a special role in the political, economic and social developments of the country during the period 1908-1920. This is a critical period in Albanian history, characterized by threatening and transformative events that helped shape the Albanian national identity. Beginning in 1908, this city became an important center of reform and intellectual movement's within the Ottoman Empire, when Albanians began to engage more in demands for autonomy and independence. The contributions of intellectuals and patriots known from Korça helped to avoid indifference to the national issue and strengthen the sense of national identity. After the declaration of Independence on November 28, 1912, Korça played an important role in the events of this historical process. The city became an important center for Albanian political and social organizations,*

## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

where ideas and strategies were formed to protect the territorial and national integrity of Albania. This period also includes major challenges, such as the First World War, which hindered socio-economic progress and brought uncertainty and unrest. In economic terms, Korça was a commercial and artisanal center, where the development of agriculture and trade affected the livelihood of the inhabitants. Changes in relevant policies, as well as trade links with neighboring regions, helped develop an active economy. Korça became an educational and cultural center, where schools and cultural societies contributed to the preservation and spread of the Albanian language and traditions.

**Keywords:** *autonomy, agriculture, autonomous region, independence trade, Themistokli Gërmenji*

### **1. Themelimi i qytetit të Korçës, zhvillimi ekonomik dhe socio-kulturor gjatë periudhës osmane.**

Themelimi i qytetit të Korçës është i lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e institucionit të vakëfeve, si një institucion me karakter ekonomik dhe shoqëror, i prirur kryesisht për të ndihmuar shtresat në nevojë dhe për të përmirësuar kushtet e jetës shoqërore, nëpërmjet investimeve në infrastrukturë Me anë të dekreteve të Sulltan Bajazitit II, Iliaz Bej Mirahorit i dhuroheshin fshatrat e Vithkuqit, Leshnicës dhe Peskopjes. Sipas studiuesit Eduart Caka, “*Mirahori do t’i kthejë në vakëf këto fshatra, në të cilat ai do të ndërtojë edhe disa ndërtesa bamirësie të cilat konsiderohen si zanafilla e kthimit në një qendër urbane të zonës në fjalë. Sipas dokumentit të themelimit të vakëfit. kuptojmë se ndërtimi i objekteve të bamirësisë në fshatit Peskopje, me kalimin e kohës do të sjellë banimin e kësaj zone, që në shekuj do të rritet duke u bashkuar me kalanë e Korçës për t’u quajtur më vonë si qyteti i Korçës.*”<sup>1</sup> Gjithashtu, edhe studiuesi Nuçi Naçi, në veprën e tij “*Korça dhe Katundet e Qarkut*” shprehet se “*për të mësuar për Korçën, duhet më parë të dimë cili ishte, dhe ç’ka qenë Koxha Mirahori, madhëria e Korçës i detyrohet veprës ti shumë*”.<sup>2</sup>

Sigurisht që historiografia shqiptare, mbi bazën e dokumenteve dhe materialeve arkivore, e ka ezauruar prej kohësh kohën dhe mënyrën e themelimit të Korçës si qendër urbane, duke vendosur theksin tek institucioni i vakëfeve. Si promotor i lindjes së qendrave urbane, duke u dhënë këtyre hapësirave një dimension social, humanitar dhe fetar, ky institucion ka ndikuar në rritjen e mirëqenies së popullsisë shqiptare. Në historiografinë urbane për Ballkanin, nën dritën e dokumenteve të ndryshme arkivore, është bërë e qartë se, Perandoria Osmane, në trojet e zotëruara prej saj, ka ndjekur politikën e veta përsa i përket urbanizimit dhe ndërtim-strehimit. Gjithashtu vërehet se këto qytete janë rritur gjatë periudhës së qeverisjes osmane. Popullsia është shtuar, është bërë e larmishme, si dhe ka pasur veprimtari të dendur tregtare e ekonomike<sup>3</sup>. Arsyeja ishte se, vetë dinamika sociale e përhapjes së islamit ishte e përqendruar tek jeta urbane. Peter Slugett, në librin *The Urban Social History*

<sup>1</sup> Eduart Caka, *Të dhëna mbi disa vakëfe kryesore të qytetit të Korçës gjatë periudhës osmane (shek. XVI-XIX)*, në Studime Historike, nr. 1-2, Tiranë 2017, f.85

<sup>2</sup> Nuci Naçi, *Korça dhe katundet e qarkut*, Kotti, Korçë 1923, f.58

<sup>3</sup> Ahmet Davutoglu, *Qytete dhe Qytetërime*, Logos-A, Shkup 2016, f.85

## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

vë në dukje se “...një jetë e mirë islame mund të jetohet vetëm brenda një organizmi urban”<sup>1</sup>.

Zhvillimi i Korçës në shekujt XV-XVIII ishte i ngadaltë në raport me qytetet e tjera shqiptare, si Elbasani, Prizreni, Shkodra, Berati dhe Shkupi. Sipas studiuesit Caka “udhëtari i njohur osman i shek. XVII Evlia Çelebiu, i cili ka vizituar të gjitha qytetet dhe qendrat urbane të perandorisë gjatë kësaj periudhe, nuk i ka dhënë hapësirë në veprën e tij këtij qyteti, çka tregon se në periudhën kur ai ka udhëtuar në hapësirën shqiptare, kjo zonë nuk kishte ndonjë rëndësi të veçantë për të qenë objekt i vëmendjes së këtij udhëtari”<sup>2</sup>. Edhe studiuesi Zia Shkodra në veprën e tij “Esnafet Shqiptare”, kur analizon zhvillimin e qyteteve shqiptare në shekullin XVII nuk e përmend Korçën<sup>3</sup>. Ndërsa Nuçi Naçi shkruan se “Istoria e Korçës nis nga 1885” në kuptimin e zhvillimit ekonomik të qytetit, duke e lidhur këtë zhvillim me emigracionin, që disa “bij të saj tregëtarë” emigruan në Rumani dhe Egjipt<sup>4</sup>. Rikuperimi i Korçës i kishte rënë në sy edhe konsullit të Austrisë në Janinë, zotit Han, i cili vërente: “Tani kohët e fundit po bahet Korça, që është në lulëzim e sipër, një konkurrent i rrezikshëm i Janinës, përsa i përket tregtisë me viset e veriu. Pozita e saj ku kryqëzohen shumë rrugë kryesore, asht shumë e përshtatshme për tregëtinë dhe tregëtarët e Janinës kanë filluar të shqetësohen”<sup>5</sup>.

Sigurisht që edhe Korça e këtyre viteve u zhvillua brenda sistemit të esnafëve (kooporatave), që ka një traditë të lashtë në vendin tonë. Mëkëmbja graduale e jetës urbane ndihmoi në forcimin e ekonomisë monetare. Ky proces u krye nëpërmjet një ndarjeje më të madhe shoqërore të punës në fushën profesionale<sup>6</sup>. Kështu, ekonomia qytetare po hynte në një fazë të re zhvillimi, ku pjesën kryesore e mbante prodhimi zejtar. Pjesa dërrmuese e zejeve ushtrohej nëpër njësi të vogla, siç ishin dyqan-punishtet. Prodhimi i mallrave përgjithësisht ishte fryt i punës së dorës. Ky zhvillim solli nevojën e organizimit të zejtarëve në esnafe (kooporata).<sup>7</sup> Sipas studiuesit At Zef Valentini, “Kooporatat në Shqipëri kanë pas një histori ma të gjatë se kudo n’Europë, një histori ndoshta ma të gjatë pse kanë kryes, munt të thomi, njëkohësisht të gjitha funksionet qi mund të kenë organizata të tilla; kanë pasur një histori të lumnushmë qi nuk njohu dekadencë moralisht dhe drejtësisht, por la vetëm kujtime të mira dhe të përmallshme”<sup>8</sup>. Pra, Korça filloji të hyjë në linjën e zhvillimit urban modern, ku ekonomia filloi të mbështetet mbi tregtinë dhe prodhimin. Këtë qasje ka dhe sociologu Max Weber kur flet për qytete të urbanizuara, duke vendosur theksin tek triniteti tregti-prodhim-treg duke e quajtur pjesë e pandashme e formës

<sup>1</sup> Peter Sluglett, Edmond Burke III, *The Urban social history of Middle East 1750-1950*, Syracuse University Press, New York 2008, f.1.

<sup>2</sup> Eduart Caka, “Të dhëna mbi disa vakëfe kryesore të qytetit të Korçës”, f. 86.

<sup>3</sup> Sipas Shkodrës “qytetet më të rëndësishme ishin Elbasani me 28 lagje të vogla e të mesme me rreth 4000 shtëpi, Prizreni me 3620 shtëpi, Berati me 2000 shtëpi të ndara në 30 lagje, Prishtina, Vucitërna dhe Gjirokastra, me nga 2000 shtëpi dhe Vlora me 1300 shtëpi. Nga të gjitha këto, qyteti më i populluar ishte Shkupi me 10.000 shtëpi”. Zia Shkodra, *Esnafet Shqiptare*, Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë 1973, f.47.

<sup>4</sup> Nuçi Naçi, *Korça dhe katundet e qarkut*, f.57.

<sup>5</sup> Pirro Thomo, *Korça, Urbanistika dhe Arkitektura*, Shtypshkronja Morava, Tiranë 2012, f.35.

<sup>6</sup> Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar. 395-1875*, Botimet Toena, Tiranë 2004, f. 232.

<sup>7</sup> Duhet theksuar se lindja e këtyre kooportave të zejtarëve kishte qenë një eksperiencë paraosmane, që ndikoi në ringjalljen e shpejtë të kësaj tradite.

<sup>8</sup> Giuseppe Valentini, *Vepra I, Kooporatat shqiptare* f. 893.



## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

kapitaliste të prodhimit dhe urbanizimit.<sup>1</sup> Një zejtari e hershme dhe mjaft e zhvilluar ishte ajo e gëzofëve të punuar me lëkurë kafshësh të egra e të buta, ku Korça luante një rol të rëndësishëm.<sup>2</sup> Vend nderi zinte prodhimi i mbulesave dhe i shtrojeve prej leshi. Për purpunimin e velenxave, sidomos atë të llojit flokatë Korça dallohej së bashku me Kosovën, Janinën, Çamërinë dhe Konicën. Velencat e kësaj pjesë të Shqipërisë zunë vende nderi në ekspozitën ndërkombëtare të Parisit më 1855.<sup>3</sup> Në rrugët tregtare që lidhnin qendrat kryesore të vendit, pazari i Korçës kishte një pozicion që e favorizonte, në raport më qendrat e tjera. Që prej vitit 1822 kemi dëshmi të një tregu që ishte lidhur jo vetëm me tregjet e brendshme, por edhe ato përtej Adriatikut. Në kronikën e djegies së Pazarit, dëshmohet se “shumë nga tregëtarët kishin sjellë të gjithë mallin e tyre nga Triestja e Venediku, ndërsa më të shumtët e voskopojarëve kishin sjellë këtu, si në vendin më të sigurt, gjithë sendet e tyre me vlerë”<sup>4</sup>

### 2. Nga Reformat e Tanzimatit në Vetëqeverim, një rrugëtim i vështirë i rikuperimit ekonomik të Korçës.

Dështimi i reformave të Tanzimatit, në pjesën më të madhe të tyre, solli pasoja të rënda në hapësirën shqiptare. Ndarja e re administrative e vitit 1864 në vilajete, si njësi më të vogla se ato të mëparshmet, e theksoi centralizimin e pushtetit osman. Në krye të vilajeteve, të sanxhakëve, të kazave, dhe të nahijeve qëndronin tani nëpunës civilë të dërguar nga qendra, në shumicën e rasteve turq.<sup>5</sup> Për shkak të shpenzimeve të mëdha në Luftën e Krimesë, për herë të parë osmanët u detyruan të merrnin hua nga shtetet e tjera.<sup>6</sup> Për të përballuar situatën e vështirë të post-Krimesë, në kushtet kur të ardhurat fiskale ishin pakësuar me humbjet tokësore që kishte pësuar, nuk mbetej tjetër rrugë, veç shtrëngimit të darës së taksave.<sup>7</sup> Për të rritur të ardhurat, Porta përqendroi në duart e veta në formë monopolesh shtetërore tregtinë e një vargu artikujsh të përdorimit të përditshëm siç ishin: kripa, plumbi, duhani, baruti dhe peshku, duke i ngarkuar ato me taksa të veçanta.<sup>8</sup> Përveç taksave shtetërore, popullsia e qyteteve paguante edhe një numër taksash komunale, si: taksën e peshimit në treg, taksën policore, taksën e rrugës (detyrimi për katër ditë pune angari në vit, bashkë me kafshët e punës) etj.<sup>9</sup> Në kuadër të zbatimit të reformës administrative, më 1864, vendin e ejaleteve e zunë vilajetet. Në fund të Krizës Lindore (1881), tokat shqiptare u ndanë në katër vilajete. Korça tani bënte pjesë në Vilajetin e Manastirit. Si Sanxhak, ai përfshinte edhe kazatë e Starovës, Bilishtit, Oparit, Kolonjës, Kosturit dhe Hurpishtit. Kjo ndarje e re administrative, duket se e ndihmoi Korçën në rrafshin tregtar. Nuçi Naçi vëren se “sundimi turk me dëshirën

<sup>1</sup> Max Weber, *Economy and Society*, Berkeley&Los Angeles, University of California Press 1978, f. 1212.

<sup>2</sup> Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar 395-1875*, Botimet Toena, Tiranë 2004, f. 329.

<sup>3</sup> Po aty, f. 330.

<sup>4</sup> Pirro Thomo, *Korça, Urbanistika dhe Arkitektura*, Shtypshkronja Morava, Tiranë 2012, f.35.

<sup>5</sup> Historia e Shqipërisë II, f.149-150.

<sup>6</sup> Sipas një marrëveshjeje të nënshkruar me 28 qershor 1855, osmanët morën nga Britania dhe Franca një hua prej 5 milion sterlinash, me një përqindje vjetore prej 4%, plus 1% amortizim. Këstet e huasë do të paguheshin dy herë në vit: në qershor dhe dhjetor.

<sup>7</sup> Shuma e taksave të mbledhura nga Perandoria Osmane në vitin 1850 ishte 2.5 milion lira ari, më 1860 arriti në 4 milion dhe vijonte të rritej. Historia e Shqipërisë II, f. 150.

<sup>8</sup> Ibrahim Gashi, *Reformat në Perandorinë Osmane dhe Shqiptarët (1792-1876)*, Alsar, Tiranë 2021, f. 149.

<sup>9</sup> Po aty, f. 149.

## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

*e popullit dhe tregëtarëve bashkoi Korçën më Manastirë, kështu që tregëtia zu të bëhej me Manastirë dhe Seleniknë, i cili duke i bashkuar me hudhë të hekurta me Manastirë, i dha Korçës një interes tregëti të madhe”.<sup>1</sup> Gjithashtu sipas Naçit, Korça, duke qenë Shqipëri, duhet të tregtojë në një nga limanet e Shqipërisë, sepse “korçarët, të lindur tregëtarë e kanë kuptuar që lidhja me kanalet e Adriatikut është e vlefshme, por mjerisht duke mos patur rrugë të mira që lehtësojnë tregëtinë, po vazhdojnë të punojnë më Selaniknë”.<sup>2</sup>*

Pas një shekulli përpjekjesh të rilindasve tanë, Shqipëria ia doli që më 28 nëntor 1912 të fitojë pavarësinë. Shqipëria e 1912-ës ndodhej në një nivel ekonomiko-shoqëror të vështirë. Forcat prodhuese kishin mbetur prapa dhe kjo shprehej drejtpërdrejt edhe në prapambetjen e marrëdhënieve në prodhim. Marrëdhëniet kapitaliste në prodhim kishin filluar të lindnin në qytetet shqiptare nga fundi i shekullit XIX, por ato ecnin me ritëm të ngadaltë. Objektivisht, fitorja e pavarësisë kombëtare dhe krijimi i shtetit shqiptar duhet të ndikonin në zhvillimin ekonomik të vendit. Por fatkeqësisht, fill pas pavarësisë, vendi u përfshi në vorbullën e Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore. Rajoni i Korçës ishte një nga rajonet që njohu të gjithë brutalitetin e ngjarjeve.

Viti 1908 shënoi shpalljen e Hyrietit (Kushtetutës) nga Perandoria Osmane, e cila lehtësoi aktivitetet kombëtare shqiptare për hapjen e shkollave dhe përdorimin e gjuhës shqipe. Në vitin 1908, Kongresi i Manastirit përcaktoi alfabetin shqip, një ngjarje me ndikim të madh në arsimin dhe kulturën e Korçës, duke çuar në hapjen e shkollave shqipe në qytet dhe rrethina. Me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, Korça u përfshi në procesin e konsolidimit të administratës shqiptare.<sup>3</sup>

Megjithatë, pas Shpalljes së Pavarësisë, qyteti ra nën presionin e ushtrisë greke, duke e bërë të pamundur kontrollin e plotë shqiptar mbi të. Në vitin 1913, Korça u pushtua nga trupat greke, të cilat pretendonin aneksimin e saj si pjesë e "Vorio-Epirit". Gjatë kësaj kohe, grekët tentuan të vendosnin administratën e tyre, duke ndaluar përdorimin e gjuhës shqipe dhe duke mbyllur shkollat shqipe. Kjo periudhë shkaktoi rezistencë të fortë nga patriotët korçarë si Themistokli Gërmenji dhe Sali Butka të cilët udhëhoqën përpjekjet për të ruajtur identitetin shqiptar dhe për të kërkuar autonominë e qytetit. Në vitin 1914, qyteti i Korçës u pushtua nga trupat greke, të cilat synonin ta aneksonin rajonin në shtetin e tyre. Ky pushtim u shoqërua me represione ndaj popullsisë shqiptare, djegie të fshatrave dhe përpjekje për ta helenizuar qytetin. Në vitin 1915, me hyrjen e Luftës së Parë Botërore, ushtritë greke u tërhoqën pas presionit ndërkombëtar dhe qyteti kaloi nën kontrollin e forcave franceze.<sup>4</sup>

Më 10 dhjetor 1916, pas hyrjes së ushtrisë franceze në Korçë, u nënshkrua Protokollin i Korçës, i cili shpalli krijimin e një krahine autonome nën mbikqyrjen franceze. Ky protokoll i dha Korçës një status të veçantë vetëqeverisës, duke i lejuar qytetarët shqiptarë të krijonin institucione lokale të pavarura. U krijua një këshill qeveritar me

<sup>1</sup> Nuçi Naçi, *Korça dhe katundet e qarkut*, f. 8.

<sup>2</sup> Po aty, f. 8.

<sup>3</sup> *Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi II* (Tiranë: TOENA, 2002), 377.

<sup>4</sup> Milo, *Politika...*, 269.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

14 anëtarë, të përbërë nga 7 myslimanë dhe 7 të krishterë, për të siguruar një përfaqësim të drejtë të popullsisë. Për herë të parë, flamuri shqiptar u ngrit zyrtarisht më 1 mars 1917, duke simbolizuar sovranitetin kombëtar.<sup>1</sup> Flamurin shqiptar me kravatë franceze, i cili u ngrit në Korçë më 10 dhjetor 1916, gjenerali Descoins ia dorëzoi Xhemal Dinos, i ngarkuari me Punë në Legatën Shqiptare në Paris.<sup>2</sup>

Gjuha shqipe do të përdorej si gjuhë zyrtare. Kjo u lexua në gazetën “Gazetë e Korçës”, ku u njoftua mbi përdorimin e gjuhës shqipe si: “*gjuhë zyrtare e Vetëqeverisë kazasë së Korçës do të jetë sot dhe paskëtaj shqipja*”.<sup>3</sup> U krijua një trupë policore shqiptare, e cila siguroi rendin dhe qetësinë në qytet. Themistokli Gërmenji, një patriot dhe udhëheqës lokal, ishte një figurë kyçe në autonominë e Korçës, duke koordinuar bashkëpunimin me autoritetet franceze dhe duke mbrojtur interesat e popullit shqiptar. Këshilli Administrativ që u zgjodh nga populli, i cili kryente detyrat edhe të parlamentit, edhe të qeverisë, mori masa për zbatimin e protokollit. Ai filloi me organizimin e Prefekturës së Policisë, pasi vendi ishte i pushtuar dhe në gjendje lufte. Sipas protokollit, krijohej një trupë xhandarmërie-policie, me detyrë ruajtjen e rendit të brendshëm, si dhe forcimin kundër propagandave të huaja, si ajo e agjenturës greke.<sup>4</sup>

Themistokli Gërmenji ishte një nga figurat kryesore të administratës shqiptare të krahinës. Pavarësisht faktit se nuk ishte anëtar i Këshillit Qeveritar, ai arriti të drejtojë më sukses Prefekturën e Policisë. Ai, së bashku me drejtues të tjerë hartuan disa rregullore në lidhje me administratën publike, financat, arsimin, buxhetin, policinë, për zhvillimin ekonomik të krahinës.<sup>5</sup>

Shumë interesant ishte dhe pasqyrimi në gazetën “Adriatiku” i ceremonisë që u bë në Korçë për nënshkrimin e Protokollit. Ky njoftim i drejtohej popullit të Korçës dhe të qarkut të saj që, që në orën 9 e gjysmë, në oborrin e shkollës së Shën Gjergjit, të merrnin pjesë për të mirën e Korçës dhe qarkut të saj.<sup>6</sup>

Nënshkimi i protokollit për palën shqiptare mori vlera historike, për faktin se përbënte aktin e vetëm politik të nënshkruar gjatë Luftës së Parë Botërore, mbi baza partneriteti midis Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe forcave të ndryshme pushtuese. Ai që shprehje e një bashkëqeverisjeje me përfaqësues të vendit nga besime të ndryshme, një shembull i bashkëjetesës së mirë fetare dhe me autoritetet ushtarake franceze.<sup>7</sup> Gjithashtu, lidhur me ngjarjet politike në Korçë, Lëvizja Kombëtare Shqiptare pati mbështetje, jashtë dhe brenda vendit, nëpër kolonitë shqiptare dhe organizatave të tyre. Ndër to përmendin Federatën “Vatra” në SHBA.<sup>8</sup>

Korça njihet për një jetë kulturore të pasur dhe aktivitete sociale të gjalla gjatë kësaj periudhe. Pjesa më e madhe e popullsisë ishte e angazhuar në jetën shoqërore përmes krijimit të klubeve kulturore si: “Klubi i Rinisë Korçare” dhe “Klubi i Gruas

<sup>1</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, (Tiranë: Albas, 2014), 88.

<sup>2</sup> Kalopi Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve “Adriatiku” dhe “Gazet” e Korçës*, (Tiranë: Kristalina KH, 2017), 19.

<sup>3</sup> *Po aty*, 29.

<sup>4</sup> *Po aty*, 42.

<sup>5</sup> *Po aty*, 15.

<sup>6</sup> Naska, *Vetëqeverimi...*, 17.

<sup>7</sup> *Po aty*, 23.

<sup>8</sup> *Po aty*, 39.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Shqiptare", të cilët promovonin gjuhën dhe kulturën kombëtare. Gjatë kësaj kohe, Korça ishte një qendër e rëndësishme arsimore në Shqipëri. Liceu Francez i Korçës, i hapur në këtë periudhë, u kthye në një institucion kryesor për edukimin e elitës së ardhshme shqiptare. Me rritjen e ndërgjegjes kombëtare, gratë nisën të luanin një rol më të madh në shoqëri, duke marrë pjesë në aktivitete sociale dhe politike. Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe aksesimi në arsim ndikoi në ndryshimet sociale të qytetit. Gjatë periudhës 1908-1920, Korça përjetoi ndryshime të rëndësishme sociale, të cilat ndikuan në strukturën dhe jetën e qytetit. Pas Kongresit të Manastirit (1908), në Korçë u hapën disa shkolla shqipe, duke përfshirë shkollën e parë shqipe për vajza në vitin 1917, e drejtuar nga Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi. Liceu Francez i Korçës (1917), një nga institucionet më të rëndësishme arsimore të kohës, ofroi arsim të avancuar për të rinjtë shqiptarë dhe ndikoi në përhapjen e kulturës perëndimore në rajon.<sup>1</sup>

Në këtë periudhë nisën të botoheshin revista dhe gazeta që promovonin kulturën dhe ndërgjegjen kombëtare si: gazeta "Zgjimi" dhe "Bashkimi Kombëtar." Përfshirja e grave në arsim dhe në aktivitetet kulturore njohu një rritje të ndjeshme gjatë kësaj periudhe. Shoqëria "Gruaja Shqiptare" u themelua në Korçë dhe luajti rol të rëndësishëm në mbështetjen e edukimit të vajzave dhe në promovimin e të drejtave të grave. Gratë filluan të kenë një rol më të dukshëm në organizatat e ndryshme kulturore dhe arsimore, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe përparimit shoqëror.<sup>2</sup>

Nën administratën franceze (1916-1920), u ndërморën hapa për të përmirësuar infrastrukturën e qytetit siç ishin: ndërtimi i rrugëve, ndriçimi publik dhe sistemet e kanalizimeve, hapja e qendrave të reja shëndetësore dhe krijimi i shërbimeve publike, duke ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetesës. Lufta sollti vështirësi ekonomike dhe sociale për banorët e Korçës, që u dukën me përhapjen e varfërisë dhe emigrimin e një pjese të popullsisë drejt qyteteve të tjera, apo edhe jashtë vendit. Megjithatë, pranisë franceze i atribuohet një farë stabiliteti dhe sigurie, duke sjellë një frymë bashkëpunimi midis komuniteteve myslimane dhe ortodokse në qytet. Një klasë e re e intelektualëve dhe tregtarëve u shfaq si rezultat i përmirësimeve ekonomike dhe edukative. Marrëdhëniet midis komuniteteve fetare (myslimane dhe ortodokse) u forcuan përmes bashkëpunimit në administratën e Krahinës Autonome të Korçës.<sup>3</sup>

Gjatë Krahinës autonome u bënë përpjekje për përmirësimin e gjendjes ekonomike. Këshilli Qeveritar, në bashkëpunim me administratën ushtarake franceze, me qëllim uljen e varfërisë, u përpoq për të siguruar dy vagonë me grurë, miell dhe misër. Themistokli Gërmenji, prefekt i Prefekturës së Policisë, u kërkoi të gjithë furraxhinjve të furrave të bukës që të prodhonin me miellin e qeverisë dhe të mos i përzienin me lëndë të tjera. Ata nuk kishin të drejtë ta shisnin me çmim më të shtrenjtë se vlera e vendosur, në rast të kundërt do të gjobiteshin.<sup>4</sup> U miratua "Rregullorja për të mbajturit e llogarive", ku drejtorja e financave do të

<sup>1</sup> Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe*, (Tiranë: 8 Nëntori, 1978), 18.

<sup>2</sup> Myzyri, *Shkollat...*, 21.

<sup>3</sup> Duka, *Histori...*, 89.

<sup>4</sup> Kaliopi, *Vetëqeverimi...*, 57.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

kontrollonte datën e lëshimit dhe firmosjes së çdo dëftese, mandat pagese.<sup>1</sup> I dërgohet kryetarit të Postës së Pojanit që të veprojë këtë punë si duhet, të cilit i kujtohet që të këtë vërejtje të plotë mi të ngriturin të misërit. Kur të ngarkohet misri që nga vendi i depos do të hiqet se sa okë ngarkohet dhe kështu Nënpunësi tuaj që do të jetë atje do t’ju japë qeraxhinjve ose Xhander maja një dëftesë se sa okë do të sjellë këtu në Hanbart.<sup>2</sup>

Kulturat e duhanit dhe grurit ishin burimet kryesore të të ardhurave për Korçën. Investimet në këto fusha ndihmuan në stabilitetin ekonomik të qytetit. Gjithashtu, aktiviteti ekonomik u ndikua nga ndryshimet politike dhe pretendimet territoriale greke, të cilat krijuan pasiguri për tregtarët dhe investitorët lokalë.<sup>3</sup>

Zejtarët korçarë u bënë të njohur për prodhimet e tyre artizanale si: veshjet popullore, tekstilet, qeramika dhe përpunimi i drurit. Punishtet tradicionale që prodhonin këpucë, armë dhe mobilje u zgjeruan duke përdorur teknika më të avancuara. Gjatë administratës franceze (1916-1920), u investua në përmirësimin e infrastrukturës duke përfshirë rrugët, urat dhe shërbimet komunale, të cilat ndihmuan në zhvillimin ekonomik të qytetit. Po kështu, Këshilli Qeveritar, për t’i prerë rrugën kontrabandës, vendosi ngritjen e administratës doganore dhe në kufirin shqiptaro-grek, vendosi zyrat e doganës me qendër në Bilisht.<sup>4</sup>

Me krijimin e Krahinës Autonome të Korçës në vitin 1916, administrata franceze solli investime të reja në ekonomi, duke nxitur zhvillimin e tregtisë dhe industrisë lokale. U krijua një sistem fiskal më i organizuar, duke vendosur taksa mbi prodhimet bujqësore dhe tregtare. Stabiliteti ekonomik, i sjellë nga francezët, ndihmoi në rritjen e sigurisë dhe në inkurajimin e sipërmarrësve lokalë për të zgjeruar aktivitetet e tyre. Në 25 janar 1917 administrata shqiptare e Krahinës Autonome të Korçës, në kuadër të zhvillimit të tregut, emetoi kartëmonedhat e saj shqiptare dhe në 1 mars 1917, filloi nxjerrjen e bonove me prerje të ndryshme. Tashmë ato do të zëvendësonin monedhat e huaja.<sup>5</sup>

Gjatë administratës franceze 1916-1920 u ndërmorën hapa të rëndësishëm për përmirësimin e ekonomisë lokale përmes investimeve në infrastrukturë dhe krijimin e kushteve të favorshme për

tregtinë. Administrata Franceze pati një ndikim të dukshëm në zhvillimin ekonomik të Korçës duke mbështetur zejët dhe tregtinë lokale, si dhe duke futur rregulla të reja administrative që forcuan stabilitetin ekonomik, duke vlerësuar gjithashtu ndikimin e tregjeve të reja dhe përmirësimin e kushteve të transportit, i cili lehtësoi eksportin e produkteve bujqësore dhe artizanale.<sup>6</sup>

Administrata franceze implementoi një sistem të ri tatimor që ndihmoi në rritjen e të ardhurave dhe stabilizimin e ekonomisë lokale. Raportet franceze theksojnë se përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe organizimi më i mirë i tregjeve lehtësuan qarkullimin e mallrave dhe rritjen e të ardhurave për banorët. U shtuan shumë

---

<sup>1</sup> *Po aty*, 60.

<sup>2</sup> AQSH, Fondi 239, (Korçë: 2 dhjetor 1919), 202.

<sup>3</sup> *Po aty*

<sup>4</sup> Kaliopi, *Vetëqeverimi...*, 58.

<sup>5</sup> *Po aty*, 63.

<sup>6</sup> Duka, *Historia...*, 88

## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

përpjekjet për të zhvilluar bujqësinë dhe për të krijuar një sistem të qëndrueshëm të furnizimit me ujë për tokat bujqësore.<sup>1</sup>

### **Bibliografia**

- AQSH, Fondi 239, Korçë: 2 dhjetor 1919  
100 Vjet Vetëqeverimi i Korcës, Botim i posacëm i Universitetit “Fan S. Noli”,  
Promo Print, Korçe 2016
- Ahmet Davutoglu, *Qytete dhe Qytetërime*, Logos-A, Shkup 2016
- AQSH, Fondi 239, Korçë: 2 dhjetor 1919.
- Eduart Caka, “*Të dhëna mbi disa vakefe kryesore të qytetit të Korcës gjatë periudhës osmane (shek. XVI-XIX)*”, në *Studime Historike*, nr. 1-2, Tiranë 2017
- Historia e popullit shqiptar, Vëllimi II*. Tiranë: TOENA, 2002.
- Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe*. Tiranë: 8 Nëntori, 1978.
- Ibrahim Gashi, *Reformat në Perandorinë Osmane dhe Shqiptarët (1792-1876)*,  
Alsar, Tiranë 2021
- Kalopi Naska, *Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve “Adriatiku” dhe “Gazet” e Korçës*. Tiranë: Kristalina KH, 2017.
- Max Weber, *Economy and Society*, Berkeley&Los Angeles, University of California Press 1978
- Muin Cami, *Shqiptarët dhe francezët në Korçë, 1916-1920*. Tiranë: Dituria, 1999.
- Nuci Naci, *Korça dhe katundet e qarkut*, Kotti, Korçë 1923
- Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*. Tiranë: TOENA, 2013.
- Peter Sluglett, Edmond Burke III, *The Urban social history of Middle East 1750-1950*, Syracuse University Press, New York 2008
- Pirro Thomo, *Korça, Urbanistika dhe Arkitektura*, Shtypshkronja Morava, Tiranë 2012
- Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*. Tiranë: Albas, 2014.

---

<sup>1</sup> Muin, *Shqipëtarët...*, 50.

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

**AVENTURA E KRAHINËS AUTONOME DHE DINAMIKAT E  
ADMINISTRIMIT TË RAJONIT TË KORÇËS  
NËN PROTEKTORATIN FRANCEZ (1916-1920)**

**Brendon SALIH**

salihbrendon@gmail.com

**Abstrakt**

*Lufta e Parë Botërore ishte momenti i ndryshimeve të mëdha historike, e cila shënoi ndarjen e epokave në jetën e shoqërive dhe shteteve të ndryshme europiane. Një prej këtyre ngjarjeve unike, që ndodhi jashtë parashikimeve dhe llogarive të gjeopolitikës së Fuqive të Mëdha, ishte aventura e krahinës autonome të Korçës, nën administrimin ushtarak francez.*

*Nga vjeshta e 1916 deri në verën e 1920, kemi një periudhë ku falë riorganizimit dhe miradministrimit të burimeve njerëzore, financiare, natyrore, rivendosjes së rendit publik dhe ruajtjes së balancave fetare, u krijua paradoksalisht një hapësirë “paqeje” dhe zhvillimi ekonomik brenda rajonit, gjatë një lufte dhe një konteksti gjeopolitik të komplikuar. Modeli i arsimit publik laik në gjuhën shqipe, sipas shembullit francez, pati Liceun si elementin kurorëzues të influencës kulturore dhe trashëgimisë franceze në Shqipëri.*

*Cilat ishin pasojat e protektoratit francez në rajonin e Korçës dhe efektet socio-ekonomike të reformave të tyre në jetën e popullsisë lokale? A krijoi pragmatizmi apo idealizmi i disa ushtarakëve francezë precedentin e një modeli funksional të vetëqeverisjes në vend? Pse mbeti simbolike trashëgimia politike e prezencës franceze?*

*Pas një analize të faktorëve të ndryshëm, të vendosur në kontekstin historik të kohës dhe ndërthurjes apo krahasimit të burimeve me njëra-tjetrën, dalim në konkluzionin se rasti i Korçës ishte një përjashtim nga rregulli dhe një rezultat i mungesës së interesave afatgjatë dhe vizionit të politikës franceze mbi Shqipërinë.*

**Fjalët kyçe:** *Administrim ushtarak, autonomi, Francë, Korçë, politikë, reforma*

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

**THE ADVENTURE OF THE AUTONOMOUS PROVINCE AND THE  
ADMINISTRATION DYNAMICS OF THE KORÇA REGION,  
UNDER THE FRENCH PROTECTORATE (1916-1920)**

***Abstract***

*WWI was a moment of great historical changes which marked the change of an era in the lives of different European societies and states. One of these unique events, which occurred beyond the predictions and calculations of the Great Powers geopolitics, was the adventure of the autonomous province of Korça, under French military administration.*

*From 1916 to 1920, there was a period in which, thanks to the reorganization and good administration of human, financial, natural resources, restoration of public order and the preservation of religious balances, a space of "peace" and economic development was paradoxically created within the region, during a time of war and a complicated geopolitical context. The model of secular public education in the Albanian language, according to the French example, had the Lyceum as the crowning element of the French cultural influence and heritage in Albania.*

*What were the consequences of the French protectorate in the region of Korça and the socio-economic effects of their reforms on the local population? Did the pragmatism or idealism of certain French military officials set the precedent for a functional model of self-government in the country? Why did the political legacy of the French presence remain symbolic?*

*After an analysis of the various factors, placed within the historical context of the time and interweaving or comparison of different sources with each other, we conclude that Korça's autonomy was an exception to the rule and a result of the lack of long-term interests and vision in French policy towards Albania.*

***Key words:*** *Autonomy, France, Korça, military administration, politics, reforms.*



**Hyrje**

*“Një hije që jep strehë por nuk shtyp.”<sup>1</sup>*

Kështu do të shprehej vite më vonë në kujtimet e tij<sup>2</sup> koloneli Descoins në lidhje me shpalljen e krahinës autonome të Korçës në 10 dhjetor 1916 dhe që tregon simbolikisht në një farë mënyre edhe botëkuptimin dhe idetë e tij, të cilat e shtynë të ndërmerre atë akt, por edhe perceptimin e kësaj ngjarjeje nga popullsia dhe pjesëmarrësit e asaj kohe. Në një farë mënyre ai mund të konsiderohet si “ati themelues”<sup>3</sup> i autonomisë së Korçës, pasi me largimin e tij edhe autonomia e rajonit nuk do të ishte më e njëjta.

### ***Mbërritja e francezëve në Korçë***

Pas një misioni zbulimi të një skuadroni francez në mars të 1916, në qershor të 1916 gjenerali Sarraill vendos të pushtojë kazanë e Korçës. Sigurisht që ushtria franceze e Lindjes dhe komandanti i saj e morrën vendimin për arsye strategjike dhe taktike, ushtarake, në shërbim të frontit të tyre të Luftës së Parë Botërore kundër Austro-Hungarezëve dhe Bullgarëve, por njëkohësisht edhe për tu lidhur me aleatët e tyre italianë në Shqipërinë e Jugut. Në këtë mënyrë do të evitohej lënia e një hapësire të rrezikshme bosh në krahun e majtë të ushtrisë franceze, por do të ndërpritej gjithashtu edhe rruga Pogradec-Korçë-Janinë, një nyje e rëndësishme komunikimi midis Bllokut Qëndror me Athinën, ku mbreti Konstandin mbante një qëndrim kundër Antantës, krahasuar me pjesën greke të kryeministrit Venizellos<sup>4</sup>.

Mosmarrëveshjet me Italinë në lidhje me shtrirjen e trupave të tyre drejt Korçës dhe numri i pamjaftueshëm i trupave franceze dhe aleate në Selanik, përballë atyre bullgare, e vunë në dyshime gjeneralin Sarraill për t’u futur në një teatër operacionesh që konsiderohej dytësor. Skuadronet e para të kalorësisë franceze hynë në Korçë në 22 qershor 1916, por u detyruan të tërhiqen për shkak të vështirësive të furnizimit dhe ruajtjes së komunikimit me shtabin në Selanik.<sup>5</sup>

Pavarësisht këtyre pengesave objektive, reale, gjenerali Sarraill këmbënguli në idenë e tij dhe në vjeshtën e 1916 dërgon në Korçë regjimentin e parë të kalorësisë afrikane nën komandën e kolonelit Joseph Bardi de Fourtou. Në 2 tetor 1916 kazaja e Korçës ndodhet nën kontrollin e ushtrisë franceze të cilët dëbojnë forcat e armatosura greke, ndalojnë e më pas dëbojnë në Selanik funksionarët e administratës mbretërore greke.<sup>6</sup>

Në 15 nëntor koloneli Descoins do të emërohet në krye të misionit ushtarak francez në Korçë, i cili përbëhej nga dy batalione këmbësorie, njëri prej tyre me trupa

<sup>1</sup> Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)», *Revue d'Histoire de la Guerre Mondiale*, Paris, A. Costes, 1929, f. 339. (Un ombrage qui abrite mais n'écrase pas, përkthimi im).

<sup>2</sup> Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)», *Revue d'Histoire de la Guerre*

*Mondiale*, Paris, A. Costes. (Artikujt janë publikuar në numrat e tetorit 1929 dhe janarit 1930 të revistës).

<sup>3</sup> Një konsideratë të tillë do të jepte për kolonelin Descoins edhe senatori dhe shqiptarofili tjetër i madh Justin Godart, në parathënien e veprës së tij në 1925.

<sup>4</sup> Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)», ..., 1929, f.332, f.341-342.

<sup>5</sup> Stefan Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*, Thèse de doctorat de 3<sup>e</sup> cycle en Histoire, Paris, Université Panthéon-Sorbonne - Paris I, 2013, f.87-88. Sipas arkivave ushtarake italiane të cituara nga Popescu, komanda franceze kishte tentuar madje të dërgonte një batalion serb, por që u tërhoq pas një muaji për shkak të ofensivës bullgare.

<sup>6</sup> Po aty f.89.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

koloniale nga Azia Jug-lindore (Indokina), dy skuadronë kalorësish afrikanë, një kompani artilerie dhe një mitralozësh, të cilave më vonë do tu bashkohej edhe një skuadrilje e avionit luftarak francez.<sup>7</sup> Në 18 shkurt 1917 trupat franceze u bashkuan me ushtrinë italiane në veri të Ersekës<sup>8</sup>. Territori nën kontrollin francez në Shqipërinë Jug-lindore arriti shtrirjen e tij maksimale në 10 shtator 1917, pas marrjes së Pogradecit me një numër total popullsie, myslimane dhe ortodokse, prej rreth 122 mijë banorësh.<sup>9</sup>

Ngjarjet që do të ndodhin në vazhdim në Korçë do të ndikohen nga konteksti gjeopolitik i vendit dhe fuqive ndërluftuese, por kryesisht nga personaliteti dhe vullneti personal i një pjese të oficerëve të lartë francezë, roli i të cilëve do të tejkalojë detyrat e tyre ushtarake dhe në disa momente edhe do të vendosë në vështirësi politikën dhe diplomacinë franceze në raportet me aleatët e tyre evropianë dhe ballkanikë.

Duhet përmendur fakti që Franca po hynte në kontakt direkt me një pjesë të shqiptarëve duke pasur një imazh jo të mirë, për shkak të politikës së saj ballkanike në raport me pavarësinë e vendit, madje mund të themi se një pjesë e shqiptarëve e konsideronin edhe jo miqësore, si një fuqi filo-serbe apo filo-helene. Por përtej nevojave thjesht ushtarake koloneli Descoins ishte një njeri i vendosur, me personalitet, i ashpër, por njëkohësisht i komunikueshëm, inteligjent dhe i bindur në njohuritë dhe dijet e tij.<sup>10</sup>

Ai u dërgua nga gjenerali Sarraill për të zëvendësuar kolonelin Bournazel dhe administratën greke venizelliste duke përfutur edhe nga njohja e vjetër që kishte koloneli me ish-prefektin grek të Selanikut Perikli Argyropoulos, për ta bërë sa më të lehtë tranzicionin e pushtetit. Duke u bazuar edhe në kërkesat e parisë dhe popullsisë lokale gjenreali Sarraill vendosi që as esadistët, as grekët dhe as italianët, të mos të ndërhyjnë në kontrollin dhe administrimin e rajonit. Pas mbërritjes së tij në mbrëmjen e 21 nëntorit 1916 në Korçë, në 22 nëntor Argyropoulos i transferon pushtetin kolonelit Descoins, i cili pa vonesë kërkoi shpërndarjen dhe largimin e bandave të andartëve grekë nga rajoni dhe u fut në negociata me krerët shqiptarë Themistokli Gërmenji, Sali Butka etj për të ulur armët<sup>11</sup> dhe fituar besimin e popullsisë.

### **Shpallja e krahinës autonome**

Pas negociatave të suksesshme u firmos midis ushtarakëve francezë dhe krerëve shqiptarë protokollin i famshëm i 10 dhjetorit 1916, që duke parë situatën e pushtuar të pjesës tjetër të Shqipërisë, e shpalli rajonin e Korçës autonom, nën mbrojtjen ushtarake franceze. Administrimi i rajonit iu besua një këshilli prej 14 anëtarësh vendas, 7 të krishterë, 7 myslimanë dhe synimi kryesor ishte bashkëpunimi i autoriteteve lokale me ushtrinë franceze. Një oficer francez do të ishte i atashuar

<sup>7</sup> Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917) »..., 1930, f.29-30.

<sup>8</sup> Stefan Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*, 2013, f.89. Kontakti i parë ndërkohë midis dy ushtrive ishte vendosur që në javën e parë të dhjetorit 1916 në Leskovik sipas kolonelit Descoins në Général Descoins, « Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917) »..., 1929, f.329.

<sup>9</sup> Po aty f.92. Sipas të dhënave të Dhimitër Kolovanit në librin, *La Question de Koritza*, Paris, Henri Diéval, s.d.

<sup>10</sup> Jérôme Carcopino, *Souvenirs de la guerre en Orient, 1915-1917*, Paris, Hachette, 1970, f. 189-190.

<sup>11</sup> Général Descoins, « Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917) »..., 1929, f.320-321, f.324, f.328.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

gjatë gjithë kohës pranë këshillit, si i deleguar i komandantit francez. Administrata dhe xhandërmaria, të dyja me përbërje shqiptare, do të vazhdonin të ishin nën komandën franceze, gjuha shqipe u njoh si gjuhë zyrtare dhe u lejua ngritja e flamurit kombëtar shqiptar me një dekor të vogël simbolik francez.<sup>12</sup> Duhet përmendur gjithashtu fakti që anëtarët e këshillit nuk kishin një mandat të kufizuar kohor dhe në rast mungesash zëvendësoheshin nga një anëtar tjetër i po të njëjtës fe. Kryetari i këshillit ishte përherë me rotacion midis një myslimani dhe një të krishteri. Teorikisht ishte vendosur që vendimet e votuara në këshill mund të miratoheshin me 50% plus një dhe në rast barazie votash do të prevalonte vota e kryetarit, por në shumicën e rasteve këshilli u përpoq t'i miratonte vendimet e tij me unanimitet.<sup>13</sup>

Megjithëse myslimanët ishin numerikisht më të shumtë në numër, ushtarakët francezë u munduan gjatë gjithë kohës të ruanin një ekuilibër në çështjet politike dhe fetare lokale. Gjithashtu edhe nga pala shqiptare nuk u ngrit asnjë pretendim apo ankesë në lidhje me këtë ndarje të barabartë, pavarësisht trazirave dhe krimeve që kishin ndodhur në rajonin e Korçës gjatë luftërave ballkanike, popullsia lokale vazhdonte të përpiquej të ruante në raportet ndërmjet komuniteteve tolerancën dhe bashkëjetesën fetare, duke mos e përzierë atë me çështjet politike.

Ideja e anëtarëve të këshillit administrativ për ta cilësuar në dokumentet e kohës krahinën autonome të Korçës me termin *Republika shqiptare*, ishte politike më shumë sesa një çështje gjuhësore apo administrative. Synimi i tyre ishte për të afirmuar karakterin shqiptar të kësaj iniciative si etnik, gjuhësor e kulturor, por edhe politik e kombëtar gjithashtu, për aq sa do të ishte e mundur.<sup>14</sup>

Perandoria Austro-Hungareze kishte jo vetëm një eksperiencë afatgjatë, të madhe dhe pozitive në imazh, influencë dhe kontakte në raport me shqiptarët dhe çështjen e tyre kombëtare, por si shtet deri diku administrativisht federal dhe multi-etnik e kishte më të lehtë menaxhimin e popullsisë me etni, gjuhë apo besime fetare të ndryshme. Francezët nga ana tjetër vinin nga një model dhe koncept shtetëror republikan, i centralizuar dhe pa shumë njohuri apo eksperiencë në këtë rajon, veçanërisht me shqiptarët. Eksperiencia e perandorisë së tyre koloniale mund ti ndihmonte deri në një limit të caktuar, pasi konteksti gjeopolitik, realiteti dhe mentaliteti i popullsisë së Ballkanit, për më tepër në mes të një lufte, nuk ishte i njëjtë me administrimin e territoreve dhe popullsisë në kontinentet e Afrikës, Azisë etj përtej oqeanëve.

Për të gjitha këto motive oficerët francezë u treguan të kujdesshëm fillimisht në raportet e tyre me popullsinë lokale, madje në fshatrat e rajonit ata toleruan dhe promovuan modelin ekzistues organizativ, administrativ, komunal, të trashëguar edhe nga koha e Perandorisë Osmane<sup>15</sup>. Ata vendosën në bazë të eksperiencave dhe njohurive të tyre individuale, ndoshta edhe personale për disa prej tyre në kolonitë franceze, të zbatojnë në praktikë një model funksionimi të rajonit disi të veçantë, por natyrisht duke u inspiruar nga ai francez, të cilin do e vemë re në disa drejtime.

<sup>12</sup> Po aty f.337-339.

<sup>13</sup> Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917) »..., 1930, f.18.

<sup>14</sup> Po aty f.40.

<sup>15</sup> Po aty f.22 dhe Jacques Bourcart, *L'Albanie et les Albanais, avec 19 photographies prises par l'auteur et une carte hors texte*, Paris, Bossard, 1921, f. 278-279.

## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

Njëkohësisht francezët tentuan të përzgjedhin në administratën lokale njerëz të besuar, me të cilët kishin arritur të vendosnin një komunikim të afërt dhe mbajtën në detyrë një pjesë nga administrata e kaluar e qytetit, pasi siç dihet në ato vite nuk ekzistonte luks i përzgjedhjes midis një numri të madh alternativash në burimet njerëzore. Njerëzit apo familjet ku banuan oficerët francezë dhe ata që punuan me ta, kryesisht ishin pjesë të elitës së kohës të qytetit dhe rajonit të Korçës, madje shtabi madhor i ushtrisë franceze në Korçë ishte vendosur në godinën e mitropolitit të larguar grek të qytetit.<sup>16</sup>

### **Reformat e ndërmarra, gjendja dhe pasojat në sektorë të ndryshëm**

Korça ishte një qëndër urbane e madhe për Shqipërinë me rreth 24-25.000 banorë, ndoshta edhe më shumë në momente krizash si lufta.<sup>17</sup> Francezëve ju dukej një vend i këndshëm me arkitekturën dhe urbanistikën e saj moderne në një kryqëzim stilesh, kulturash dhe mentalitetesh, midis Lindjes dhe Perëndimit. Një nga aspektet e para që ju bënte përshtypje oficerëve francezë ishte pastërtia e qytetit dhe rrugëve, diçka jo e zakonshme në Ballkanin e kohës dhe jo vetëm. Përveç traditës së banorëve të qytetit për pastrimin e pjesës së rrugës para shtëpisë së tyre, francezët mbështetën këshillin administrativ për organizimin e një shërbimi publik të pastrimit të qytetit me vendosjen e disa “koshave” dhe çdo mëngjes mblidheshin mbeturinat e qytetit nga një mjet për ti dërguar në pikën e caktuar për grumbullimin e tyre,<sup>18</sup> siç tregon në letrën e tij të 29 nëntorit 1917 koloneli Ordioni.

Organizimi i territoreve shqiptare nën kontrollin francez përfshiu të gjitha drejtimet dhe nëse shohim ndarjen e detyrave specifike midis oficerëve të ndryshëm francezë në Korçë dhe roli që luajtën gjatë autonomisë, mund të themi se i ngjante deri diku një “qeverie” më shumë sesa një grupi oficerësh. Por le ti shohim me rradhë cilët ishin sektorët ku ndërhyjnë francezët për ti ngitur nga zeroja apo për ti reformuar, në rast se ata ekzistonin në çdo lloj forme apo niveli.

Që në momentet e para ata vendosën prioritetet e tyre për administrimin e rajonit. Në 27 dhjetor 1916 u miratua rregullorja e financave publike<sup>19</sup> për të mbikqyrur të ardhurat, taksat dhe shpenzimet e fondeve publike të krahinës autonome të Korçës, pra u krijua një buxhet mujor si fillim, për shkak të situatës por që do të ndryshonte më pas me stabilizimin e gjendjes së brendshme. Si risi që zbatoheshin për herë të parë në praktikë në Shqipëri mund të përmendim tatimin mbi të ardhurat, taksën e pullës në aktet zyrtare, dokumentet juridike, noteriale etj. Të ardhurat kryesore do të vinin nga taksat në lidhje me bujqësinë dhe tokën, pasi taksat mbi ndërtesat apo tregtinë në qytet që kishin ekzistuar gjatë sundimit osman ishin eliminuar prej administratës së mëparshme greke dhe francezët gjithashtu vendosën të mos i rikthejnë.<sup>20</sup>

<sup>16</sup> André Ordioni, *Un officier français dans les Balkans, Albanie et Macedoine (1917-1925)*, Dominique Danguy des Déserts, Tome I, Tiranë, Maluka, 2014, f.25.

<sup>17</sup> Për shkak të pranisë së njerëzve të ardhur në qytet për të kërkuar strehim nga lufta, sipas kolonelit Descoins, popullsia e Korçës arrinte në ato momente në rreth 40.000 banorë. Général Descoins, «*Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)*»..., 1930, f.22.

<sup>18</sup> André Ordioni, *Un officier français dans les Balkans, Albanie et Macedoine (1917-1925)* ..., 2014, f.24-26.

<sup>19</sup> SHD, 20N847, Conseil d'Administration, Règlement sur Comptabilité Publique, 27 dhjetor 1916.

<sup>20</sup> Général Descoins, «*Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)*» ..., 1930, f.19-20.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

Shpenzimet kryesore ishin të fokusuar në prioritetin nr.1 të francezëve, pjesa e rendit dhe sigurisë. Për këtë motiv u vendos krijimi i xhandërmarisë, një trupë prej rreth 300 vetësh në fillim e më pas prej gati 600 vetësh nën drejtimin e dy-tre oficerëve francezë si instruktorë dhe prefektit të ri të policisë Themistokli Gërmenji, i cili nuk ishte anëtar i këshillit administrativ. Këto trupa do të ruanin rendin publik në qytet dhe fshatra, por edhe do të mbështeste ushtarakisht sipas nevojave ushtrinë franceze në front. Nga ana tjetër shpenzimet e tjera të natyrës administrative do të synohej të mbaheshin në nivelin më minimal të mundshëm, për të mos kaluar në deficit dhe të rrezikohej balanca e brishtë sociale dhe ekonomike që po tentohej të vendosej.<sup>21</sup>

Për të luftuar spekulimin në treg, sidomos atë të monedhës, në 1 shkurt 1917 Këshilli vendosi vendosi të printojë në Korçë monedhën e krahinës autonome të Korçës, frangën shqiptare.<sup>22</sup> Siç dihet në atë periudhë në Korçë dhe në Shqipëri qarkullonin monedha dhe kartëmonedha të shteteve të ndryshme europiane, ballkanike dhe deri tek ato turke, si trashëgimi e mbetur nga Perandoria Osmane. Një masë tjetër për të evituar spekulimin e drithërave kryesisht ishte ngritja e një depoje rezervash nga ana e administratës së re.<sup>23</sup>

Së dyti në mars të 1917 këshilli i krahinës autonome urdhëroi vendosjen e pikave të doganës në kufi me Greqinë, duke afirmuar në një farë mënyre edhe autoritetin “shtetëror” në territorin e administruar prej tyre. Mund të themi se u vendos gjithashtu edhe një politikë doganore, importesh dhe eksportesh, ku mallrat e ardhura nga Greqia, pas një vendimi paraprak, u vendos të taksoheshin të gjitha, por më pas duke parë kostot ekonomike që një politikë e tillë fiskale do të kishte mbi popullsinë u vendos të përjashtoheshin nga taksimi, përveç produkteve të luksit si alkooli, duhani etj. Kurse produktet me rëndësi madhore apo parësore për jetesën, kryesisht ato bujqësore e blegtorale (lëkurat, leshi, drithërat, djathërat, frutat, perimet e ndryshme) dhe jo vetëm, që lidheshin me furnizimin direkt të popullsisë vendase dhe ushtrisë, u ndaluan të eksportoheshin jashtë territorit të krahinës.<sup>24</sup>

Francezët donin me çdo kusht të evitonin situata krizash apo urie, siç mund të kishin ndodhur në të kaluarën, që mund të shkaktonin pakënaqësi dhe revolta të cilat mund të ktheheshin në pengesën e tyre kryesore pranë vijës së frontit. Për këtë arsye ata u përpoqën të përmirësonin sa të mundnin kushtet e jetës dhe ekonominë lokale, në mënyrë që të garantonin qetësinë në front, pa u detyruar të përdorin forca ushtarake shtesë që nuk kishin luksin ti gjenin apo shpërdoronin në detyra të tjera.

Në 1917 u krijua një drejtori e re apo seksion i veçantë në administratë, Shërbimi Bujqësor. Kultura dominuese bujqësore në ato vite ishte misri, më pak gruri dhe si risi francezët futën si kulturë të re bujqësore pataten. Por rajoni dhe kodrat e qytetit të Korçës ishin mjaft të pasura edhe me vreshta dhe prodhimi i verës dikur ishte

<sup>21</sup> Po aty f.20, f.38 dhe Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917) »..., 1929, f.341-342.

<sup>22</sup> Monedhat, ashtu si edhe pullat postare të krahinës autonome u realizuan nga ushtari francez Davier, nxënës i Oscar Roty (1846-1911) një nga artistët më të njohur francezë. Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917) »..., 1930, f.37 dhe Stefan Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940) ...*, 2013, f.102.

<sup>23</sup> Jacques Bourcart, *L'Albanie et les Albanais ...*, 1921, f. 284.

<sup>24</sup> Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917) »..., 1930, f.19.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

mjaft i rëndësishëm, para se të fillonte tradita e mëvonshme e prodhimit të birrës në fundvitet 20'. Por duhet thënë se në atë periudhë rrushi dhe pjesa tjetër e frutave përdorshin kryesisht për prodhimin e rakisë.<sup>25</sup>

Për të arritur vetëmjaftueshmërinë ushqimore u hartua një plan për shfrytëzimin, punimin dhe mbjelljen më efikase dhe intensive të tokave bujqësore të krahinës së Korçës, të cilat ende nuk shfrytëzoheshin në mënyrën e duhur, pavarësisht potencialit të tyre të madh. Këtu shpesh francezët llogarisnin edhe potencialin e madh të peshkimit në atë hapësirë që ishte dikur liqeni i Maliqit, jo thjesht kënetat. Kjo reformë u arrit falë ekspertizës të një oficeri francez togerit Vuillier, i cili kishte mbaruar studimet për agronomi në Francë para se të mobilizohej në luftë. Në kujtimet e tij koloneli Descoins flet për hartimin e kontratave me fermerët vendas, të cilët pranonin dhe merrnin farat për mbjelljen falas nga ana e administratës. Në këmbim të saj fermerët pas të korrave duhet të dorëzonin dyfishin e asaj që ju ishte dhënë hua, kurse pjesën e mbetur mund ta mbanin vetë fermerët.<sup>26</sup>

Për kujdesin ndaj kafshëve, sidomos atyre që shërbenin për pjesën e transportit dhe ushtrisë, por edhe për ato të bujqësisë dhe blegtorisë së zonës u vendos të ngrihet shërbimi veterinar, i cili udhëhiqej nga një mjek ushtarak veteriner, ndihmës-majori i klasit të parë Bonhomme. Shërbimi i tij u vlerësua shumë për ekspertizën dhe ndihmën e tij falas nga ana e popullsisë vendase.<sup>27</sup>

Por Korça kishte edhe një potencial industrial, megjithëse modest, pasi në qytet dhe krahinën rreth tij ekzistonte një “industri” manufakture e prodhimit të qilimave, tapeteve, kuvertave prej leshi etj. Mund të përmendim ekzistencën e disa mullinjve me avull, disa punishteve për prodhimin e tullave etj, por gjithashtu edhe pjesën e artizanatit me prodhimin e armëve, bizhuterive prej argjendi, aksesoreve personale etj.<sup>28</sup> Kuptohet që zhvillimi i mëtejshëm i industrisë në rajon kërkonte kapitale të mëdha financiare, të cilat ishte e vështirë të gjendeshin dhe investoheshin në një kontekst të tillë. Megjithatë francezët u munduan të paktën të hulumtojnë dhe të vendosin në dukje, brenda mundësive, burimet dhe potencialet e rajonit të cilat mund të shfrytëzoheshin në të ardhmen.

Për këto arsye një tjetër fushë ndaj të cilës francezët treguan një interes të madh ishte ajo e burimeve natyrore. Rajoni i Korçës ishte një rajon i pasur me burime pyjore, minerare, ujore dhe jo vetëm. Në këtë situatë gjatë administrimit të tyre francezët vendosën të studiojnë terrenin që do të administroinin. Ata caktuan disa oficerë të tyre me formimin e nevojshëm universitar dhe shkencor para lufte, ku mund të përmendim togerin e xhenios Bidon i cili u morr me studimin e minierave dhe burimeve minerare, për shkak se ishte inxhinier minierash.<sup>29</sup> Mund të përmendim gjithashtu edhe ushtarakun tjetër francez, gjeografi i universitetit prestigjioz të Sorbonës, Jacques Bourcart, i cili kreu një studim gjeografik dhe gjeologjik të territorit nën administrimin francez që e përdori më pas për tezën e tij të

<sup>25</sup> Jacques Bourcart, *L'Albanie et les Albanais...*, 1921, f. 283-285.

<sup>26</sup> Général Descoins, «*Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)*»..., 1930, f.27.

<sup>27</sup> Po aty f.28.

<sup>28</sup> André Ordioni, *Un officier français dans les Balkans, Albanie et Macedoine (1917-1925)* ..., 2014, f.25 dhe Bourcart, Jacques, *L'Albanie et les Albanais...*, 1921, f. 286.

<sup>29</sup> Général Descoins, «*Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)*»..., 1930, f.27.

### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

doktoraturës, të cilën e publikoi pas lufte me rikthimin e tij në Francë.<sup>30</sup> Në vitet 1921-1924 ai do të publikonte një seri librash, artikujsh etj mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, duke kontribuar edhe në njohjen më të mirë të vendit nga një publik francez i kufizuar.

Një tjetër aspekt kyç që ju kushtua vëmendje ishte ai i komunikimit, për të rivendosur shërbimin postar, telegrafik dhe atë telefonik, megjithëse ky i fundit përdorej vetëm prej francezëve kryesisht. Zona e Korçës njihej edhe në atë periudhë për emigracionin dhe diasporën e madhe në SHBA dhe jo vetëm.<sup>31</sup> Nuk duhet harruar fakti që edhe në ato vite remitancat apo ndihmat financiare që emigracioni shqiptar dërgonte për familjet e tyre ishin shumë të rëndësishme, gjë që fatkeqësisht vazhdon edhe sot si fenomen madhor social dhe ekonomik. Francezët u ndeshën me një gjendje dramatike në këtë sektor, pasi morrën kontrollin e situatës, si pasojë e veprimeve të mëparshme të administratës greke e cila e kishte limituar në minimum shërbimin postar, madje pothuajse e kishte nxjerrë jashtë shërbimit në pjesën më të madhe të tij.

Në këto rrethana, këshilli dhe koloneli Descoins vendosën të rivendosin fillimisht shërbimet bazike që ishin dëmtuar dhe më pas të mendonin edhe deri diku në “afatgjatë” se si do të mbijetonte ekonomkisht ky shërbim i rëndësishëm për ushtrinë, administratën dhe popullsinë. Vendimi madhor në këtë drejtim ishte printimi në qytet i pullave të reja postare, të cilat do të mbanin edhe simbolikat e reja shqiptare të krahinës autonome. Të ardhurat nga taksa e pullave shërbyen për ringritjen dhe mirëmbajtjen e këtij shërbimi, gjatë gjithë periudhës së funksionimit të tij. Shpërndarja e postës nëpër fshatrat e rajonit gjatë kësaj kohe ju caktua xhandërmarisë shqiptare.<sup>32</sup>

Për ngritjen, mirëmbajtjen dhe funksionimin e një rrjeti rrugor dhe mjeteve të transportit, por edhe për të drejtuar të gjithë sektorët e punëve publike në tërësi, francezët emëruan kapitenin Dumont i cili kishte pasur më herët eksperiencë si inxhinier urash dhe rrugësh në Azinë e vogël. Ata nëpërmjet trupave të tyre dhe mijëra vendasve të punësuar në të gjithë pjesën e sektorëve të punëve publike garantonin jo vetëm objektivat e tyre ushtarakë, por edhe “paqen sociale”, falë mobilizimit civil të popullsisë e cila merrte të njëjtin trajtim ushqimor si ushtarët francezë, por edhe një pagë të rregullt ditore.<sup>33</sup> Në bashkëpunim edhe me italianët, ata mirëmbanin rrugën kryesore Sarandë-Korçë-Follorinë-Selanik, e cila u kthye në aksin më të rëndësishëm ushtarak, ekonomik etj në jug të Shqipërisë midis dy ushtrive të Antantës.

Për shkak të mungesës së numrit të njaftueshëm të mjeteve automobilistike francezët vendosën të organizojnë rrjetin e transportit me karvanë, duke përdorur kafshët e punës vendase, kryesisht kuaj, mushka etj, duke u inspiruar nga një model i ngjashëm me atë që përdorej në Marok në atë periudhë. Togerit i kalorësisë Gastel

<sup>30</sup> Jacques Bourcart, *L'Albanie et les Albanais...*, 1921, f. 286 dhe Jacques Bourcart, *Les Confins albanais administrés par la France (1916-1920). Contribution a la géographie et à la géologie de l'Albanie moyenne*, Paris, Librairie Delagrave, 1922.

<sup>31</sup> Général Descoins, «*Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)*»..., 1930, f.21.

<sup>32</sup> Général Descoins, «*Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)*»..., 1930, f.20-21.

<sup>33</sup> Po aty f.26-27.

### “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

u emërua në krye të organizimit të shërbimit të karvanëve të furnizimit. Sipas kolonelit Descoins, para largimit të tij në maj të 1917, kishte mbi 1200 kuaj transporti që ishin në shërbim të nevojave të ushtrisë franceze dhe jo vetëm.<sup>34</sup>

Në aspektin juridik francezët organizuan planin për ngritjen e institucioneve të drejtësisë. Në 19 mars 1917 u krijua këshilli i luftës i territorit të Korçës, në përbërje të të cilit ishin vetëm oficerët francezë. Ky këshill merrej kryesisht me çështjet e rënda penale, krimet, shkeljet e ndryshme, problemet e sigurisë dhe çështjet ushtarake. Pak muaj pas krijimit të tij, në 21 maj 1917 hyn në fuqi kodi i ri penal, sipas modelit francez, i cili parashikoi krijimin e një këshilli të rendit dhe policisë, i cili do të kishte kompetenca të kufizuara, si psh lufta kundër spekulimit dhe spekulatorëve në treg, çështjet ordinere të zakonshme të rendit publik etj. Këto këshilla do të ishin në rolin e gjykatave. Një vit më pas, tanimë nën administrimin e drejtpërdrejtë ushtarak francez, në 17 qershor 1918 u ngrit gjykata e faktit në Korçë, e cila do të kishte në kompetencat e saj të gjykonte të gjitha çështjet e lidhura me shkeljen e ligjeve dhe rregullave apo thyerjes së disiplinës në territorin e rajonit.<sup>35</sup>

Për pjesën e çështjeve civile, tregtare, administrative, francezët, sipas edhe eksperiencave të mëparshme në kolonitë e tyre por edhe për të përforcuar ndjenjën e autonomisë tek shqiptarët, vendosën të mbajnë në fuqi dhe të njohin autoritetin dhe juridiksionin e gjykatave fetare, duke mos u përzierë më problemet e zakonshme familjare të popullsisë lokale si divorcet, martesat, trashëgimitë etj.<sup>36</sup>

Një tjetër element i influencës së modelit francez është edhe fakti se menaxhimi i çështjeve fetare në gjysmën e parë të vitit 1917 i kaloi pjesës laike të administratës, drejtorisë së arsimit.<sup>37</sup> Si përfundim mund të përmendim faktin se, në bashkëpunim me togerin francez Siegfried, këshilli i krahinës autonome gjatë periudhës së funksionimit të tij përpunoi, miratoi dhe shpalli 25 ligje, kode dhe rregullore të ndryshme. Ky korpus juridik do të shërbente për të rregulluar marrëdhëniet publike dhe private në fusha dhe çështje të ndryshme, institucionale, penale, fiskale, administrative, bashkiake, pronësore, shëndetësore, arsimore, agrare, minerare etj.<sup>38</sup> Në fushën e shëndetësisë situata ishte edhe më dramatike se në drejtimit e tjera, për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe ilaçeve të mjaftueshme, pavarësisht ekzistencës së farmacive në qytet.<sup>39</sup> Prandaj një reformë u ndërmorr edhe në këtë sektor tejet të rëndësishëm, jo vetëm për popullsinë por edhe në kontekstin e luftës. Personeli shëndetësor, francez dhe vendas, i cili drejtohej nga një mjek ushtarak majori Danos, do të kujdesej për trupat dhe për të gjithë popullsinë. U ngrit fillimisht në shkurt 1917 një spital ushtarak nën drejtimin e një mjeku tjetër ushtarak majorit Canonne, me një shërbim ambulancash, me shërbim kirurgjikal, të cilat ishin mjaft efikase për kohën dhe një risi për Shqipërinë. Kushtet e vështira pas hapjes të spitalit arritën të përmirësohen gradualisht edhe falë autoriteteve shqiptare. Një vit më pas

<sup>34</sup> Po aty f.27-28.

<sup>35</sup> SHD, 20N848, Rapport sur le fonctionnement du Conseil de guerre du Territoire de Kortcha, 1918 dhe Territoire de Kortcha, Règlement portant création d'un Tribunal Prévôtal, 17 qershor 1918.

<sup>36</sup> Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)»..., 1930, f.23.

<sup>37</sup> Stefan Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*., 2013, f.96.

<sup>38</sup> Justin Godart, *L'Albanie en 1921: Mission de M. Justin Godart*, Paris-La Flèche, Dépôt des publications de la Conciliation, 1921, f.283-284.

<sup>39</sup> André Ordioni, *Un officier français dans les Balkans, Albanie et Macedoine (1917-1925)*., 2014, f.26.



## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

në tetor të vitit 1918, nën administrimin ushtarak francez, u krijua në Korçë spitali civil, edhe ky sipas modelit francez dhe që do të jepte një kontribut shumë të madh në luftën kundër sëmundjeve mjaft të përhapura në popullsinë e rajonit të Korçës, gjatë atyre viteve.<sup>40</sup>

### ***Krijimi i Liceut franko-shqiptar***

Dhe në fund, por jo më pak e rëndësishmja, nga të gjitha fushat e përmendura, ajo ku kontributi dhe influenca franceze do të mbetej edhe në aspektin afatgjatë, do të ishte arsimiti.

Sipas kolonelit Descoins në Korçë në momentin e mbërritjes së francezëve ekzistonin një gjimnaz dhe dy shkolla fillore greke me rreth 2.000 nxënës, një shkollë arumune, dhe disa shkolla myslimane. Në disa fshatra ekzistonin shkolla të tjera të klerit mysliman dhe greke. Ajo që i bashkonte të gjitha këto institucione arsimore ishte fakti se në asnjërën prej tyre mësimi nuk zhvillohej në gjuhën shqipe. Kërkesa e banorëve të Korçës, myslimanë dhe të krishterë, ishte hapja e një shkolle laike, jo fetare, publike dhe mbi të gjitha shqiptare, e cila jo vetëm do të mundësonte mësimin e gjuhës shqipe por edhe do të forconte lidhjet dhe bashkimin kombëtar midis dy komuniteteve.<sup>41</sup>

Në 1917 u ngrit gjithashtu edhe një komision shkollor apo drejtoria e arsimit, nën kryesimin e shqiptarëve. Francezët nën komandën e kolonelit Descoins që në fund të vitit 1916 vendosën të rielejnin hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe mbylljen e atyre në gjuhën greke, përveç gjimnazit grek të Korçës, i cili konsiderohej si shkolla më e mirë në qytet dhe rajon deri në ato momente. Pas këtij vendimi u hapën rreth 200 shkolla fillore shqipe në territorin e krahinës.<sup>42</sup>

Me largimin e kolonelit Descoins në maj 1917, masave të marra për reduktimin e autonomisë dhe ndryshimeve që po ndodhnin në vjeshtën e 1917 në terren, hapja e Liceut francez të Korçës në gjuhët shqip dhe frëngjisht në 25 tetor 1917 ishte një surprizë e madhe për popullsinë vendase. Ky do të ishte një moment historik, jo vetëm për qytetin dhe rajonin por edhe për të gjithë vendin, pasi Liceu ishte shkolla e parë e mesme publike dhe laike, deri në fillim të viteve 20' kur hapet gjimnazi i shtetit në Shkodër.

Liceu në kontekstin e Luftës dukej si një projekt i përealizueshëm për shkak të mungesës së infrastrukturës së përshtatshme, burimeve njerëzore, teksteve etj. Por dërgimi i Vital Gerson nga misioni laik i Selanikut si drejtor i shkollës do të ishte momenti i zbatimit në terren të vendimit për ngritjen e shkollës. Ai do të bashkëpunonte me 3 profesorë vendas, një oficer francez Recoing dhe do të merrej edhe me trajnimin e tyre dhe të tjerëve në periudhën në vijim, për shkak të eksperiencës së tij të gjatë. Gjatë vitit të parë shkollor 1917-1918 Liceu pati të regjistruar vetëm 36 nxënës. Tre vitet e ardhshme deri në 1921 numri i nxënësve nuk i kaloi 50, pavarësisht mbylljes edhe të gjimnazit grek të qytetit në vitin shkollor 1920-1921, pas largimit të francezëve, i cili kishte rreth 100 nxënës por shihej si

<sup>40</sup> Général Descoins, «Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)»..., 1930, f.28, f.35-36.

<sup>41</sup> Po aty f.23.

<sup>42</sup> Lyceum, e përkohëshmjia e liceut të Korçës, viti i parë, numër i vetëm, korrik 1936, f. 12.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

rrezik ndaj ndjenjave kombëtare shqiptare.<sup>43</sup> Ndërkohë duhet përmendur fakti se shkollat fillore greke u lejuan të rihapen në disa fshatra në shtator të vitit 1918 dhe po mendohej rihapja e të tjerave, fakt për të cilin gjenerali Salle, i cili anulloi vendimet e Descoins, informonte ministrin e jashtëm grek Politis.<sup>44</sup>

Shkolla u hap në një godinë modeste aty ku sot ndodhen pallatet në sheshi në krah të kinemasë së qytetit dhe synimi kryesor ishte mësimi i gjuhës shqipe dhe asaj franceze, përhapja e kulturës frënge etj. Fillimisht siç dihet shkolla nuk e kishte të gjithë strukturën akademike të plotë dhe as atë institucionale etj, të cilat u plotësuan me kalimin e kohës gjatë viteve 20-30' me kontributin financiar të këshillit, më pas të shtetit shqiptar apo edhe të prindërve të nxënësve, filantropëve dhe banorëve të Korçës. Në provimet e fundit të vitit shkollor, gjatë verës së vitit 1919, drejtori Gerson fton edhe komandantin francez të rajonit me oficerët të merrnin pjesë me një vizitë gjatë zhvillimit të tyre.<sup>45</sup>

Por mbarimi i luftës dhe rikthimi i pronares së shtëpisë ku banonte në Korçë nga Selaniku, pamundësia për të gjetur një banesë të re për familjen, e detyruan atë ti kërkojë komandantit francez, në fund të korrikut 1919, ndihmë për rimbursimin, qoftë edhe të pjesshëm, të shpenzimeve dhe organizimit të udhëtimit deri në Marsejë me familjen e tij. Ai e argumentoi kërkesën e tij si shenjë mirënjohjeje nga ana e Francës për shërbimin e gjatë jashtë atdheut në Orient, edhe në Tuniz dikur. Ai përmend gjithashtu faktin që 3 nga djemtë e tij kishin shërbyer gjatë luftës në ushtri, ku njëri ishte plagosur dhe një tjetër kishte humbur jetën në Francë.<sup>46</sup> Duke i transmetuar kërkesën e tij komandës eprorë në Maqedoni, komandanti francez i Korçës kërkonte t'i plotësohej kërkesa familjes Gerson.<sup>47</sup> Do të duhej të prisnim fillimin e vitit shkollor 1921-1922 që të rishihnim një drejtor të ri francez në krye të Liceut, Leon Monbouyan.

Liceu, ai siç e njohim dhe përfytyrojmë sot, në ato vitet e para 1917-1920 ishte ende një shkollë e thjeshtë, modeste dhe akoma shumë larg nivelit dhe prestigjit që do të arrinte më pas në nivel kombëtar dhe pse jo deri diku edhe ndërkombëtar. Mungesat dhe vështirësitë e hasura në vitet e para do të plotësoheshin dhe tejkaloreshin gradualisht, falë një pune të vazhdueshme dhe serioze nga ana e stafit dhe autoriteteve lokale dhe qëndrore. Gjithsesi pavarësisht kontekstit të komplikuar ku u hap dhe funksionoi Liceu arriti të mbijetojë dhe rezistojë, për tu konsoliduar më pas me kalimin e viteve.

Por ndërkohë çfarë kishte ndodhur në kontekstin politik dhe ushtarak që ndikoi në zbehjen e autonomisë së krahinës dhe abrogimin e saj. Si u mbyll aventura e krahinës autonome dhe cili ishte procesi i largimit të francezëve.

### ***Abrogimi i autonomisë, pasojat dhe tërheqja e francezëve nga Korça***

Lënia e duarve të lira kolonelit Descoins në terren në një rajon të vogël, në periferi të Europës, shkaktoi një stuhi diplomatike në Paris që i hapi shumë kokëçarrije

<sup>43</sup> Lyceum, e përkohëshmjia ..., 1936, f.12-14.

<sup>44</sup> Ștefan Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*, 2013, f.117.

<sup>45</sup> SHD, 20N857, "Instruction publique", letër e 5 korrikut 1919.

<sup>46</sup> SHD, 20N857, "Instruction publique", letër e 29 korrikut 1919.

<sup>47</sup> SHD, 20N857, "Instruction publique", letër e 2 gushtit 1919.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

gjeneralit Sarraill, i cili u mundua të mbrojë dhe justifikojë vendimet e vartësit të tij. Por përtej presionit politik dhe diplomatik, në 11 maj 1917, koloneli Descoins largohet nga Korça pasi komanda e lartë franceze ishte e pakënaqur me politikën e tij personale dhe sidomos raportet që ai dërgonte në Manastir dhe Selanik mbi burimet e tij shqiptare në lidhje me Bullgarët dhe Austro-Hungarezët apo takimi që zëvendësi i tij Massiet kreu pranë Sali Butkës, akt që u pa si ulje e prestigjit të Francës.<sup>48</sup>

Pas largimit të tij krahina autonome do të fillonte gradualisht të humbiste autonominë e zgjeruar dhe kompetencat e saj, për shkak edhe të presionit të Quai D’Orsay për të kënaqur dhe qetësuar aleatët ballkanikë, Esat Pashë Toptanin, por edhe ata italianë. Në 27 shtator 1917 gjenerali Sarraill vendosi të abrogojë protokollin e 10 dhjetorit 1916, pa u mbushur ende viti i firmosjes së tij dhe e kaloi krahinën e Korçës nën një statut të ri. Administrimi i territorit ju besua komandantit francez të grupimit të Maliqit dhe me zbatimin e urdhërave, vendimeve të tij, u ngarkua një oficer francez me titullin Administrator i deleguar. Këshilli administrativ u zëvendësua me një këshill konsultativ me 12 anëtarë, dy më pak se i mëparshmi, përsëri i ndarë në gjysëm ortodoksë dhe gjysëm myslimanë, por pa kompetencat e vjetra.<sup>49</sup>

Territori i rajonit u vendos të ndahej në dy zona, në jug zona e Korçës dhe në veri ajo e Pogradecit. Akti që i vendosi vulën praktikisht apo de facto eliminimit të pushtetit në duart e shqiptarëve do të ishte arrestimi, gjykimi e më pas pushkatimi në Selanik i Themistokli Gërmenjit, prefektit të policisë të Korçës, në 12 nëntor 1917, me akuzën e bashkëpunimit me armikun. De jure, abrogimin e autonomisë shqiptare të Korçës, do ta kërkonte po në nëntor 1917 ministri i jashtëm francez Stefan Pichon. Vendimi zyrtar për abrogimin e krahinës autonome u morr nga gjenerali Jules-Henry Salle, komandant i grupimit të Maliqit, në 16 shkurt 1918, duke eliminuar edhe atë autonomi minimale, të kufizuar, që kishte mbetur në muajt e fundit. Megjithatë pavarësisht se zyrtarisht territori kaloi nën administrimin e drejtpërdrejtë të ushtarakëve francezë, shqiptarët vazhduan të mbanin postet e tyre në administratën lokale, por pa fuqi vendimmarrëse tashmë.<sup>50</sup>

Pas firmosjes së armëpushimit në 11 nëntor të 1918, në vitet 1919-1920 trupat franceze, që tashmë kishin avancuar deri në Shkodër dhe Shqipërinë e Veriut përtej Korçës apo edhe në drejtime të tjera në Ballkan, do të merrnin urdhrin nga autoritetet franceze për tu tërhequr nga Ballkani dhe nga territoret shqiptare.<sup>51</sup>

Shqipëria nuk ishte pjesë e interesave madhore të strategjisë politike dhe diplomatike të Francës në Ballkan dhe vendi ishte paracaktuar edhe nga traktati i fshehtë i Londrës si një territor që do të ndahej midis fqinjëve, ku fuqia kryesore që do të kishte rolin dominant do të ishte Italia. Por pavarësisht mungesës së interesave madhorë, francezët do të gjenden në një situatë të vështirë midis popullsisë vendase, kërkesave të aleatëve të tyre serbë e grekë, por edhe presionit italian.

Pavarësisht dhënies së garancive diplomatike aleatëve të tyre, francezët ishin

<sup>48</sup> Jérôme Carcopino, *Souvenirs de la guerre en Orient ...*, 1970, f.191-195.

<sup>49</sup> Stefan Popescu, *L’Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*, 2013, f.101.

<sup>50</sup> Po aty f.101.

<sup>51</sup> Po aty f.116.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

informuar për pozicionin që fuqia e re e madhe botërore SHBA-të kishin marrë në raport me Shqipërinë dhe jo vetëm. Kësisoj ata po diskutonin të mos lejonin futjen e trupave jugosllave dhe greke në territoret shqiptare, sipas kufijve të vitit 1913, deri në Konferencën e Paqes. Në mars 1920 francezët arritën të tërheqin batalionin e tyre nga Shkodra<sup>52</sup>, por për trupat franceze në Pogradec dhe Korçë situata ishte më e komplikuar, edhe për shkak të lajmeve që qarkullonin se ky rajon do t'i kalonte Greqisë dhe francezët i druheshin shpërthimit të një konflikti në një zonë të cilën arritën ta administrojnë pothuajse paqësisht për më shumë se tre vjet.

Fillimisht duke mbështetur aleatët e tyre italianë dhe grekë, pas paktit Titoni-Venizellos, francezët këshilluan grekët që të tregoheshin të kujdesshëm nqs donin të merrnin nën kontroll rajonet e Korçës dhe Gjirokastrës. Negociatat franko-helene kulminuan me marrëveshjen e 21 gushtit 1919 midis gjeneralit francez Nayral de Bourgon dhe atij grek Leonidas Paraskevopoulos, sipas të cilit forcat greke mund të pushtonin rajonin e Korçës.<sup>53</sup> Siç dihet reagimi i fortë shqiptar dhe konteksti gjeopolitik ndërkombëtar i detyruan francezët dhe grekët të heqin dorë nga plani i tyre fillestar.<sup>54</sup>

Korça do të mbetet nën administrimin shqiptar pas tërheqjes së trupave franceze, deri në momentin e caktimit të kufijve shqiptarë nga Konferenca e Paqes në Paris. Kjo marrëveshje u zyrtarizua në 28 maj 1920 me protokollin shqiptaro-grek të Kapshticës, në prezencë të të dy palëve, por duhet thënë se grekët luajtën bllofin në negociatat me shqiptarët. Siç do mund të vërtetohej më vonë, grekët nuk kishin pasur forcat e duhura ushtarake për një pushtim të tillë, pasi ushtria e tyre ishte përqëndruar kryesisht në Azinë e vogël, për shkak të fillimit të luftës Greko-Turke.<sup>55</sup> Pothuajse një muaj pas kësaj marrëveshjeje, në 21 qershor 1920, trupat franceze do të tërhiqeshin përfundimisht drejt Selanikut,<sup>56</sup> duke i dhënë fund qëndrimit të tyre pothuajse katër vjeçar në Shqipëri dhe duke përmbyllur një kapitull që la gjurmë të thella në memorien historike të Korçës dhe shqiptarëve.

### *Trashëgimia franceze*

Reformat dhe organizimi që tentuan dhe zbatuan francezët në Korçë nuk ishte diçka e re në vetvete si akt, por ajo që e bëri unike krahinën autonome është vizioni dhe veprimet e kolonelit Descoins. Këto veprime të cilat ndikuan në rrjedhën e historisë koloneli Descoins, ashtu si edhe gjenerali Sarraill, do t'i justifikonin në publikimet që bënë pas luftës me urgjencën e përshtatjes me realitetin faktik në terren dhe situatën e frontit.<sup>57</sup>

Ajo që është e veçantë për tu përmendur gjatë komandës së tij 6-mujore në Korçë është procesi i transformimit nga filo-helen në filo-shqiptar të bindur i kolonelit Descoins, një kthesë prej gati 180 gradësh nga qëndrimet e tij të mëhershme si njeri.

<sup>52</sup> Ștefan Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*, 2013, f.116-117.

<sup>53</sup> Po aty f.117 dhe Lyceum, *e përkohëshmjia ...*, 1936, f. 12.

<sup>54</sup> Ardit Bido, *Autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë në marrëdhëniet shqiptaro-greke, 1918-1937*, Disertacion doktorature në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Tiranë, Universiteti i Tiranës, 2015, f.12

<sup>55</sup> Po aty f.12-16.

<sup>56</sup> Ștefan Popescu, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*, 2013, f.118.

<sup>57</sup> Général Sarraill, *Mon commandement en Orient (1916-1918)*, Paris, Flammarion, 1920. Kurse Descoins do të përdorte si një nga justifikimet për veprimet e tij mospasjen dijëni mbi Traktatin e fshehtë të Londrës të vitit 1915. Général Descoins, « *Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916-mai 1917)* »..., 1929, f.323.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

Kjo metamorfozë shqiptarofile e kolonelit në një kohë kaq të shpejtë gjatë qëndrimit të tij në Korçë me sa duket e tejkaloi limitin e neutralitetit të synuar nga eprorët e tij. Paslufta do të tregojë se influenca franceze në Shqipëri mbeti e limituar kryesisht në Korçë dhe më shumë në aspektin social, kulturor dhe deri diku atë ekonomik. Kjo e fundit pasi u favorizua tregtia dhe akumulimi i kapitalit vendas, si dhe nga ana tjetër ushtria franceze i blinte produktet në krahinën e Korçës me çmime më të larta se vendasit. Në qytetin e Korçës një kategori tjetër njerëzish që përfituan ekonomikisht nga prezenca ushtarake franceze ishin qeradhënësit e shtëpive në Korçë ku banuan oficerët francezë, pronarët e të cilëve përfituan nga mundësia e papritur për të ngritur nivelin e qerave dhe për të fituar më shumë.<sup>58</sup>

Në Korçë shihet qartë rezultati i reformave *Descoinsiane*, të cilat përmirësuan administrimin, shërbimet publike, arsimore dhe shëndetësore, rritën cilësinë e jetës së banorëve dhe ekonominë. Gjithashtu masat e marra në lidhje me gjuhën, flamurin, autonominë dhe shkollat, pavarësisht se deri diku jetëshkurtëra, ndikuan edhe në rritjen e krenarisë dhe vetëdijësimit kombëtar shqiptar në Korçë.

Një element tjetër për t’u përmendur është trashëgimia financiare e krahinës autonome të Korçës. Sipas kolonelit Descoins administrata greke i kishte lënë bosh financat e qytetit por që në 6 mujorin e parë deri në maj të 1917 u prodhua një sufiçit buxhetor prej disa qindëra mijë frangash dhe deri në 16 shkurt 1918 kur u abrogua autonomia ky sufiçit kishte arritur në mbi 2,9 mln franga.<sup>59</sup> Në 1919, një vit pas armëpushimit, ushtarakët francezë ndanë me autoritetet lokale shqiptare të Korçës fondet të cilat ishin krijuar si rrjedhojë e sufiçitit të buxheteve, gjatë viteve të administrimit nën protektoratin e ushtrisë franceze.<sup>60</sup> Pas bashkimit zyrtar të Korçës me Shqipërinë në 1920 fondet e mbetura në thesarin lokal i kaluan qeverisë së Tiranës në buxhetin e saj.

### **Përfundime**

Përveç stafit pedagogjik francez të Liceut, modelit të administrimit dhe institucioneve të ngritura gjatë qëndrimit në rajon, prezencën franceze në Korçën e pasluftës e gjejmë edhe në kujtimet e njerëzve që e jetuan atë periudhë, por edhe simbolikisht në vendosjen e emrave të disa oficerëve francezë rrugëve të qytetit.<sup>61</sup> Franca do të mbetet ende prezente falë mësimin të gjuhës dhe studimit të një numri jo të vogël studentësh shqiptarë bursistë dhe jo bursistë në universitetet franceze midis dy luftërave. Lidhja e tyre shpirtërore me kulturën franceze mbeti fija që mbajti gjallë edhe në momentet më të errëta, shpresën e një afrimi më të madh midis dy shteteve në një të ardhme.

Në konkluzion mund të themi se rasti i Korçës ishte një përjashtim nga rregulli dhe

<sup>58</sup> Ștefan Popescu, *L’Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*..., 2013, f.118.

<sup>59</sup> Général Descoins, «*Six mois d’histoire de l’Albanie (novembre 1916-mai 1917)* »..., 1930, f.37 dhe Justin Godart, *L’Albanie en 1921*..., 1921, f.283.

<sup>60</sup> Ștefan Popescu, *L’Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*..., 2013, f.119. Sipas Popescut, zyra e financave në Korçë i dorëzoi kapitenit Bouchard, oficer i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë franceze në Maqedoni shumë e 1,2 mln frangave franceze, të cilat u depozituan në thesar me rikthimin në Francë. Kurse pjesa tjetër e fondeve rreth 2 mln franga u mbajt nga autoritetet lokale në Korçë. Një pjesë e këtyre fondeve të cilat ishin në bono të qeverisë franceze do të refuzoheshin që ti riktheheshin më pas shtetit shqiptar nga ana e ministrisë franceze të mbrojtjes.

<sup>61</sup> Justin Godart, *L’Albanie en 1921*..., 1921, f.93-94 dhe Général Descoins, «*Six mois d’histoire de l’Albanie (novembre 1916-mai 1917)* »..., 1930, f.41.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

një aventurë personale e një koloneli, gjenerali apo grupi oficerësh dhe jo e një politike të mirëfilltë shtetërore franceze, madje gjatë disa muajve mund të themi se doli gati edhe kundër saj. Ky distancim dhe qëndrim nga francezët në raport me Shqipërinë e asaj periudhe mund të kuptohet si një rezultat i mungesës së interesave të mëhershme dhe afatgjatë për të ardhmen. Në vizionin e diplomacisë franceze vendi konsiderohej nga Parisi si një zonë influence italiane dhe prandaj dominon të evitonin çdo konflikt sado të vogël apo hipotetik, të mundshëm, me Romën. Njëkohësisht qëndrimi francez mund të shihet edhe si çështje prioritesh rajonale, pasi Franca kishte ndërtuar dhe po vazhdonte të ndërtonte lidhje të forta dhe aleanca me fqinjët ballkanikë të Shqipërisë. Si rrjedhojë ajo nuk mund të prishte ekuilibrat dhe të dëmtonte interesat e tyre me vendimet e saj.

Por për shqiptarët kjo ngjarje mbetet e një rëndësie historike kombëtare, pasi jo vetëm arriti të ruajë territorin dhe popullsinë, brenda mundësive, nga asimilimi, dhuna dhe pushtimi grek, por u kthye gjithashtu në një model shumë të mirë praktik dhe të suksesshëm të qeverisjes lokale, duke treguar kështu një rrugë apo mënyrë se si mund të zhvillohej shoqëria dhe ekonomia e shtetit shqiptar në vijim. Për fat të keq edhe ato pak modele të mira në Shqipëri nuk e kanë jetën e gjatë dhe impaktin real, duke parë edhe rrjedhën e mëpasshme të ngjarjeve në historinë e vendit.

Për këtë arsye mendoj se mbetet detyrë e historianëve, kërkuesve shkencorë, profesorëve, studiuesve, mësuesve etj, që të ndikojnë në promovimin në shoqëri, veçanërisht tek të rinjtë, në media, pranë institucioneve lokale e qëndrore, të këtyre modeleve pozitive nga e kaluara, jo thjesht për hir të trashëgimisë dhe ruajtjes së kujtesës historike të një kombi, por për të gjetur tek to elementë të vlefshëm dhe pse jo për t'i përshtatur e zbatuar në kontekstin e ditëve tona.

### **Bibliografi**

#### **Burime arkivore:**

SHD Service Historique de la Défense, (Arkivi i ministrisë së mbrojtjes në Vincennes, Francë), Seria N, 20 N 843-860, territoire et place de Koritza, groupement de Malik et confins albanais (territori i Korçës, grupimi i Maliqit dhe kufijtë shqiptarë).

#### **Burime dhe kujtime të publikuara:**

Bourcart, Jacques, *L'Albanie et les Albanais, avec 19 photographies prises par l'auteur et une carte hors texte*, Paris, Bossard, 1921.

Bourcart, Jacques, *Les Confins albanais administrés par la France (1916-1920). Contribution a la géographie et à la géologie de l'Albanie moyenne*, Paris, Librairie Delagrave, 1922.

Carcopino, Jérôme, *Souvenirs de la guerre en Orient. 1915-1917*, Paris, Hachette, 1970.

Descoins, Général, *Six mois d'histoire de l'Albanie (novembre 1916 - mai 1917)*, Paris, A. Costes, 1929, 1930.

Godart, Justin, *L'Albanie en 1921: Mission de M. Justin Godart, introduction de M. d'Estournelles de Constant*, Paris-La Flèche, Dépôt des publications de la Conciliation, 1921.

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

Godart, Justin, *L'Albanie en 1922: l'enquête de la Société des Nations, introduction de M. d'Estournelles de Constant*, Paris-La Flèche, Dépôt des publications de la Conciliation, 1922.

Lyceum, *e përkohëshmjia e liceut të Korçës*, viti i parë, numër i vetëm, korrik 1936.

Ordioni, André, *Un officier français dans les Balkans, Albanie et Macedoine (1917-1925)*, Dominique Danguy des Déserts, Tome I, Tiranë, Maluka, 2014.

Sarrail, Général, *Mon commandement en Orient (1916-1918)*, Paris, Flammarion, 1920.

**Artikuj, libra, studime:**

Bido, Ardit, *Autoqefalia e Kishës Ortodokse të Shqipërisë në marrëdhëniet shqiptaro-greke, 1918-1937*, Disertacion doktorature në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Tiranë, Universiteti i Tiranës, 2015.

Elsie, Robert, *Historical Dictionary of Albania*, 2<sup>nd</sup> edition, Historical Dictionaries of Europe, N°. 75, Plymouth, Scarecrow Press, 2010.

Iordachi, Constantin, « Surmonter l'orientalisme: nouvelles approches de l'histoire moderne des Balkans », *Critique internationale*, (N° 63), Paris, Presses de Sciences Po, 2014. f. 173-180.

Mousset, Albert, *L'Albanie devant l'Europe: 1912-1929*, Paris, Delagrave, 1930.

Popescu, Stefan, *L'Albanie dans la politique étrangère de la France (1919-juin 1940)*, Thèse de doctorat de 3<sup>e</sup> cycle en Histoire, Paris, Université Panthéon-Sorbonne - Paris I, 2013.

**ROLI DHE NDIKIMI I GRAVE NË JETËN INTELEKTUALE DHE POLITIKE NË KORÇË GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE**

**Dajana SARAÇI**

Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë  
Universiteti “Fan S. Noli”

**Abstrakt**

*Gjatë Luftës së Parë Botërore, roli i grave në jetën intelektuale dhe politike të Korçës, si dhe në të gjithë Shqipërinë, ishte i rëndësishëm dhe i shumanshëm. Në këtë periudhë, gratë filluan të angazhohen më aktivisht në çështjet shoqërore, politike dhe kulturore, duke sfiduar normat tradicionale të shoqërisë patriarkale. Gjatë periudhës 1912-1920, Korça ishte një qendër e rëndësishme kulturore dhe arsimore në Shqipëri, dhe gratë intelektuale luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin e jetës intelektuale dhe shoqërore.*

*Gratë e Korçës, veçanërisht ato të shtresave të mesme dhe të larta, si në shumë qytete të tjera, luajtën një rol aktiv në përparimin e arsimit dhe të kulturës, ku shumë prej tyre ishin të lidhura me lëvizjet për arsimim kombëtar, duke ndihmuar në rritjen e nivelit të arsimit dhe vetëdijes kombëtare. Ndër kontributet më të rëndësishme ishte përfshirja e tyre në hapjen e shkollave shqipe dhe mësimdhënie, duke përhapur gjuhën dhe kulturën kombëtare. Përmendim rolin e Sevasti Qiriazit, e cila ishte ndër gratë e para që u përfshi në përpjekjet për të themeluar shkolla për vajzat shqiptare, sikundër ishte hapja e shkollës së parë për vajza në Korçë në vitin 1891, e cila e shtriu kontributin e saj edhe politikisht në përpjekjet për mbrojtjen e identitetit shqiptar në një periudhë kur Shqipëria rrezikohej nga forcat e huaja.*

*Gjithashtu, arsimitare dhe veprimtare e njohur ishte edhe motra e vogël e Sevastisë, Parashqevi Qiriazit e cila luajti rol të madh në përhapjen e edukimit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e alfabetit shqip. Veçanërisht gjatë kohërave të vështira të luftës, ajo u përfshi në veprimtari patriotike dhe politike, duke marrë pjesë në Kongresin e Manastirit për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe në konferenca ndërkombëtare për njohjen e Shqipërisë si shtet i pavarur. Një figurë tjetër e rëndësishme intelektuale që kontribuoi për përhapjen e gjuhës shqipe, kulturës dhe veprimtarisë humantiare gjatë luftës ishte dhe Gjergjina Tashko. Frosina Konda ishte një tjetër mësuese dhe veprimtare e shquar, e cila luajti gjithashtu rol të rëndësishëm në edukimin e vajzave. Ajo kishte një ndërgjegjësim të fortë politik dhe kombëtar, prandaj ishte pjesë e lëvizjeve të rezistencës kundër ndikimeve të huaja. Një figurë femërore e njohur patriotike dhe politike nga Korça ishte dhe Marie Curcia, e cila kontribuoi në lëvizjen kombëtare shqiptare dhe punoi për të ndihmuar në mbrojtjen e qytetit nga forcat e huaja. Ndër të tjera për kontributin e tyre të shquar përmendim dhe disa gra të tjera nga Korça si: Vasilika Kola- një nga figurat e njohura të arsimit, e angazhuar në krijimin e shkollave për vajzat. Margarita Koliqi- shkrimtare dhe aktiviste, e cila kontribuoi në letërsinë shqiptare dhe ishte e angazhuar në lëvizjet për të drejtat e grave.*

*Sofia Koka- mësuese dhe aktiviste, e cila luajti një rol të rëndësishëm në promovimin e arsimit dhe barazisë gjinore. Anastasia Kola- një figurë e njohur në fushën e*



## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

kulturës dhe artit, e cila kontribuoi në zhvillimin e aktiviteteve kulturore në Korçë. Dora Dosti- aktiviste e njohur për të drejtat e grave dhe një mbështetëse e arsimit për vajzat.

Lufta e Parë Botërore krijoi një vakuum politik në shumë rajone të Shqipërisë, prandaj, në këtë suazë, gra nga qyteti i Korçës u përfshinë në çështjet politike. Ato filluan të angazhohen në aktivitete politike duke u bërë pjesë e lëvizjeve kombëtare e duke përhapur idetë e pavarësisë, autonomisë dhe të drejtatve të shqiptarëve. Gjithashtu, organizonin protestat dhe manifestimet për të kërkuar ndryshime dhe për të mbështetur luftën për liri. Disa gra morën pjesë aktive në luftë, në mënyra të ndryshme, madje edhe si infermiere, duke ndihmuar ushtarët e plagosur dhe duke ofruar mbështetje logjistike. Ato luajtën rol të rëndësishëm në mbështetje të forcave që luftonin për pavarësi. Angazhimi i grave në këto fusha ndihmoi në rritjen e vetëdijes kombëtare dhe në forcimin e identitetit shqiptar. Këto gra ishin një forcë motivuese për ndryshime dhe përparim, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të bashkuar.

Pra, roli i grave në jetën intelektuale dhe politike të Korçës gjatë Luftës së Parë Botërore ishte një faktor kyç në transformimin e shoqërisë shqiptare. Ato jo vetëm që sfiduan normat e kohës, por gjithashtu ndihmuan në ndërtimin e një shoqërie më të barabartë dhe më të vetëdijshme për të drejtat e individëve. Angazhimi i grave në arsim, politikë, luftë dhe kulturë ishte një hap i rëndësishëm drejt emancipimit dhe përmirësimit të statusit të tyre në shoqëri.

**Fjalë kyçe:** intelektuale, fuqitë e huaja, mësuese, ndërgjegje kombëtare, Korça, patriote, shkolla shqipe.

### **Abstract**

*During the First World War, the role of women in the intellectual and political life of Korça, as well as in the whole of Albania, was important and multifaceted. In this period, women began to engage more actively in social, political and cultural issues, challenging the traditional norms of patriarchal society. During the period 1912-1920, Korça was an important cultural and educational center in Albania, and intellectual women played an important role in the development of intellectual and social life.*

*The women of Korça, especially those in the middle and upper classes as in many other cities, played an active role in the advancement of education and culture, where many of them were associated with movements for national education, helping to increase level of education and national awareness. Among the most important contributions was their involvement in the opening of Albanian schools and teaching, spreading the national language and culture, where we mention the role of Sevasti Qiriazhi, who was among the first women involved in the efforts to establish schools for Albanian girls. such as the opening of the first school for girls in Korca in 1891, which extended its contribution politically to the efforts to protect the Albanian identity in a period when Albania was threatened by foreign forces. Sevastia's younger sister, Parashqevi Qiriazhi, was also a well-known educator and*

### **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

activist, who played a major role in spreading education and raising awareness of the importance of the Albanian alphabet, especially during the difficult times of the war, she was involved in patriotic and political activities, participating in the Congress of Bitola for the protection of the rights of Albanians and in international conferences for the recognition of Albania as an independent state. Another important intellectual figure who contributed to the spread of the Albanian language, culture and humanitarian activity during the war was Gjergjina Tashko. Frosina Konda was another prominent teacher and activist who played an important role in the education of girls, as well as having a strong political and national awareness, where she was part of resistance movements against foreign influences. A well-known patriotic and political figure from Korça was Marie Curcia, who contributed to the Albanian national movement and worked to help defend the city from foreign forces. Among others, we mention several other women from Korça for their outstanding contribution, such as:

- Vasilika Kola: One of the well-known figures of education, engaged in the creation of schools for girls.

-Margarita Koliqi: A writer and activist, who contributed to Albanian literature and was engaged in movements for women's rights.

-Sofia Koka: A teacher and activist, who played an important role in promoting education and gender equality.

-Anastasia Kola: A well-known figure in the field of culture and art, who contributed to the development of cultural activities in Korça.

-Dora Dosti: A well-known activist for women's rights and a supporter of education for girls.

The First World war created a political vacuum in many regions of Albania, therefore women from the city of Korça became involved in political issues. They began to engage in political activities, becoming part of national movements spreading the ideas of independence, autonomy and the rights of Albanians. They also organized protests and demonstrations to demand changes and support the fight for freedom. Some women took an active part in the war, as nurses, helping wounded soldiers and providing logistical support. They played an important role in supporting the forces fighting for independence. The involvement of women in these fields helped to increase national awareness and strengthen the Albanian identity. These women were a driving force for change and progress, contributing to building a stronger and more united society.

In conclusion, the role of women in the intellectual and political life of Korça during the First World War was a key factor in the transformation of Albanian society. They not only challenged the norms of the time, but also helped build a more equal society and more aware of the rights of individuals. The involvement of women in education, politics, war and culture was an important step towards their emancipation and improving their status in society.

**Keywords:** Intellectual, Foreign Powers, Teacher, National Consciousness, Korça, Patriots, Albanian School

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Nga fundi i shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, Shqipëria nisi të zhvillohej nga pikëpamja politike, ekonomike dhe shoqërore. Vështirësitë e krijuara, për shkak të kushteve të ndërlikuara, nuk e penguan konsolidimin e shqiptarëve si komb, për rritjen e lëvizjes kombëtare dhe zhvillimin e përparimin e saj. Rilindja Kombëtare Shqiptare ishte një lëvizje e gjithanshme, me përmbajtje ideologjike, politike, ekonomiko-shoqërore, kulturore dhe organizative. Qëllimi i saj ishte të çlironte vendin nga pushtuesit osmanë, të bashkonte trojet shqiptare në një shtet të vetëm dhe të pavarur dhe t'i hapte rrugën zhvillimit të vendit.<sup>62</sup>

Periodha e Rilindjes solli përparimet e veta veçanërisht tek gjuha shqipe që ishte tipari themelor i kombit shqiptar dhe një nje bashkuese mes shqiptarëve. Tashmë, konsolidimi i kombit shqiptar solli dhe përhapjen e mëtejshme të gjuhës shqipe, që do të sillte dhe kapërcimin e prapambetjes në shkrim dhe lexim.<sup>63</sup>

Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, një kontribut të shquar kanë dhënë edhe motrat Qiriazi, të cilat, që në moshë të vogël ishin rritur më dashuri për atdheun dhe me zell të madh për të mësuar dhe përhapur gjuhën shqipe. Pavarësisht vështirësive, synimi i tyre ishte që bashkë me vëllanë, Gjerasimin, të hapnin një shkollë për vajza. Motrat Qiriazi shpreheshin se tashmë kishte ardhur koha që gjuha shqipe të lulëzonte dhe të mbahej gjallë, duke u mësuar si duhet nga brezi i ri. Shkollat e tyre do të përgatitnin mësueset e ardhshme. Sevastinë, që në moshën 5-vjeçare, prindërit do ta dërgonin në shkollën greke të qytetit, për faktin se përdorimi i gjuhës shqipe ishte i ndaluar dhe nuk mendohej të kishte një shkollë të tillë. Nga shkolla greke e Manastirit, Sevastia ruante kujtime të mira për drejtoreshën e saj, e cila ishte shqiptare, por e arsimuar në Athinë. Ajo ruante ndjenjat për gjuhën shqipe dhe vendin. *“Ajo u kujdesua shumë për mua, -shkruante ajo, - unë shkoja me dëshirë në shkollë dhe nuk pata vështirësi të mësonja, të lexonja dhe të shkruanja greqishten”*.<sup>64</sup> Sevastia nuk e vazhdoi gjatë këtyre shkollë. Shkak u bë sëmundja e saj. Një ditë, kur ishte shtrirë në shtrat nga ethet e forta, me dhimbjet e saj ajo tërhoqi vëmendjen e misionarit amerikan zotit Xheni, i cili u ndodh në oborrin e shkollës amerikane që ishte ngjitur me shtëpinë e Qiriazëve. Kur ai merr vesh për sëmundjen e vogëlushes, ai e viziton menjëherë duke i dhënë barnat e duhura dhe që nga ai moment e vizitonte shpesh Sevastinë derisa u shërua plotësisht.<sup>65</sup>

Do të ishte ky, shkak që midis Sevastisë së vogël dhe zotit Xheni do të lindte një miqësi e ngushtë. Ai e ftoi Sevastinë të vazhdonte të ndiqte studimet tek shkolla e tij. Zoti Xheni u bë sebeb që nëna të më hiqte nga shkolla greke, edhe për arsyen që shkolla e tyre ishte ngjitur me shtëpinë tonë.<sup>66</sup> Në kohën që Sevastia ndiqte studimet në shkollën amerikane, Gjerasimi sapo ishte çliruar nga çeta e Shahin Matrakut. Në vitin 1885 midis nxënësve që mësonin shqip bënte pjesë edhe Sevastia. Në këtë kohë ajo shkruan në kujtimet e saj: *Mësova të lexonja e të shkruaja gjuhën tonë amëtare*.<sup>67</sup> Gjithë formimin ajo ia kushtonte vëllait të saj Gjerasimit. *Që në fillim më udhëhiqte*

<sup>62</sup> Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe*, (Tiranë: 8 nëntori, 1964), 9.

<sup>63</sup> *Po aty*, 11.

<sup>64</sup> Instituti për Studime Shqipëtare dhe Protestante, *Jeta ime Jëtëshkrimi i pabotuar i “Mësueses së Popullit” Sevasti Qiriazi-Dako*, (Tiranë: ISShP, 2016), 15

<sup>65</sup> *Po aty*

<sup>66</sup> AQSH, *Fondi 42, Sevasti Qiriazi*, D.2, 8.

<sup>67</sup> Instituti..., 17.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

dhe drejtonte që të kuptoja vlerën e vërtetë të arsimit dhe si duhej jetuar dhe punuar në dobi të mëmëdheut. Gjithçka që më thoshte mbetej thellësisht e rrënjësuar në mendjen time dhe kur u nisa në Stamboll, kishte diçka konkrete në mendjen time se cili do të ishte qëllimi i jetës dhe detyra ime në të ardhmen.<sup>68</sup>

E ushqyer me ndjenjën e dashurisë për atdheun, me krenarinë për t’i shërbyer popullit për arsimimin e tij, Sevastia e priti me gëzim të madh lajmin për vazhdimin e studimeve të larta në Stamboll, në kolegjin amerikan për vajza.<sup>69</sup> Sevastisë i bëri shumë përshtypje ceremonia e pritjes së studentëve dhe ishte shumë e emocionuar për eksperiencën e re. Ajo, duke kuptuar nevojën urgjente, e vetëdijshme për detyrën që e priste, kërkoi me këmbëngulje që të ndiqte mësimet drejtpërdrejt në vitin e dytë: *U thashë se isha gati t’u nënshtrohem provimeve dhe se duhej të përfundoja studimet sa më parë për të ndihmuar vëllanë të çelte një shkollë për vajzat në Shqipëri.*<sup>70</sup> Në të njëjtën kohë, e ndihmuar dhe prej shoqërisë së gjerë të vëllait të saj Gjerasimit, në Stamboll Sevastia ra në kontakt me patriotë si Naim Frashëri, Mid’hat Frashëri, Shahin Kolonja etj. Një shembull guximtar dhe patriotik i Sevastisë ishte ai në burgun famëkeq të Judi Kules, me rilindasin shqiptar Koto Hoxhi. Në burg ishte e ndaluar të hynin femra. Sevastia preu flokët shkurt, u vesh si një burrë shqiptar dhe iu paraqit drejtorit të burgut si i ardhur nga Shqipëria vetëm dhe vetëm për të takuar mësuesin e vet të dikurshëm.<sup>71</sup> Pas disa kohësh, me ndërhyrjen e vetë Naim Frashërit, i cili punonte si nëpunës i arsimit në Stamboll, Sevasti Qiriazit iu dha e drejta për çeljen e shkollës së vashave në Shqipëri. Ajo kthehet në Manastir duke iu vënë punës për hapjen e shkollës në fjalë, por nuk ishte aq e lehtë, ashtu siç e kishte menduar. Autoritetet osmane të vendit, por edhe kleri ortodoks, do të bënin gjithçka për ta ndaluar hapjen e shkollës. Ata thurnin plane deri në zhdukjen fizike të Gjerasimit dhe Sevastisë. Duke mos e realizuar dot planin e tyre, vendosën të përhapin fjalë kudo, që shkolla e vashave që do të hapej në Korçë kishte për qëllim t’i kthente shqiptarët në protestantë.<sup>72</sup> Në të vërtetë, Gjerasimi dhe Sevastia u ndihmuar për hapjen e shkollës prej shoqërive misionare angleze dhe amerikane, të cilët kishin për qëllim zgjimin e vetëdijes nacionale shqiptare. Kjo vihej re në programin që Sevasti Qiriazit bëri vetë për shkollën e vashave, duke u përpjekur të futë aty një frymë kombëtare.<sup>73</sup>

Shkolla e vashave u hap në Korçë, por si fillim numri i vajzave ishte i ulët. Falë miqësisë me patriotë të Stambollit, Sevastia siguroi disa tekste në gjuhën amtare. Ajo u përpoq gjithashtu të ndikojë në arsimimin dhe emancipimin e vashave të këtyre trevave, që të dilnin sa më shpejt nga një botë e mykur, pavarësisht se cilit religion fetar i përkisnin. Kur dëgjonin për motrat Qiriazit, gratë shqiptare bashkoheshin për t’i dëgjuar.<sup>74</sup>

Një tjetër kontribut i Sevastisë do të ishte thirrja e saj në Manastir, në kuvendin ku do të diskutohej dhe flitej për shkronjat dhe alfabetin shqip. Sevastia u prit më shumë

<sup>68</sup> AQSH, *Fondi...*, 14.

<sup>69</sup> Dhimitër Dishnica, *Motrat Qiriazit*, (Tiranë: Enciklopedia, 1997), 26.

<sup>70</sup> *Po aty*

<sup>71</sup> Dishnica, *Motrat...*, 28.

<sup>72</sup> *Po aty*, 29.

<sup>73</sup> *Po aty*, 30.

<sup>74</sup> *Po aty*, 32.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

përzemërsi në Manastir. Aty ajo u takua me personalitete të kulturës shqiptare si: Ndre Mjeda, Sotir Peci, Gjergj Fishta, Mid'hat Frashëri, Luigj Gurakuqi etj.<sup>75</sup> Gjatë ditëve të zhvillimit të Kongresit të Manastirit, Sevastia qëndroi tek shtëpia e vëllait të saj Gjergjit, e cila u vendos plotësisht në shërbim të kongresit. Në Kongres Sevastia përkrahu alfabetin latin. Në bisedat e saj të fshehta në shtëpinë e vëllait, ajo ishte njohur gjithashtu me idetë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke mbështetur fuqishëm veprimtarinë e lëvizjes kombëtare. Sevastia nuk doli për të mbajtur ligjëratë në kuvend, pasi ajo u druhej veprimeve të turqve të rinj, të cilët herë pas here kishin bërë plane për t'ia mbyllur shkollën e vashave. Prandaj preferoi heshtjen dhe veprimtarinë ilegale.

Pavarësisht kësaj, ajo mbështeti ngjarjet e mëdha që pasuan në Ballkan dhe në Shqipërinë e saj. Ashtu sikundër ishte vendosur në kongresin e Manastirit, një tjetër kongres i alfabetit u thirr në Elbasan, ku do të vlerësohej rruga e nisur, do të shiheshin pengesat dhe si mund të kapërceheshin ato. Edhe në këtë kongres Sevastia do të zgjidhej si delegate e Korçës. Së bashku më miqtë e vet iu drejtua Elbasanit. Sevastia u çudit nga pritja që iu bë delegatëve të Korçës në Elbasan. Në kujtimet e saj ajo shkruante: *Dyshoj nëse Qezari kur hyri në Romë, me gjithë lavdinë e fitoreve të tij, të ketë ndjerë këtë gëzim që ndjemë ne delegatët në këtë rast. Gëzimi ynë nuk vinte nga nderi që po na bëhej, por nga fakti se të gjithë shqipëtarët, gëzoheshin për lirinë që kishim fituar në përdorimin e gjuhës tonë, në shkollat që patëm çelur. Ndjenim se porta e hekurt e paditurisë ishte rrëzuar dhe tani në Shqipëri mund të hynte gëzimi dhe lumturia.*<sup>76</sup>

Si e vetmja delegate grua, Sevasti Qiriazi u dëgjua me respekt të veçantë në të teta ditët që zhvilloi punimet Kongresi i Elbasanit. Ajo do të ishte ndër nismëtarët e hapjes së shkollës Normale e cila do të përgatiste mësuese duke i dhënë kështu një shtytje më të madhe zhvillimit të arsimit kombëtar.<sup>77</sup>

Me nismën e Sevastisë, në dhjetor të vitit 1909, në qytetin e Korçës u organizua një tubim në të cilin morën pjesë rreth 15.000 vetë që mbushën sheshet dhe rrugët e qytetit, duke kërkuar që të mos pengohej arsimimi kombëtar shqiptar. Madje, disa ditë para tubimit, vetë Sevastia shkroi disa vargje me shkronjat shqipe. Këto vargje ia dha orkestrës frymore të qytetit dhe kënga u kompozua brenda pak ditësh. Në ditën e tubimit, orkestra frymore shpërndante melodinë, ndërsa qytetarët këndonin pas saj. Jehona e tubimit të Korçës nxiti shumë nxënës që të largoheshin masivisht nga shkollat turke dhe greke dhe shprehën gatishmërinë për të mësuar gjuhën shqipe.<sup>78</sup> *Vajzat bojkotuan shkollën greke dhe kaluan në shkollën shqipe të vashave në Korçë e cila është mbushur plot e përplot.*<sup>79</sup> *Kombi kurrë s'ka për të harruar shërbimet e zonjës Sevasti Qiriazi dhe shoqeve të saj, të cilat punuan pa rreshtur e me vullnet të madh dhe që dëshirojnë që shkolla të madhohet e të përpunonjë lart e më lart.*<sup>80</sup> Në vjeshtën e vitit 1912, edhe pse Porta e Lartë ra përfundimisht dhe

<sup>75</sup> Instituti..., 36.

<sup>76</sup> AQSH, *Fondi Sevasti Qiriazi*, d 9, 7.

<sup>77</sup> Instituti..., 40.

<sup>78</sup> *Po aty*, 51.

<sup>79</sup> *Shypja e Shqypnijas*, (Sofje: 2 shkurt 1910).

<sup>80</sup> *Liria*, (Selanik: 19 qershor 1910).

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

Ismail Qemali ngriti flamurin në Vlorë, Korça, Starova, Kolonja dhe Gjirokastra ishin ende të pushtuara nga ushtria greke. Grekët ishin të parët që kontrolluan gjendjen në Korçë dhe vranë disa mësues shqiptarë. Madje, ata rrethuan disa herë edhe shkollën e vashave, brenda së cilës Sevastia mbante një grup të armatosur. Çetat e Sali Butkës dhe Çerçiz Topullit patën lajmëruar priftërinjtë grekë se, *nëse andartë do të futeshin në shkollën e vashave, atëherë flakët e zjarrit do të shkonin deri në Selanik*. Pavarësisht se mësimit vazhdonin fshehurazi, Sevastia u jepte zemër mësueseve dhe nxënëseve të saj, duke folur që ditë të bardha do u vinin.<sup>81</sup>

Gjithashtu, Sevastia shfrytëzoi vizitën e Edit Durham në Korçë, në pranverën e vitit 1913 dhe e ftoi atë të hynte në shkollën e vashave. Falë inteligjencës së saj dhe anglishtes së shkëlqyer që zotëronte, Sevastia e vendosi në dijeni Durhamin me të gjitha llojet e politikave të ndyra me të cilat grekët donin të rrëmbenin Korçën. Madje, ajo e shoqëroi atë në disa shtëpi ku kishin trokitur priftërinjtë grekë, për t'u marrë me dhunë korçarëve firmat, për gjoja bashkimin e tyre me Greqinë. Sevastia, me anën e vëllait të saj Gjergjit, Shahin Kolonjës dhe atdhetarëve të tjerë, përgatiti një dosje të plotë me dokumente që bënin fjalë për masakrat greke në jugun e Shqipërisë.<sup>82</sup> Këto dokumente autentike, Edit Durhami i dërgoi në dhomën e lordëve në Angli, duke dhënë një ndihmesë të konsiderueshme për çështjen shqiptare, madje, në një letërkëmbim, Durhami i shkruante Sevastisë, *është kryesisht ndihma juaj dhe e miqve tuaj, që unë u interesova për fatin e shqiptarëve në këto treva... Gjatë këtyre viteve, unë kam dedikuar shumë punë dhe mendimë për kauzën tuaj*.<sup>83</sup>

Qershori i vitit 1914 do të ishte tejet i trishtueshëm për korçarët, por sidomos për vashat që uleshin në bankat e shkollës së Sevastisë. Forcat greke e rrethuan shkollën e vashave, por nuk hynin dot pasi u trembeshin luftëtarëve shqiptarë. Në këtë situatë, vashat filluan të largoheshin nga shkolla. Bashkë me to do të largohej edhe Sevastia, por një letër e komandës ushtarake greke e ndalonte atë të dilte nga shkolla. Kësaj gjendjeje i dolën përballë disa atdhetarë shqiptarë, të cilët organizuan arratisjen e Sevastisë nga shkolla e vashave ku qëndronte e mbyllur. Mbi 200 luftëtarë shqiptarë hynë në mesnatën e 12 korrikut në Korçë dhe fshehurazi vranë disa andartë pranë shkollës. Të gatshëm për të filluar luftën ata e nxorën Sevastinë nga shkolla dhe e dërguan në Manastir. Andartët grekë, të detyruar prej Fuqive të Mëdha, u larguan nga Korça dhe Kolonja. Ende jo shumë larg tyre, ata u informuan se misionet e huaja ishin larguar për në Tiranë. Pas këtij informacioni u dyndën duke vranë e duke djegur kryesisht çdo shqiptar që ishte mysliman, por pa kursyer edhe të krishterët patriotë. Ndërsa ndiqte ngjarjet nga Manastiri, Sevastia do të shkruante: *U takova këto ditë me konsullin anglez në Manastir, zotin Greg. Jo pa shqetësim ai më tregoi listën e personave që do të ekzekutoheshin nga andartët grekë. Në këtë listë unë isha e treta...*<sup>84</sup>

Në fund të vitit 1914, Sevastia së bashku me motrën e saj Parashqevinë, por edhe me burrin e saj Kristo Dako, udhëtuan për në Amerikë. Të dyja motrat filluan atje veprimtarinë e tyre, si në aspektin politik dhe atë publicistik, duke ndikuar në

<sup>81</sup> Dishnica, *Motrat...*, 41.

<sup>82</sup> Instituti..., 57.

<sup>83</sup> AQSH, *Fondi Sevasti Qiriazzi*, d,10, 19.

<sup>84</sup> AQSH, *Fondi Sevasti Qiriazzi*, d,2, 67.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

ndërgjegjësimin e shqiptarëve për shkollën dhe gjuhën e tyre kombëtare. Sevasti Qiriazi, në fillim të vitit 1918, duke parë turbullirat ballkanike, si dhe gjendjen tejet të vështirë në Shqipëri, iu drejtua me një manifest të veçantë ambasadorëve të Europës, duke ua bërë të qartë se shqiptarët pavarësisht qeverive, do të luftonin me armë në dorë për të mbrojtur të drejtat e tyre kombëtare. Madje, një kopje të këtij manifesti, ajo ia dërgoi dhe mikeshës së ngushtë të shqiptarëve, Edit Durhamit, me qëllim që ajo të publikonte mendimin intelektual të shqiptarëve. Në përgjigjen që Edit Durhami i dërgonte Sevastisë kohë më pas, lidhur me këtë manifest i shkruante: *Sapo lexova manifestin tënd, jam shumë e emocionuar për të gjithë atë ç’ka keni shkruar... kam porositur 100 kopje prej tij dhe do t’i dërgoj tek ata persona që do të mund të binden që ta konsiderojnë çështjen shqiptare në mënyrë të favorshme. Në tërësi manifesti është shumë i mire, në fakt ai dukej.*<sup>85</sup>

Gjithashtu, Sevastia mbante korrespondenca të shumta me atdhetarë shqiptarë, dhe ndiqte me vëmendje lëvizjet diplomatike të fqinjëve tanë. Ajo mundi të parashikonte rrezikun italian pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Për këtë, Sevastia i ka dërguar letra edhe ambasadorit italian në Amerikë. Ndërkohë, edhe Ismail Qemali i shkruante Sevastisë për këtë rrezik. Mes të tjerash i thoshte: *koha erdhi dhe shkon, për të kërkuar të drejtat e Shqipërisë. Sot është dita e fundit për Shqipërinë, do ta ngjallim apo do të vdesim.*<sup>86</sup>

Pas Luftës së Parë Botërore, Fuqitë e Mëdha po përhapnin çdo ditë e më shumë, opinionin se “Shqiptarët nuk qeverisnin dot”. Ata vendosën që, edhe ato troje të mbetura shqiptare të viheshin nën protektoratin italian. Edhe në këto rrethana puna e Sevastisë ishte kolosale. Ajo u dërgoi me dhjetra letra e memorandume, por edhe peticione, personaliteteve europiane dhe amerikane, madje protestoi fort me zërin e saj në konferencën e Paqes në Paris.<sup>87</sup>

Një kontribut të rëndësishëm ka luajtur dhe motra e saj Parashqevi Qiriazi. Në vitin 1908, ajo ishte e deleguara e shkollës së vashave, në ngjarjen historike të Kongresit të Manastirit, ku u caktua sekretare e njëmbëdhjetë burrave të respektueshëm, që do të zgjidhnin problemin e alfabetit shqip. Më pas, në vitin 1909 ajo shkroi abetaren sipas alfabetit të ri. Sigurisht, bashkë me të motrën punuan fort për emancipimin e grave shqiptare, duke themeluar në Korçë në vitin 1912 shoqatën e parë të grave “Ylli i Mëngjesit”.

Me fillimin e Luftës së Parë Botërore në vitin 1914 ajo u largua fillimisht në Bukuresht e më pas, në 1915 në Amerikë.<sup>88</sup>Në Boston, qytetin ku u vendos, ia kushtoi të gjithë punën, vëmendjen dhe energjinë vendit të saj dhe emancipimit të grave shqiptare, përmes themelimit dhe botimit të revistës shqiptaro-amerikane “Ylli i Mëngjesit” (nga viti 1917 deri në 1920). Në vitin 1919 shkoi në Paris si e vetmja diplomate shqiptare në Konferencën e Paqes.

Në fillim të vitit 1920 Parashqevia u kthye në atdhe, me Sevastinë dhe kunatin e saj Kristo Dako. Ata vazhduan misionin dhe punën e tyre për edukimin e vajzave shqiptare, duke themeluar më pas dhe institutin “Qiriazi” (Kyrias) për vajza, të hapur

<sup>85</sup> Po aty, 25.

<sup>86</sup> AQSH, *Fondi Ismail Qemali*, d.1, 4.

<sup>87</sup> Dishnica, *Motrat...*, 42.

<sup>88</sup> Po aty

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

afër Tiranës, që do të nxirrte mësuese. Ato do të jepnin kontributin e tyre në shkollat e hapura për arsimimin e brezave.<sup>89</sup> Një moment shumë i rëndësishëm për shkollën e vashave ishte dhe diplomimi i mësueseve të para si: Polikseni Dhespoti, Efigjeni Pendavinji, Helidhona Fani, të cilat do të shërbenin si mësuese të ciklit të ulët.<sup>90</sup>

Synimi i shkollave shqipe dhe vetë misioni i motrave Qiriazi nuk ishte vetëm të përgatiste dhe edukonte femrën shqiptare për të ardhmen, por ai ishte edhe më madhor. Ashtu siç e cilësonte Sami Frashëri femrën shqiptare si *“shtyllën e kombit”*, nga kjo shkollë do të dilnin arsimtaret heroina që do të luftonin për emancipimin kombëtar dhe shoqëror.

Lufta e Parë Botërore krijoi një vakuum politik në shumë rajone të Shqipërisë, prandaj, në këtë suazë, gra nga qyteti i Korçës u përfshinë në çështjet politike. Ato filluan të angazhohen në aktivitete politike, duke u bërë pjesë e lëvizjeve kombëtare e duke përhapur idetë e pavarësisë, autonomisë dhe të drejtave të shqiptarëve. Gratë organizonin protesta e manifestime për të kërkuar ndryshime dhe për të mbështetur luftën për liri. Disa prej tyre morën pjesë aktive në luftë, madje edhe si infermiere, duke ndihmuar ushtarët e plagosur dhe duke ofruar mbështetje logjistike. Ato luajtën rol të rëndësishëm në mbështetje të forcave që luftonin për pavarësi. Angazhimi i grave në këto fusha ndihmoi në rritjen e vetëdijes kombëtare dhe në forcimin e identitetit shqiptar. Këto gra ishin një forcë motivuese për ndryshime dhe përparim, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të bashkuar.<sup>91</sup>

### **Përfundime**

Nga fundi i shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, Shqipëria nisi të zhvillohej nga pikëpamja politike, ekonomike dhe shoqërore. Vështirësitë e krijuara, për shkak të kushteve të ndërlikuara, nuk e penguan konsolidimin e shqiptarëve si komb, për rritjen e lëvizjes kombëtare dhe zhvillimin e përparimin e saj. Kjo lëvizje u quajt Rilindja Kombëtare Shqiptare dhe ishte lëvizje e gjithanshme, me përmbajtje ideologjike, politike, ekonomiko-shoqërore, kulturore dhe organizative. Qëllimi i saj ishte të çlironte vendin nga pushtuesit osmanë, të bashkonte trojet shqiptare në një shtet të vetëm dhe të pavarur dhe t'i hapte rrugën zhvillimit të vendit.

Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, një kontribut të shquar kanë dhënë edhe motrat Qiriazi, të cilat, që në moshë të vogël ishin rritur më dashuri për atdheun dhe me zell të madh për të mësuar dhe përhapur gjuhën shqipe. Pavarësisht vështirësive, synimi i tyre ishte që bashkë me vëllanë, Gjerasimin, të hapnin një shkollë për vajza. Motrat Qiriazi shpreheshin se tashmë kishte ardhur koha që gjuha shqipe të lulëzonte dhe të mbahej gjallë, duke u mësuar si duhet nga brezi i ri dhe shkollat e tyre do të përgatitnin mësueset e ardhshme.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, roli i grave në jetën intelektuale dhe politike të Korçës, si dhe në të gjithë Shqipërinë, ishte i rëndësishëm dhe i shumanshëm. Në këtë periudhë, gratë filluan të angazhohen më aktivisht në çështjet shoqërore, politike dhe kulturore, duke sfiduar normat tradicionale të shoqërisë patriarkale. Sevasti Qiriazi është emri më i spikatur i intelektualëve shqiptare të kohës për të

<sup>89</sup> Po aty, 74.

<sup>90</sup> “Mësuesi”, Artikulli i Kristo Frashëri, “Shkolla e Vashave dhe platforma e saj pedagogjike”, 21 tetor 1986.

<sup>91</sup> Po aty



## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

gjitha sfidat që përballoi në ato kohëra të mëdha historike.

Gjatë periudhës 1912-1920, Korça ishte një qendër e rëndësishme kulturore dhe arsimore në Shqipëri. Intelektualet e Korçës, veçanërisht ato të shtresave të mesme dhe të larta, si në shumë qytete të tjera, luajtën një rol aktiv në përparimin e dijes dhe të kulturës. Shumë prej tyre ishin të lidhura me lëvizjet për zgjim kombëtar, duke ndihmuar në rritjen e nivelit të arsimimit dhe vetëdijes kombëtare. Parashqevi Qiriazi luajti rol të madh në përhapjen e edukimit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e alfabetit shqip. Veçanërisht gjatë kohërave të vështira të luftës, ajo u përfshi në veprimtari patriotike dhe politike, duke marrë pjesë në Kongresin e Manastirit për mbrojtjen e të drejtave dhe alfabetit të gjuhës së shqiptarëve, si dhe në konferenca ndërkombëtare për njohjen e Shqipërisë si shtet i pavarur.

Figurë tjetër e rëndësishme femërore e intelektuale, që kontribuoi gjatë luftës për përhapjen e gjuhës shqipe, kulturës dhe veprimtarisë humanitare ishte dhe Gjergjina Tashko. Gjithashtu, Frosina Konda ishte një tjetër mësuese dhe veprimtare e shquar, e cila luajti rol të rëndësishëm në edukimin e vajzave dhe kishte një ndërgjegjësim të fortë politik dhe kombëtar. Ajo ishte pjesë e lëvizjeve të rezistencës kundër ndikimeve të huaja. E njohur për veprimtarinë patriotike dhe politike, nga Korça ishte edhe Marie Curcia, e cila kontribuoi në lëvizjen kombëtare shqiptare dhe punoi shumë për të ndihmuar në mbrojtjen e qytetit nga forcat e huaja.

Roli i grave në jetën intelektuale dhe politike të Korçës gjatë Luftës së Parë Botërore ishte një faktor kyç në transformimin e shoqërisë shqiptare. Ato jo vetëm që sfiduan normat e kohës, por gjithashtu ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të barabartë dhe më të vetëdijshme për të drejtat e individëve. Angazhimi i grave në arsim, politikë, luftë dhe kulturë ishte një hap i rëndësishëm drejt emancipimit dhe përmirësimit të statusit të tyre në shoqëri.

### **BIBLIOGRAFIA**

Dishnica, Dhimitër. *Motrat Qiriazi*. Tiranë: Enciklopedike, 1997.

Instituti për Studime Shqipëtare dhe Protestante, *Jeta ime Jetëshrimi i pabotuar i “Mësueses së Popullit” Sevasti Qiriazi-Dako*. Tiranë: ISShP, 2016.

Instituti për Studime Shqipëtare dhe Protestante, *Gjerasimi*. Tiranë: ISShP, 2016.

Myzyri, Hysni. *Shkollat e para kombëtare shqipe*. Tiranë: 8 nëntori 1964.

Gazeta “*Liria*”. Selanik, 19 qershor 1910.

Gazeta “*Mësuesi*”. Artikulli i Kristo Frashëri. “*Shkolla e Vashave dhe platforma e saj pedagogjike*”. 21 tetor 1986.

Gazeta “*Shypja e Shqypnijas*”. Sofje: 2 shkurt 1910.

Fondi Ismail Qemali, Dosja 1.

Fondi Sevasti Qiriazi, Dosja 2, 9, 13.

## SHOQËRITË KULTURORE NË KORÇË DHE SHKODËR NË VITET '20- ROLI I HILË MOSIT NË LËVIZJET KULTURORE- PATRIOTIKE NË KORÇË E SHKODËR GJATË KËSAJ PERIUDHE

*Sereta KOPERAJ*

*Erzen KOPERAJ*

“Kur përmend emra të tillë si Korça dhe Shkodra, mendja të shkon te dy organizma të largëta, të largëta me trup, por të afërta me shpirt. Jeta qytetare, kultura, antropologjia e ngjashme sociale dhe urbane e këtyre dy qyteteve të Shqipërisë të cilat edhe pse janë të largëta nga pozita gjeografike, ka krijuar “një alkimi të pashoqe e të pakrahasueshme midis vetes”- siç e cilëson këtë lidhje, një shkrimtar dhe studiues Shkodran, Stefan Çapaliku, në librin e tij *“Korçë e Shkodër, meridiane dhe paralele”*<sup>1</sup>. Ato ia kanë dalë të komunikojnë kaq shumë me njëra-tjetrën edhe në kohën kur komunikimi ishte aq i vështirë. Dhe për periudhën e dekadës së dytë të shekullit të kaluar, një prej emblemave të kësaj lidhjeje është padyshim: atdhetari, publicisti e poeti, Hilë Mosi. Një pjesë të mirë të veprimtarisë së tij patriotike dhe kulturore ai e ndau mes këtyre dy qyteteve.

Hilë Mosi, që kur ishte student në Klagenfurt të Austrisë do të binte në sy për përpjekjet e bashkimit të elementit shqiptar. Ai vuante kur shihte se në qytetin e tij të lindjes, në Shkodër e kishte mjaft të vështirë të bashkonte elementin përparimtar për çështjen shqiptare. Fragmentarizimi, kryesisht religjioz, ndasitë për shkak të origjinës krahinore ishin pengesa vështirësisht të kapërcyeshme. Në shtator të 1907, te gazeta “Drita” ku ai do të botonte thirrjen “Çonju”, drejtuar shqiptarëve, pa dallim, *të pasur e të varfër, burra e gra, të rinj e pleq, mësuesve, nxënësve, priftërinjve e hoxhallarëve*, thirrje me të cilën i grishte të punonin e të përgatiteshin për kryengritjen që do të shpërthente në pranverën e vitit 1908 dhe që do të sillte lirinë e Shqipërisë, jepte dhe shprehjen e tij të famshme “nqoftëse Fanatizmin ke për fe, atdhetar i mirë nuk je”. Ndërsa në shkrimin tjetër “Gegë ku e latë?”, botuar po në këtë gazetë në janar të vitit 1908, Hilë Mosi u bënte thirrje gegëve, myslimanë, katolikë e ortodoksë, që të bashkoheshin me toskët, *“që kishin dalë maleve për lirinë e atdheut”* dhe *“të rroknin armët kundër armikut”*. Mesa duket, pas çdo dështimi të përpjekjeve të tij në Shkodër, ai gjente veten në Korçë. Më 1908, nga vendlindja ku jo vetëm nuk kishte arritur të bashkonte shoqëritë *Bashkimim* dhe *Agimi*, por edhe kishin paragjykuar veprimtarinë e tij Hilë Mosi do të nisej drejt Korçës për tu bashkuar me Mihal Gramenon.

1908 është dhe viti Kongresit të Manasitirit dhe Mosi do të ishte aktiv sa në Korçë aq në Shkodër për mbrojtjen e alfabetit me shkronja latine. Në *“Jetëshkrimin”* e tij, kur flet për këtë periudhë, Thanas Floqi, një tjetër personazh aktiv në mjediset patriotike në mbrojtje të alfabetit të shqipes me shkronja latine, përshkruan situatën *“Ne mblidheshim në zyrat e Klubeve, në dhomat e shkollës, në zyrat e gazetave “Korça” e “Lidhja orthodhokse”. Përpjekjet e të gjithëve synonin në ruajtjen e alfabetit latin. Themistokli Gërmenji, Mihal Grameno, Sami Pojani, dr. Haki Korça,*

<sup>1</sup> S. Çapaliku, Korçë e Shkodër, meridiane dhe paralele, Botimet Fishta, 2023

*Spiridon Ilo, Hilë Mosi e unë, epnim e merrim pa pushim.”<sup>2</sup>*

Po këtë vit Mosi themeloi në Shkodër klubin "Gegnija", klub të cilin do ta perfaqësonte në kongresin e Manastirit (ndërkohë ishte edhe delegat i Shkodrës në këtë kongres), ku u zgjodh sekretar i kongresit. Pas kryerjes së punimeve të Kongresit të Manastirit, Hilë Mosi rikthehet në Korçë, ku qëndron për më shumë se një vit.

Do të ishte pikërisht koha kur ai do të krijonte shoqërinë "Vëllazërija", shoqërinë më jetëgjatë kulturore-sportive shqiptare, duke nisur nga Korça për të vijuar në Shkodër. Aktiviteti i kësaj shoqërie ishte i mirëpërcaktuar që në faqen e parë të statutit të saj: *“Rregullore e shoqërisë “Vëllazëria” e ngritur në Korçë për edukimin kombëtar e sportiv të të rinjve”*

Kjo rregullore përbante 9 nene dhe 32 paragrafe. Në këtë rregullore, apo siç do të quhej më pas, *“Kanonizmë e Shoqërisë Vëllazëria”* çdo gjë ishte sanksionuar qartë dhe me qëllim të mirëfunksionimit të saj si një shoqëri kulturore e sportive, por mbi të gjitha patriotike. Ashtu siç do të vihej re edhe kur kjo shoqëri do të ngrihej në Shkodër, veprimtaria sportive nuk shihej si primare, por gjithnjë në funksion të një ndërgjegjësimit kombëtar. Kjo vihet re në të gjitha pikat e saj:

Kështu, që në nenin 1, shkruhej se *“Anëtarë të shoqërisë mund të jenë të gjithë ata shqiptarë, të cilët pranojnë dhe do të përpiqen të zbatojnë programin e kësaj rregulloreje.*

Ndërsa në nenin 2 theksohet se *“Qëllimi i shoqërisë është t’i mësojë djalërisë gjimnastikë dhe t’i mbjellë ndjenjat kombëtare”.*

Hilë Mosi dhe Kristo Floqi, me të cilin do të bëheshin binomi drejtues i *“Vllazërisë/Vllaznisë”* në Korçë e më pas në Shkodër do të përpiqeshin që mos ta fragmantarizonin

shoqëri do të synonte që aktivitetin e saj ta shtrinte edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë në trajtën e degëve lokale. Ajo kishte si qëllim përhapjen e ndjenjave patriotike, ngritjes kulturore dhe aktiviteteve sportive tek të rinjtë shqiptarë, duke i afruar dhe përgatitur ata me dashurinë për njëri-tjetrin dhe atdheun. Sipas Petraq Pepos dhe Enver Bushatit në artikullin e tyre *“Aspekte të kulturës fizike në rrethin e Korçës gjatë viteve 1887-1924”*, Revista pedagogjike, nr.4, 1973, f.141, kjo u vu re edhe nga fakti se gjatë ekzistencës së saj, shoqëria iu kundërvu shoqërisë gjimnastikore *“Ta Patria”*.

Megjithëse shoqëria Vëllazëria e Korçës nuk do të kishte një aktivitet të qëndrueshëm në vitet në vijim, ajo do të linte gjurmë si model. Një shoqëri e ngjashme, me emrin *“Përparimi”*, u themelua edhe në Korçë më 25 mars 1917. Sipas nenit 3 të kësaj shoqërie *“Kanonizmë e shoqërisë “Përparimi” në Korçë”* Shtypshkronja *“Korça”*, 1917, f.1. Qëllimi i kësaj shoqërie, sipas statutit, ishte organizimi i lojërave gjimnastikore, shfaqjeve teatrale dhe mësimi të përjavshëm për përhapjen e ndjenjave kombëtare e përparimtare të kombit shqiptar – *“Për të mbushur qëllimin do të përdorim muzikën, gjimnastikën dhe të çelurit e shkollave të natës”* - pika që i gjejmë edhe te rregullorja e Mosit e 1909.

Gjatë periudhës së pas Luftës së Parë Botërore në vitet 1920, përveç , përparimit do

<sup>2</sup> Thanas Floqi, *“Jetëshkrimi”*, faqe 6-7. Citimi është marrë nga T. Plangarica *“Vlera të rishfaqura. Përmbledhje me studime, në 110-vjetorin e Shkollës Normale të Elbasanit”*, Onufri, 2019, f. 193.

të kishim edhe *Korça sport, Zhgaba* e shoqëri të tjera. Atë që kishte parë në Korçë dhe atë shembull që kishte demonstruar Korça në periudhën e vetëqeverisjes autonome, kur shqiptarët kishin kapërcyer ndasitë fetare duke krijuar komisione të përbashkëta përfaqësimi, duke vënë identitetin e tyre kombëtar mbi gjithçka, Hilë Mosi do të rikthehej në Shkodër për të bashkuar rininë e atij qyteti.

Në Shkodër, që në gjysmën e dytë të shekullit XIX, veprimtaritë kulturore zhvilloheshin në mënyrë sporadike dhe të ndara, Kjo për shkak të ndarjes së qytetit në dy pjesë: lagjet katolike dhe lagjet myslimane. Kështu, në vitin 1914, ekzistonin dy shoqëri kryesore: “Vaso Pasha” ku ishte përqendruar elementi katolik<sup>3</sup> dhe “Mustafa Pasha” e cila përbëhej nga elementi mysliman.<sup>4</sup> Pavarësisht kësaj ndarjeje, e cila ishte imponuar për shkak të rrethanave historike, këto dy shoqëri kulturore përfshinin në gjirin e tyre elementë patriotë dhe përparimtarë, të cilët luftonin për një zhvillim, përparim dhe bashkim të rinisë, por ky realitet nuk mund t’i përgjigjej aspiratave dhe kërkesave të kohës<sup>5</sup>.

Në vitin 1914, Hilë Mosi ishte përpjekur të ngrinte shoqërinë “Lidhja Kombëtare”. Në programin e saj ajo e vinte theksin kryesisht tek arsimit dhe nevojat emergjente të qytetit. Në krijimin e “Lidhja Kombëtare”, Mosi kishte si qëllim të bashkonte elementet e ndryshëm. Në këtë vit kjo ecën paralel me artikujt e tij në shtypin e kohës, duke qenë i pranishëm me shkrime të shumta, ku ka shpalosur idetë e tij për organizimin e shtetit të ri shqiptar, me përbërje kombëtare, si dhe për domosdoshmërinë e një kuvendi kombëtar. Por edhe kjo shoqatë s’do të rezultonte jetëgjatë.

Në fakt, shoqëria që do të hidhte themelet e vërteta të bashkimit të rinisë shkodrane ishte shoqëria “Vllaznia”, e cila u krijua në Shkodër më 16 shkurt 1919<sup>6</sup>. Atë që kishte nisur 10 vite më parë në Korçë, Hilë Mosi do ta sillte në Shkodër jo vetëm si model, por edhe si emër.

Rrethanat historike, në të cilat shoqëria “Vllaznia” mori jetë, ishin tejet të ndërlikuara. Territoret shqiptare ishin të kërcënuara nga një ndarje e re<sup>7</sup>, pas asaj të 1913. Ndërkohë që vetë Shkodra ishte nën administrimin e forcave ndërkombëtare. Kjo shoqëri, sikurse e tregon edhe emri, që në fillim i vuri vetes për detyrë të siguronte bashkimin popullit të këtij qyteti në luftë kundër armiqve të pavarësisë së Shqipërisë.

Shoqëria “Vllaznia” u bë shpejt qendra kryesore e jetës kulturore<sup>8</sup> në qytet. Detyra e saj nuk ishte thjesht kulturore e sportive (siç e mori më pas), por edhe arsimore,

<sup>3</sup>“Shoqnia Teatrale «Vasa Pasha»”, *Shqypnia e re*, nr.51, 12.1.1914, f.2; “Shoqnia «Vasa Pasha»”, *Shqypnia e re*, nr.52, 15.1.1914, f.3.

<sup>4</sup>Andrea Skanjeti, “Zhvillimi i teatrit dramatik në Shkodër”, *Shkodra*, nr.1, 1961, f.162.

<sup>5</sup> Një përshkrim të detajuar të kësaj periudhe, organizimin e aktivitetetve sportive dhe shoqërive të tilla, e jep në monografinë e tij studiuesi B.Nako në “Historia e sportit shkodran” (dorëshkrim, në proces botimi)

<sup>6</sup> “Mbledhja zgjodhi me shumicë votash si kryetar Hil Mosin dhe si sekretar Jonuz Tafilajn. Për katër degët vepruese u zgjodhën drejtues të veçantë; z.Kristo Floqi (avokat) i degës letrare, z.Salih Nivica (profesor) i degës teatrore, z.Ndue Paluca (profesor) i degës muzikore ndërsa për degën e gjimnastikës u zgjodh z.Kolë Margjini (profesor)” - *AQSH*, f.447, D.163, V.1919. Fletorja e mbledhjeve të parisë së shoqërisë “Vllaznia”, 16.2.1919.

<sup>7</sup> M. MacMillan, “Peacemakers. Paris 1919. Six Months That Changed the World”, Random House Publishing Group, 2007, f.358-360.

<sup>8</sup>Sh. Osmani, J. Kastrati, W. Kamsi, “Kontribut për historinë e bibliotekave të Shkodrës”, *Shkodra*, nr.1, 1961, 104-110.

politike e shoqërore<sup>9</sup>. Drejtuesit e kësaj shoqërie synonin bashkimin e shqiptarëve, arsimimin dhe futjen e një fryme të re, emancipuese të rinisë.

Kjo do të realizohej që në hapin e parë që do të bënte shoqëria “Vllaznia” që në krijimin e saj, pikërisht në bashkimin e anëtarëve të dy shoqërive të deriatëhershme “Vaso Pasha” dhe “Mustafa Pasha”, të cilat si dominoheshin dhe kishin si pikë referimi përkatësinë religjioze. Ky ngjan të ishte edhe qëllimi kryesor, gjë që bie në sy edhe në procesverbalin e themelimit të kësaj shoqërie, ku thuhet:

*“Disa djelmoça shkodranë morën inisiativën për të formue në Shkodër një shoqni, e cila të ketë rreth vetes të gjithë ata djelmoça katolikë e muhamedanë qi vepronin në shoqnina të tjera me emna të ndryshëm”.*<sup>10</sup>

Mbledhja e parë për themelimin e kësaj shoqërie u zhvillua më 6 shkurt 1919 në shtëpinë e Kel Marubit. Megjithëse në program theksohej në mënyrë të qartë se “shoqëria nuk do të merrej aspak me politikë”<sup>11</sup>, pasi diçka e tillë kërkohej edhe nga autoritetet ndërkombëtare që administronin Shkodrën e zonat përreth saj, aktivitetet dhe realiteti i asaj periudhe dëshmon të kundërtën.<sup>12</sup> Shoqëria, lëvizjen dhe përhapjen e ideve patriotike i zhvillonte në aktivitetet kulturore e sportive të saj.

Ajo që të bën përshtypje është jo vetëm prania por edhe caktimi i në një prej pozicioneve drejtuese të shoqatës, patriotit korçar Kristo Floqi. Madje, shoqëria “Vllaznia” po t’i referohemi kujtimeve që kanë dëshmitarët e asaj kohe shihej si një shoqatë që drejtohej nga kjo dyshe, Mosi – Floqi. Ajo që e bashkonte fort Kristo Floqin me Hilë Mosin, ishte bindja se në çështjet kombëtare nuk duhej të përzihesh identiteti fetar. A s’ishte drama në vargje e K. Floqit, “Fe dhe kombësi” një prej shprehjeve më të bukura të kësaj ideje në art? Përveç kësaj ajo që bashkonte Mosin me Floqin ishte edhe satirizimi që i bënin veseve dhe qëndrimeve të shoqërisë shqiptare. Sa herë që ne bëhemi të ndërgjegjshëm se kjo nuk është bota më e mirë e mundshme, na duhet ndihma e komedianëve për të përballur “defektet” e pakapërcyeshme të realitetit. Sidomos komeditë e Floqit nuk harronin të vinte në dukje defekte, gabime e vese të mentalitetit shqiptar duke argëtuar, por njëkohësisht dhe duke bërë të reflektonte publikun shqiptar, i cili nuk kishte si të mos i analizonte jetën e tij të përditshme te pjesë të tilla të njohura të asaj kohe “Vllazni e interesë”, “Zi e më zi”, “Rrogat e nëpunësve” etj.

Kjo shoqëri pati përkrahjen e ndihmën e patriotëve më të shquar të kohës si të Luigj Gurakuqit, që u zgjodh kryetar nderi, po ashtu, përkrahjen e Bajram Currit etj. Pavarësisht rrethanave tepër të vështira ekonomike dhe politike, anëtarët e shoqërisë “Vllaznia” derdhën të gjitha energjitë e tyre për t’iu përgjigjur me punë e vepra shoqërisë së tyre.

Këtë e tregon fakti se në vitin 1920, sipas kujtimeve të protagonistit Kolë Hila, kur

<sup>9</sup> Brenda një kohe të shkurtër ajo ngriti një shkollë për të rritur me katër rinde dhe shtatë mësues.

<sup>10</sup> *AQSH*, F.447, D.163, V.1919, fl.1. Fletorja e mbledhjeve të parisë së shoqërisë “Vllaznia”, 6.2.1919.

<sup>11</sup> Në program shkruhej se anëtarët e shoqërisë “Mustafa Pasha” e “Vaso Pasha” u bashkuan duke formuar shoqërinë “Vllaznia”, programi i së cilës ishte ky:

*I. Zgjidhimi i djelmnisë shqiptare në fushën letrare, teatrale, muzikore e gjimnastike.*

*II. Mbledhja e një kapitali për me ndërto një ndërtesë e cila kishte me qenë selija e shoqërisë, ashtu edhe qendra e zhvillimit të veprimeve të saja.*

*III. Botimi i një të përkohëshmes me këtë program, por pa u përzije me politikë”.*

<sup>12</sup> R. Gurakuqi, *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore (1 nëntor 1918-9 nëntor 1921)*, Shkodër: Camaj-Pipa, 2007, f. 89-90.

u zhvillua një ndeshje me skuadrën e trupave italiane, me qëllim që t’i tregohej atyre se populli shqiptar ishte i fortë dhe i zoti, kryetari i shoqnisë, Hilë Mosi i mbledhi të gjithë futbollistët dhe i porositi *“Shikoni djelmosha!... Atdheu ynë asht në rrezik; jeta jonë si komb asht para një momenti kritik, para një lufte të madhe me anmiqt. Duhet me ba diçka me pendë, me pushkë e sport për me ju tregue atyne se kush asht shqiptari. Me mbledhë shokët tuej ku i keni e ku s’i keni, me ba aktivtete sportive, me u ndeshë me ushtritë okupuese dhe me u dhanë me kuptue atyne se edhe na jemi komb me tradita të lashta historike, stërnipat e Skënderbeut, të zotët me jetue, me luftue në çdo moment për të mos lëshue asnjë pëllambë tokë shqiptare”*.<sup>13</sup>

Zhvillimi dhe organizimi i këtyre shoqërive në qytetin e Korçës dhe Shkodrës pati ndikimin e vet edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë. Edhe në qytete të tjera të Shqipërisë po ndiqej shembulli i shoqërisë “Vllaznia” në krijimin e shoqërive kulturore-sportive.<sup>14</sup> Kështu, me rastin e ngritjes së një shoqërie në Durrës me të njëjtin emër, themeluesi “Vllaznisë” së Shkodrës, Hilë Mosi, shkroi në revistën “Agimi” një artikull me titull: “Moti 1920”, në të cilin shprehte kënaqësinë personale dhe të bashkëqytetarëve të tij për një hap të tillë. Ai shkruante ndër të tjera se *“Na shpresojmë se, të tilla shoqni kanë me u ngritë kudo në Shqipni dhe se djelmënia Shqiptare, tue përdorë mjetet ma të bukura: leteraturën, teatrin, muzikën, gjimnastikën ka me e shti popullin tonë në jetë të re, që ka me u quejtë ajo e Përlindjes së Shqipnisë”*.<sup>15</sup>

Veprimtaria e shoqërisë “Vllaznia” zgjati deri në maj të vitit 1922. Duhet theksuar se ideali i anëtarëve të kësaj shoqërie që filloi në Korçë e zuri rrënjë në Shkodër kishte qenë gjithnjë vetëm bashkimi, vëllazërimi i të gjithë elementëve me kombësi shqiptare me një qëllim të caktuar përparimin dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare. Shoqëria Vllaznia, do të humbiste protagonizmin së bashku me degët e saj në fillim të viteve 20, pikërisht pas zhvillimit të Kongresit të Bashkimit të Shoqërive ku morën pjesë 47 delegatë dhe 110 dëgjues nga 27 qytete të Shqipërisë. Kongresi formoi Federatën “Atdheu”, e cila do të kthehej në qendrën drejtuese të shoqërive ekzistuese kulturore-sportive shqiptare.<sup>16</sup>

Kur jemi marrë me materialet për hartimin e këtij artikulli modest kemi ndjerë një formë magjepsjeje ndaj veprës së këtyre personazheve, në një kohë kur aktiviteti dhe tekstet e tyre janë të mënjanuar aq shumë, ndoshta për atë çfarë kanë dhënë, vetëm konstatimi është i pamjaftueshëm, pasi mund të ndihemi të përfshirë dhe të gjejmë diçka që na përket së afërmi edhe ne, diçka që mbërrin përmes jeheve të kohës e të hapësirës të tyre, në njëmendësinë e tanishme shqiptare, e sidomos atë shkodrane në veçanti: kredon që Hilë Mosi i jepte shoqërive që ngrinte:

*.... jemi pasuria e njëri tjetrit.*

<sup>13</sup>Muzeu i Shkodrës, Dosje Praktika IV, Kategoria E, dok.nr.151. Kujtime të marra nga Kolë Hila.

<sup>14</sup>“Mbi masat që duhet të marrë qeveria për të nxitur klube sportive për përgatitjen e kuadrove sportive”, *Zani i popullit*, nr.13, 3.2.1923, f.1; “Shoqëria sportive “Vlora”. Filloi përsëri aktiviteti sportiv. Njoftim nga Vlora”, *Shqipëri e re*, nr.129, 6.5.1923, f.1.

<sup>15</sup>“Moti 1920”, *Agimi*, qershor 1920, f.1.

<sup>16</sup>H. Kordha – T. Gjoleka, *Shoqëria “Bashkimi” (1922-1925)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1987, f.41.

**RUAJTJA DHE MBROJTJA E KUFIRIT NË RAJONIN E KORÇËS NË  
VITET 1912 – 1924**

**Dr. Jorgo QIRICI**

**Abstrakt**

*Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, vendi u përball me sfida të mëdha për të ruajtur integritetin territorial dhe sovranitetin e tij. Shteti i ri shqiptar u krijua në një kohë dhe në rrethana tepër të vështira politike, ekonomike dhe ushtarake. Atij i duhej të forconte institucionet krahas mbrojtjes së egzistencës, perballë synimeve lakmitare të fqinjëve ballkanas. Por atij i mungonin forcat dhe mjetet ushtarake të domosdoshme për të realizuar këto synime. Për këtë arsye u gjykua dhe u zbatua praktikisht ideja që, krahas forcave efektive, rezerviste dhe villnetare të Ushtrisë, forcat e Xhandarmerisë të ngarkoheshin edhe me detyra mbrojtëse. Një nga rajonet më të prekura nga këto sfida ishte Korça, e cila u kërcënua nga forcat pushtuese greke që synonin aneksimin e saj. Kjo periudhë historike karakterizohet nga një sërë ngjarjesh dhe përballjesh të vazhdueshme midis forcave greke dhe atyre shqiptare, të cilat u organizuan për të mbrojtur kufijtë e Shqipërisë. Studimi i kësaj periudhe historike është i rëndësishëm për të kuptuar sfidat dhe përpjekjet e shqiptarëve për të ruajtur dhe mbrojtur kufijtë e tyre. Rajoni i Korçës luajti një rol kyç në këto përpjekje dhe ngjarjet e kësaj periudhe tregojnë vendosmërinë dhe guximin e popullit shqiptar për të mbrojtur pavarësinë dhe integritetin e tyre territorial.*

**Fjalët kyçe:** *Rajoni i Korçës, mbrojtja e kufijve, forcat greke, forcat shqiptare,*

**Abstract**

*After the Declaration of Independence of Albania on November 28, 1912, the country faced significant challenges in maintaining its territorial integrity and sovereignty. The new Albanian state was established during extremely difficult political, economic, and military circumstances. It needed to strengthen institutions while defending its existence against the greedy ambitions of Balkan neighbors. However, it lacked the necessary military forces and means to achieve these goals. Consequently, the idea was practically implemented that, alongside the effective forces, reservists, and volunteers of the Army, the Gendarmerie forces would also be tasked with defensive duties. One of the regions most affected by these challenges was Korça, which was threatened by Greek occupying forces aiming to annex it. This historical period is characterized by a series of events and continuous confrontations between Greek and Albanian forces, organized to defend Albania's borders. Studying this historical period is crucial to understanding the challenges and efforts of Albanians to maintain and protect their borders. The Korça region played a key role in these efforts, and the events of this period demonstrate the determination and courage of the Albanian people to defend their independence and territorial integrity.*

**Key words:** *Korça Region, border defense, Greek forces, Albanian forces,*

## **Hyrje**

Për këtë arsye u gjykua dhe u zbatua praktikisht ideja që, krahas forcave efektive, rezerviste dhe villnetare të Ushtrisë, forcat e Xhandarmerise të ngarkoheshin edhe me detyra mbrojtëse. Një nga rajonet më të prekura nga këto sfida ishte Korça, e cila u kërcënua nga forcat pushtuese greke që synonin aneksimin e saj. Kjo periudhë historike karakterizohet nga një sërë ngjarjesh dhe përballjesh të vazhdueshme midis forcave greke dhe atyre shqiptare, të cilat u organizuan për të mbrojtur kufijtë e Shqipërisë. Studimi i kësaj periudhe historike është i rëndësishëm për të kuptuar sfidat dhe përpjekjet e shqiptarëve për të ruajtur dhe mbrojtur kufijtë e tyre. Rajoni i Korçës luajti një rol kyç në këto përpjekje dhe ngjarjet e kësaj periudhe tregojnë vendosmërinë dhe guximin e popullit shqiptar për të mbrojtur pavarësinë dhe integritetin e tyre territorial.

## **Krijimi i forcave ushtarake të shtetit shqiptar**

Pas shpalljes së pavarësisë më 28 Nëntor 1912, Shteti i ri shqiptar dhe territori i tij rrezikoheshin si nga ushtritë turke, të thyera në frontin grek, që vërshonin në Shqipëri e që mund të orvateshin për të përmbysur shtetin shqiptar të porsaformuar, ashtu edhe nga ushtritë greke që, nën preteksin e ndjekjes së kundërshtarëve të tyre turq, mund të hynin në thellësi të territoreve shqiptare, deri në Vlorë, për t'u bërë kështu zot të krahinave shqiptare, për të cilat ëndëronin prej kohësh.

Shteti i ri shqiptar u krijua në një kohë dhe në rrethana tepër të vështira politike, ekonomike dhe ushtarake. Atij i duhej të forconte institucionet krahas mbrojtjes së ekzistencës, përballë synimeve lakmitare të fqinjëve ballkanas. Por, atij i mungonin forcat dhe mjetet ushtarake të domosdoshme për të realizuar këto synime. Në këto rrethana, Qeveria e Përkohshme e Vlorës morri një sërë masash për të përballuar këtë rrezik. U gjykua dhe u zbatua praktikisht ideja që, krahas forcave efektive, rezerviste dhe villnetare të Ushtrisë, forcat e Xhandarmërisë, si pjesë përbërëse e saj, të ngarkoheshin edhe me detyra për mbrojtjen e kufijve të shtetit shqiptar të atëhershëm. “Ajo do të kryente edhe detyra mbrojtëse në kufirin shtetëror krahas ruajtjes së tij, deri në krijimin dhe organizimin e plotë të Ushtrisë Shqiptare”.<sup>1</sup>

Kësisoj, Xhandarmëria u përball dhe luftoi për të frenuar sulmet e forcave pushtuese serbe apo greke në kufi dhe në brëndësi të territoreve të shtetit shqiptar të pavarur. “Të kësaj natyre ishin veprimet përgjatë vijës bregdetare të Sarandës në fillim të dhjetorit 1912, në drejtimin e Lushnjës në mars të vitit 1913 si dhe në drejtimin e fshatrave të Prefekturës së Elbasanit dhe të Korçës po në vitin 1913”.<sup>2</sup>

Krahas detyrave të mësipërme, repartet apo nënrepartet e Xhandarmërisë në disa Prefektura, morën përsipër e kryen edhe detyra të vëzhgimit e të ruajtjes së kufijve. Pas krijimit të detashmenteve të Xhandarmërisë shqiptare, në dhjetor 1913, vëmëndja u përqëndrua sidomos në trevat shqiptare të pushtuara nga forcat shoviniste greke. Madje, sipas dokumentit të emërtuar “Dekret për xhandarmërinë e Shqipërisë Jugore”, të dhjetorit të këtij viti, kjo ishte detyra kryesore për Xhandarmërinë shqiptare.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Historia e Ushtrisë Shqiptare, Tiranë 2000, f. 59

<sup>2</sup> Historia e Ushtrisë Shqiptare, pjesa e parë, 1912-1939, f.104

<sup>3</sup> Po aty, f.105



### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Në këtë kuadër, mjaft shprehës ishte dërgimi nga qeveria në javën e parë të dhjetorit, të më se 250 xhandarëve, në drejtimin e Korçës.

Kur trupat ushtarake greke vazhdonin të bënin barbarizma në tokat shqiptare të pushtuara, xhandarmëria shqiptare e atëhershme, si e vetmja forcë ushtarake e përforcuar edhe me vullnetarë, u bëri atyre një qëndresë të suksesëshme. “Ato, pasi kishin marrë në dorëzim Ersekën dhe kishin arritur në afërsi të Leskovikut, u pritën befasisht me zjarr nga forcat e qeverisë “Vorio Epiriote”, nga forcat e kompanive “të shënjta”, në përbërjen e të cilave ishin edhe reparte të ushtrisë greke”.<sup>4</sup>

#### **Forcat për mbrojtjen e territoreve shqiptare në kohën e Princ Vidit**

Për t'u bërë ballë fuqive ushtarake greke, që kërcënonin Korçën më 1914, vetë autoritetet e vendit, duke mbajtur parasysh edhe mungesën e përvojës dhe të aftësisë së forcave të xhandarmërisë ekzistuese shqiptare, vendosën formimin e një ushtrie të vogël për mbrojtjen e kufirit në atë qark. “Për këtë, u thirrën nën armë të gjithë burrat prej moshës 20-40 vjeç dhe me ata u formuan tre batalione, të cilët u dislokuan në qendrat kryesore të zonës juglindore në Kolonjë, Korçë, mbi Devoll dhe në Starovë (Pogradec). Batalionet u organizuan mbi bazën e kompanive dhe u dislokuan në afërsi të kufirit.<sup>5</sup> “Kjo forcë ushtarake kishte përmasat e një regjimenti dhe ishte njësia më e madhe organizative deri në atë kohë në Shqipërinë e pas vitit 1912”.<sup>6</sup>

Detyra e këtij regjimenti ishte mbrojtja e kufirit juglindor të Shqipërisë nga kërcënimi i përhershëm i pushtimit dhe i aneksimit grek. “Nën maskën epiriote, mbas ngjarjes tragjike të Odriçanit (Frashër-Përmet), më 2 Prill 1914, forcat ushtarake greke filluan luftën në gjithë vijën e kufirit provizor, ku ishte grumbulluar xhandarmëria shqiptare për të marrë në dorëzim vendet e jugës”.<sup>7</sup>

Në mbrojtje të prefekturës së Korçës, e cila kërcënohej nga forcat pushtuese greke, “veproi edhe një repart i përmasave të një batalioni, me efektiv prej 300 vetash (250 xhandarë këmbësorë dhe 50 kalorës), i komanduar nga Ali Fehmi Kosturi”.<sup>8</sup>

Gjatë veprimeve luftarake, ky batalion bashkëveproi edhe me forcat e xhandarmërisë së prefekturës së Vlorës (250 xhandarë), të ardhura në Korçë për të njëjtin qëllim. “Ky ishte formacioni i parë ushtarak i rregullt, i shtetit shqiptar, që lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen dhe mbrojtjen e kufirit shtetëror”.<sup>9</sup>

Të suksesshme, në këtë periudhë, janë edhe veprimet e forcave të batalionit të Kolonjës, për të përballuar sulmet e kryengritësve të Esat Pashë Toptanit, të cilët më 21 qershor 1914, pasi kishin marrë Elbasanin, duke u mbështetur mbi propogandën serbo-greke dhe mbi “ferrat” e mbjella prej Esatit, ishin nisur për në Pogradec, me qëllim që këtu të formonin një kufi të përbashkët me grekët e t'u lehtësonin atyre rrugën për në drejtim të Korçës e Kolonjës. Kjo bëhej në një kohë kur “Shqipëria e jugut po digjeshë e përvëloheshe nën barbarizmat greke, kur me qindra fshatra të Frashërit (Përmet), të Kolonjës, të Leskovikut, të Tepelenës dhe të Kurveleshit po

<sup>4</sup> Arkivi i Institutit të Histori-Gjeografisë, USHT, filmi 36, arkivi i Vjenës, vëll. I, f.448

<sup>5</sup> AQSH, Libri “Shqipëria më 1937”, vëll. II, f.85

<sup>6</sup> Historia e Ushtrisë Shqiptare, vepër e cituar, f.98

<sup>7</sup> Teki Selenica “Shqipëria më 1927”, libër i cituar, f.36

<sup>8</sup> *Po aty*, 85

<sup>9</sup> Historia e Ushtrisë Shqiptare, vepër e cituar, f.98

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

bëheshin hi, kur me mijra njerëz thereshin si bagëtia, kur me qindra mijëra të tjerë po mbeteshin pa strehë e pa bukë; ja, në këtë moment të pikëlluar, zjarri i fantazmës, nga Shqipëria e mesme, po zgjeroheshe për në Jug”.<sup>10</sup>

Afrimi i turmës së kryengritësve fanatikë në Pogradec kishte rrezikuar disi pozitën e fuqive kombëtare (trupave mbrojtëse) të Korçës, të cilat, të frymëzuara nga ndjenjat patriotike më të zjarrra, pa dyshim ishin në gjëndje për të përballuar sulmin e armikut, por ama nuk mund të luftonin midis dy zjarreve, me grekun dhe me rebelët. “*Megjithkëtë, dashuria për atdhe ishte aq e madhe, sa djemtë e Kolonjës, me batalionin e tyre, me gëzim u nisën kundër fanatikëve, ku, me heroizëm të madh, luftuan dhe u vranë, duke i treguar botës se shqiptari di të kuptojë dhe të vdesë për një ideal e për një Shqipëri të lirë*”.<sup>11</sup>

Edhe gjatë qeverisjes së Princ Vidit, nuk u arrit që të vendosej pushteti i juridiksionit të saj në të gjithë territorin e vendit. Kjo sepse qeveria shqiptare nuk kishte ende forca të armatosura të mjaftueshme, ndërsa në krahinat jugore të Shqipërisë vijonin të qëndronin ende trupat greke, gjë që binte ndesh me vendimet e Komisionit Kufitar lidhur me vijën e kufirit, e cila ishte përcaktuar në *Protokollin e Firences të dhjetorit 1914*. Por Greqia nuk hiqte dorë nga synimet e saj për të marrë Jugun e Shqipërisë, sipas asaj që ata, në gjuhën e tyre, e quanin “Vorio-Epir”.<sup>12</sup>

Megjithatë, në mesin e muajit shkurt 1914 u duk sikur qeveria greke pranoi thirjen e Fuqive të Mëdha për të zbrazur krahinat shqiptare të Jugut. Për rrjedhojë, formalisht, më 1 mars të këtij viti, trupat greke u larguan nga Korça dhe, të nesërmen, në qytet hynë repartet e xhandarmërisë shqiptare. Kjo bëri që të vihej në punë administrata shqiptare e këtij qyteti, tashmë nën vartësinë e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK) e, njëkohësisht, atje u formua edhe një formacion me vullnetarë vendas, i cili u vu nën komandën e Themistokli Gërmenjit.

Por, pamvarsisht kësaj, ditën tjetër, bandat shoviniste greke, të mbështetura edhe nga peshkopi grek Germanos, kaluan në sulm për të larguar administratën shqiptare. Ndërkohë, ato u ndeshën me xhandarmërinë e Korçës, nën komandën e majorit holandez *G. Sneller*, të ndihmuar edhe nga forcat vullnetare të fshatrave përreth Korçës, që drejtoheshin nga *Th. Gërmenji*, të cilat së bashku, mundën të shtypin puçin e armatosur, të organizuar nga shovinistët grekë për të rrëzuar administratën e sapongritur shqiptare. Për pasojë, forcat greke u detyruan të largoheshin nga qyteti brënda disa ditëve.<sup>13</sup>

Ndërsa xhandarmëria, në Prefekturën e Korçës, mori masa për të siguruar mbrojtjen, rregullin dhe qetësinë publike, si dhe për të krijuar kushte të përshtatshme pune për administratën e kësaj prefekturë.

Pas luftimeve me repartet “*vorio-epirote*” në Korçë, forcat e xhandarmërisë shqiptare u vunë në lëvizje drejt krahinave të Kolonjës e Leskovikut, ndërkohë që një pjesë tjetër kaloi në veprime sulmuese për të çliruar Gjirokastrën, të cilat përfunduan me sukses.

Lidhur me veprimtarinë e xhandarmërisë së qeverisë së Vidit në territoret shqiptare

<sup>10</sup> Teki Selenica “Shqipëria më 1927”, libër i cituar, f.39

<sup>11</sup> Teki Selenica “Shqipëria më 1927”, libër i cituar, f. 39-40

<sup>12</sup> Historia e popullit shqiptar, vëll. III-të, f.60

<sup>13</sup> Historia e Shqipërisë, vëll. III-të, Tiranë 1984, f.134

### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

jugore, shkruante edhe gazeta Përlindja e Shqipëriës. Në artikullin e saj me titullin “Gjindarmëria Shqiptare u nis për në viset e lëshuara prej ushtëriës greke”, shkruhej: “N’a lajmojnë prej Skrapari se Zotnia Themistokli Gërmenji u nis, me 150 gjindarmër, për në Voskopoje, e cila sikundër dihet, u lëshua prej Grekëve. Zoti nënprefekt i Skraparit do të vejë ma parë në Vithkuq, në disa fshatëra të tjera dhe pastaj në Voskopoje. Më tjetër anë Zoti Dajlan Panariti, me 250 gjindarmë, u nis për në Panarit e fshatërat për qark. Dihet se togje (reparte ose nënreparte) gjindarmësh presin në të gjitha viset që të bashkohen me këta edhe të gjithë tok, t’i marin në dorë viset të lëshuara prej ushtërisë greke”.<sup>14</sup>

Më pas, në vitet e Luftës së Parë Botërore, me rënien e qeverisë së Princ Vidit, në Shqipëri nuk mund të bëhej fjalë më për kufij shtetërorë dhe as për ruajtjen e tyre, për shtet dhe forca të xhandarmërisë. Pothuajse të gjithë vëndin e përfshiu anarkia dhe spontaniteti i përgjithshëm; territori shqiptar u shndërua në fushë luftimesh midis palëve ndërluftuese.

### **Bibliografia**

- 1 Historia e Ushtrisë Shqiptare, Tiranë 2000, f. 59
- 2 Historia e Ushtrisë Shqiptare, pjesa e parë, 1912-1939, f.104
- 3 Historia e Ushtrisë Shqiptare, pjesa e parë, 1912-1939, f.105
- 4 Arkivi i Institutit të Histori-Gjeografisë, USHT, filmi 36, arkivi i Vjenës, vëll. I
- 5 AQSH, Libri “Shqipëria më 1937”, vëll. II, f.85
- 6 Historia e Ushtrisë Shqiptare, vepër e cituar, f.98
- 7 Teki Selenica, “Shqipëria më 1927”, Tiranë 1928, f.36
- 8 Teki Selenica, “Shqipëria më 1927”, Tiranë 1928, f.85
- 9 Historia e Ushtrisë Shqiptare, vepër e cituar, f.98
- 10 Teki Selenica “Shqipëria më 1927”, libër i cituar, f.39
- 11 Teki Selenica “Shqipëria më 1927”, libër i cituar, f.39-40
- 12 Historia e popullit shqiptar, vëll. III, f. 60
- 13 Historia e Shqipërisë, vëll. III-të, Tiranë 1984, f. 134
- 14 Historia e popullit shqiptar, vëll. III, f.65

---

<sup>14</sup> Po aty, f.65

**FILLIMI I SHEKULLIT XX:  
KORÇA, PATRIOTIZMI DHE NDIKIMI PERËNDIMOR**

*Msc. Fjoralba PRIFTI*

*Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar*

Historia mesjetare e Shqipërisë, është e mbushur me pushtime, aneksime, pabesira dhe përçarje, luftëra të jashtme dhe të brendshme. Shqipëria vinte nga një sundim otoman 500-vjeçar, ku njerëzit ishin të zhytur në varfëri dhe injorancë, pa ditur identitetin e tyre, kujt i përkisnin, pa ditur origjinën, pasojë kjo e moszhvillimit në të gjitha aspektet, mosarsimimi dhe për më tepër ndalimi i mësimin të gjuhës shqipe. Si pasojë e pushtimit Osman Shqipëria përjetoi një periudhë mesjetare të tejzgjatur, e cila në botën perëndimore kishte marrë fund prej shekullit të 16-të. Si në mesjetë qytetet ishin të organizuara me një kishë (ose xhami), në qendër, rrethuar nga një shesh para kultit fetar. Jeta e çdo banori ishte e ndërtuar në bazë të fesë dhe besimit dhe duke qenë se shumica e popullsisë nuk dinte shkrim e këndim, kishat përcillnin fjalën e tyre, biblike nëpërmjet figurave të pikturuara, si afresket (pikturat murale apo dhe ikonat) (rasti në Korçë).

Zgjimi kombëtar u ideua dhe u mbështet pikërisht nga disa njerëz të cilët patën mundësinë të jetonin dhe të arsimoheshin në disa nga vendet më të zhvilluara, qoftë pjesë e perandorisë osmane, qoftë dhe ato perëndimore. Rilindasit kuptuan se njerëzit duhet të ndërgjegjësoheshin dhe të mësonin gjithçka mbi të kaluarën e tyre historike, trashëgiminë dhe origjinën.

Idetë për shkëputjen totale prej botës orientale dhe luftës për krijimin e identitetit shqiptar, lirinë, bashkimin e kombit, formimin e shtetit, përparimin me hapa galopantë për të kompesuar shekuj të humbur, solli ndryshime të dukshme në qasjen perëndimore të shumë prej përparimtarëve të asaj periudhe, të cilët shkruan një histori tjetër për Shqipërinë dhe hodhën hapat e parë të lëvizjeve e shek të 19-të, 20 –të, të cilat bazoheshin në besimin për përparimin e shoqërisë.

Një nga rolet tepër të rëndësishme luajti arti figurativ, i cili kryesisht zhvillohej në formën religjioze, atë të ikonës apo afreskut dhe po në fund të 19-tës, fillimi i shek.20-të, kemi dhe dëshmitë e para të pikturës laike dhe duke filluar me mitizimin e heroit Kombëtar, Skënderbeut.

Ashtu si ikona e cila është krijuar tërësisht simbolike, e interpretuar t’iu bërë të njohur historinë biblike njerëzve dhe për të manipuluar mendjet e tyre, këta intelektualë megjithëse të pakët në numër, menduan të sillnin në vemendje figurën e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, duke prezantuar portretin e tij dhe luftën që ai kishte bërë kundër osmanëve, si dhe kahun dhe vizionin e tij drejt perëndimit. Portretet e Skënderbeut u kthyen në “ikona”. Paraqitja e tyre ishte e njëjtë, sipas variantit të parë të J. Panaritit, ku portreti i Skënderbeut shfaqej në profil, me mjekër të gjatë dhe përkrenaren me kokë dhie. Jorgji Panaritit, ikonograf dhe freskograf, e realizoi në vitin 1883. Vijon nga Anastas Ballamaçi 1898 dhe Nikolla Lako 1919 – 1920.

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*



Jorgji Panariti  
"Portreti i Skënderbeut",  
vaj, 1883



Vangjel Zengo,  
"Skënderbeu",  
vaj, (GKA)



Spiro Xega,  
"Skënderbeu",  
vaj, (GKA)



Nikolla Lako,  
"Skënderbeu",  
kartolinë


Kompozimi i njohur i versionit të heroit mbi kalë, është një kopje e realizuar fillimisht nga Andrea Ballamaçi, por e interpretuar komplet me nota orientale, prej versionit të piktorit francez Gericault. Spiro Xega, i cili prej vitit 1913 realizoi 8 versione te ndryshme mbi heroin., ku rasti i versionit te vitit 1931, ishte kopje e versionit të A. Balllamaçit, por në interpretimin e Xegës, u hoqën tërësisht fryma orientale dhe u futën edhe disa elemente kombëtare si përkrenarja apo dhe kalaja e Krujës. Një kopje me përmasa më të vogla ruhet në Galerinë e Arteve, Korçë. Figura e Skënderbeut dhe bëmave të tij ishte kthyer tashmë në një nga temat më të përdorura dhe simbolike të bashkimit kombëtar.



Gericault,  
Oficer Roje imperial, 1812



Anastas Ballamaçi  
1889



Spiro Xega 1931

Fundi i Shek.i 19-të, dhe fillimi i 20-tës, solli një valë ndryshimesh, sociale, kulturore, arsimore, në gjithë Shqipërinë, por kryesisht në Korçë, ku personalitete të shkolluar, të formuar nëpër universitete të ndryshme europiane, filluan të rilindnin një qytet dhe ta kthenin atë drejt perëndimit.

Në qarkun e Korçës, piktorët kryesisht ishin piktorë–ikonografë–freskografë, të studiuar dhe kishin kryer aktivitetin e tyre fillimisht në Greqi dhe Malin e Shenjtë, Athos. Tradita e mësimin në Athos (pjesë e perandorisë Bizantine, më pas pushtuar nga osmanët), ishte pjesë e rëndësishme e arsimit dhe mësimin mbi ikonografinë prej

### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

shumë shekujsh dhe ka nxjerrë emra të rëndësishëm të artit ikonografik në Shqipëri dhe jo vetëm. Duke filluar nga K. Jeromonaku, vëllezërit Zografi, etj. në vazhdim shek.17-të, 18-të.

Piktorët e fillimshkullit të 20-të i përkisnin pikërisht atelieve të ngritura dhe të konfirmuara të piktorëve- ikonografë, kryesisht me origjinë nga Korça, siç ishte ajo e Zdrulit, nga fshati Dardhë, e cila zhvillonte aktivitetin në malin Athos, por ikonat e tij shpërndaheshin në shumë kisha, në Shqipëri, Greqi, Bullgari, Ukrainë etj. Fshati Dardhë dhe dardharët janë ndër brezat e fundit të cilët u morën me ikonografi dhe sollën ndryshime rrënjësore dhe koncepte të reja mbi ikonografinë dhe artin vizual. Në MKAM ndodhen rreth 250 ikona dhe rreth 24 autorë me origjinë nga Dardha.

Familja Zengo, prej disa brezash, familja Zdruli, apo Keret, jane disa nga piktorët, të cilët shenjojnë, ndryshimet e mëdha ikonografike post-bizantine, në Shqipëri.

**\*\*Papajani Zengo (1832-1912)** ishte ksilograf, fotograf dhe mësues shqiptar i shekullit XIX, ndër të parët fotografë shqiptarë, arsimoi të tre djemtë e tij, dhe të tre trashëguan talentin e tij, Nikollës, Eftimit, dhe Vangjelit. Vangjel Zengo është ai me krijmtari më të madhe dhe më të njohur, si dhe trashëgoi tek vajzat e tij talentin për artin figurativ.

Grigor Zdruli Vdekur me 1906, emri i vërtetë i tij ishte Sotir. Ishte prift dhe profesionin e piktorit e mori në Malin e Shenjtë. Pikturoi kishën e Shën Gjergjit në Dardhë. Në MKAM janë identifikuar tri ikona të tij. Në Malin e Shenjtë, formon atelienë e vet, ku mësuan pikturë shumë djem të rinj shqiptarë, korçarë, si tre djemtë e Papa Jani Zengos, Grigor Jeromanak Zdruli (i riu). Thanas Zengo, Pandi Gjino, Spiridhon Dunka, Dhimitër Papaveshi nga Lehova, Marko Ballkameni, etj.

Grigor Zdruli ka meritën gjithashtu të kalimit gradual nga ikonografia me rregulla të rrepta bizantine tek ajo me volum dhe frymës klasike perëndimore, frymë e cila u zhvillua dhe më shumë nga pasardhësit e tij.

Tek ikona “Ringjallja e Krishtit” pjesë e fondit muzeal MKAM nga Grigor Zdruli, vemë re tentativë për të imituar skenat biblike të kompozura si në kishën perëndimore. Në trupat e figurave njerëzore vihen re volume dhe interpretimi i veprimt të gjithë secilit. Por ende jemi larg të qenit realist dhe interpretim të natyrshëm. Figurat vazhdojnë të rrinë të ngrira, skenat ku shfaqen tre mirëprureset dhe ëngjëlli që iu flet janë pa lidhje me skenën kryesore të ngritjes në qiell. Ato janë vendosur pa kujdes dhe duken sikur qëndrojnë në ajër. Krishti ka dimensione më të mëdha se ushtarët (tipike bizantine, ku heroi apo shenjti kryesor në ikonë ka përmasa shumë herë më të mëdha se figurat e tjera). Ai qëndron në qiell dhe mungon peizazhi.

E veçanta e kësaj ikone është se ushtarët, megjithëse të veshur si ushtarë romakë, portret e tyre janë tipike otomane dhe interpretimi i veshjes së tyre legjionare është si ai osman (evidentohet si armik).

1. Përgjatë pushtimit otoman, megjithëse komunitetet e krishtera dhe arti bizantin mbijetoi në një botë ku nuk lejohej të pikturohej figura njerëzore, influenca e rrymave perëndimore dhe sigurisht e asaj lindore nuk mund të shmangej.

2. Interpretim i artistit duke paralelizuar ushtarët romake dhe ata otomane, të dy

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

kundër krishtërit dhe pushtues njëkohësisht. Kjo do ta kthente veprën me një pararendëse simbolike, ku njerezit e paarismuar do të vështronin atë që duhej të vështronin, të njihnin armikun dhe të luftonin për të ardhmen. Dhe ku më mirë do të vëzhgohej kjo vepër se në kisha ku komuniteti mblidhej dhe lutej përballë këtyre ikonave.



*Grigor Zdruli Ringjallja e Krishtit 1899  
MKAM (Origjina e saj është nga Kisha e  
Burimit Jetëdhënës në Korçë, realizuar në  
vitin 1899)*



*Paolo Veronese – 1570  
Ringjallja e Krishtit*

Pas shpalljes se Pavarsisë piktorët-ikonografë patën një aktivitet artistik të ngjeshur, në ikona, afreske, por u zhvillua shumë dhe arti laik.

Një nga përfaqësuesit me dinjitozë ishte Vangjel Zengo 1875-1941. Ai kryesoi me një numër të lartë ikonash dhe afreskesh mbi kisha të rëndësishme si bashkautor në kishën e Shën Gjergjit, Korçë me Anastas Papapostol Ziçishti dhe Sotir Papaila Dardhe (Kere), në 1921 pikturojnë xhaminë e Mirahotit, në Korçë, 1922-23 pikturon kishën e Ungjillizimit, Tiranë, në 1929, kishën e Shën Marisë në Korçë, kishën e Shën Gjergjit Dardhë dhe me pas kishën në Hoçisht, Shën Thanasin, Korçë, Kishat ne Polenë, Opar, Mujasit dhe ne 1936 “Katedralen Burimi Jetëdhënës” në Korçë.

Në disa prej kishave vajzat e tij kanë qenë bashkëautore. Vajzat e tij Androniqi dhe Sofia Zengo janë konsideruar si vajzat e para piktoresh në Shqipëri.

Gjithashtu krijmataria në ikonografi e tij është mjaft e lartë. Vetëm në MKAM janë evidentuar 159 ikona nga dora e tij deri tani. Por, ai pikturoi për shumë kisha në Greqi, Malin Athos, Rusi, Ukrainë, Bullgari, etj., por dhe plotësoi me ikona kishën e Brixhford, SHBA.

Krijmtaria e tij laike zë një vend shumë të rëndësishëm duke përmendur portrete të figurave të rëndësishme të asaj kohe si Fan Noli, (MHK), Sotir Peci, etj., apo Skënderbeun në disa tablo të ndryshme si Beteja e Skënderbeut dhe Skënderbeu mbi kalë (GKA), portretet familjare, si ato të prindërve, të vajzës së tij, Thomaidhës, shumë gjenden në koleksione private, por edhe shumë prej tyre ndodhen në MHK apo GKA.

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**



*Fan Noli, MHK*



*Beteja e Skënderbeut, MHK*


Jo vetëm në artin e Vangjel Zengos, por dhe tek të gjithë bashkëkohësit e tij piktorë si Sotir Kere, Anastas Ziçishti, Todi Dallta, Thanas Zengo, etj., vihet re dalja përfundimtare nga kornizat e artit bizantin, të ikonografisë dhe duke nisur që nga mënyrat e trajtimit të skenave, të cilat kishin totalisht frymën perëndimore deri tek volumi, ngjyrat e peizazhi.

Neoclasicismi (*Fundi i shek.18-të, fillimi i 19-tës, në Europë, ishte koha e Revolucionit, shënon fillimin e stilit Neoklasik, ku piktura dhe arkitektura, shpesh të pandashme, rikthehen tek bukuria klasike greke, linjat gotike dhe mjeshtrat e Rilindjes, pas një shekulli*), solli ndryshime të mëdha në Europë, por edhe në Malin Athos ku shumë prej këtyre artistëve mësuan të pikturonin ikonografi dhe ku mjeshtrat e mëdhenj të Rilindjes Italiane dhe më pas, kopjoheshin me rigorozitet. Kjo ndodhi dhe me mjeshtrat tanë korçarë, të cilët e përfaqjuan me nxitim këtë mënyrë të re ikonografike të pikturimit.

**“Prerja e kokës së Johan Pagëzorit”**



*Mësues Kostandini,  
sh.17 MKAM*



*Sotir Ilia Dardhioti Kere  
sh.20-të MKAM*



*Pierre, Jean-Baptiste Marie  
(1714-1789)*

“Prerja e kokës së Johan Pagëzorit” ka origjinën nga fshati Vithkuq dhe i përket shek. të 17-të, pikturuar nga mësues Kostandini. Pikturimi ndonëse është trajtuar me tepër naivitet i është përmbajtur të gjitha rregullave bizantine. Përmasat e figurave njerëzore nuk kanë proporcione të rregullta. Në pikturën bizantine përmasat e



## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

figurave krijohen sipas rëndësisë së figurës që paraqesin. J.P. paraqitet me aureolë në kokë për të bërë dallimin midis atij që është shenjtor dhe dy personazheve te tjera, Salomesë dhe xhelatit. Piktura është dy dimensionale dhe dekorative.

Ndryshimi është tepër i dukshëm në “Prerja e kokës së Johan Pagëzorit”, që përcillet nga Kere, duke u bazuar, ilustruar dhe kopjuar me rigorozitet nga mjeshtrat e mëdhenj si p.sh. Pierre, Jean-Baptiste Marie (1714-1789) Caravagio, etj. Piktura është trajtuar me vëllim, dhe figurat janë në lëvizje. Sapo ka përfunduar akti i prerjes së kokës dhe ndihet dhe neveria e kokës së prerë, dhe një trup të pajetë. Skena është përcjellë me shumë realizëm dhe vërtetësi. Edhe sfondi është shumë dimensional dhe tregon thellësi. Ndihen muret e trasha, të errëta dhe të ftohta të kalasë ku ka ndodhur ngjarja.

Si në telajot e këtyre mjeshtrave, edhe në ikonën e Keres, bie në sy, mënyra e kompozimit, sesi xhelati mban në dorë kokën e Johanit, mbas aktit të vrasjes, tepër gjakftohtë, duke e drejtuar mbi tabakanë rrumbullake, të cilën e mban me të dyja duart Salomeja. Ajo mban kokën mënjane duke ndier njëkohësisht keqardhje, por dhe bindje në kërkesën e saj, si dhe pak neveri nga ajo kokë e cila kullon gjak. Pas saj qëndron një shoqëruese e saj, me kokën e mbuluar dhe të drejtuar në të kundërtën e Salomesë, duke parë me guxim kokën e prerë dhe duke balancuar në këtë mënyrë, kompozimin dhe shikimin të personazheve, të tjerë.

Elementet orientale të botës otomane janë tepër të dukshme si në ikonën e shek. 17-të, ku xhelati është i veshur me parzmore romake, por me elementë të një ushtari otoman ku bie në sy helmata, portreti apo dhe dekoracioni i parzmores, si dhe në rastin e ikonës së shek. 20-të ku shpata e përdorur nga xhelati është tipike otomane. Johan Pagëzori, sipas rregullave bizantine jemi mësuar gjithmonë ta shohim duke mbajtur kokën e tij në duar dhe një pergamenë dhe gjithashtu me krahë ku tregon pjesën jo njerëzore të tij. Në krijmtarinë e V. Zengos dhe bashkëkohësve të tij në shek e 20-të vjen me ngjashmëri të plotë kompozicionale, si Tintoreto apo El Greko.

I vendosur në qendër të tablosë, para një peizazhi qielli zë kati gjysmën e kompozimit dhe ndihet prania e ujit dhe gjelbërimi. Ai me njëren dorë tregon



rrugën, të cilën njerëzimi duhet të ndjekë. Ai qëndron me një këmbë para, i lirshëm dhe me vështrimin larg, djathas. Edhe veshja e tij është gati e njëjtë, ku në përshtatje me kohën i përkasin antikitetit të hershëm dhe ku mbizotërojnë tonet e gjelbra dhe kafe.

***Johan Pagëzori,***

*Shek. 18-të, anonim MKAM*



*Shek. 20-të Vangjel Zengo  
MKAM*



*Shek. 17-të El Greco*



*“Lajmërimi”,  
Anonim, shek.14-të*



*Lajmërimi, V. Zengo shek.20-të*



*Lajmërimi, Luca Giordano 1672*

Të njëjtën ngjashmëri dhe frymëzim vëme re dhe tek ikona e “Lajmërimin”. Dyert e bukura paraqesin skenën e lajmërimin. Ikona ka paraqitje tipike bizantine, i përket shek. të 14-të, e pikturuar në frymën e shkollës Kreto-Veneciane, para rilindjes Italiane, ikona mbart vlera të larta artistike, megjithëse e vendosur në një sfond dekorativ, të thjeshtë e të ndarë në dy ngjyra. Të dyja figurat, Ëngjëlli dhe Shën Maria qëndrojnë të qetë dhe të palëvizur ndërsa në ikonën e V. Zengos, ngjarja paraqitet ndryshe. Të dyja figurat po kryejnë veprim, Ëngjëlli po përcjell fjalën e Perëndisë dhe në dorë mban zambakun e bardhë –simboli i virgjërisë. Ky symbol është tipike i pikturës fetare perëndimore. Shën Maria paraqitet e bindur kundrejt vullnetit të Perëndisë dhe duke u lutur mbi një tavolinë si e devotshme ndaj tij. Ngjarja po ndodh në ambjent të brendshëm ku vihen re perdet që varen dhe thellësi, në perspektive në sfond pëllumbi –shpirti shenjtë. E gjithë piktura ka volum dhe realizëm.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Në këtë periudhë të gjitha ikonat, vihet re se kishte një varfëri të tejskashme, dhe sigurisht dhe të kishës. Ikonat pikturoheshin jo vetëm në dru, por në çdo vend, në telajo, në llamarinë, në fibra, letra etj. Mënyrat e përgatitjes ishin kryesisht jo cilësore. Artistët ikonografe filluan të mos përdornin më bojrat e ujit por ato të vajit. Por kjo nuk e ndali prodhimtarinë ku një sërë kishash u ndërtuan dhe u rindërtuan duke investuar vlera të larta monetare në to, siç ishte kisha e Shën Gjergjit në Korçë, ndërtimi (1875-1905), e cila për fat të keq u shkatërrua në kohën e diktaturës.

Frymëzimi nga perëndimi në fakt u reflektua në të gjitha fushat, siç ishte letërsia, shkencat, arkitektura, muzika. Në arkitekturë shohim se shumë nga katedralet janë në stilin Romanik. Një stil i përhapur shumë në botën perëndimore.

Zhvillim pati shumë dhe fotografia, ku përmenden emra të njohur si: Kristo Sulidhi, Perikli Kaçauni, Vani Burda, Dhimitri Vangjeli, Thimi Raci, etj. Ata jo vetëm dokumentuan ngjarjet historike, por gjithashtu dokumentuan jetën e përditshme, traditat, zakonet, veshjet apo dhe mënyrën e jetesës.



*Kisha “Burimi Jetëdhënës*




*Kisha e Metamorfozës*



*Shën Gjergji, Korçë*



*Vani Burda “Djem Korçarë*



*Thimi Raci Dardharet në valle*

Zgjimi konsistonte, përveçse figurativisht, dhe në transmetimin e fjalës dhe shpirtit

### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

të shenjtë në gjuhën shqipe. Prej shumë vitesh kishte tentativë në përkthimin e Biblës në gjuhën shqipe. Duke u iniciuar prej Gjerasim Qiriazit dhe Thanas Sinës u morën me redaktimin e përkthimeve në shqip të Shkrimit të Shenjtë. Thanas Sina gjithashtu shpërndante libra të Shoqërisë Biblike Britanike dhe predikonte ungjillin në gjuhën shqipe dhe me ndihmën e Gjergj Qiriazit, rishkroi Dhiatën e Re në dialektin tosk duke e shkruar me alfabetin e ri shqip në vitin 1912.

Ndërkohë pati disa përkthime nga Fan Noli, të liturgjive të ndryshme, si dhe meshimet filluan të kryheshin në gjuhën shqipe. Në vitin 1914 Atë Josif Qirici kreu meshën e parë në shqip, në Korçë. Ikonat, afresket dhe historitë biblike filluan të shkruheshin në gjuhën shqipe, nga artistët piktorë.

Finalizohet me shpalljen e kishës autoqefale në vitin 1922.



### **Referenca**

“Standardizimi i figurës së Skënderbeut nga artistët shqiptarë në fillim të shek. XX – Dr. Ermir Hoxha

MKAM (“Piktorë ikonografë nga Dardha” Kristaq Balli & Kristofor Naslazi)

“Dardharët” Ekspozitë dhe sesion shkencor në MKAM, viti 2021

**RAJONI I KORÇËS: RËNDËSIA E POZICIONIT GJEOGRAFIK,  
RRUGËVE TREGTARE DHE USHTARAKE NË ZHVILLIMIN E TIJ**

**Dr. Ermira JASHIKU**

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë,  
Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë  
ejashiku@unkorce.edu.al

**Abstrakt**

*Kushtet e favorshme natyrore të rajonit të Korçës, përfshirë tokat pjellore, burimet ujore dhe pyjet e pasura, kanë ndikuar në popullimin e tij që nga lashtësia. Pozicioni strategjik gjeografik i Korçës ka favorizuar kalimin e rrugëve të rëndësishme tregtare dhe ushtarake nëpër këtë rajon, duke lidhur Adriatikun me Egjeun, si rruga Egnatia. Në këtë artikull trajtohen rrugët që kanë kaluar që nga antikiteti dhe vazhdojnë të kalojnë edhe sot në rajonin Juglindor të Shqipërisë, si dhe rëndësia e tyre tregtare dhe ushtarake. Rrugët kryesore dhe dytësore të ndërtuara gjatë periudhave të ndryshme historike kanë luajtur një rol të rëndësishëm në lëvizjen e njerëzve, mallrave, kapitaleve dhe në shkëmbimet kulturore. Rajoni i Korçës edhe sot luan një rol shumë të rëndësishëm në komunikimin e pjesës perëndimore të Shqipërisë me shtetet fqinje si Maqedonia e Veriut, Republika e Greqisë dhe më gjerë*

**Fjalët kyçe:** *Rajoni i Korçës, pozicioni strategjik, rrugët tregtare, rrugë ushtarake, rrugët antike.*

**THE REGION OF KORÇA: THE IMPORTANCE OF ITS  
GEOGRAPHICAL POSITION, TRADE, AND MILITARY ROUTES IN ITS  
DEVELOPMENT**

**Abstract**

*The favorable natural conditions of the Korça region, including fertile lands, water sources, and rich forests, have influenced its population since ancient times. The strategic geographical position of Korça has favored the passage of important trade and military routes through this region, linking the Adriatic to the Aegean, such as the Egnatia road. This article addresses the routes that have passed since antiquity and continue to pass even today in the southeastern region of Albania, as well as their trade and military importance. The main and secondary roads built during various historical periods have played a significant role in the movement of people, goods, capital, and cultural exchanges. The Korça region still plays a very important role in communicating the western part of Albania with neighboring countries such as North Macedonia, the Republic of Greece, and beyond.*

**Keywords:** *Korça region, strategic position, trade routes, military routes, ancient roads.*

## **Pozicioni gjeografik**

Pozicioni gjeografik në të cilët ndodhet rajoni i Korçës, bën që ai të përcaktohet si një pikë e rëndësishme gjeostrategjike, në të cilën kanë kaluar rrugë të rëndësishme tregtare që nga lashtësia dhe në vazhdimësi, të cilat kanë bërë të mundur komunikimin e vendeve të perëndimit me ato të lindjes dhe anasjelltas. Në këtë rajon ka qënë pikëtakimi i popujve ilire, helene dhe maqedonas ku kufijtë e tij kanë ndryshuar vazhdimisht. Si pjesë e territorit shqiptar ky rajon ka qënë pjesë e perandorive të mëdha që kanë kontrolluar Ballkanin.

Rajoni i Korçës shtrihet në juglindje të Shqipërisë, në kufi me dy shtete fqinje: Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Greqisë. Nëpërmjet gjetjeve të ndryshme arkeologjike është vërtetuar që rajoni i Korçës është populluar që në periudha prehistorike. Faktorët Kryesorë të popullimit të këtij rajoni kanë qënë të lidhur kryesisht me kushtet natyrore si: *Toka Pjellore*: Vendbanimet e hershme rurale shpesh ndodheshin në zona me tokë pjellore që lehtësonte bujqësinë dhe blegtorinë. *Burimet Ujore*: Afërsia me lumenjtë, liqenet dhe burimet natyrore të ujit ishte thelbësore për zhvillimin e jetës, bujqësisë dhe peshkimit. *Strehimi Natyror*: Shpella, kodra dhe male që ofronin mbrojtje natyrore dhe kushte të favorshme për jetesë. *Pozicioni Strategjik*: Vendndodhja e përshtatshme në kryqëzimin me rrugët tregtare lehtësonin shkëmbimin e mallrave dhe kulturës, duke ndihmuar në zhvillimin e komuniteteve.

Rajoni i i Korçës ka një popullim të hershëm dhe të vazhdueshëm që nga prehistoria deri në ditët e sotme. Kjo vërtetohet nëpërmjet vendbanimeve si vendbanimi shpellor i Trenit, vendbanimi neolitik i Linit, vendbanimi Palafit i Dunavecit dhe Maliqit me një sërë gjetjesh arkeologjike.

Gjatë periudhës së parë të hekurit në këtë zonë gjenden disa vendbanime të fortifikuara si Gradishta e Shuecit, kalaja e Trajanit, Vëntrokut, kalaja e Korçës, kalatë e Kolonjës, kalaja e Bilishtit, etj.<sup>1</sup> Vazhdimësia e popullimit duket me gjurmët që janë gjetur në këtë zonë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme jetësore.

Rrugët e ndryshme që kanë kaluar nëpërmjet qafave ndërmallore dhe grykave si: Pragu i Çërravës, Qafa e Thanës, Qafa e Qarrit, Gryka e Cangonjit, Gryka e Kapshticës, Qafa e Kazanit dhe Qafa e Badrës kanë shërbyer për lidhjen e rajonit Juglindor me Maqedoninë Perëndimore me Egjeun dhe Thesalinë.<sup>2</sup>

## **Rrugët gjatë periudhës së antikitetit**

Zhvillimi i rrjetit rrugor në Shqipëri është i lidhur ngushtë me historinë e popullit shqiptar, me marrëdhëniet e tij ekonomike-shoqërore, me lidhjet që kishin krahinat e ndryshme të vendit tonë midis tyre dhe vendeve fqinje, në Ballkan dhe përtej Adriatikut. Pozita e favorshme gjeografike e Shqipërisë dhe e rajonit juglindor në veçanti, ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm të tij. Shqipëria jo vetëm që ka një vijë mjaft të gjerë bregdetare që prej Shkodrës në Vlorë, por me anën e luginave të Drinit, të Shkumbinit, të Devollit dhe të Vjosës lidhet me brendinë e gadishullit dhe këndeje me Lindjen.<sup>3</sup> Gjatë luginës së Devollit në kohët e vjetra u zhvilluan disa rrugë kryesore, të cilat mundësonin këmbimet tregtare, por

<sup>1</sup> Pirro Thomo, *Korça, Urbanistika dhe arkitektura*, (Tiranë: Morava, 2012), f. 26

<sup>2</sup> Skënder Aliu, *Kolonja, Studime Arkeologjike, Jeta Kultura dhe Identiteti*. (Korçë: Kotti, 2020), 26

<sup>3</sup> Jovan Adami, *Rrugë dhe objekte arkeologjike në Shqipëri*, (Tiranë: 8 Nëntori, 1983), 5

ato shërbyen edhe si rrugë strategjike ushtarake. Lugina e Devollit dhe Osunit kanë shërbyer si rrugë natyrore për lidhjen e qytetërimeve adriatiko- egjeane.<sup>4</sup>

Gjatë periudhës së antikitetit, të dhënat në lidhje me rrugët e rajonit juglindor përgjithësisht janë të pakta dhe në formën e shënimeve nga autorët antikë të cilët kanë shkruar mbi Ilirinë duke u bazuar në ato ç’kanë dëgjuar, prandaj dhe shënimet e tyre kanë mjaft gabime për sa u përket emrave dhe nuk japin të dhëna të sakta.<sup>5</sup> Polibi, Straboni, Ptolemeu, Plini, Dion Kasi, Tit Livi, Plutarku, Ciceroni etj., në veprat e tyre flasin për një numër të konsiderueshëm të rrugëve që përshkonin gjithë rajonin juglindor, dhe këto kryesisht me karakter ushtarak, duke u ndalur fillimisht tek Rruga Egnatia.<sup>6</sup>

Sipas Strabonit, kjo rrugë kishte dy pikënisje, njëra në Durrës dhe tjetra në Apoloni. Konkretisht Straboni shkruan: *“Ata që nisen nga Apolonia dhe Epidamni, pihen në një pjesë të rrugës që ka largësi të njëjtë nga këto qytete. Rruga e tërë quhet Egnatia, pjesa e parë është ajo që kalon nga Kandavia, mal i Ilirisë, dhe shkon përmes qytetit Lyhniid dhe vendit të quajtur Pylon, që shënon kufirin midis Ilirisë dhe Maqedonisë mbi këtë rrugë. Prej këtej shkon përmes heraklesë, lynkestëve dhe eordejve për në Edesë dhe Pella gjer në Thesalonik”*.<sup>7</sup> Sipas Strabonit ky ishte një itinerar shumë i rëndësishëm sepse bënte lidhjen e brigjeve të Adriatikut me zonat e brendshme të Ilirisë dhe ndërkohë lidhte rajonin e sotëm juglindor me vise të Maqedonisë dhe Greqisë. Ajo vazhdonte në Manastir, Selanik, Konstandinopojë e përtej.

Në kohët antike kanë ekzistuar edhe rrugë të tjera tokësore, të cilat lidhnin qytetet ose krahinat e ndryshme midis tyre. Karl Patsch nëpërmjet hartës së tij arkeologjike të Shqipërisë, flet për një rrugë që lidhte Beratin me Elbasanin duke përshkruar një itinerar prej Beratit, në drejtim të veriut, nëpër fushë derisa arrinte Devollin. Më pas vazhdonte anës së majtë të këtij lumi, e kapërcente atë te vendi Kadi-Pasha dhe pasi vazhdonte rrzës së kodrave arrinte Shkumbinin tek vendi Topçias, duke e kapërcëyer këtë mbi një urë.<sup>8</sup> Terreni i vështirë dhe kushtet e relievit, bënë të domosdoshme ekzistencën e një rruge të tillë në këto anë, të cilat, veç të tjerave vuanin edhe kontaktet e shpeshta mes tyre.

Karl Patsch hedh dritë edhe për një tjetër rrugë që lidhte Beratin me Korçën. Sipas tij, kjo rrugë vinte nga Berati në fushën e Korçës deri për në qytetin ilir të Pelionit. Në lidhje me qytetin e Pelionit ende nuk ka një evidentim të saktë të vendodhjes së tij; disa studiues mendojnë se ka qënë pranë grykës së Cangonjit, disa të tjerë e evidentojnë në majë të një kodre që kontrollonte fushën e Devollit, por edhe Maqedoninë. Konkretisht Patschi përshkruan: *“Shkonte pas Osunit, kalonte pastaj në të majtë dhe pas Tomorit vazhdonte për në Lindje”*.<sup>9</sup> Autorë të tjerë flasin për një pjesë rruge të rregullt, e cila shkonte në anën perëndimore të Tomorit, afër Qafës së Dardhës. Megjithatë, rruga e mëvonshme e karvanit Berat-Korçë, që kalonte nga Qafa e Dardhës tregonte për një rrugë me funksion tregtar. Kjo rrugë mendohet se është ndërtuar që në lashtësi, pasi ajo tregon për komunikimin midis pjesës juglindore me fushën e Myzeqesë nga e cila siguronte edhe prodhimet kryesore

<sup>4</sup> S. Aliu, *Kolonja*, 26

<sup>5</sup> J. Adami, *Rrugë*, 5

<sup>6</sup> *Po aty*

<sup>7</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, (Tiranë: Toena, 2002), 160

<sup>8</sup> J. Adami, *Rrugë dhe objekte*, 43

<sup>9</sup> *Po aty*,

bujqësore. Një rrugë tjetër e ndërtuar që në periudha të hershme ka qënë ajo që lidhte Shqipërinë Lindore, fushën e Devollit dhe atë të Korçës me Maqedoninë.<sup>10</sup>

Këto rrugë nuk kanë shërbyer vetëm për funksion tregtar, por edhe ushtarak. Të dhënat flasin për rëndësinë strategjike të fushës së Devollit, e cila ka qënë porta hyrëse e ushtrive të ndryshme drejt Shqipërisë, si në rastin e betejës së Aleksandrit të Madh të Maqedonisë me ilirët e Klitit dhe të Glaukisë në qytetin e Pelionit. Ndërkohë, Tit Livi në librin e tij të XXXI përshkruan luftrat e Filipit për të zgjeruar territoret e Maqedonisë. Gjatë luftimeve me romakët ai jep një përshkrim për rrugën që kalonte në rajonin e sotëm juglindor gjithashtu edhe për zhvillimin bujqësor të këtij rajoni. Ai e përshkruan kështu udhëtimin e Filipit: “*Ai u nis me ushtrinë e tij për në krahinën e Desaretëve dhe gjithë drithin që mori me vete nga kampi i tij i dimrit nuk e harxhoi, meqënëse tokat e desaretëve kishin mjaft bërëqet për ushtarët*”.<sup>11</sup> Nga këto të dhëna mund të themi se rajoni i sotëm juglindor ka qënë një zonë e cila është populluar që në periudha të hershme, me toka pjellore, bujqësi të zhvilluar dhe ka patur lulëzim dhe një rëndësi të madhe për komunikimin me zonat e tjera.

### **Rrugët në Shqipëri gjatë periudhës së Mesjetës dhe Kohës së Re**

Pozita gjeografike në kufi me Italinë e rriti së tepërmi rolin strategjik të trevave shqiptare, të cilat u kthyen në një nyje komunikimi ndërmjet Lindjes e Perëndimit. Një rol të tillë e favorizonte ekzistenca e rrjetit rrugor që fillonte nga brigjet lindore të Adriatikut e të Jonit dhe shtrihej në thellësi të gadishullit, duke lidhur me bregdetin qendra të tilla të rëndësishme, si Nishi, Shkupi, Ohri, Kosturi, Selaniku, e vetë Kostandinopoja.<sup>12</sup>

Ashtu si në shekujt e mëparshëm, Via Egnatia vazhdoi të luante rolin kryesor të komunikimit ndërmjet provincave të Perandorisë në rrafshin horizontal. Krahas kësaj rruge ekzistojnë edhe një sërë rrugësh të tjera, të cilat bënë mundur kontaktet mes zonave të brendshme apo ndarjes së vonshme të territoreve të Shqipërisë në rajone. Deri në shekullin XII, rrugët e Shqipërisë kishin më tepër rëndësi ushtarake, por pas kësaj periudhe rritet shkëmbimi i bendshëm dhe i jashtëm, zhvillohet tregëtia dhe si rrjedhim investohet edhe te rrugët. Rrugët e vjetra ekzistuese fituan një rëndësi të re dhe rrugë të reja u krijuan sipas nevojave të reja të vendit.

Shekulli XV shënon ndryshime të mëdha në jetën politike-shoqërore dhe ekonomike. Tiparet më të përhapura të kësaj periudhe janë të pranishme në një rënie të shpejtë të forcave prodhuese. Në kohën e pushtimit turk si rezultat i ndërprerjes së zhvillimit normal të ekonomisë në Shqipëri, shumë rrugë humbën rëndësinë dhe ato nuk ishin gjë tjetër veçse një vazhdim i rrugëve mesjetare. Pas shekullit XVI qytetet shqiptare rimëkëmben ekonomikisht, duke krijuar qendra tipike mesjetare. Organizimi i panairëve ku merrnin pjesë fshatarë të zonave përreth, zejtarë, tregtarë vendas dhe të huaj bëri të domosdoshëm funksionimin e një rrjeti rrugor, i cili shfrytëzoi akset e rrugëve antiko-mesjetare paraardhëse. Për strehimin dhe pushimin

<sup>10</sup> *Po aty*, 44

<sup>11</sup> AShSh, *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, (Tiranë: Toena, 2002), 109

<sup>12</sup> J. Adami, *Rrugë*, 45



e tregtarëve të huaj dhe vendas, gjatë rrugëve dhe qyteteve kryesore u ndërtuan karvansarajat (hotelet e kohës).<sup>13</sup> Krahinat e Shqipërisë Juglindore, për arsye gjeografike nuk prekeshin nga vijat e mëdha transversale të komunikacionit. Lugina e Devollit, për shkak të terrenit të vështirë nuk krijonte kushte të përshtatshme për ndërtimin e një rruge të mirëfilltë. Megjithatë, krahinat e Shqipërisë Juglindore kishin lidhje dhe shkëmbime më të lehta me Maqedoninë dhe bregdetin e Adriatikut. Duke iu referuar të dhënave arrijmë të evidentojmë disa rrugë, të cilat ndihmonin në lidhjen e këtyre territoreve. Një prej tyre ishte rruga që afronte Shkodrën, Lezhën me Elbasanin dhe me Shipërinë e Jugut, me Ohrin, me Korçën, me Beratën e me Përmetin; kjo rrugë kalonte mbi qafën e Kërrabës. Në kohën e sundimit turk, gjatë kësaj rruge, transportohej posta zyrtare nga Shkodra për në Manastir. Po të marrim parasysh konfiguracionin e terrenit nëpër të cilin kalonte kjo rrugë mund të themi se ka patur një rëndësi të madhe dhe “*jo rrugë për qerre*”- shpjegon J. Adhami.<sup>14</sup> Rruga Durrës- Elbasan- Qafë e Thanës ishte vazhdim mesjetar i Rrugës antike Egnatia. Me fillimin e sulmeve osmane në shekullit XIV kundër Shqipërisë, Qafa e Thanës luajti një rol kryesor meqë Manastiri dhe Ohri ishin bazat turke më të përparuara. Mendohet se kjo rrugë ka patur një rëndësi të madhe, sidomos për krahinën e Mokrës, e cila shtrihej në të majtë dhe në të djathtë të saj. Pas kësaj rruge udhëtonin karvanet që niseshin nga Durrësi, Shkodra, Berati, Elbasani për të transportuar prodhimet shqiptare për në Ohër, Manastir, Maqedoni, Bullgari dhe Vllahi. Këtë rrugë e rrihnin karvanet e tregtarëve të mëdhenj voskopojarë të shekullit XVII-XVIII.<sup>15</sup>

Rruga midis Korçës dhe Elbasanit ishte e vetmja lidhje e drejtpërdrejtë mes këtyre dy qyteteve. Ajo kalonte qafën e Shën-Premtes, e cila në dimër ishte e pakalueshme për asrye të lartësisë së saj prej 1444m dhe bllokimit prej borës.

Rruga Vlorë-Berat-Voskopojë-Korçë ishte një rrugë e karvanëve, e cila mundësonte furnizimin e rajonit juglindor me vaj dhe ullinj, por në të njëjtën kohë këto produkte eksportoreshin edhe në Maqedoni apo edhe në vende të tjera në lindje të Ballkanit. Drithi dërgohej nëpër krahinat e varfra malore ose përtej detit, kurse vaji dhe ullinjët merrnin rrugën e Korçës, të Maqedonisë dhe të vendeve të tjera në lindje të Ballkanit. Dy rrugë i shërbenin këtij qëllimi, e para shkonte në lindje për në fushën e Korçës, tjetra shkonte në juglindje, përgjatë Osunit dhe përfundonte në Kolonjë.<sup>16</sup> Rruga e lindjes kalonte në anën e djathtë të Osunit- Vodice- pllaja veriperëndimore e Tomorit- Qafa e Dardhës- Trovë- Ostin- Romas. Më pas kalonte lumin e Tomoricës- Dobrenj- Guri i Prerë, i cili njihej si kufi midis Korçës dhe Beratit, vazhdonte në Dushar- Protopapë dhe drejtohej për nga Voskopoja.

Voskopoja ishte një qendër ekonomike dhe kulturore mjaft e rëndësishme në shekujt XVII- XVIII. Ajo dallohej për zeje të ndryshme sidomos për përpunimin e leshit. Tregtarët e saj bënin tregëti me Beogradin, Vjenën, Venedikun Budapestin, Transilvaninë, Turqinë, Vllahinë, Bosnjën.<sup>17</sup> Një pjesë e mirë e prodhimeve të zonës

<sup>13</sup> Valter Shtylla, *Rrugët dhe urat në Shqipëri*, (Tiranë: Toena, 1997), 92

<sup>14</sup> J. Adami, *Rrugë dhe objekte*, 58

<sup>15</sup> *Po aty*,

<sup>16</sup> *Po aty*, 63

<sup>17</sup> Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës (1669-1769)*, (Tiranë: Toena, 2010), 99

njihej dhe tregtohej në Ballkan, konkretisht qilimat dhe sixhadet e Korçës dhe shajaku i Voskopojës. Krahas zhvillimit të marrëdhënieve tregtare, Voskopoja e kësaj periudhe paraqitet edhe si një qendër e rëndësishme administrative dhe kulturore. Në atë kohë ekzistonte një shërbim i rregullt karvanesh, të cilin dokumentat e kohës e cilësojnë “per via di Voskopoli”-dmth me një rrugë, e cila nga Durrësi ose Vlora shkonte për në Voskopojë. Tregtarët voskopojarë transportonin postën zyrtare të Venedikut deri në Stamboll ose Durrës, prandaj njiheshin me emrin korrierët diplomatikë të Republikës Venedikase.<sup>18</sup> Për një periudhë ta gjatë kohore Voskopoja e zhvilloi tregëtinë e saj me zonat përreth, por jo vetëm, nëpërmjet rrjetit tokësor. Rruga e Voskopojës vazhdonte deri në Stamboll dhe Vllahi. Nga Voskopoja kalonte pas përroit të Gjonomadhit për në Voskop, vazhdonte nëpër fushë duke kaluar nëpër Turan dhe arrinte Korçën nga ana perëndimore. Megjithëse Korça dokumentohet që para pushtimit të turqve, ajo nuk luante ndonjë rol të rëndësishëm për tregtarët voskopojarë; zhvillimi i saj filloi pas prishjes së Voskopojës nga fundi i shekullit XVIII.

Në këtë periudhë një qendër mjaft e rëndësishme tregtare ishte edhe Kosturi. Ky qytet ka qënë pronë e familjes së Muzakajve dhe gjatë sundimit turk dallohej mjaft sidomos për prodhimin e qyrqeve, të cilët ishin mjaft të njohur në të gjithë Perandorinë Osmane. Tregtarët e Kosturit kishin lidhje të rregullta me tregtarët e Voskopojës, Korçës dhe Ohrit.<sup>19</sup> Rruga Korçë- Fushë e Devollit- Kostur bënte lidhjen e krahinave të Shqipërisë Juglindore, Maqedonisë dhe Kosturit. Rruga Korçë- Kostur ndiqte një itinerar të tillë duke filluar që nga ana perëndimore e Moravës- gryka e Cangonjit- Bilisht- Kapshticë- Labanicë-Shën e Djel-Kostur.

Nga Gryka e Cangonjit ishte edhe një rrugë tjetër, përgjithësisht një rrugë karvani e cila të çonte në Follorinë, prej këtu në Manastir ose Selanik. Kjo rrugë e kapërcente lumin Devoll te Ura e Sapunxhiut, kalonte në jug të kodrave të Gollobordës - Maçurisht - Progër - Gryka e Ujku - përgjatë Prespës së Vogël - Drenovë - Bukovik - Zhelovë - Pisoder - Follorinë. Një rrugë tjetër mjaft e rëndësishme që i përket kësaj periudhe ishte Rruga Korçë- Kolonjë- Janinë. Edhe kjo rrugë kishte një rëndësi mjaft të madhe për komunikimin e këtij rajoni me Janinë. Rruga kalonte nga Korça, anës Moravës – Floq - Qafa e Qarrit – Ura e Dukës – Starje–Borovë–Barmas–Prodë–Leskovik - Ura e Peratit - hani i Kalibaqit - Janinë.

Gjatë shekujve XV-XIX, për realizimin e transportit tokësor, i cili përballonte një ngarkesë të madhe në marrëdhëniet tregtare të kohës funksiononin një sërë rrugësh, kryesisht për karvane me kafshë, e më pak për karro e qerre në terrenet fushore.<sup>20</sup> Në fushën e ndërtimit të rrugëve, sistemi otoman nuk ndërmerri iniciativa për hapje rrugësh; përgjithësisht u shfrytëzuan rrugët ekzistuese.

Zhvillimi i raporteve kapitaliste dhe ndikimi i kapitalit të huaj në mesin e shekullit XIX shtroi si domosdoshmëri ndërtimin e rrugëve nga Perandoria Turke. Eksperienca e Luftës Ruso-Turke i tregoi turqve rëndësinë e rrugëve për të transportuar ushtritë dhe furnizimet. Rrugët që do ndërtoheshin, krahas qëllimeve

<sup>18</sup> J. Adami, *Rrugë*, 65

<sup>19</sup> P. Thomo, *Korça, Urbanistika*, 33

<sup>20</sup> V. Shtylla, *Rrugët dhe urat*, 94

strategjike do të përdroreshin edhe për të lidhur midis tyre krahinat e ndryshme të perandorisë. Megjithëse u mendua për ndërtimin e një rrjeti rrugor, administrata turke nuk ishte në gjendje të ndërtonte vepra të tilla. Prandaj, e vetmja rrugë e ndërtuar nga qeveria turke gjatë kësaj periudhe ngeli rruga Manastir- Korçë-Janinë.<sup>21</sup> Ndërtimi i saj filloi në vitin 1892, në një distancë prej 250 km nga Manastiri në Janinë; punimin e rrugës, si gërmimin, çeljen e hendeqeve dhe shtrimin e çakëllit e bëri popullsia vendase si punë angari.<sup>22</sup>

### **Rrugët e ndërtuara përgjatë shekullit XX**

Në fillim të shekullit XX u shtrua plani për ndërtimin e një rruge midis kryeqytetit dhe viseve perëndimore, siç ishte Via Egnatia e dikurshme. Për këtë arsye, në vitin 1902 filloi ndërtimi nga Manastiri dhe Elbasani. Në fazën e parë të ndërtimeve u krye rruga Manastir -Ohër, ndërsa në fazën e dytë (1908-1909) u ndërtua pjesa prej Qukësit në Hotolisht. Megjithatë, rruga nuk u përfundua kurrë. Me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar në 1912, nga sundimi turk ngelën vetëm 160 km rrugë në pjesën Goricë – Korçë - Ura e Peratit, nga e cila mund të kalohej me qerre. Gjatë viteve 1914-1918 Shqipëria u bë pjesë e Luftës së Parë Botërore, duke u pushtuar nga fuqitë e ndryshme ndërluftuese; Austro-Hungaria pushtoi Shqipërinë e Veriut e të Mesme dhe arriti deri në Vjosë, Italia pushtoi jugun nga Vlora deri në Kolonjë dhe francezët qarkun e Korçës.

Gjatë kohës kur rajoni i Korçës ishte nën pushtimin francez rajoni i Korçës kishte më shumë rrugë se të gjitha krahinat e tjera. Megjithatë ashtu si austro-hungarezët dhe italianët, edhe autoritet franceze, për nevojat e tyre luftarake ndërtuan disa vepra me rëndësi në fushën e infrastrukturës lokale. Në Rajonin e Korçës nga francezët, u ndërtuan dhe u përmirësuan këto rrugë: Korçë- Follorinë; Korçë- Maliq Pogradec, Korçë- Voskopojë; Korçë- Zvezdë- Podgorie- Pogradec, Korçë- Ersekë.<sup>23</sup> . U ndërtua edhe rruga Zvezdë- Grabovicë, e cila kalonte pas Malit të Thatë dhe shërbente kryesisht për qëllime ushtarake.<sup>24</sup>

Gjatë viteve 1920-1939 u ndërtuan disa akse rrugore të cilat ndihmuan në qarkullimin e njerëzve dhe të mallrave. Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës filloi meremetimin e disa rrugëve dhe urave sidomos për arteriet kryesore të lëvizjes. Në vitin 1922 u krijua Ministria e Punëve Botore “Batalionet e rrugëve” në të cilin ishin të punësuar rreth 800 punëtorë.<sup>25</sup> Edhe pse nuk pati suksesin e pritur, gjatë kësaj periudhe, në vitin 1923 filluan punimet për ndërtimin e pjesëve të rrugës Durrës-Elbasan Korçë. Njëkohësisht u hap rruga Peqin- Elbasan- Librazhd- Hotolisht dhe Qukës-Qafë Thanë- Pogradec, ku punimet vazhduan deri në vitin 1926.

Ishte pikërisht kjo rrugë që ndryshoi marrëdhëniet tregtare të qarkut të Korçës, të cilat para hapjes së saj zhvilloheshin vetëm me Manastirin dhe Selanikun. Ndërtimi i kësaj rrugë shtoi marrëdhëniet tregtare të rajonit juglindor me perëndimin e Shqipërisë, por edhe me vendet e Europës Perëndimore. Sipas Teki Selenicës, Prefektura e Korçës kishte tre arterie kryesore më të cilat komunikonte: Rruga

<sup>21</sup> J. Adami, *Rrugë dhe objekte*, 63

<sup>22</sup> Po aty,

<sup>23</sup> Aqsh. Fondi 440, Dosja 1-21, Themistokli Gërmenji, fl, 203.

<sup>24</sup> AShSh, *Historia e Popullit Shqiptar, Volumi III*, (Tiranë: Toena, 2007),107

<sup>25</sup> J. Adami, *Rrugë dhe objekte*, 78

Korçë- Bilisht- Follorinë, e cila bënte të mundur lidhjen me Greqinë. Rruga Korçë-Kolonjë- Leskovik- Përmet, e cila bënte lidhjen me Beratin, Vlorën, Gjirokastrën dhe Sarandën. Rruga Korçë- Pogradec- Elbasan, e cila bënte lidhjen me Elbasanin, Tiranën dhe Durrësin.

Deri në fund të vitit 1926 në prefekturën e Korçës funksiononin disa rrugë kombëtare të “goditura” (me kalldrëm): *“Lumturisht gjithë rrugët e kësaj Prefekturë janë të goditura dhe kështu komunikacioni me botën e jashtme e shqiptare është i siguar e i lehtë dhe kjo lehtësi ka shpejtuar zhvillimin e përparimin e vendit në kohë fare të shkurtër”*.<sup>26</sup> Numëroheshin disa rrugë të tilla si Korçë- Maliq- Grabovicë (27 km), Korçë- Zvezdë (35 km), Korçë- Kufi me Greqinë (26 km), Korçë- Qarr (22 km), Pogradec- Qafë e Thanës (25 km), Pogradec- Grabovicë (15 km), Cangonj- Kufiri Grek (21 km). Ndërkohë, Teki Selenica përmend edhe rëndësinë e komunikimit midis dy shteteve Shqipëri - Maqedoni nëpërmjet liqenit të Ohrit. Lëvizja bëhej një herë në javë nëpërmjet vaporet me emrin A. Garique me itinerarin Pogradec- Ohër. Nëpërmjet kësaj linje bëhej i mundur kalimi i njerëzve, por edhe i mallrave, shumica e të cilave importoheshin nga Maqedonia.<sup>27</sup> Deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, në këtë hapësirë gjeografike, në lidhjen trepolare Korçë–Manastir–Follorinë kanë ekzistuar marrëdhënie ekonomiko–tregtare intensive. Gjatë gjithë periudhës së pas luftës, kjo hapësirë rezultoi e izoluar dhe me nivelin më minimal të shkëmbimeve tregtare. Pas përfundimit të Luftës së II Botërore ndryshimet në gjatësinë e rrugëve nacionale që kalonin nëpër rajonin e Korçës kanë qënë jo shumë të mëdha.

### **Rrugët sot**

Shqipëria trashëgoi nga e kaluara komuniste një infrastrukturë të pazhvilluar dhe të papërshtatshme për kërkesat që kërkonte një ekonomi tregu e lirë. Vitet e tranzicionit u karakterizuan nga një infrastrukturë rrugore me investime të mëdha, krahasuar me periudhat e mëparshme. Ajo, përbën sot një nga prioritetet kryesore për zhvillimin e përgjithshëm të rajonit juglindor. Peshën më të madhe në këtë rajon e ka transporti automobilistik, i cili, nëpërmjet Qafës së Thanës, Tushemishtit, Goricës dhe nëpërmjet grykës së Kapshticës mundëson lidhjen me shtetet fqinje.

Një pjesë e akseve rrugore klasifikohen në kategorinë e superstradës; një ndër to është edhe rruga që kalon nga Kapshtica në Qafë Plloçë në një distancë prej 67 Km. Njëherazi ky segment rrugor përbën edhe aksin kryesor të gjithë rajonit. Në të fluksi i qarkullimit është në intensitet të lartë, për shkak të gjerësisë optimale dhe shpejtësisë më të madhe. Segmenti Qafë Plloçë–Kapshticë përveçse është pjesë e aksit kombëtar lindor ai ka rëndësi ndërkombetare pasi mundëson lidhjen fizike të Korridorit VIII me portin e Selanikut.

Duke e parë në këndvështrimin gjeopolitik rajonal, mund të themi se hapësira gjeografike e rajoni të Korçës ndodhet pranë fluksit të fuqishëm të lëvizjes së mallrave, njerëzve, kapitaleve, informacionit etj, që kalojnë nga perëndimi në lindje përgjatë Korridorit VIII. Prania e një korridori të tillë është një element nxitës për zhvillimin ekonomik të gjithë rajonit ballkanik në përgjithësi dhe atë të vendit tonë në veçanti. Rajoni juglindor ndodhet në kontakt me gjurmën tradicionale të korridorit

<sup>26</sup>Teki Selenica, *Shqipëria më 1927*, (Tiranë: Shtypshkronja “Tirana”, 1928), 330

<sup>27</sup> T. Selenica, *Shqipëria*, 331

VIII Durrës-Qafë Thanë. Në hapësirën e tij ndodhen edhe disa pika të rëndësishme doganore si ajo e Qafë Thanës (pranë të cilës realizohet edhe qarkullimi më i madh për pjesën lindore të këtij korridori), Tushemishtit dhe Goricës në një distancë 45 - 60 km nga qyteti i Korçës me anë të cilave realizohet komunikimi me Maqedoninë, ndërsa pikat doganore të Kapshticës dhe të Tre Urave vendosin kontaktin me Greqinë.

Konkretisht, lidhja e rajonit juglindor me Greqinë bëhet nëpërmjet Korridorit VIII me linjën shqiptare, Tiranë-Korçë-Kapshticë-Selanik, ndërsa me Maqedoninë bëhet nëpërmjet linjës maqedonase Shkup-Follorinë-Selanik. Rrugët që lidhin Korçën si qendra më e rëndësishme urbane e kësaj zone me qendrat e tjera janë përgjithësisht sipas standarteve të kohës, çka ka lehtësuar lëvizjen e njerëzve, kapitaleve edhe mallrave.

#### **Konkluzione:**

- Rajoni i Korçës është i pasur me toka pjellore, liqene, lumenj dhe burime nëntokësore, çka ka mundësuar një popullim të vazhdueshëm që nga prehistoria.
- Ky rajon gjithashtu ka një histori të hershme në lidhje me kalimin e rrugëve kryesisht me qëllime ushtarake dhe tregtare. Kufiri me dy shtetet, Greqinë dhe Maqedoninë, ka bërë të mundur komunikimin nga Lindja në Perëndim dhe anasjelltas.
- Kalimi i rrugëve të rëndësishme tregtare nëpër rajonin e Korçës tregojnë për rëndësinë e tij nga pikpamja ekonomike dhe strategjike.
- Këto rrugë ndihmuan në zhvillimin e tregtisë dhe kulturës, duke e bërë Korçën një qendër të rëndësishme të shkëmbimeve tregëtare dhe kulturore.
- Rruga Egnatia ka pasur një funksion të rëndësishëm në lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe kapitaleve; rëndësia e saj duket edhe sot.

#### **Bibliografia**

Aqsh. Fondi 440, Dosja 1-21, Themistokli Gërmenji, Fl, 203.

Adami, Jovan. *Rrugët dhe objekte arkeologjike në Shqipëri*, (Tiranë: 8 Nëntori, 1983),

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar, Volumi III*, (Tiranë: Toena, 2007)

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, (Tiranë: Toena, 2002),

Aliu, Skëndër *Kolonja, Studime Arkeologjike, Jeta Kultura dhe Identiteti*. (Korçë: Kotti, 2020)

Selenica, Teki. *Shqipëria më 1927*, (Tiranë: Shtypshkronja “Tirana”, 1928)

Shtylla, Valter. *Rrugët dhe urat në Shqipëri*, (Tiranë: Toena, 1997),

Thomo, Pirro. *Korça, Urbanistika dhe arkitektura*, (Tiranë: Morava, 2012),

Xhufi, Pellumb. *Shekulli i Voskopojës (1669-1769)*, (Tiranë: Toena, 2010)

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

## **TIPARET E ZHVILLIMIT URBAN TË QYTETIT E KORÇËS DHE TRASHËGIMIA NË FIZIONOMINË E SOTME**

**Prof. as. dr. Edlira MENKSHI**

*Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë  
Universiteti “Fan S. Noli”*

**Msc. Jorida TOLLKUÇI**

*Biblioteka publike “Thimi Mitko”, Korçë*

**Dr. Ermiona BRAHOLLI**

*Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë  
Universiteti “Fan S. Noli”*

### **Abstrakt**

*Zhvillimi urban i qytetit të Korçës është kushtëzuar nga konteksti gjeografik dhe historik dhe në mënyrë të dukshme është formësuar nga influencat ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Ky zhvillim i referohet shtrirjes fizike, kapacitetit të infrastrukturës, ndërtimeve dhe shërbimeve sociale, të cilat kanë influencuar cilësinë e jetës së banorëve dhe dinamikat e komunitetit. Studimi analizon tiparet e zhvillimit urban të qytetit të Korçës, transformimet në formën dhe strukturën urbane, si edhe elementët e trashëguar në fizionominë e qytetit të sotëm. Metodologjia e përdorur për realizimin e punimit është përshkruese kualitative, bazuar në perspektivën e kërkimit historik, analizën e transformimit të qytetit, analizën e hartave etj.*

*Në përfundim, nëpërmjet analizës të dhënave të siguruara, janë paraqitur disa përfundime dhe sugjerime në lidhje me politikat e zhvillimit urban të qytetit në të ardhmen dhe ruajtjen e elementëve tradicionalë. Karakteri i studimit është gjeografik, por analiza e të dhënave është bërë në ndërthurje edhe me njohuri nga disiplinat e tjera. **Fjalë kyçe:** fizionomi urbane, zhvillim i infrastrukturës, konteksti historik, influenca kulturore*

## **CHARACTERISTICS OF THE URBAN DEVELOPMENT OF KORÇA CITY AND THE HERITAGE IN TODAY'S PHYSIOGNOMY**

### **Abstract**

*The urban development of the city of Korça is conditioned by the geographical and historical context and is shaped by economic, social, cultural, and political influences. This development refers to the physical extent and capacity of the infrastructure, construction, and social services, which have influenced the residents' quality of life and the community dynamics. The study analyzes the features of the urban development of the city of Korça, the transformations in the urban form and structure, and the inherited elements in the physiognomy of today's city. The methodology used for the realization of the work is qualitative descriptive, based on the perspective of historical research, the analysis of the city's transformation, the analysis of maps, etc. In conclusion, through the analysis of the provided data, some conclusions and suggestions are presented regarding the city's future urban development policies and the protection of traditional elements. The character of the study is geographical, but the data analysis is done in combination with knowledge from other disciplines.*

**Keywords:** *urban physiognomy, infrastructure development, historical context, cultural influence*

## **1. Hyrje**

Qyteti i Korçës përbën qendrën urbane të bashkisë dhe qarkut Korçë. Në nivel kombëtar, ai është pjesë e një rrjeti të gjerë të qyteteve shqiptare, ndërkohë që në kontekstin rajonal, përsa i përket madhësisë, popullsisë, administrimit, aktiviteteve ekonomike dhe kulturore, qyteti përbën qendrën kryesore urbane të rajonit juglindor të Shqipërisë. Favorizuar nga pozicioni gjeografik, roli i qytetit konsiderohet gjithashtu i rëndësishëm edhe në këndvështrimin historik ndër-rajonal, ku dominojnë lidhjet e hershme me qendrat urbane në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Ohrin, Manastirin, Shkupin) dhe në Greqi (Kosturin, Follorinën dhe Selanikun). Prej vitit 1990, këto lidhje ndër-rajonale janë rritur dukshëm dhe përbëjnë akse të rëndësishme potenciale për zhvillimin e qytetit (Menkshi & Shehu, 2020).

Territori i qytetit të Korçës ndodhet në gjerësinë gjeografike  $V 40^{\circ} 36' 22''$  -  $J. 40^{\circ} 37' 23''$  (2.5 km) dhe gjatësi gjeografike  $L 20^{\circ} 46' 15''$  -  $P. 20^{\circ} 47' 45''$  (1.5 km). Qyteti shtrihet në lartësinë 870-900 m mbi nivelin e detit (përcaktuar sipas imazheve satelitore) në një sipërfaqe prej 17 km<sup>2</sup>. Në aspektin fiziko-gjeografik qyteti shtrihet në lindje të fushëgropës së Korçës dhe pjesërisht rrëzë kodrave të Partizanit (kodrat e Shën Thanasit dhe Shëndëllisë). Morfologjia e relievit me pjerrësi nga lindja në drejtim të perëndimit, ka kushtëzuar zgjerimin dhe shtrirjen e qytetit në pjesën më të madhe të tij, në drejtim të perëndimit Kodrat përfaqësojnë mbetje terrigjene (mbizotërim të argjilave) të strukturës grabenore të Korçës (Gruda, 2020), (Qiriazi, 1985). Qyteti dallohet për mesdhetare paramalore, nënzona jugore me ndikime të klimës kontinentale, e shprehur kjo në temperatura dhe rreshje. Temperaturat mesatare vjetore janë 10.50 C , muaji më i ftohtë është janari 0.50 C dhe muaji më temperatura më të lartë është korriku me 39.0 C (Qiriazi, 2019). Sasia mesatare vjetore e reshjeve përlllogaritet 790 mm, të cilat janë konsideruar nën vlerën mesatare vjetore të territorit shqiptar. Rreshjet e dëborës janë të pranishme në periudhën e ftohtë të vitit. Hidrografia përfaqësohet me lumin e Dunavecit dhe disa burime të vegjël ujorë. Pozicioni gjeografik dhe faktorët natyrorë, kanë ndikuar në shtrirjen dhe zgjerimin e qytetit, në orientimin e sistemit rrugor apo orientimin e ndërtimeve nga lindja drejt perëndimit.

Procesi i zhvillimit urban të qytetit, nëpërmjet perspektivës historiko-gjeografike kaluar në disa periudha të rëndësishme duke filluar që nga krijimi i qytetit deri në ditët e sotme; themelimi i qytetit të Korçës deri në fund të shek XVIII; zhvillimi i qytetit në shek.XIX; zhvillimi i qytetit në shek. e XX (diktuar zhvillime të rëndësishme historike) dhe zhvillimi i qytetit të sotëm. Në kuadrin e kërkimeve shkencore gjeografike, ky studim analizon tiparet e zhvillimit urban të qytetit të Korçës, duke nxjerrë në pah elementët fizikë që strukturojnë qytetin dhe proceset që kanë ndikuar në formimin e tij.

## **2. Metoda e studimit**

Studimi i morfologjisë urbane të qytetit të Korçës është realizuar nga rishikimi i literaturës shkencore, analizës së hartave të qytetit në periudha të ndryshme historike, vëzhgimeve të objekteve në terren, analizës së fotove dhe regjistrimeve të kohës. Karakteri divers i vendbanimeve urbane, shtron nevojën e studimit të saj

nëpërmjet ndërthurjes së njohurive nga shumë disiplina; gjeografia, historia, arkitektura, arkeologjia, planifikimi urban etj. (Whitehand, 2012). Metodologjia e përdorur për realizimin e punimit është përshkruese kualitative, bazuar në perspektivën e kërkimit historiko-gjeografik, në analizën e transformimit të qytetit të pasqyruar në harta. Nëpërmjet përdorimit të ArcGIS 10.1 janë krijuar harta digjitale për periudhat të ndryshme të zgjerimit të qytetit (shek.XVII-XXI), mbi të cilën janë pasqyruar ndryshimet e formës urbane të qytetit. Gjithë materiali i siguruar dhe analiza e të dhënave, u shoqëruan me ekspertizën në terren, për të parë nga afër gjurmët e ekzistencës historike, ndryshimet aktuale në strukturën urbane të qytetit që përfshijnë rrugët, blloqet e ndërtimit dhe ndërtimet, aktivitetet përdorimit të tokës dhe hapësirat e hapura. Metodologjia e analizës bazohet duke kombinuar evidentimin e disa elementëve: strukturave, materialeve të ndërtimit, blloqeve të ndërtimit dhe ndërtesave, që formojnë qytetin dhe i japin karakterin dhe tipologjinë e veçantë.

### **3. Krijimi i qytetit të Korçës dhe zhvillimi urban deri në fund të shek.XIX.**

Gjetjet arkeologjike (vendbanime, vendvarrime, fortifikime) që janë zbuluar në zonat përreth qytetit të sotëm të Korçës, si: në Maliq, Vashhtëmi, Dunavec, Barç, Kamenicë, Mborje etj. dëshmojnë për ekzistencën e jetës dhe vazhdimësinë e pandërprerë të saj, që në prehistori (Menkshi, 2020). Referuar këtyre dëshmime, studiuesit mendojnë se qyteti mund të ketë ekzistuar si vendbanim qysh në antikitet, megjithatë origjina e krijimit dhe ekzistencës së tij, është ende e diskutuar në mes të studiuesve.

Dokumentet e kohës dhe burimet e shkruara e përmendin Korçën si vendbanim, në gjysmën e parë të shek.XV (Selenica, 1928). Të dhëna për ekzistencën e qytetit përcjellin edhe shkrimet e Gjon Muzakës (1510), feudal shqiptar, i cili në një testament të lënë prej paraardhësit të tij Andrea Muzaka (1280-1319) Sebastokrator, përmend si zotërimet të Muzakajve, krahas Myzeqesë, Tomoricës, Oparit, Devollit, Kosturit edhe Korçën. (Pepo, 1981) (Thomo, 2012).

Në Kodikun e Korçës dhe Selasforit (shek.XVIII-fillim shek.XX), shkruhet se në regjistrat osmanë të viteve 1431-1432, bëhet fjalë për një kala të banuar që numërontë 26 shtëpi, pranë së cilës ndodheshin Mborja me 90 shtëpi dhe Peskëpia me 70 shtëpi. (Pepo, 1981). Edhe nëse do ti referohemi studiuesit Nuçi Naçi, në librin e tij “Korça dhe fshatrat për qark”, në vitin 1900 ai shkruan se “...Korça përpara 1487 ka qenë një fshat i vogël me bujq, që ka pasur jo më shumë se 10-15 shtëpi dhe atëherë quhej Pes-stëpi...dhe kishin një kishë me emër Shën e Premte. Koxa Mirahori e bleu, e bëri së pari teqe dhe pastaj xami dhe kjo sot është xami e madhe”. Po këtu studiuesi shprehet “..se në një ferman, Sulltan Bajaziti i II-të, i fal Koxha Mir’ahorit viset e Gjorxesë...”, Gjorxhesë. Kjo fjalë është turqisht dhe në shqip do të thotë ”shiko dhe shko” (N.D.N., 1901). Diskutimet e studiuesve në lidhje me origjinën e emrit, kohën e ekzistencës së vendbanimit mbi të cilin do të ngrihej qyteti i sotëm janë të shumta, ndaj në funksion të studimit tonë, do të fokusohemi tek periudha e ngritjes së xhamisë së Iliaz Bej Mirahorit, (1496) (Ramo, 2012), përreth së cilës do të konfigurohej forma urbane e qytetit të sotëm. Ajo çka mund të thuhet edhe nga dëshmitë që ekzistojnë në regjistrat osmanë dhe shkrime të kohës



## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

pas ardhjes së Iliaz Bej Mirahorit struktura urbane e qytetit ndryshoi. Në dokumentet historike të kohës thuhet se Iliaz bej Mirahori shpërnguli pazarin pranë xhamisë dhe ndërtoi gjithashtu edhe një medrese, hamam dhe imaret (institutcion bamirësie) dhe zotërimet e tij i ktheu në vakëfe (N.D.N., 1901), (Pepo, 1981), (Ramo, 2012). Këto ndërtime do të përbënin bërthamën e një qendre të re social-ekonomike, tregtare dhe arsimore dhe po kështu të një qendre të re urbane, që do të zgjerohej në mënyrë të qëndrueshme shekujt në vazhdim. Zhvendosja e pazarit dhe nevoja e afërsisë me të, diktoi ardhjen e popullsisë nga zonat kodrinore përreth duke çuar në zgjerimin e territorit në shek.XVI, XVII, me ndërtime të reja, kryesisht të tipit të banesave në drejtim të zonës fushore në perëndim dhe veriperëndim.


Sipas studiuesit Piro Thomo (2012) gjurmët urbanistike, për të paraqitur sa më mirë elementët dhe formën urbane të qytetit në shek. XVII-XVIII, janë të zbehta. Megjithatë nga dëshmitë historike dhe nga ajo çka mund të shihet, disa nga tiparet kryesore, që kanë shoqëruar zgjerimin e qytetit në këtë periudhë kanë të bëjnë me një rritje spontane e favorizuar edhe nga terreni i butë në drejtim të fushës. Për sa i përket formës urbane të qytetit të Korçës, po të shikojmë hartat e vjetra, në shekullin e XVIII-të, kemi të bëjmë me një vendbanim me tre njësi kryesore përbërëse (ngastra), të ndara nga lumi i Moravës që buron nga mali me të njëjtin emër (harta 1. b). Në të djathtë të lumit në verilindje ndodhej Varoshi (popullsi ortodokse) dhe në të majtë në jug perëndim ndodhej Kasabaja (popullsi myslimane). Pazarit ndahej nga lumi, ku pjesa më e madhe e tij ndodhej pranë Kasabasë (N.D.N., 1923). Rrjeti rrugor i çrregullt, me rrugë të ngushta që krijojnë parcela të mbyllura ndërtimesh në trajtë qarqesh (Thomo, 2012). Në të njëjtën kohë banesat ruajnë lidhjen e familjes me ekonominë bujqësore, duke kushtëzuar në ambjentet e tyre, praninë e një sërë mjedisesh ndihmëse si oborri, plevicat, hajati, çardaku ashefi, pusi (Pepo, 1981), (Riza, 1991), (Thomo, 2012). Nuk mungojnë gjithashtu ndërtimet e kultit, në veçanti kishat (në 1707 u ngrit katedralja “Burimi Jetëdhënës” etj.).

Të dhënat më të qarta dhe më të plota për qytetin i përkasin shek. XIX, në të cilin qyteti u fut në rrugën e zhvillimit. Në gjysmën e parë të shek.XIX-të, prodhimi zejtar u rrit ndjeshëm dhe qyteti u fut në rrugën e zhvillimit të shpejtë ekonomik. Për rrjedhojë zgjerohet zona e ndërtimeve (harta 1.c) dhe tipar dallues është krijimi i ansambleve të ndërtimeve sipas një ndarje funksionale të tyre në rezidenciale dhe ekonomike. Aktiviteti zejtar dhe tregtar ishte përqendruar tek tregu apo pazari. Nga dëshmitë e kohës, struktura urbanistike e banesave evidentonte ndryshimin klasor ku binin në sy banesat dy katëshe me oborre dhe kopshte, përkundrajt atyre të ulëta njëkatëshe të shtresave të varfëra (Pepo, 1981), (N.D.N, 1923), (Thomo, 2012). Përpos tendencës së zgjerimit me ndërtime të reja, nga pikëpamja e formës urbane, qyteti dallohet për zgjerim me parcela të reja ndërtimesh, por me probleme në mungesën e infrastrukturës.

Në mesin e shek.XIX-të qyteti shënon një fazë të re të zhvillimit ekonomik, ku prodhimi zejtar mbulon gjithë veprimtarinë ekonomike dhe rrjeti i tregtisë shtrihet në të gjitha qendrat brenda dhe jashtë vendit, me një strukturë shoqërore të organizuar. Në nivel kombëtar, Korça konsolidoi pozitën administrative krahinore dhe fuqinë ekonomike, duke u shndërruar në qendër të rëndësishme prodhimi dhe

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

shkëmbimi në gjithë jugun e Shqipërisë. Popullsia e rrit me mbi 10 000-13 000 banorë (Pepo, 1981), çka çoi në rritjen e kërkesës për ndërtime, por edhe për cilësinë e tyre.



Harta 1. Zgjerimi i formës urbane të qytetit të Korçës gjatë periudhave historike, (krijuar sipas planit të vitit 1920). a) qyteti shek.XVII; b) qyteti shek.XVIII, c) qyteti shek.XIX; d) qyteti fund shek.XIX-fill shek.XX; e) qyteti gjysma e dytë e shek.XX. (burimi: autorët)

Këto zhvillime ndikuan në fizionominë e qytetit, që përfitoi tipare të reja urbane. Krahas rindërtimeve sipas tipologjisë së vjetër në këtë periudhë konstatohet lindja e një tipi të ri banese, e cila i përgjigjej kërkesave të shtresës së re të borgjezisë (Riza, 1991).

Tipologjia e banesës dallohet për elementë të pasur si në pamjen e jashtme ashtu edhe në mjediset e brendshme. (Thomo, 1978). *Një element që vlen për t'u përmendur në arkitekturën e veçantë të ndërtimeve dhe karakterin dekorativ të tyre, është pasqyrimi në të i elementëve të kulturës perëndimore të sjellë nga korçarët e udhëtuar nëpër vendet e Evropës.* Në fund të shek.XIX-të, struktura urbane e qytetit të Korçës kishte fituar kompaktësinë e vet me një fizionomi të konsoliduar urbane.

### 4. Fizionomia urbane e qytetit në shekullin të XX-të.

Në fillim të shek. XX, qyteti kishte formuar një strukturë të rregullt urbanistike, në bazë të cilit qëndronte sistemi ortogonal, me rrugë dhe rrugica me dritë dhe korente ajrore për jetën ekologjike të qytetit (Velo, 2014). Popullsia e qytetit erdhi duke u rritur nga 15 453 banorë në 1913, në 25 593 mijë banorë vitin 1927 dhe Korça ishte qyteti me popullsinë më të madhe ndër qytetet e Shqipërisë (Karaguni, & Alizoti,

2013). Qyteti zhvillohet me ritme të shpejta përtej bërthamës së tij. Konkretisht zgjerimi i qytetit ndodh në dy akset kryesore, rrugën e Shën Gjergjit (bulevard Shën Gjergj), dhe rrugën e Follorinës (sot bulevard Republika). Sistemi rrugor i rregullt dhe ortogonal lidh blloqet e ndërtimeve dhe ndërtimet. Në të njëjtën kohë vlen për t’u përmendur krijimi i lagjeve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese, Varoshi, Kasabaja, Varoshi i Poshtëm apo Katavaroshi (N.D.N., 1901), (Thomo, 2012), (Pepo, 1981). Lagjet përshkruhen nga rrjeti i dendur rrugor me kalldrëm, me prirje për krijimin e formave të rregullta gjeometrike. Nga ekzistenca e disa banesave të kësaj periudhe dëshmohet rregullsia që ndjek vendosja e tyre. Formohen parcela të vogla drejtkëndore me ndërtime. qyteti ka formuar një strukturë të rregullt urbanistike, në bazë të të cilit qëndron sistemi ortogonal, me disa shmangje të kushtëzuar nga relievi dhe kushtet klimaterike të terrenit.

Në të njëjtën kohë, brenda territorit urban rriten ndërtimet, (4000 m rrugë, 150-200 dyqane e shtëpi të reja sipas sistemit të ri, kanalizimi i ujërave të zeza etj.) (Arkiva e Bashkisë, 1950). Sipas të dhënave të kohës, ndërtimi i lagjeve të reja sipas një skeme ortogonale dëshmon për ekzistencën një plani që ka disiplinuar ndërtimet e qytetit, që kohën e pushtimit turk. Po kështu në arkivat e bashkisë në vitin 1910 gjendet njoftimi i parë për planin e qytetit, ku parashikohet hapja dhe sistemi i rrugëve të vjetra me gjerësi 8-12 m, për të ardhur tek rregullime dhe zgjerime të përcaktuara të qytetit sipas planit të vitit 1930 (dy inxhinierë të huaj vjenezë, Kohler dhe Bertoldi) (Thomo, 2012). Ndër ansamblet ndërtimore kryesore të qytetit ishte pazari, roli i të cilit në gjysmën e dytë të shek të XIX-të, ishte fuqizuar duke shprehur qartë natyrën zejtarë-tregtarë të zhvilluar të këtij qyteti. (Riza, & Strazimiri, 1972) Pazari i Korçës, tërhiqte tregtarë dhe udhëtarë nga zonat përreth, por edhe nga vise të tjera të Shqipërisë dhe vendeve fqinje. Sipas dëshmimeve historike rindërtimi i pazarit pas zjarrit të vitit 1879 (u dogjën mëse 600 dyqane) nxori në pah një strukturë të rregullt ndërtimesh. Nëse shihej, në hapësirën e zonimit të pazarit binte në sy një ndarje funksionale e aktiviteteve prodhuese, tregtuese, nga mjediset e pushimit (hanet, 16 të tilla) (Thomo, 2012). Nga dëshmitë historike gojore, fotografike si edhe gjurmët që ka trashëguar pazari i sotëm sheshet e tregtimit ishin të shpërndara në pika të ndryshme të pazarit, në të cilat tregtoheshin prodhime zejtarie, bujqësore dhe blegtorale, por edhe veshje apo produkte të tjera. Dyqanet dykatëshe rrethonin sheshin kryesor të pazarit, ndërsa njësitë brenda pazarit lidheshin nëpërmjet tyre me një sërë rrugicash të drejta. Shturja e organizatave esnafore, formimi i ndërrmarjeve të para të prodhimit kapitalist, dyndja e mallrave nga jashtë, diferencimi i shtresës së zejtarëve dhe tregtarëve dhe kërkesat e mënyrës së re të jetesës për t’i patur sa më afër konsumatorit njësitë e shërbimit të tregtimit ishin faktorët që çuan në dobësimin e rolit të pazarit në jetën social ekonomike në dhjetëvjeçarët që pasuan. Disa prej funksioneve të pazarit u shpërngulën në qendra dhe ansamble të reja (rrobaqepës, këpucarë etj) . Karakteristikë ishte shërbimet dhe dyqanet në katet e para dhe banim në katet e sipërme.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*



Foto 1.2. Pamje nga qyteti i Korçës në vitet 1930 (Burimi: arkivat e kohës, Biblioteka “Thimi Mitko

Një element i rëndësishëm në formimin e fizionomisë së re urbane dhe strukturës së organizmit funksional në këtë periudhë, është krijimi dhe fuqizimi i ansambleve me karakter shoqëror, si ndërtesa administrative: bashkia, prefektura, gjykata, një sërë Biblioteka e qytetit (1921), kino-teatri “Mazhestik”, Spitali (1933-1934), shërbimesh telegrafi, hotele, farmaci, hane dhe një sërë njësisish shitjesh etj. (Thomo, 2012), (Miho, 2003), (Velo, 2014). Në vitet 20-30 forma urbane e qytetit ndryshon duke u zgjeruar me rrugë dhe ndërtime të reja. Ngrihen ndërmarrje industriale si fabrika e miellit, e leshit, tullave, duhanit, alkoolit, birrës etj që pozicionohen në periferi të zonës rezidenciale. Kontributi i përbashkët i popullsisë dëshmohej qartë në ndërtimin kolektiv të objekteve publike.

Pas çlirimit të vendit, qyteti ju nënshtrua një sërë transformimeve në fizionominë urbane. Krahas ndërtimeve me karakter industrial, zunë vend edhe ndërtimet me karakter rezidencial, në trajtën e blloqeve të ndërtimit. Disa prej ndërtimeve të trashëguara nga periudhat e mëparshme u prishën dhe vendin e tyre e zunë ndërtimet të reja të realizmit socialist. Një ndër ndryshimet e dukshme në fizionominë e qytetit në vitet '60, ishte devijimi i lumit të Moravës, që kalonte përmes qytetit dhe ndërtimi në rrjedhën e tij të një prej bulevardeve ekzistues. Në vitin 1968 numëronte qyteti 46 300 banorë (Sheri, 1970). Në të njëjtën kohë vlen për t'u evidentuar edhe prishja e një sërë ndërtimesh karakteristike, objekte të kultit (Kisha e Shën Gjergjit në vitin 1968) duke u zëvendësuar me godina të reja, të cilat çuan në transformimin e qendrës së qytetit. Zonifikimet e ndërmarra në vitin 1973 dhe 1984 synuan mbrojtjen e Qendrës Historike të qytetit dhe banesave tradicionale që ndodheshin në brendësi të saj, duke ju dhënë statusin e “Monumentit të Kulturës”, Kategoria e parë dhe Kategoria e dytë.

Pas viteve '90 kushtet e reja të zhvillimit social ekonomik dhe rritja e kërkesës për banesë e përballën qytetin e Korçës me zhvillime të dukshme. Në këtë kuadër qendra historike e qytetit pësoi disa ndryshime në vitet 2002, 2005, 2011, 2017, ku u përcaktuan zonime të reja, që sipas rregullores së mbrojtjes së saj, ka synuar ruajtjen e rrjetit rrugor duke kushtëzuar rikonstruksionet dhe ndërtimet e reja. Me gjithë ndryshimet që u analizuan më sipër, qyteti i Korçës ka arritur deri në ditët tona me një fizionomi të formuar urbanistike dhe arkitekturore, ku pasqyrohen elementë të dukshëm të zhvillimit. Për sa i përket tipologjive urbane të periudhave të ndryshme historike ato bashkëjetojnë të ndërthurura me njera-tjetrën, duke krijuar një mjedis të veçantë ndërtimesh. Fizionomia e veçantë e qytetit e gërshetuar me arkitekturën

tradicionale kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj. Aktualisht qyteti dhe rrethinat e tij janë kanë konfirmuar tashmë si destinacione turistike në zhvillim (Menkshi, 2020). Në funksion të zhvillimit të turizmit krahas rehabilitimit të rrjetit rrugor janë rikonstruktuar një sërë objektesh kulturore (pazari i vjetër, banesa, parku i qytetit etj.). Vitet e fundit qyteti dhe në veçanti qendra e tij, është përfshirë nga ndërtime të reja, me qëllim gjallërimin e jetës dhe tërheqjen e vizitorëve. Ndërtimet kanë të bëjnë kryesisht me përshtatjen e banesave ekzistuese për funksion turistik, (hotele, bujtina dhe restorante). Në disa raste këto kanë ruajtur karakterin ekzistues tradicional, në disa të tjera kanë synuar stilin modern, jo vetëm në formë dhe arkitekturë por madje edhe në ngjyra. Nga ana tjetër mungesa e investimeve ka sjellë braktisjen e disa banesave “monument kulture”, duke shfaqur rrezikun e degradimit të mëtejshëm. Një fenomen që po përhapet me shpejtësi është prishja e banesave individuale në lagjen tradicionale dhe zëvendësimi me ndërtime trekatëshe, të tipit të apartamenteve. Përpos zhvillimeve të ndërmarra, nga konstatimet e bëra në terren pohojmë se në mjaft raste mungon lidhja e ndërtimeve të reja me ansamblet ndërtimore të trashëguara, duke ndikuar ndoshta në krijimin të një fizionomie të re të qytetit në të ardhmen.

## **5. Përfundime**

Pasi analizuam tiparet e morfologjisë urbane, arrijmë në përfundimin se perspektiva historiko- gjeografike, ka ndikuar në formimin e qytetit të Korçës, me një identitet dhe fizionomi të qartë urbane. Zhvillimi ekonomik, social-kulturor, që përfshiu qytetin në mesin e shek. XIX-të, ishin faktorë që do të ndikonin në transformimet e mëtejshme të tipareve fizike të tij. Si rrjedhojë, fillimi i shek. XX-të, e gjeti qytetin me territor urban të unifikuar, rrjet rrugor ortogonal, rregullsi të blloqeve të ndërtimit, kompaktësi të strukturës urbane. Proceset aktuale të ndërhyrjeve për rregullimin e infrastrukturës urbane, në funksion të një qyteti që të ofrojë zhvillim dhe mirëqenie për komunitetin, kanë ndikuar në përmirësimin e sistemit rrugor dhe shërbimeve. Zëvendësimi i banesave të vjetra në qendrën tradicionale (fundi i shek. XIX-të dhe fillimin i shek. XX-të) me ndërtime të reja kanë synuar rigjallërimin e mjedisit urban. Nga vëzhgimet në terren konstatohet se ndërtime monument kulture të tipit të banesave, të trashëguara nga, në disa raste i janë përshtatur funksionit turistik, sipas arkitekturës ekzistuese, por në shumë raste vuajnë dëmtime të rënda nga mungesa e investimeve. Megjithatë, sugjerojmë se ndërhyrjet me karakter zhvillimor të qeverisjes lokale, por edhe sipërmarrjes private, duhet jenë të kujdesshme në ruajtjen e tipologjisë e trashëgimisë ndërtimore në qendrën historike të qytetit. Për këtë është e nevojshme të merret në konsideratë kriteret e ndërtimeve në zona të rëndësishme historike. Në të njëjtën kohë nuk duhet të shmanget mendimi i specialistëve të fushës së trashëgimisë për të ruajtur vlerat e saj. Së fundmi, me ndryshimet e shpejta që po pëson qyteti, ndikuar nga zhvillimi i turizmit, shtrohet nevoja e ndërmarrjes së studimeve mbi zhvillimin urban të qytetit në të ardhmen, rëndësinë e ruajtjes së fizionomisë dhe identitetit të tij. Në këto studime kontributi i gjeografit në është i domosdoshëm.

## **6. Referenca**

- Gruda, G. (2020). Relievi Strukturalor i Shqipërisë. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 523-28.
- Karaguni, M., Alizoti, A., (2013), Hapësira urbane shqiptare në harkun kohor të një shekulli, Revista Albanologjike, Tiranë, fq. 159-167
- Menkshi, E. (2020). Trashëgimia natyrore dhe kulturore e qarkut Korçë. Korçë: Promo Print.
- Menkshi, E., & Shehu, D. (2020). Roli i infrastrukturës në zhvillimin e territorit urban: Rast studimi qyteti i Korçës. Vjetari FEF, 66-76
- Menkshi, E., Braholli, E., (2023) Analiza e Morfologjisë Urbane të Qytetit të Korçës, Përmbledhje e Kumtesave, Konferenca Shkencore Qendrat e Banuara të Shqipërisë, Gjendja dhe e Ardhmja, 2021. fq.671-690
- N, D. N. (1901). Korça dhe fshatrat përfaqar. Sofje
- Naçi, N. N. (1923). Korça dhe katundet e qarkut. Korçë: Kotti.
- Pepo, P. (1981). Materiale dokumentare për Shqipërinë Juglindore, shek. XVIII-filim i shek. XX (Kodiku i Korçës dhe Selasforit), Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
- Pinho, P., & Oliveira, V. (2007). Cartographic analysis in urban morphology. Environment and Planning B: Planning and Design, 1-22.
- Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Korçë. (2014) pdf
- Qiriazhi, P. (1985). Morfologjia dhe morfogjeneza e gropave juglindore dhe maleve përreth tyre. Tirane: Universiteti i Tiranës.
- Qiriazhi, P. (2019). Gjeografia fizike e Shqipërisë. Tiranë: Mediaprint,
- Ramo, S. (2012). Ilia Panariti dhe Korça. Korçë: Kotti.
- Raport. (2014). Planifikimi urban. Korçë: Bashkia Korçë.
- Riza, E., & Strazimiri, B. (1972). Vështrim mbi arkitekturën e qytetit të Korçës. Monumentet 3, 120.
- Riza, E. (1991). Qyteti dhe banesa shqiptare e mesjetës së vonë. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 231-233
- Sahni, S., & Chahal, S. K. (2017). Determinants of urban form in the evolution of settlements. Local government quarterly, 28-38.
- Selenica, E. (1982). Korça në faqet e historisë. Tiranë: 8 Nëntori.
- Selenica, T. (1928). Shqipëria më 1927. Tiranë: Shtypshkronja "Tirana", fq.311-341
- Sheri, F. (1970). Popullsia e Shqipërisë. Tiranë: 8 Nëntori
- Thomo, P. (1978). Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës. Monumente historike në vendin tonë, 5-256
- Thomo, P. (2012). Korça, urbanistika dhe arkitektura. Tiranë: Morava.
- Velo, M. (2014). Betonizimi i Shqipërisë. Tiranë
- Whitehand, J. W. (2012). Issues in urban morphology. Urban morphology 16(1), 56-65. pdf

**KORÇA MIDIS FRANCËS DHE GREQISË:  
NJË UDHËKRYQ I LUFTËS SË PARË BOTËRORE**

**PhD. Marcela MELE**

*Departamenti Histori-Gjeografi,  
Universiteti “Fan S. Noli”,  
mele9840@gmail.com*

**Abstrakt**

*Integriteti territorial i vendit ishte vazhdimisht nën presion dhe natyra shumëdimensionale e çështjeve kufitare e bënte një sfidë të rëndësishme për Shqipërinë që të ruante kontrollin mbi territoret e saj. Ky është një punim analizë historik për zhvillimin gjeopolitik dhe socio-ekonomik dhe jep një pasqyrë të natyrës shumëdimensionale të kufijve të Shqipërisë Jugore (Korçë) në Luftën e Parë Botërore, duke theksuar tensionet politike, diversitetin gjeografik, kompleksitetin etnik dhe konsideratat ushtarake që formësuan integritetin territorial të vendit gjatë asaj periudhe. Ngjarjet e viteve 1916-1920 patën një ndikim të qëndrueshëm në gjeografinë politike të rajonit. Rëndësia strategjike e qytetit dhe vendndodhja e tij në udhëkryqin e interesave konkurruese e bënë atë një pikë qendrore të tensioneve rajonale. Koncepti i një zone tampon, ndonëse përdoret pak, nuk e mbrojti plotësisht Shqipërinë nga presionet e jashtme. Ndërsa Koritza (Korçë) përfundimisht u bë pjesë e Shqipërisë, trashëgimia e konfliktit dhe dinamika komplekse etnike vazhdojnë të formësojnë identitetin e rajonit. Përvoja e pushtimit dhe e rezistencës gjatë kësaj periudhe ka lënë gjurmë të thella në kujtesën kolektive të popullatës vendase.*

**Fjalët kyçe:** *Koritza (Korçë), Lufta e Parë Botërore, marrëdhënia Francë-Greqi, zona tampon, gjeografi politike.*

**KORÇA BETWEEN FRANCE AND GREECE:  
A CROSSROADS OF WORLD WAR I**

**Abstract**

*The territorial integrity of the country was constantly under pressure and the multidimensional nature of border issues made it a significant challenge for Albania to maintain control over its territories. This is a historical analysis of geopolitical and socio-economic development and provides an overview of the multidimensional nature of the borders of Southern Albania (Korça) in World War I, highlighting the political tensions, geographical diversity, ethnic complexity and military considerations that shaped the territorial integrity of the country during that period. The events of 1916-1920 had a lasting impact on the political geography of the region. The strategic importance of the city and its location at the crossroads of competing interests made it a focal point of regional tensions. The concept of a buffer zone, although little used, did not fully protect Albania from external pressures. While Koritza (Korça) eventually became part of Albania, the legacy of the conflict and complex ethnic dynamics continue to shape the identity of the region. The experience of occupation and resistance during this period has left deep traces in the collective memory of the local population.*

**Key words:** *Koritza (Korçë), World War I, France-Greece relations, buffer zone, political geography.*

## **1. Një vështrim retrospektiv i kufijve të Shqipërisë para viteve 1920**

Edhe pse populli shqiptar e ka ruajtur individualitetin e vet ndër shekuj, Shqipëria nuk ka pasur kurrë kufijtë e saj si njësi më vete. Në vitet e fundit të sundimit osman mbi Shqipërinë, Italia dhe Austria patën ndikim mbizotërues atje: atë në jug dhe këtë në veri. Por të dy ranë dakord, në interes të paqes, të mbështesin pavarësinë kur në 1913-1914 Konferenca e Ambasadorëve në Londër u përpoq të zgjidhte të gjitha çështjet që rezultuan nga luftërat ballkanike. Kufijtë që më pas iu caktuan në mënyrë të përmbledhur shtetit të Shqipërisë, përfaqësonin një kompromis midis aspiratave shqiptare, të sponsorizuara kryesisht nga Italia dhe Austria me mbështetjen e Gjermanisë, dhe atyre malazeze-serbo-greke, të mbështetur kryesisht nga Franca dhe Rusia. Pas Luftës së Madhe, përmes ngjarjeve diplomatike shumë komplekse të ndërthurura ngushtë me rregullimin e Adriatikut, Shqipëria arriti të marrë njohjen e kufijve të 1913.

Shqipëria shpalli pavarësinë e saj nga Perandoria Osmane më 28 nëntor 1912. Megjithatë, vendi u përball me një sërë sfidash politike dhe territoriale në vitet në vijim. Fuqi të ndryshme evropiane, duke përfshirë Italinë, Greqinë dhe Serbinë, kërkuan të ushtronin ndikimin e tyre mbi Shqipërinë, duke çuar në mosmarrëveshje territoriale dhe paqëndrueshmëri politike. Gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918 dhe ngjarjeve diplomatike të pasluftës, Shqipëria ka ruajtur emancipimin politik që kishte arritur që nga viti 1913. Pavarësinë e saj ia detyron ndjenjës së lartë kombëtare të popullit të saj, një ndjenjë që as skllavëria laike nuk arriti ta bëjë. mbytje. Por vendit ende nuk i është dhënë organizimi solid shtetëror që mund të sigurojë jetën dhe zhvillimin e tij civil. Shqipëria po kalon në thelb një krizë të pashmangshme përshtatjeje, një krizë e cila, nëse në aspektin ndërkombëtar mund të konsiderohet e kapërcyer falë aftësive të politikanëve të saj, përkundrazi është në zhvillim të plotë për sa i përket organizimit të brendshëm. Që në nëntor 1918 - sapo mbaroi lufta evropiane - shqiptarët rikonfirmuan - me favorin dhe interesin e Italisë - dëshirën e tyre për pavarësi, duke mbledhur Asamblenë Kombëtare dhe duke ia besuar çështjen dhe fatin e tyre një qeverie të përkohshme. Mbi të gjitha, ndarja e organizimit shoqëror, e rënduar nga dallimet fetare, kundërshton krijimin e një shteti autonom dhe të fortë.

Ndikimet e qytetërimit ballkanik preku një brez të madh në kufirin juglindor, që korrespondon me pellgun e liqeneve të Prespës dhe Ohrit dhe pellgjet e Devolit të sipërm, Vojusës së sipërme dhe Calamas, ku të gjitha gjurmët e organizimit antik kanë tani. u zhdukën patriarkale dhe zakonet e qytetëruara. Në vendet e pellgut të liqeneve shkrirja paqësore e romanizimit me elementët paraekzistues dhe me popullin pushtues e solli shpejt këtë rajon në një shkallë të lartë pasurie, prosperiteti, kulture dhe edukimi shoqëror, Korça, një qendër e rëndësishme e zonë, u bë kështu qyteti më i kulturuar dhe më i pasur në Shqipëri. Në vend të kësaj, ndikimi ekskluziv i ballkanizmit në Epir shfaqet kryesisht në lidhjen me jetën komode të qytetit, në frymën tregtare dhe në dëshirën për fitim, të cilat gjithashtu japin një farë elasticiteti në konceptet morale, në mosbesim dhe mashtrim, në fanatizëm dhe në prirje për të diskutuar për çështje fetare, në mungesë të frymës së aventurës dhe luftarisë, në ndjenjën e pakët të detyrës, solidaritetit dhe përgjegjësisë dhe rrjedhimisht në



mbizotërimin e egoizmit në çdo veprim, në dorën e epërme të besëtytnive mbi fenë tek ortodoksët dhe në fanatizmi dhe intoleranca në mesin e muslimanëve. Epiri ia detyron këtë evolucion, jo të dobishëm në çdo aspekt, nacionalizmit grek të përhapur përmes Kishës Ortodokse, pra Patriarkanës Ekumenike, e cila gjithashtu kishte ndërhyrje në qeverisjen civile (Blumi, 2017, Popescu, 2015; Lutfiu, 2017). Por edhe në këto vende emigracioni sjell efektet e tij të dobishme me arritjen e pavarësisë ekonomike dhe rizgjim, kundër propagandës helene, të ndjenjës kombëtare shqiptare.

### **1.1 Shqipëria, Gjeografia Politike dhe Zona Buffer (zona tampon) 1916-1920**

Periudha ndërmjet viteve 1916 dhe 1920 ishte një kohë e fluksit të madh politik dhe territorial në Ballkan, ku Shqipëria ishte një lojtar kyç në këtë dinamikë. Koritza (tani e njohur si Korçë), një qytet në Shqipërinë juglindore, ishte veçanërisht i vendosur në udhëkryqin e interesave të ndryshme konkurruese, duke e bërë atë një pikë qendrore me rëndësi strategjike. Shqipëria, për shkak të vendndodhjes së saj strategjike dhe përbërjes komplekse etnike dhe fetare, shpesh parashikohej si një zonë e mundshme tampon. Pozicioni i saj midis Italisë, Greqisë dhe Serbi-Malit të Zi e bëri atë një territor vendimtar për ruajtjen e ekuilibrit rajonal. Megjithatë, koncepti i një zone tampon shpesh përdorej nga fuqitë më të mëdha për të justifikuar ambiciet e tyre territoriale dhe për të ushtruar kontroll mbi rajonin.

Sipas Fjalorit Enciklopedik Britanik, një rajon midis dy ose më shumë shteteve të fuqishme, shpesh armiqësore, që synon të minimizojë një konflikt quhet zonë tampon. Në kontekstin shqiptar, mund t'i referohet territoreve të përdorura për të ndarë fuqitë konkurruese dhe sferat e tyre të ndikimit. Një zonë tampon, në aspektin gjeopolitik, është një zonë neutrale që shërben si një barrierë midis dy ose më shumë fuqive armiqësore. Ky koncept fitoi rëndësi gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave si një mjet për parandalimin e konfliktit dhe ruajtjen e stabilitetit. Në kontekstin e Ballkanit, ideja e një zone tampon shpesh përdorej për të zbutur tensionet midis fuqive më të mëdha dhe për të mbrojtur kombet më të vogla nga ndikimi i tyre.

## **2. Francezët dhe Republika e Korçës (1916-1920)**

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Korça, një qytet në Shqipërinë juglindore, u bë një pikë qendrore e tensionit gjeopolitik dhe një simbol i kompleksitetit të qeverisjes dhe aleancave të kohës së luftës. Vendndodhja strategjike e qytetit dhe pretendimet territoriale të mbivendosura nga Franca, Greqia dhe Shqipëria e bënë atë një fushë beteje kyçe jo vetëm për kontrollin ushtarak, por edhe për ideologjitë politike konkurruese dhe interesat ndërkombëtare. Korça (Koritza), me popullsinë e saj të larmishme dhe rëndësinë ekonomike, ishte një territor veçanërisht i lakmuar. Ndodhej në një rajon me një popullsi të konsiderueshme greqishtfolëse, duke e bërë atë një pikë grindjeje midis Shqipërisë dhe Greqisë. Të dy vendet u përpoqën të siguronin kontrollin e tyre mbi qytetin, duke çuar në përplasje të shpeshta dhe manovra diplomatike. Gjatë kësaj periudhe, peizazhi politik në Ballkan ishte shumë i paqëndrueshëm (Clayer, 2009; Blumi, 2014).

Franca luajti një rol të rëndësishëm në formësimin e peizazhit të luftës dhe të pasluftës së Korçës. Pas rënies së rezistencës serbe në vitin 1915, Ushtria Franceze e Orientit, nën gjeneralin Maurice Sarrail, përparoi në Shqipëri dhe mori kontrollin

### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

e Korçës në dhjetor 1916. Franca ishte e motivuar nga dëshira për të siguruar një zonë tampon kundër forcave austro-hungareze, për të mbrojtur interesat e saj në rajon dhe të parandalojë zgjerimin e Greqisë në Shqipëri. Me pushtimin e qytetit, administrata franceze krijoi një njësi vetëqeverisëse të njohur si Republika Autonome e Korçës në vitin 1916. Ky ishte një zhvillim i rëndësishëm pasi shënoi një përpjekje për të krijuar një administratë lokale të pavarur nga kontrolli shqiptar dhe grek, i mbikëqyrur nga Ushtria franceze. Statusi autonom i dha Korçës një shkallë të vetëqeverisjes, me një këshill të zgjedhur në vend (të kryesuar nga Themistokli Gërmenji, një nacionalist shqiptar) dhe përdorimin e gjuhës frënge dhe shqipe në çështjet zyrtare. Kjo autonomi u pa kryesisht si një lëvizje strategjike e Francës për të stabilizuar zonën dhe për të fituar besimin e popullatës vendase shqiptare, e cila kishte frikë nga aneksimi nga Greqia (Clayer, 2009; Çami 2002; Begolli, 2108).

Periudha gjatë Luftës së parë Botërore ishte një kohë e trazuar në Ballkan, e shënuar nga ndryshimi i aleancave, ambicjeve territoriale dhe tensioneve etnike. Për të kuptuar më mirë kontekstin gjeopolitik në marrëdhëniet Francë dhe Greqi, Koritza e pavarur në këto vite. Studimi i shpërndarjes hapësinore të dukurive politike, si shtetet, kombet dhe partitë politike janë koncepte të gjeografisë politike. Gjeografia politike shqyrton se si proceset politike, si zgjedhjet dhe mosmarrëveshjet kufitare, janë formësuar nga faktorë gjeografikë, duke u shoqëruar shpesh dhe me një ideologji politike që mbron aneksimin e territoreve të banuara nga njerëz të cilët pasuesit i konsiderojnë si pjesë të kombit të tyre. Në rastin e Greqisë, kjo shpesh përfshinte pretendime për territore në Ballkan, veçanërisht ato me popullsi greqishtfolëse. Marrëdhëniet Francë-Greqi historikisht kanë qenë komplekse, me periudha bashkëpunimi dhe tensionesh. Gjatë fillimit të shekullit të 20-të, Franca dhe Greqia shpesh ndanin interesa në Ballkan, veçanërisht në drejtim të kufizimit të ndikimit osman.

Traktati i Londrës (1913) vendosi kufijtë e shtetit të ri të pavarur shqiptar, por territore të rëndësishme të populluara nga shqiptarët u përjashtuan, duke nxitur pretendime irredentiste. Periudha midis viteve 1916 dhe 1920 ishte një kohë komplekse dhe e trazuar për Shqipërinë, me disa faktorë që ndikuan në gjeografinë e saj politike dhe çuan në konceptin e një zone tampon dhe pretendime irredentiste, e shënuar nga pushtimi i huaj, pretendimet irredentiste dhe lufta për identitetin kombëtar dhe integritetin territorial. Franca dhe Greqia ndonjëherë bashkëpunuan për të krijuar zona tampon në Ballkan për të parandaluar zgjerimin e fuqive të tjera, si Italia apo Bullgaria. Koncepti i një zone tampon dhe aspiratat për një Shqipëri të Madhe ishin të ndërthurura me dinamikën më të gjerë gjeopolitike të rajonit. Vendndodhja e Shqipërisë në Gadishullin Ballkanik, në kufi me Italinë, Greqinë dhe Serbinë, e bëri atë një rajon të rëndësishëm strategjik për fuqitë evropiane.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Fuqitë e Mëdha këto fuqi u përpoqën të vendosnin kontrollin mbi Shqipërinë për të siguruar interesat dhe ndikimin e tyre në rajon. Në vitin 1916, Italia pushtoi Shqipërinë e Jugut, duke përfshirë qytetin e Koricës, duke synuar të krijonte një zonë tampon midis saj dhe Greqisë, e cila ishte gjithashtu nën ndikimin e saj. Ky pushtim synonte të parandalonte çdo ambicie të mundshme

### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

territoriale greke në rajon. Irredentizmi është një lëvizje politike që kërkon të rimarrë territoret e humbura. Në rastin e Shqipërisë, pretendime irredentiste u bënë në territoret e banuara nga popullsia shqiptare në vendet fqinje, si Kosova, pjesë të Malit të Zi dhe rajone në Greqinë veriore (Çamëria). Koncepti i “Shqipërisë së Madhe” u shfaq gjatë kësaj periudhe, duke përfshirë territore përtej kufijve të shtetit të sapopavaruar shqiptar në vitin 1912. Kjo ide u ushqye nga ndjenjat irredentiste dhe dëshira për të bashkuar të gjitha trojet e banuara nga shqiptarët. Qyteti i Koricës, i vendosur në jug të Shqipërisë, ishte një qendër e rëndësishme e nacionalizmit dhe kulturës shqiptare. Vendndodhja e saj strategjike dhe popullsia e përzier e bënë atë një territor të kontestuar midis Shqipërisë dhe Greqisë.

#### **3. Tensionet gjeopolitike: Korça midis Francës dhe Greqisë**

Zonat tampon kanë qëllime të ndryshme, politikisht ose ndryshe. Ato mund të krijohen për një sërë arsyes, si për të parandaluar dhunën, për të mbrojtur mjedisin, për të mbrojtur zonat e banuara dhe tregtare nga aksidentet industriale ose fatkeqësitë natyrore, apo edhe për të izoluar burgjet. Zonat tampon shpesh rezultojnë në rajone të mëdha të pabanuara, të cilat vetë vlejnë për t’u përmendur në shumë pjesë gjithnjë e më të zhvilluara ose të mbushura me njerëz të botës.

Nën sundimin francez, Korça përjetoj zhvillime të dukshme social-ekonomike. Administrata franceze prezantoi reforma që synonin modernizimin e qytetit, të tilla si përmirësime në infrastrukturë, arsim dhe shëndet publik. Francezët krijuan gjithashtu shkolla, ku mësohej gjuha shqipe dhe frënge, dhe u përpoqën të ndërtonin institucione lokale që mund të shërbenin si themel për qeverisjen e ardhshme (Augris, 2008; Begolli, 2018).

Megjithatë, prania franceze nuk u mirëprit plotësisht nga të gjitha fraksionet brenda Korçës. Ndërsa disa shqiptarë i shihnin francezët si mbrojtës kundër ekspansionit grek dhe serb, të tjerë e shihnin praninë e tyre si një ndërhyrje imperialiste. Po kështu, minoriteti grek në Korçë kundërshtoi refuzimin francez për të lejuar aneksimin e rajonit nga Greqia. Qeveria greke e shikonte Korçën si një pjesë thelbësore të ambicieve të saj territoriale, kryesisht për shkak të popullsisë së saj ortodokse greke dhe lidhjeve kulturore me Greqinë (Çami, 2002).

Konteksti më i gjerë diplomatik i Luftës së Parë Botërore i shtuan një shtresë tjetër kompleksiteti fatit të Korçës. Rajoni ishte një udhëkryq për rivalitetet gjeopolitike, pasi fuqitë aleate (veçanërisht Franca) dhe lojtarët rajonalë si Italia dhe Greqia kërkuar ndikim. Ambiciet e Greqisë për të kontrolluar pjesë të Shqipërisë jugore u ndeshën me kundërshtimin e Francës, e cila ishte e vendosur të mbante Korçën si një zonë tampon kundër zgjerimit austro-hungarez dhe të siguronte neutralitetin e Shqipërisë në konflikt.

#### **4. Përfundime**

Ngjarjet e viteve 1916-1920 patën një ndikim të qëndrueshëm në gjeografinë politike të rajonit. Ndërsa Koritza përfundimisht u bë pjesë e Shqipërisë, trashëgimia e konfliktit dhe dinamika komplekse etnike vazhdojnë të formësojnë identitetin e rajonit. Përvoja e pushtimit dhe e rezistencës gjatë kësaj periudhe ka lënë gjurmë të thella në kujtesën kolektive të popullatës vendase.

### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Protectorati francez në Korçë zgjati deri në vitin 1920, kur Traktati i Versajës dhe negociatat e mëpasshme çuan në tërheqjen e forcave franceze. Në këtë kohë, situata në Shqipëri kishte ndryshuar, me krijimin e shtetit shqiptar nën Ahmet Zogun dhe stabilizimin e kufijve të Shqipërisë. Korça gjatë Luftës së Parë Botërore ishte një mikrokozmos i betejave më të gjera gjeopolitike që formësuan Ballkanin gjatë dhe pas LIB. I kapur mes interesave franceze dhe greke, eksperimenti i shkurtër i qytetit me vetëqeverisjen nën mbikëqyrjen franceze nxori në pah kompleksitetin e identitetit kombëtar, pretendimet territoriale dhe ndërveprimin midis popullsisë vendase dhe fuqive të huaja. Zhvillimet socio-ekonomike të paraqitura nga francezët, megjithëse jetëshkurtër, hodhën themelet për evolucionin modern të Korçës, duke ekspozuar gjithashtu tensionet e rrënjësura thellë etnike dhe politike që vazhduan të ndikojnë në rajon në vitet në vijim.

Periudha midis viteve 1916 dhe 1920 ishte një kohë komplekse dhe e trazuar për Shqipërinë, e shënuar nga pushtimi i huaj, pretendimet irredentiste dhe lufta për identitetin kombëtar dhe integritetin territorial. Koncepti i një zone tampon dhe aspiratat për një Shqipëri të Madhe ishin të ndërthurura me dinamikën më të gjerë gjeopolitike të rajonit. Kjo periudhë ishte një kohë vendimtare për Shqipërinë dhe Korçën. Rëndësia strategjike e qytetit dhe vendndodhja e tij në udhëkryqin e interesave konkurruese e bënë atë një pikë qendrore të tensioneve rajonale. Koncepti i një zone tampon, ndonëse përdoret pak, nuk e mbrojti plotësisht Shqipërinë nga presionet e jashtme. Megjithatë, përmes përpjekjeve diplomatike dhe luftimeve të brendshme, Shqipëria mundi të pohonte sovranitetin e saj mbi Korçën dhe të siguronte vendin e saj në hartën e Evropës.

### **Referenca**

- Augris, E. (2008). Korçë dans la Grande Guerre Le sud-est albanais sous administration française (1916-1918), *Balkanologie*, IV (2), 1-11.
- Begolli, E. (2018). Historical Events in Korça Region after the Declaration of Independence until the end of World War I, *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 7(1), 57-63.
- Blumi, I. (2014). Albania, in: 1914-1918-online. International Encyclopedia of the First World War, ed. by Ute Daniel, Peter Gatrell, Oliver Janz, Heather Jones, Jennifer Keene, Alan Kramer, and Bill Nasson, issued by Freie Universität Berlin, Berlin.
- Clayer, N. (2009). L'albanisation de La Zone Frontière Albano-Grecque Et Ses Aléas Dans L'entre-Deux-Guerres. *Südost-Forschungen*, 68, 328-348. fihalshs-00656456f
- Çami, M. (2002). Ushtarakët Francezë në Korçë Mbështetës të Aspiratave Kombëtare të Popullsisë (1916-1920). *Studime historike*, (1-2), 61-77.
- Lutfiu, S. (2017). Political Circumstances in Albania from 1920 to 1924, *European Journal of Interdisciplinary Studies*, 3(4), 132-141.
- Popescu, S. (2015). L'Albanie dans la politique étrangère de la France, 1919-juin 1940, *Bulletin de l'Institut Pierre Renouvin*, No 41, 121-126, Printemps.

**MIT'HAT FRASHËRI DHE FILLESAT E MODERNIZMIT NË  
LETËRSINË SHQIPE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE**

**Prof. as. dr. Eris RUSI**

*Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë*

*Universiteti “Fan S. Noli”*

*erusi@unkorce.edu.al*

**Abstrakt**

*Ky studim fokusohet mbi veprën "Hi dhe Shpuzë" të Mit'hat Frashërit, botuar në vitin 1915 gjatë kulmit të Luftës së Parë Botërore, duke shqyrtuar se si ajo pasqyron tensionet sociale dhe politike të kohës dhe kontribuon në lindjen e modernizmit në letërsinë shqiptare. Hipoteza e kërkimit është se Frashëri, përmes përdorimit të elementeve të letërsisë fantastike, adreson çështjet e identitetit kombëtar dhe aspiratat shoqërore gjatë një periudhe krizash dhe transformimesh. Duke analizuar tregimet, veçanërisht "Plaku i Ylynecit", artikulli zbulon se si Frashëri krijon një narrativë ku realja dhe fantastikja bashkëjetojnë, duke pasqyruar aspiratat kombëtare dhe sfidat shoqërore. Në një Shqipëri të përballur me trazira politike, varfëri dhe analfabetizëm, autori përdor letërsinë si mjet për të zgjuar ndërgjegjen kombëtare dhe për të promovuar emancipimin shoqëror. Vepra "Hi dhe Shpuzë" shënon një hap të rëndësishëm drejt modernizmit letrar në Shqipëri. Përdorimi i prozës poetike dhe elementeve fantastike tregon përpjekjen e Frashërit për të tejkaluar kufijtë tradicionalë dhe për të integruar influencat evropiane në krijimtarinë shqiptare. Kjo qasje reflekton nevojën për një identitet të ri kulturor dhe për harmonizimin e Shqipërisë me zhvillimet moderne të kohës.*

**Fjalë kyçe:** *Mit'hat Frashëri, Hi dhe Shpuzë, Lufta e Parë Botërore, letërsia fantastike, modernizmi letrar, identitet kombëtar*

**1. Hyrje**

Kushtet historike të fillimit të shek. XX në vendin tonë, ishin specifike dhe të veçanta në funksion të çështjes kombëtare, duke u shoqëruar me përpjekjen që padija dhe varfëria intelektuale e kushtëzuar nga jeta nën perandorinë osmane, të zëvendësohej gradualisht nga një lehtësim i *dritshëm* i jetës shpirtërore të vendit përmes kulturës dhe letërsisë. Duhet të themi që ishin vërtet në minorancë njerëzit e fillim shekullit XX në Shqipëri që lexonin poema apo romane. Pjesa tjetër e vendit ishte e mpakur në leksikon e vet të varfër, që *keqësohej* akoma më tepër nga jeta e rrëmujshme, e paqëndrueshme politike e vendit, si dhe nga hapësirat e vështira ekonomike me të cilët dialogonin shumica. Zgjidhja që u bë nga intelektualët dhe krijuesit e kohës, ishte që të orientohej vëmendja kah letërsia, tek botimi i periodikëve, tek ringritja e një sensi të brendshëm, fisnik sa dhe njerëzor, për të kulturuar jetën e vendit. Veç në këtë mënyrë, do të arrihej të shihej përtej, do të mund të kapej çdo sinjal rrugëzgjdhje dhe kapërcimi i vështirësive, megjithëse krijimet letrare reflektonin frymën e kohët, ekstremitetin e gjendjes shoqërore shqiptare si dhe mangësitë, vështirësitë apo të metat e kritikueshme të kulturës sonë të frenuar dhe të pazhvilluar si duhej.

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Letërsia mori funksionin didaktik, udhërrëfyes dhe përçues të dritës dhe shkëlqimit, drejt viseve të errëta të botës shqiptare, e si një metaforë e jetës, erdhi duke kapur formën e të nevojshmes, të së domosdoshmes në dimensionin e mëvetësisë shqiptare. Aty ku deri dje vonohej të shihej vegimi i trishtë i jetës së fshehur të thellësive, i varfërisë shpirtërore, i barbarisë dhe i zakoneve arkaike, të paqytetëruara, barbare, letërsia nisi të zbulojë dhe të nxjerrë në dritë secilën prej këtyre të metave, duke ofruar edhe pasionin, edhe ndjenjën, edhe lartësimin e të mirës dhe të bukurës në vetvete. Në këtë pikë, na duhet të përmendim sërish një aksiomë të artit letrar, që fantastikja dhe realiteti nuk janë dy universe paralele dhe të dallueshme nga njëri-tjetri. E aq më shumë nuk mund të shihen si dy botë të kundërta, në një garë se kush do të fitojë në fund. Fantazia e mirëfilltë, në fakt, nuk duhet ta shohim kurrë si një vendstrehim për ata që ndjehen të zhgënjyer nga realiteti. Apo që duan me çdo kush t’i arratisen realitetit. Botët fantastike, për të qenë të gjalla, duhet të ushqehen me të dyja duart nga realiteti, nga dramat, vështirësitë, të pamundurat dhe zymtësitë e tij. Për krijuesit e kohës, realiteti nuk përmbylej në vetvete: *“i gjithi është këtu...”* Përkundrazi, në çdo spirale shprese, shihej mundësia që limitet e realitetit të shtyheshin më tej, kjo falë forcës tunduese të fjalës së shkruar. Letërsia shqipe ishte mbrapa ritmit me të cilin ishte zhvilluar letërsia evropiane, e për më tepër ishte e angazhuar në procesin e identitetit kombëtar, ku dhe pavarësia e Shqipërisë edhe shumë më vonë se vendet e tjera ballkanike. Por nga ana tjetër krijuesit e kësaj letërsie kishin kontakt të vazhdueshëm, e njihnin dhe ushqeheshin me atë që ishte letërsi e kohës, evropiane dhe botërore. Në këtë pikë, mund të sjellim rastin e Lumo Skëndos, i cili ofron interes studimi sidomos me prozat e tij poetike, ku ngrihet imagjinata, përfytyrimi i së mrekullueshmes dhe ndjesia fantastike, por kjo e lokalizuar dhe e jo e përhapur në të gjitha krijimet e përmbledhjes në prozë “Hi dhe shpuzë”

Sikundër shprehet në parathënien e librit studiuesi Nasho Jorgaqi: *“Lumo Skëndo u shfaq në jetën shqiptare në dekadën e fundit të Rilindjes, kur në qiellin e letërsisë sonë po ngjitej plejada e Faik Konicës, Fan Nolit, Luigj Gurakuqit, Gjergj Fishtës me shokë. Ishte ky brez i ri letrarësh dhe veprimtarësh atdhetarë që duke mos e ndarë artin nga dituritë dhe duke u njohur atyre rolin militant në kauzën e çlirimit të atdheut, synoi dhe punoi për një emancipim të gjithanshëm të jetës shpirtërore të kombit”*.<sup>1</sup>

Pra kjo është një përmbledhje e emrave që frymonin letërsinë në fillim të shekullit të XX. angazhimi dhe përpjekjet në rrafshin kombëtar, bëjnë që nga kritika çdo lloj qasje që i largohet këtij prizmi nacionalist, të shikohet si një luhatje e çastit, si një dalje nga rrjedha që duhet të kishte letërsia e kohës, për t’u rikthyer me të shpejtë në reshtin e reales dhe të vërtetësisë ideore të përshkrimit dhe ilustrimit të kohës.

Vijon më tej Nasho Jorgaqi: *“[...]Në këtë aspekt u bënë përpjekje të frytshme për të kapërcyer kufijtë e një letërsie poetike e cila kish krijuar vepra të shkëlqyera, për të dalë në një terren pak a shumë djerrë siç është proza. Duke qenë e një stadi fillestar nga ana artistike, si një prozë diturake-historike-publicistike, me vlera njohëse dhe edukative, ajo nuk i përmbushte nevojat e një letërsie kombëtare siç ndodhte me poezinë shqipe bashkëkohore”*.<sup>2</sup>

Në një farë mënyre njihet dobësia miturake e prozës shqiptare në fillimet e saj, për

<sup>1</sup> Lumo Skëndo, *Hi dhe shpuzë*, Shtëpia botuese Albinform, Tiranë, 1995, f. 4

<sup>2</sup> Po aty.

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

të patur një identitet të mirëpërcaktuar që në publikimet e para. Mund të mos jemi dakord me përcaktimin “terren i djerrë”, referuar prozës në tërësinë e saj, meqenëse emocionet e përftuara, fantazia, por dhe kombinimi i retorikës metaforike në rastin e prozave poetike, jo vetëm që nuk na ofron modele të rëndomta e të varfra në formë dhe përmbajtje, por më së shumti na bën të hamendësojmë se përse nuk u rrezikua më tepër në zgjerimin e këtyre formave të prozës poetike, në krijime më të plota dhe të guximshme.

### **2. Metodologjia**

Për të analizuar fillesat e modernizmit në letërsinë shqipe gjatë Luftës së Parë Botërore, studimi ka ndjekur një qasje të integruar, duke kombinuar metodologjitë historike, letrare dhe analitike. Studimi fillon me shqyrtimin e kushteve historike të fillimit të shekullit XX në Shqipëri, duke u fokusuar në ndikimin e Perandorisë Osmane dhe sfidat sociale që ndikonin në zhvillimin intelektual dhe kulturor të vendit. Janë vënë në pah zhvillimet historike, si aspiratat për pavarësi dhe emancipim kombëtar, të cilat ndikuan në krijimtarinë letrare të periudhës. Janë analizuar krijimet e Mit’hat Frashërit, veçanërisht përmbledhja “Hi dhe shpuzë,” për të identifikuar elementet e modernizmit dhe fantastikes. Vepra është studiuar në dritën e shkollave letrare bashkëkohore dhe ndikimeve evropiane, me theks në raportin mes reales dhe fantastikes. Është kryer një krahasim midis letërsisë shqiptare të fillim shekullit xx dhe letërsisë evropiane, për të përftuar një kuptim më të gjerë të ndikimeve dhe specifikave kombëtare. Kjo metodë ka ndihmuar në vendosjen e veprës së Frashërit në kontekstin e zhvillimeve letrare globale. Elementet e strukturës, gjuhës dhe simboleve në tregimet e Frashërit janë shqyrtuar në thellësi për të zbuluar mesazhet që ato përcjellin lidhur me identitetin kombëtar, krizën sociale dhe transformimet e kohës. Janë shfrytëzuar parathëniet dhe kritikrat e studiuesve si Nasho Jorgaqi dhe Sabri Hamiti, të cilat ndihmojnë në thellimin e analizës së ndikimeve të veprës në zhvillimin e letërsisë moderne shqiptare. Tekstet janë shqyrtuar me një qasje interpretative, duke nxjerrë në pah elementet e realizmit të mrekullueshëm dhe simbolikat filozofike, për të kuptuar sesi Frashëri përfaqëson një pikë kthese në letërsinë kombëtare. Duke përdorur këtë metodologji të gjithanshme, studimi ka synuar të vlerësojë ndikimin e Mit’hat Frashërit në fillesat e modernizmit dhe qasjen e tij inovative në krijimin e një letërsie që kombinon traditën kombëtare me ndikimet bashkëkohore.

### **3. Simbolika në veprën “Hi dhe shpuzë”**

“Hi dhe shpuzë” përmban 15 proza poetike, 2 novela dhe gjashtë kujtime, të shkruara brenda një periudhe gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Prozat poetike i përkasin kryesisht kohës së rinisë së autorit, i cili ishte mbryjtur me frymën e të qenit larg Shqipërisë (Lumo Skëndo u largua nga Shqipëria tre vjeç dhe u rikthye në moshën 29-vjeçare). Pra ka një rrugëtim emotiv që lidhet edhe me impulsin, përfytyrimin dhe ndjesinë e përshpejtuar të një moshë kur gjithçka është e mundur. Përtej sfondit patriotik, në do të ndalemi te proza “Plaku i Ylyncit”: *“Plaku i Ylyncit është një tregim alegorik me prirje të qarta filozofike që i paraqet lexuesit për të nxjerrë kuptimin konkret dhe idetë që rreh të japë autori[...] ai pothuajse nuk ka subjekt. Gjithë ajo që zhvillohet para të hapet si një tablo sa reale aq dhe ireale, sa e vërtetë aq dhe fantastike. Edhe*

### **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

pse bëhet fjalë për një vend të njohur të Shqipërisë së jugut, siç është shkëmbi i Ylyncit, ajo shënon vetëm pikënisjen, lokalizimin formal të ngjarjes që shtjellohet më pas.”<sup>3</sup>

Studiuesi Sabri Hamiti në “Letërsia moderne shqiptare” gjen një Shqipëri reale dhe ideale të autorit. Plaku i Ylyncit “rrok temën e Shqipërisë, po tani në ballafaqim me tiraninë e kohës dhe të përjetësisë; nuk ka vetëm identifikim me dashurinë atdhetare, por dhe me drojën. Kërkuesi i së vërtetës, këtu autori, njeh dhe shpalos mjediset reale; ndërsa plaku që është koha, shpalos një realitet të vetin të përhershëm dhe agresiv. Fjalët e Plakut (Kohës) e shpjen dëshmitarin nga realja në pamjet fantazmagorike të botëve që ndahen me një teh: në një anë katastrofa njerëzore, ndërsa në anën tjetër lulëzimi i jetës. Ferri e Parajsa”<sup>4</sup>.

Ngjarja hapet me një panoramë të rrallë e të bukur të natyrës shqiptare, përballë së cilës narratori harron të flasë dhe magjepset nga hijeshia që lodron në vështirimin e tij: “[...]kur arritmë ne ur’ e Ilias Lamesë, pa dashur qëndrova: më dukesh se e kisha përpara meje një prej ato tabllave të rralla të moçme që figurojnë me një pamje piktoreske [...]Edhe shikova, dhe prapë e shikova ujët e thellë më të mëngjër, urën e vogël anë lumit dhe grykën e gjerë më të djathtë.”<sup>5</sup>

Ky përshkrim ilustron përshtypjen e thellë që natyra lë tek njeriu, edhe në kushtet e një realizmi të imtësishëm, magjepsja mund të vijë papritmas nga pamjet që shfaqen përpara syve të udhëtarit. Momenti kur nis e valëzohet realja me irealen, akoma nuk ka mbërritur, por kemi një përshkallëzim rritës të emocionit, të misterit dhe të asaj pritshmërie që ka nevojë për një përgjigje, kjo e dhënë përmes ndryshimit të sfondit dhe panoramës që sa vjen e bëhet me e ngushtë, më e mistershme, gati-gati e frikshme: “[...]dhe udha po gjarpëronte, herë tërthor, herë më të djathtë, herë më të mëngjër, herë thikë, këmbët duke u rëndësuar gjithnjë”.

Në pjesën teorike të punimit, treguam që thelbi i thelbi i fantastikes qëndron në veçantinë e hezitimit ndërmjet të çuditshmes dhe të mrekullueshmes, i provuar nga një qenie e cila njeh vetëm ligjet natyrale përballë një ngjarjeje në dukje të mbinatyreshme. Kalimtare, fantastikja ekziston vetëm në hapësirën e shkurtër të këtij hezitimi, i cili shfaq papritur, por aq natyrshëm sa nuk a vend për habi dhe ngjarja fantastike trajtohet si të ishte njëlloj e mirëfilltë me realitetin. Ndaj, fillimisht, autori na jep realen që ngjason me të mrekullueshmen, aq e veçantë dhe e paimitueshme ngjan: “Pranë mejë një mur i gurtë, si i bërë prej njerëz të një tjetër kohe, të një tjetër botë[...]përpara meje ishte shkëmbi i Ylyncit! Një pirg i trashë, i madh, madhështor, me një bukuri t’egër e të çuditshme.”

Dhe papritmas ndodh kthesa fantastike, e cila bën që të shtangë dhe të hezitojë veç për një çast protagonistin, pastaj duke e marrë për të mirëqenë atë që po sheh, i bën vetes pyetje nga më të zakonshmet dhe normalet: “Përnjëherësh shkëmbi u hap dhe goj’ e zez’ e një dere mbeti e çelur. S’dinja ku isha, kisha mbetur në habi, kur një plak doli nga shkëmbi. Kish mjekër të bardhë si dëborë mali, syt’ e kaltër si ujët e Vjosës. Sa vjeç do qe? A ish gjashtëdhjetë, nëntëdhjetë apo njëqind? Apo dyzetë? Se

<sup>3</sup> Po aty

<sup>4</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Albas, Tiranë, 2002, f. 98-99

<sup>5</sup> Lumo Skëndo, *Hi dhe shpuzë*, Shtëpia botuese Albinform, Tiranë, 1995 (citimet e tjera të novelës janë marrë nga i njëjti tekst)



## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

*nën flokë të bardhë, kish fytyrën e një djaloshi, plot shpirt e shëndet në faqet e tij.*

Si një nga tiparet e fantastikes në letërsi, kemi ndërprerjen e koherencës universale, nga një ngjarje e paparashikueshme dhe e papritur që depërton në tekst. Na mundësohet të shohim botën e mundshme, pasi kemi kaluar shtegun e botës reale dhe kjo në vend që të shkaktojë çoroditje tek lexuesi, i jep tekstit shumësi kuptimesh dhe interpretimesh. Personazhi i mbinatyrshëm prezantohet si të jetë një nga njerëzit e zakonshëm të kësaj bote, është me një gjallëri natyrale dhe zgjat dorën të shtrengojë përzemërsisht protagonistin. Kjo e zbut habinë, e mbulon mahnitjen, por njëkohësisht vë përballë botën reale dhe botën e mundshme si simetri e jetës dhe e vdekjes:

*“[...] Edhe nga fundi i napës pashë këmbët e çelnikta – po të vogla e të bukura – të plakut, me thonj prej rame! Më dukesh se ëndërronja, po s’isha fare i çuditur. - Ç’ka aty brenda? – pyeta. - Do të shohësh? Eja!*

*Edhe më zuri për dore: m’u duk se një frymë, një dredhje gjallimi më rendi në dejet. Kur u qasmë te dera një mjegull e errët, një tym i hidhur më zuri sytë dhe më dogji gurmazë. Po plaku më preku me dorë, dhe atë çast m’u kthjelluan sytë. Vështrova dhe pashë gjëra të tmerruara! Poshtë, atje poshtë, fare thellë, shkëmbit kish një shpellë të gjerë, të hapur si një gojë skëterre. [...] Një pluhur i mugët po mbulonte këtë shpellë të vdekjes dhe mbi një kullë gjysmë të rrëzuar pashë një huruvejkë me sy të mëdhenj të rrumbullaktë. Plaku më tha: “Kanë rrojtur, tani më s’janë.”*

Ajo çka shfaqet para syve të protagonistit është një ilustrim i nëndheshëm i botës së përtejme, i të humburës, i së shkuarës, i të djeshmes së afërt dhe të largët. Është kujtim dhe përjetësi, pluhur dhe harresë, por edhe vendqëndrim për të mbledhur mendimet e për të nxjerrë uniken e çdo jete mbi tokë.

Jemi brenda një rrëfimi të mirëfilltë fantastik, e në vijim shohim se respektohen edhe disa elementë të tjerë të hulumtimit fantastik:

- kushtëzimi sensorial, emotiv dhe intelektual përballë fenomeneve të pashpjegueshme;
- përkohësia dhe përjetësia nën petkun e fatit dhe fatalitetit;
- çkodimi i domethënieve tokësore dhe hyjnore
- hezitimi ndërmjet një shpjegimi racional e realist dhe pranimit të mbinatyrshmes

Në lidhje me kushtëzimin sensorial dhe emotiv, ne e shohim se si pushtohet krejtësisht arsyeja dhe racionalja e protagonistit nga shfaqja e papritur e personazhit misterioz nga brenda shkëmbit. Gjithçka që ai flet ngjan me një kumt, është një e vërtetë e madhe, si një orakull lashtësisht plaku vjen që të zbulojë të vërtetën e këtij vendi dhe të këtyre njerëzve.

Së dyti, pamja e ofruar është therëse, gati surrealistike, por njëherazi e tmerrshme, e hidhur dhe cinike: jeta që shkon e nuk kthehet më pas, pluhuri që zë pluhurin dhe ekzistenca që rrokullisen në honet e thepisura të së djeshmes. A nuk është ky vizioni universal i mënyrës si shkojnë gjërat në këtë botë? A nuk ndodhemi përballë shfaqjes krejt papritur të Hadesit të nëndheshëm, të nëntokës Danteske, ku përzjehen dhe ngatërrohen e shkuara e patjetërsuar, me të tashmen e pasigurt?

E gjithë kjo atmosferë e tensionuar, nxit më tepër depërtimin në brendinë e tekstit. E pashpjegueshmja merr zanafillën nga mistikja e përjetësisë.

#### **4. Realja dhe irealja në Shqipërinë e fillimshkullit XX**

Është e nevojshme të shpjegohet dhe të zërthehet kuptimi i kësaj situate të mbinatyrshe, të realizohet një lloj dekodifikimi i domethënies hyjnore dhe tokësore të fjalëve të plakut të Ylynecit. Simetria është e gjithëpranishme në tekst, krahas të shkuarës, të vdekurës dhe të harruarës, lartohet jeta, qielli i së nesërme dhe njerëzit që frymojnë të mbushur me energji. Në këtë gjendje, ndërmjet reales dhe ireales, mes përumbjes në ëndërrim dhe zgjimit të mprehtë të asaj çka ofron vështrimi, realizohet edhe vizioni simbolik, që përfytyrohet nga ana e protagonistit përmes prekjes së lehtë nga ana e plakut në ballin e tij:

*“[...]Shikojel! - dhe më preku me dorë në ballët. Një djepe e vogël me një foshnjë të bukur. Foshnja sapo ishte zgjuar nga gjumi dhe kish hapur syçkat e bukur si dy këngoj të çkëlqyer; një dorë të butë dhe të kuqe si trëndafil, e kish shpënë në gojë.*

*-A po sheh? – më pyeti Plaku. Edhe mbi djep, në krye të foshnjës, këndova me shkronja të çuditshme SH.Q.I.P.R.I.J.A.”*

Gjithçka përreth ngjan e gjallë dhe reale e mund të preket dhe të ndjehet si e tillë, e megjithatë nuk të shqitet ndjesia që jemi brenda një ëndrre, e cila flet dhe bën orakullin e së nesërme. Edhe në këtë rast, ne kemi të respektuar një parim tjetër të fantastikes: hezitimin ndërmjet një shpjegimi racional dhe realist dhe pranimit të së mbinatyrshe. Nëse realja është ajo çka dimë, si kanë qenë dhe janë zhvilluar ngjarjet prapa në kohë, po a e mundur dhe jo kompromentuese është edhe e ardhmja, që misterin e saj kërkon ta zbulojë me finesën e dredhive, të plakut që krijon vizionet e agimit në mendjen e protagonistit. Çka nuk mungon, në këtë prozë, është tipari identifikues i fantastikes klasike të Tetëqindtës, tmerrri që e përshkon protagonistin në një moment kur gjërat ngjajnë të qeta, në aparcencë, pastaj ndryshojnë krejtësisht duke shkaktuar thyerjen e ekuilibrave të mëparshëm. Jo vetëm kaq, por kjo prishje e ekuilibrit shoqërohet edhe me një metamorfozë, pra me një ndryshim të personazhit tjetër në tekst, e s’ka si të mos na bëjë përshtypje trajtimi me mjeshtëri i këtyre mjeteve të letërsisë fantastike, nga ana e autorit:

*“Shikova plakun me mirënjohje: fytyra e tij m’u duk me një ëmbëlsi të pafundme dhe plot pafajësi, si fytyr’ e kësaj foshnjeje. Edhe leshrat e mjekr’ e bardhë i bënte një brerore të ndritsh, e saj fytyre dhe atyre syve plot mirësi.*

*Po, o tmerr! Ahere vura re se djepja ish vënë mbi një mur të hollë si kartë, si presë brisku. [...]Edhe Plaku më shikoi me sy t’ashpër e të ftohtë: përnjëherësh ish zhdukur ëmbëlsi e tij dhe tani kish marrë një fytyrë të keqe e të ngrirë; ahere i vura re se edhe dor’e tij që më dërrmonte krahun, ajo dorë që më ish dukur aq e bukur dhe e butë, ish prej guri dhe e ftohtë.”*

Simbolika e Shqipërisë që materializohet tek fëmija i vogël i përkundur në djep, hapësira e ndërmjetme midis reales dhe fantastikes, mundëson që të bashkëjetojë bota reale me botën e fiksionit. Ajo çka e zbeh dhe e ngadalëson rrëfimin deri në fund, megjithatë, është zbulimi i një pjese të enigmës: plaku misterioz është vetë Koha, që rrjedh në mënyrë të pandalshme, që nuk njeh hapësirë dhe është ciklike, që ka lindur me botën e do të vazhdojë pas saj. Ajo që mbetet, është misteri i foshnjës së vogël, i vendit të porsa dalë nën dritën e pavarësisë, që e pret një fat sa misterioz, aq edhe i padepërtueshëm.

Në prezantimin final të plakut të Ylynecit, ne shohim të pëshqjellohen dhe të

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

tjetërsohen në forma dhe me emra të ndryshëm, universi, koha, hapësira, nga legjionet e njëtrajtshme e të paidentifikueshme romake, deri në personazhet e përveçëm historikë si Ali pashë Tepelena apo Tafil Buzi. Kjo bashkëjetesë është sa interesante, aq dhe fantastike. Plaku-Kohë e krahason veten me lumin Vjosë, e ujërat e lumit janë si rrjedha e kohës, asnjëherë e njëtrajtshme, me misterin e futur thellë brenda saj.

Nën këtë dritë, mund ta klasifikojmë këtë novelë brenda “Realizmit të mrekullueshëm”, që si lloj letrar ndërmjetëson realitetin me dimensionin fantastik, duke u bërë paraprijës i realizmit magjik në letërsi. Në ndihmë për këtë klasifikim, na Vjen qëndrimi i David Roas i cili mbi këtë dimension, shprehet: “[...] *“Realizmi i mrekullueshëm” mundëson bashkekzistencën jo problematike të reales me të mbinatyrshmen, në një botë të ngjashme me tonën. Kjo situatë përftohet përmes një procesi natyralizimi (ngjashmërie) dhe persuadimi (bindjeje) [...] Realizmi i mrekullueshëm mbështetet mbi një strategji themelore: të denatyralizojë realen dhe të natyralizojë të pazakontën, për të integruar të zakonshmen dhe të jashtëzakonshmen në një përfaqësim unik të botës”*.<sup>6</sup>

Me këtë frymë interpretimi dhe shpjegimi, mund të marrim në shqyrtim një tjetër novelë të kësaj përmbledhjeje, që është me interes për t’u parë në dritën e fantastikes, me titullin “Tmerri”. Rrëfimi është në vetën e parë dhe protagonistin, që në fillim tregon përjetimin e ankthshëm që e kap pasi ka diskutuar me miqtë e tij mbi fatkeqësitë, varfërinë dhe vrasjen që kryheshin në Shqipërinë e asaj kohe. Është sfondi mbi të cilin ngrihet përjetimi i frikshëm, në një gjendje onirike e cila e kaplon dhe e persekuton protagonistin: “*U ngrita nga shtresa, hapa finestrën: yjtë shkëlqenin me një qiell pa hënë. Nuk e di sa ndënja përpara finestrës, por më duket se pa shkuar shumë, më zuri gjumi*” (f.52)

Jemi përpara elementëve që të kujtojnë rrëfimet e frikshme fantastike të shek. XIX. Nata e frikshme, qielli pa hënë dhe gjumi që nuk vjen si qetësim, por si persekutim i prehjes. Kalohet aq lehtë dhe pa asnjë ndërmjetësim nga bota reale, në terrenin e ëndrrës. Nuk ka asnjë element shtesë që të tregojë këtë kalim, gjithçka nënkuptohet dhe bëhet në një mënyrë të natyrshe dhe gati të thjeshtë:

*“Po nxitoja dhe qeni po më ndiqte. Nxitoja me vrap të madh dhe s’guxoja të ktheja sytë nga frika se mos i shoh gojën e kuqe dhe syt’ e zjarrtë që i ndritnin në faqet e zeza... mora një të përpjetë; dheu ish gurishte: qeni ish nja pesëdhjetë cape larg meje, po unë e ndjeja që, sa vinte, kafsh’ e egër po më qasej. Tani më dukesh sikur frym’ e tij më diqte krahët, aq e pandehnja të afruar; kisha zënë dhe të lodhem, mushkëritë më ishin ngusur, mezi mirrja frymë; po prapë vrajonja me akull në zemër.”* (f.53)

U futëm brenda ëndrrës, por ankthi i përjetuar, tmerri që ngrin gjakun e protagonistit është real dhe i prekshëm. Në këtë bashkëjetesë të botës si është në realitet, e të mikrouniversit ndjesor që zgjohet nga ëndërimi, kemi depërtuar në hapësirën e fantastikes, tokë e ushqyer nga ëndrrat, ku shihet drejtpërdrejt përfytyrimi i ardhur nga thellësitë e shpirtit.

<sup>6</sup>David Roas, *La amenaza delo fantástico*, in Aa.vv., *Teorías delo fantástico*, a cura di David Roas, Madrid, Arco, 2001, f.12.

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

Nëse ofrojmë një krahasim me letërsinë fantastike evropiane të Nëntëqindtës, duke marrë për bazë kontributin e psikanalizës, surrealizmin, realizmin magjik dhe në përgjithësi letërsinë moderne të kohës, dalim në përfundimin se ëndrrat janë gjuha përmes së cilës flet imagjinata fantastike e krijuesit.

Domeniko Porzio, në tekstin “Pikëpyetja fetare në veprën e Dino Buxatit”, shkruan: “[...] nuk ka pikë dyshimi që letërsia narrative e Buxatit[...] përmban ankthin e kohës, qëllimin gnostik për ta konsideruar botën dhe realitetin si një ëndërr ku jemi të burgosur, duke ruajtur qëllimin për të futur brenda arkitekturës së të dukshmes, “grimca të vazhdueshme absurditeti” që mund të na ngushëllojnë e qetësojnë se gjithçka është e rreme”.<sup>7</sup>

Lexuesi, në këtë rrëfim, qetësohet deri diku nga fakti që protagonistin po ëndërron, megjithatë përjetimi i ankthit të tij është real. Dhimbja është gati fizike. Tentativa për t’i shpëtuar ndjekjes nga kafsha e egër vjen si një betejë mbijetese, ai plagoset, gjakoset, i mbahet fryma dhe ndjen mushkëritë gati t’i shpërthejnë. Ndjen këmbët që nuk i bëjnë më, vështrimi i errësohet dhe dihatja e tij është si një lutje që gjithçka të marrë fund dhe të vijë zgjimi i shumëpritur. I burgosur brenda ëndrrës së vet, nuk ndodh kështu, pasi pikërisht kur mendohet se ka kaluar rreziku, ai materializohet më i afërt se kurrë:

“[...] plag’ e ballit dhe të çjerrat e turirit po zënë të më djegin, por prapë jam i lumtur se shpëtova nga ndjekja dhe nga goj’ e kuq’ e qenit.

Një zë në mes të ferrave më bën të kthej kokën. O tmerr! Qenin që pandehja se shpëtova soje, qenin në dhëmbët e të cilit më ishte varur jeta, tani e kam përpara!

Më s’pata kurajo as të ikja, as të thërrisja; sytë m’u errë, laqet e këmbës m’u zgjidhë, mbeta si i ngrirë! Tani më s’shijja gjë, vetëm veshët më dëgjonin një të lehur m një zë të mbytur, dhe – sado që sytë s’më shihnin, më dukesh se qeni më skërmitte dhëmbët dhe po bëhesh gati të më hidhesh.”

Pra si element të fantastikes, mund të cilësojmë një botë, ajo e ëndrrës, që është reale dhe e mbushur me një përndjekje të frikshme, misterioze, që vjen nga një orientim i errët, i pashkak, i pashpjegueshëm. Nuk tregohet pse nisi ndjekja, ndërsa rrëfimi merr trajtat e një ilustrimi simbolik, që i lejon tekstit të marrë një shumësi kuptimesh dhe interpretimesh të lira.

Në pjesën e dytë të rrëfimit, protagonistin zgjohet dhe i duket sikur ka lënë pas të errët misterioze të gjumit të natës. Por sërish ndjesia që gjërat nuk janë ashtu si duken në dritë të diellit, nuk i shqitet për asnjë çast. Një moment dëgjon të lehurën e qenit jashtë dhe përfton ndjesinë mos ëndrra vazhdon edhe në realitet. Kemi të bëjmë me një ndërhyrje të qartë dhe të prerë të imagjinare dhe fantastikes në qiellin e reales. Ankthi kthehet në tmerr, e as drita e diellit nuk mund të sfidojë dhe të largojë këtë pështjellim. Pyetjet retorike janë shqetësime që nuk marrin dot përgjigje. Është e huaja, e panjohura, misteriozja, ajo që përbën kërcënim për protagonistin:

“[...] Of, sa ëndërr e ligë! Me sa gas sheh njeriu që duke hapur sytë, gjith’ajo hije e zezë fluturoi. [...] Po hija akoma s’u zhduk, se prapë dëgjoj qenë që leh, dhe tani po leh me një zë të shqyer dhe të egërsuar. Ç’është kjo, ç’është ky qen? Është qeni ynë. Po pse leh, kujt i leh? [...] Ngrihem, dal në ballkon dhe shtie një sy në kopsht; s’ka

<sup>7</sup> Domeniko Porzio, *L’interrogazione religiosa nell’opera di Dino Buzzati*, në ivi, f. 71

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

njeri. *Qeni po leh afër portës dhe me zemërim i sulet murit[...]*” (f.54)

Na ofrohet një lloj shtrirje e ireales, e botës onirike, mbi realen, atë që perceptohet nga njeriu. Qeni i ëndrës shndërrohet në qenin e njohur të shtëpisë, e lehura është njëlloj dhe ankthi e tmerri nuk shqitet asnjë çast. Protagonisti i provon të gjitha, por nuk arrin të largojë vetes pasigurinë se diçka e keqe ka për të ndodhur. Lehjet e çartura e të egërsuara janë paralajmërim që mjegulla e errët do të lyejë muret e fatit të tij. Dhe kur nuk pritej, vjen konfirmimi që irealja, fantastikja, imagjinaria, është e pushtetshme dhe zgjatohet deri në jetën e përditshme:

*“A e mësove që mikun tonë...pardje e zunë dhe u hodhë në burg?...”*

*Hij’ e natës s’ish akoma çdukur!”*(f.55)

Kjo është mbyllja e novelës dhe na takon të vlerësojmë këtë krijim afër fantastikes, nga tensioni narrativ dhe kushtëzimi i ireales që ushtron tërheqjen e saj ndaj realitetit.

Para se të dalim në konkluzione paraprake, mbetet për t’u bërë një saktësim i fundit, në krahasim ndërmjet letërsisë së fillim shekullit XX në Shqipëri dhe përmasave të fantastikes në letërsinë evropiane si dhe në realizmin magjik amerikano-latin. Në këto dy platforma letrare, hibridizimi i botëve (reales dhe fantastikes) është elementi identifikues për këtë lloj letërsie, e kjo përputhet edhe me ndërhyrjen brenda të njëjtës hapësire narrative, të elementëve reale dhe elementëve të trilluar. Kombinimi mes tyre mundëson zberthimin e tekstit dhe tregon funksionalitetin në tërësi të tij. Sikur të ndalemi te letërsia e Amerikës latine, Borgezi është shembulli më i përshtatshëm për të na ofruar orientimin e nevojshëm në këtë drejtim.

“Universin fantazmagorik” të Borgezit, studiuesja Maria Barrenechea e cilëson si *“një sferë ku kufijtë ndërmjet reales dhe fiksionin letrar nuk ekzistojnë më, janë fshirë, ku nuk kuptohet më se çfarë është imagjinare dhe çfarë është e vërtetë, ku personazhet romaneskë mund të alternohen me ata historikë dhe anasjelltas, autorët realë me apokrifët, ku jeta kopjon rregullat letrare e nga ana tjetër, ajo çka është specififikisht letrare, merr vlerë vitale, madje dhe magjike”*.<sup>8</sup>

Pesimizmit të Todorovit, sipas të cilit *“fantastikja e mirëfilltë ishte e destinuar të zhdukej në shek. XX, nisur nga zëvendësimi i saj me psikoanalizën, me humbjen e ndarjes ndërmjet reales dhe ireales, çka do të sillte për pasojë fantastikimin e përgjithshëm të botës së përfaqësuar”*<sup>9</sup>, – mund t’i kundërpërgjigjemi duke argumentuar se nocioni i realitetit që vepron te lexuesi, përputhet vetëm minimalisht me nocionin e promovuar nga teksti letrar, i cili ushtron një lloj ndikimi mbi ndërgjegjen e lexuesit, por jo aq sa të shkundë dhe të kthejë përmbys kodin orientues në botën reale të tij.

Edhe lexuesi më dashamirës i fantastikes, e humbet nëse vihet përballë një situatë e cila e thyen paktin e leximit dhe koherencës e botës së mundshme të rrëfyer në tekst.

<sup>8</sup>Ana María Barrenechea y Emma Susana Speratti Piñero, *La literatura fantástica en Argentina, México, D.F.*, Imprenta universitaria, 1957 f.54.

<sup>9</sup>Mbi këtë pikë Teodorov shkruan: *“Shekulli XIX jetonte, është e vërtetë, brenda një metafizike të reales dhe të imagjinare, ndaj letërsia fantastike s’është gjë tjetër veçse ndërgjegjia e pistë e atij shekulli XIX pozitivist. Por sot nuk mund të besojmë më në një realitet të pandryshueshëm, të jashtëm, e as në një letërsi që do të kërkonte ishte vetëm transkriptimi i këtij realiteti. Fjalët tashmë kanë zotëruar një autonomi që e kanë humbur sendet [...] edhe vetë letërsisë fantastike, që në faqet e saj kthen përmbys kategori të gjuhësore, i është dhënë një goditje vdekjeprurëse: por nga kjo vdekje, nga kjo vetëvrasje, lind një letërsi e re. Sot, nuk do të ishte shenjë mendjemadhësie të pohohej që letërsia e shek. XX është, në një farë mënyre, më shumë ‘letërsi se çdo tjetër’. Teodorov, “La literatura fantástica”, f. 172.*

Themi, me të drejtë, që më e rëndësishme se raporti midis fantastikes dhe binomit reale-ireale, na duket përshtatja e lexuesit, pranimi i ngjarjes së pamundur, fantastike, duke u ndjerë këtë të fundit si diçka që zgjatet tej normales, mund të jetë deri vijim i mëtejshëm i realitetit, por pa shkaktuar trazim apo habi të thellë.

Lexuesi i sotëm mund ta gjejë plotësisht komod vetëm në këtë lloj rrugëtimi fantastik, tek shembujt e ofruar më lart. Në paraqitjen e botëve hibride, të pandara me vijë kufizuese midis reales dhe ireales, ku bota onirike ngrihet si një pësjtjellim metaforik i protagonist, fantastikja përvetësohet dhe ndjehet si e natyrshme e në harmoni me tekstin. Edhe kur është e detyruar që ngjarjet të zbardhen nën dritën e reales, kontradikta e brendshme e tekstit, që pasqyron trajta të fantastikes, e bën të gjallë dhe tërheqës deri në fund procesin e leximit. Sikundër mundëm të shohim, në këto novela të veçuara të Lumo Skëndos, jo vetëm autorët e periudhës mundeshin të krijonin sipas modelit bashkëkohës të fantastikes, por shfrytëzonin në maksimum potencialin gjuhësor dhe imagjinar të tyre, në krijimin e një lloji rrëfimi, të ri, por njëherësh dhe të lashtë sa letërsia, që përfshihej brenda fantastikes.

## **5. Përfundime**

Duke u mbështetur në këtë studim, mund të konstatojmë se Mit'hat Frashëri ofron një qasje novatore që lidh trashëgiminë kombëtare me zhvillimet letrare bashkëkohore të Evropës. Përmes përdorimit të elementeve të realizmit të mrekullueshëm dhe ndërthurjes së reales me fantastiken, Frashëri arrin të trajtojë çështje të ndërlikuara si identiteti kombëtar, ndjeshmëria shoqërore dhe sfidat e modernizimit. Kjo qasje shpreh një përpjekje të vetëdijshme për të tejkaluar kufijtë e letërsisë tradicionale shqiptare, duke e vendosur atë në një hapësirë më të gjerë të diskursit kulturor. Për të analizuar fillesat e modernizmit në letërsinë shqipe gjatë Luftës së Parë Botërore, ky studim ndoqi një qasje e integruar, duke kombinuar metodologjitë historike, letrare dhe analitike. Duke shqyrtuar kushtet historike të fillimit të shekullit XX në Shqipëri, studimi nxjerr në pah sfidat sociale që ndikonin në zhvillimin intelektual dhe kulturor të vendit. Këto kushte historike, të shoqëruara me aspiratat për pavarësi dhe emancipim kombëtar, u reflektuan në krijimtarinë letrare të periudhës. Krijimet e Mit'hat Frashërit, veçanërisht përmbledhja “Hi dhe shpuzë,” ofrojnë një shembull të rëndësishëm të kësaj lidhjeje mes zhvillimeve historike dhe tendencave të reja letrare. Kjo vepër u analizua në dritën e shkollave letrare bashkëkohore dhe ndikimeve evropiane, me theks në raportin mes reales dhe fantastikes. Tregimet si “Plaku i Zlyncit” dhe “Tmerri” dëshmojnë për një autor që eksploron kufijtë e perceptimit njerëzor dhe të realitetit social. Figura e plakut, që përfaqëson kohën si një forcë ciklike dhe të pandalshme, është një simbol universal që mbart mesazhe të thella filozofike mbi fatin dhe përjetësinë. Këto figura krijojnë një narrativë që u jep lexuesve mundësinë të reflektojnë mbi të kaluarën dhe të ardhmen e kombit, ndërsa tërheqin paralele me zhvillimet moderne në letërsinë evropiane.

Për më tepër, përdorimi i simbolikës së fëmijës në djep si përfaqësues i Shqipërisë së re dhe të brishtë pas pavarësisë, krijon një ndjesi shprese dhe mundësisë, por edhe një ndjenjë të thellë përgjegjësie për të ardhmen. Në të njëjtën kohë, tensioni mes reales dhe fantastikes, i pranishëm në të gjithë veprën, reflekton tensionet shoqërore

dhe politike të kohës. Elementet e strukturës, gjuhës dhe simboleve në tregimet e Frashërit tregojnë gjithashtu përpjekjen për të përcjellë mesazhe lidhur me identitetin kombëtar dhe transformimet sociale.

Në përfundim, Mit'hat Frashëri, përmes qasjes së tij inovative dhe përdorimit të elementeve bashkëkohore, krijon një lidhje të fortë mes trashëgimisë kombëtare dhe zhvillimeve moderne. Kjo vepër jo vetëm që shpreh shpirtin e kohës, por gjithashtu hedh themelet për një letërsi shqipe që angazhohet në mënyrë të thelluar me kontekstin global, duke e vendosur atë në një rrjedhë më të gjerë kulturore dhe intelektuale, duke dëshmuar që ndikimi i Mit'hat Frashërit nuk qëndron vetëm në risitë stilistike, por edhe në mesazhin e tij të fuqishëm për një komb që përpiqej të gjente vendin e vet në botën moderne.

## **6. Bibliografi**

1. Frashëri, M. (1915). Hi dhe shpuzë. Bukuresht: Shtypshkronja e Shqipes.
2. Frashëri, M. (1996). Hi dhe shpuzë. Vepra, Rilindja.
3. Hamiti, S. (1989). Vetëdija letrare. Prishtinë: Rilindja.
4. Hamiti, S. (2000). Bioltera, Një teori e shkrimit dhe e leximit. Prishtinë: Faik Konica.
5. Hamiti, S. (2009). Letërsia moderne shqipe. Tiranë: UET-Press.
6. Jackson, R. (1986). Fantasy. La letteratura della trasgressione. Napoli: Pironti.
7. Jakllari, A. (2003). Historia e mendimit etnologjik. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
8. Jefferson, A., & Robey, D. (2004). Teoria letrare moderne, (Një paraqitje krahasuese). Tiranë: Albas.
9. Jorgaçi, N. (1983). Lumo Skëndo dhe letërsia shqipe. Tiranë: Akademia e Shkencave.
10. Roas, D. (2001). Realizmi i mrekullueshëm dhe fantastikja. Madrid: Editorial Fantasia.
11. Rusi, E., & Zaçellari, M. (2022). Literary and linguistic symbols of the fatal signs of death in the literature of Dino Buzzati. *Journal of Language Teaching and Research*, 13(6), 1139-1146.
12. Rusi, E. (2022). Fantastic Literature against Propaganda in Ismail Kadare's Novels. *Analele Universității din Craiova, Seria Științe Filologice, Limbi Străine Aplicate*, (1), 205-218.
13. Todorov, T. (1975). *Fantastikja: Një hyrje teorike*. Paris: Éditions du Seuil.
14. Uçi, A. (1982). Mitologjia, folklori, letërsia. Tiranë: Naim Frashëri.
15. Vax, L. (1987). *La natura del fantastico*. Roma: Theoria.
16. Dibra-Zeqiri, F. (2024). The attitude of the three albanian rinsiers for the albanian language alphabet – Gjergj Qiriazi, Faik Konica, Mit'hat Frashëri. *Albanologjia: International Journal of Albanology*, 11(21-22), 104-112.
17. Xhufi, P. (2010). Shqipëria dhe ndikimet e modernizmit. Tiranë: Botimet Arbëria.

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

**KRISTO FLOQI DHE KOMEDIA “VLLAZNI E INTERESË”- VLERË E ÇMUAR NË ZHVILLIMIN KULTUROR TË KORÇËS SË VITEVE 1910-1921**

**Msc. Lonora HYSOLLI**

*Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë*

*Universiteti “Fan S. Noli”*

*lhysolli@unkorce.edu.al*

**Prof. dr. Valter MEMISHA**

*Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë*

*memisha\_valter@yahoo.com*

**Abstrakti**

*Pas shpalljes së Pavarësisë, pothuaj në fundvitin 1912, Shqipëria u përball me një mori sfidash në institucionalizimin e shtetit të saj të pavarur, si: krijimi i institucioneve të para vetqeverisëse, vështirësitë e njohjes ndërkombëtare të këtij shteti të brishtë, trazira të brendshme, konflikte ndëretnike e mbi të gjitha beteja për ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit. Rrethanat historike, politike dhe ekonomike të kohës ndikonin dukshëm në zhvillimin kulturor (arsimor, gjuhësor, letrar) në gjithë territorin etnik. Po si paraqitet kjo situatë në Rajonin e Korçës, në vitet 1910-1921, kur tanimë, pikërisht në këtë kryeqendër arsimore, më 7 Mars të vitit 1887 ishte çelur shkolla shqipe dhe kur, pas ngjarjes madhore të ndodhur jo rastësisht në Manastir, shqipja mund të shkruhej me alfabetin e vet? A mund të botoheshin libra në gjuhën shqipe? Ku mund të gjendej mbështetja financiare? Vështirësitë ishin shumë të mëdha, por mbështetja kryesore në botimin e studimeve shqiptare vijoi të ishte diaspora. Studimet shqiptare të kësaj periudhe i kushtojnë vëmendjen kryesore rritjes së identitetit kombëtar, duke u ndalur te proceset historike, politike dhe ushtarake të kohës, por padyshim edhe arsimimit të shoqërisë shqiptare. Janë bërë studime në lëmin e letërsisë, gjuhësisë, historisë, kulturës, fesë, gjeografisë, shtypit etj. Punimi ynë synon të sjellë një vështrim të rolit dhe ndikimit që kanë patur krijimet dhe botimet e diasporës korçare, më konkretisht të Kristo Floqit, përmes analizës në rrafshin arsimor, gjuhësor, letrar, të komedisë “Vllazni e interesë”, botuar në Shtypshkronjën “Nikaj”, Shkodër, 1920, në zhvillimin kulturor të shoqërisë korçare dhe shqiptare të kohës.*

**Fjalë kyçe:** *arsimim i shoqërisë, botime, diasporë, komedi, “Vllazni e interesë” zhvillim kulturor.*

**KRISTO FLOQI AND THE COMEDY "BROTHER OF INTEREST" - A PRECIOUS VALUE IN THE CULTURAL DEVELOPMENT OF KORCA OVER THE YEARS 1910-1921**

**Abstract**

*Following the declaration of independence at the end of 1912, Albania faced numerous challenges in institutionalizing its independent state. These included establishing its first self-governing institutions, difficulties in gaining international recognition for this fragile state, internal unrest, interethnic conflicts, and, above all, the struggle to preserve the country's territorial integrity. The historical, political, and economic circumstances of the time had a significant impact on*



## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

*cultural development (educational, linguistic, literary) across the entire ethnic territory. But how did this situation manifest in the Korça region during the years 1910–1921, a period when this educational hub had already opened the first Albanian-language school on March 7, 1887? Furthermore, following the pivotal event in Monastir, where the Albanian language gained its own alphabet, could books in Albanian be published? Where could financial support be secured? Despite the immense difficulties, the Albanian diaspora remained the main supporter of Albanian studies and publications. The scholarly works of this period primarily focused on enhancing national identity, emphasizing the historical, political, and military processes of the time, as well as the education of Albanian society. Studies were also conducted in the fields of literature, linguistics, history, culture, religion, geography, and the press. This paper aims to provide an overview of the role and influence of the literary creations and publications of the Korça diaspora, particularly those of Kristo Floqi. Through an analysis of the educational, linguistic, and literary dimensions of his comedy "Brotherhood and Interest", published in 1920 at the "Nikaj" Printing House in Shkodër, the study explores its contribution to the cultural development of the Korça region and Albanian society of the time.*

**Keywords:** societal education, publications, diaspora, comedy, Brotherhood and Interest, cultural development.

### **Hyrje**

Konteksti historik për të cilin bëhet fjalë është periudha drejt shpalljes së Pavarësisë dhe pas saj, në Shqipërinë e rrënuar gjithandej që me zor po mbahej në këmbë, por ende në jetë, gjatë së cilës do të ndodhte edhe ngjarja shkatërruese mbarëbotërore e Luftës së Parë. Sidomos, pas shpalljes së Pavarësisë, pothuaj në fundvitin 1912, Shqipëria u përball me një mori sfidash në institucionalizimin e shtetit të saj të pavarur, të tillë si: krijimi i institucioneve të para vetëqeverisëse, vështirësitë e njohjes ndërkombëtare, trazira të brendshme, konflikte ndëretnike, e mbi të gjitha, beteja për ruajtjen e tërësisë territoriale të vendit. Rrethanat historike, politike dhe ekonomike të kohës ndikonin dukshëm në zhvillimin kulturor (arsimor, gjuhësor, letrar) në gjithë territorin etnik.

Por, si paraqitet kjo situatë në Rajonin e Korçës, në vitet 1910-1921, kur në pranverën e vitit 1887, pikërisht në qendrën e tij ishte çelur shkolla e parë laike shqipe? Vetë Naim beu i thuri lavd e varg: *Lumja ti, moj Korça lule / Që i le pas shoqet e tua / Si trimi në ballë u sule / Ta paçim përjetë hua!* Në qytetin fqinj të Manastirit, në vjeshtën e vitit 1908, ku Korça u përfaqësua cilësisht, në Kongresin e Alfabetit, u njësua më në fund alfabeti me të cilin do të shkruhej shqipja e lashtë, duke i paraprirë kombit dhe shtetit. Pas Lidhjes së Prizrenit, Kongresi i Manastirit është i pari tubim i madh mbarëkombëtar, “është i pari kongres shqiptar përfaqësimitar, në të cilën morën pjesë shqiptarë pa dallim feje e krahine, që përfaqësonin shumicën e trojeve shqiptare dhe kolonitë shqiptare kryesore<sup>1</sup>.

Sipas akademikut Sh. Demiraj “*ishte koha kur kishte dalë si detyrë e dorës së parë vendosja e një alfabeti të përbashkët për shkrimin e gjuhës shqipe, gjë që kishte edhe rëndësi politike të dyfishitë. Mungesa e një alfabeti të përbashkët, jo vetëm që ngjallte përçarjen, që shfrytëzohej nga armiqtë për të mbjellë e për të thelluar dasitë krahinore*

---

<sup>1</sup> Prof. dr. Valter Memisha “Kongresi i Manastirit, ngjarje përcaktuese në rrugëtimin shqiptar “Një komb-një gjuhë”. (Fjalë e mbajtur më, 22 nëntor 2017, në Manastir, në Konferencën kushtuar Kongresit, 1908).

## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

e fetare midis shqiptarëve, por ishte njëkohësisht edhe një pengesë e madhe për lëvrimin e gjuhës shqipe e, si rrjedhim, edhe për arsimimin dhe zgjimin e popullit shqiptar”.<sup>2</sup> Naum Veqilharxhi, më 1836 në Enqiklikën e tij, shkruante se “*Sa kombe që kanë mbetur në padije, u ngjasin gjithnjë robëve, duke punuar nga ditë për fatbardhësinë e të qytetëruarve e të fuqishëmve; ata vetëm atëherë kanë për të dalë nga gjendja e bagëtishme ku gjenden, kur të nisin të lërojnë gjuhën e tyre kombiare. Po kjo nuk fitohet ndryshe veçse me shkronja të veçanta kombiare që janë filluar para meje.*”<sup>3</sup> Alfabeti i sotëm latin i Manastirit, nuk ishte rezultat i kompromiseve pa kriter, ai ka bërë zgjidhje që tregonin pjekurinë që kishte arritur jo vetëm mendimi kombëtar, por dhe ai shkencor në atë kohë, çka mundësonte gjithë sipërmarrjet e mëtejshme në proceset arsimore e diturore në shtetin e ardhshëm shqiptar.<sup>4</sup> Kongresi i Manastirit është gur shënues, jo vetëm për shkrimin e unifikuar të shqipes, por edhe për historinë e kulturës kombëtare dhe për vetë historinë politike të Shqipërisë. Ai nuk ishte thjesht kongresi i alfabetit, i Abesë. Pjesëmarrja përfaqësimitare në të dhe mënyra se si i zhvilloi ai punimet edhe pse u shprehën mendime të ndryshme, treguan se populli shqiptar ishte gati të hidhte hapin e madh, atë të luftës për shpalljen e pavarësisë. Nga lëvizja “Me pushkë e penë për mëmëdhenë”, po kalohej në kryengritjen mbarëkombëtare “Ja të vdesim, ja të rrojmë për liri!”, e cila u kurorëzua më 28 nëntor 1912.<sup>5</sup> Kongresi i Manastirit i tregoi botës se shqiptarët ishin një komb dhe kishin një gjuhë, e cila i identifikonte dhe i bashkonte, i bënte të ecnin në rrugën mijëra vjeçare të ilirësisë e të shqiptarisë. Por vetëm 6 muaj pas shpalljes së Pavarësisë, Shqipëria e shqiptarët copëtohen nga Fuqitë e Mëdha në 6 shtete, kjo me pasoja të pariparueshme edhe pas 100 e ca vjetësh. Pasojat i ndjeu drejtpërdrejt shqipja, e cila sot është e vetmja gjuhë në Ballkan e në Evropë që del me disa statute. Por, në një kompleks vështirësish të tilla, a mund të botoheshin e lexoheshin libra në gjuhën shqipe pa traditë të konsoliduar e të sapounifikuar shkrimore? Vështirësitë ishin shumë të mëdha e të dukshme gjatë kësaj periudhe për një mori faktorësh të sipërpërmendur, por mbështetja kryesore në botimin e letrave shqiptare, vijoi të ishte diaspora. Studimet shqiptare të periudhës, i kushtojnë vëmendjen kryesore rritjes së identitetit kombëtar, duke u ndalur te proceset historike, politike dhe ushtarake të kohës, por padyshim edhe arsimimit e emancipimit të shoqërisë shqiptare, si çelësi kryesor përmes të cilit do të arrihej e do të rritej ky identitet i kërkuar me aq ngulm nga rilindësit tanë. Janë bërë studime në lëmin e letërsisë, gjuhësisë, historisë, kulturës, fesë, gjeografisë, shtypit, etj. Në periudhën në fjalë, Korça dhe Shkodra ishin dy qytetet që kryesonin në aspektin e aktivitetit teatral. Studiuesi J. Papagjoni te “Teatri dhe Kinematografia shqiptare”, i cilëson këto dy qytete si qendra të rëndësishme të teatrit shqiptar deri në vitin 1945, duke u ndalur hollësisht në aktivitetin e tyre teatral<sup>6</sup>. Në Korçë, në këtë periudhë do të zhvillonin aktivitetin e tyre disa shoqëri artistike, të cilat vunë në skenë një numër të konsiderueshëm pjesësh dramaturgjike, kryesisht krijime të autorëve korçarë. Ndër këto shoqëri si më të rëndësishmet përmendim: Banda “Vatra”, formuar në SHBA, nga patriotë shqiptarë. Nga anëtarët e saj dhe nga të rinj shqiptarë të ardhur nga Rumania për

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Prof. dr. Valter Memisha: “Kongresi i Manastirit, ngjarje përcaktuese në rrugëtimin shqiptar “Një komb-një gjuhë”. (Fjalë e mbajtur më, 22 nëntor 2017, në Manastir, në Konferencën kushtuar Kongresit, 1908).

<sup>6</sup> J.Papagjoni, Enciklopedia Teatri dhe Kinematografia shqiptare, Tiranë, 2009.

mbrojtjen e atdheut, u krijua në vitin 1920 “Shoqëria e Arteve të Bukura”, e cila zhvilloi një aktivitet të gjerë artistik, muzikor dhe teatror.

Ky punim synon të sjellë një vështrim të rolit dhe ndikimit që kanë patur krijimet dhe botimet e diasporës në përgjithësi, duke veçuar krijimet plot vlerë të Kristo Floqit, si një zë i fuqishëm poliedrik e duke bërë një analizë në rrafshin arsimor, gjuhësor, letrar e më gjerë. Për konkretizim është veçuar për këtë lloj analize komedia **“Vllazni e interesë”**, botuar në Shtypshkronjën “Nikaj”, në Shkodër, 1920 dhe ndikimi që ajo ka patur në zhvillimin kulturor të shoqërisë korçare, pse jo edhe shqiptare, të kohës.

### **1. Kush ishte Kristo Floqi dhe si ndikoi ai në zhvillimin kulturor të shoqërisë korçare?**

Kristo Floqi, (1876-1951), lindi në fshatin Floq, prej nga mori dhe mbiemrin. Mësimet e para i kreu në qytetin e Korçës, kurse studimet kryesore i bëri në Athinë për drejtësi, ku e ushtroi për pak kohë profesionin e tij. Pasi u kthye në qytetin e lindjes e ushtroi atë për gjashtë vjet. Pas kësaj, jeta private dhe profesionale e tij pëson ndryshime dhe zhvillime të ndikuara nga lëvizja kombëtare. I përfshirë aktivisht në të, ai shkoi në Stamboll, në Greqi, sërish në Korçë, në Vlorë, në Amerikë, kryesisht për shkak të përndjekjes që i bëhej drejt eliminimit, si një prej figurave kryesore të lëvizjes kombëtare. Atdhetari korçar Kristo Floqi pati një jetë aktive në shërbim të çështjeve kombëtare. i ushqyer me burimet e pasura të letërsisë greke, i pajisur me kulturë perëndimore e amerikane. Pas kryerjes së studimeve universitare për drejtësi në Athinë, në fundvitet e shekullit XIX dhe fillimvitet e shekullit XX, i ka pasur të gjitha kushtet objektive dhe subjektive, për të sjellë vlera cilësore në proceset e zhvillimit kulturor të vendit, posaçërisht në letërsinë shqipe të periudhës 1912 – 1939, veçanërisht në dramaturgjë. Synimi i veprave të tij nuk ishte vetëm për krijimtari letrare, por ai i jepte shoqërisë korçare e mbarëshqiptare, dije, kulturë, vlera estetike e gjithçka të nevojshme diktuar nga realiteti i shoqërisë. Ai nuk hyn rastësisht në listën e patriotëve dhe intelektualëve korçarë, por u ndikua dukshëm nga tradita e krijuar prej rilindësve, për të përcjellë dhe përmirësuar idetë e tyre në kushte të reja të zhvillimeve politike, social - ekonomike e kulturore të rajonit të Korçës e më gjerë. Frymëzimin më të parë e pati prej poezive të përmetarit prej Frashëri, Naimit: *Më ndezi aq shumë ndjenjën kombëtare sa mund të them se qysh atëhere s’pushova të jem një shqiptar i flaktë*<sup>7</sup> - shkruan ai. Kështu, emrat e Naum Veqilharxhit, Thimi Mitkos, Spiro Dines, Asdrenit, Mihal Gramenos, Grigor Cilkës, Sami Pojanit, Thoma Avramit, Qiriazëve, Shefqet e Mit’hat Frashërit, e kishin hedhur më së miri themelin e Korçës, që i dha kombit bijtë e saj (të cilët ia shpërblyen denjësisht) dhe mundësinë për t’u ndier krenarë në rrjedhë të së ardhmes. Pasues gjatë dhe pas kohës së veprës së këtyre emrave, Kristo Floqi bën vendin e vet në histori, pasi tanimë, shqipja, gjuha e shqiptarëve, ishte njësuar në Manastir, me miratimin e një alfabeti të vetëm, shkollat shqipe ishin hapur, Pavarësia ishte shpallur, autonomia e Korçës gjithashtu. Pra, flamuri, gjuha, shkolla ishin faktorët objektivë mbështetës për të zhvilluar e përparuar. Kështu, Kristo Floqi i përkushtohet atdheut dhe kulturës sonë, me shpirt nacionalisti të kulluar që përtej oqeanit. Në Boston të Amerikës, botoi të përjavshmen “Dielli” në gjuhën shqipe, kurse në shtator të vitit 1911, u bë bashkëthemelues i federatës panshqiptare “Vatra”, së bashku me Nolin dhe Konicën.

<sup>7</sup> AQSH, *Fondi Kristo Floqi, D.1*

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Në 1912, botoi të përjavshmen “Zëri i popullit” në Nju Jork, kurse në 1913 ishte delegat në Kongresin e Triestes. Pas Triestes shkoi në Milano, ku bashkë me Xhuzepe Skiroin, Cosmo Seremben e Hilë Mosin themeloi shoqërinë “Shqipëria e Re”, e cila arriti të vihej në shërbim të çështjes kombëtare, pasi u mbështet edhe nga Ismail Qemali. Në qeverinë e tij, Ismail Qemali e ngarkoi me misionin e organizimit të drejtësisë shqiptare dhe e emëroi President të Gjykatës së parë të këtij qyteti. Thuhet se ka qenë i pari që ka shkruar procedurë gjyqësore në gjuhën shqipe. Pas pushtimit të Vlorës, u shpërngul në Shkodër. Aty ngriti një zyrë juridike ku ushtroi veprimtarinë dhe profesionin gjatë Luftës së Parë Botërore.

Në maj 1919, nisi botimin e të përmuajshmes “Agimi” organ i shoqërisë “Vllaznia” e më pas u bë kryetar i Gjykatës së Apelit në Shkodër. Në dhjetor të vitit 1920 u caktua ministër i arsimit në kabinetin e Iljaz Vrionit e më pas këshilltar i shtetit. Në legjislaturën e parë u zgjodh deputet i Dibrës, kurse në 1925, deputet i Korçës. (Pas Luftës së Dytë Botërore, u arrestua, sikundër mjaft intelektualë të pasluftës që nuk ishin larguar nga vendi. Vdiq në 1951, pas 7 vitesh burgim).

Por aktiviteti i tij i dendur nuk ishte vetëm politik e publicistik. Ai realizoi misionin e tij edhe në letërsi. Sipas albanologut Robert Elsie, ai është dramaturgu më popullor shqiptar në gjysmën e parë të shekullit XX. Gaetano Petrotta e cilëson si një nga shkrimtarët shqiptarë që e kanë të siguar emrin në të ardhmen. Shkroi vepra juridike që kontribuan në edukimin e shqiptarëve me konceptet e së drejtës, që mbizotëronin tek popujt e qytetëruar të Europës. Të tilla ishin: “Administrata ose e drejta studimore”, “E drejta konstitucionale”, “Elemente të ekonomisë politike” etj. Kristo Floqi shkroi edhe në poezi e prozë siç mund të përmendim: vëllimin me poezi “Tingëllimat e zemrës”, poemën “Dëshmorët e Rilindjes”, “Antologji shkollore”, si edhe një sërë artikujsh me karakter historik, letrar, muzikor, gjuhësor e politik në shumë organe të shtypit. Kontributi më i madh letrar i tij i përket gjinisë dramatike. Në 1912, ai botoi te “Dielli”, dramën e parë “*Fe e kombësi*”, më pas dramën “*Karlo Topia*”, kurse në 1923 botoi tragjedinë “*Pirro Neotolemi*” etj.

Pavarësisht këtyre dhe të tjerave, kur flasim për rolin e Kristo Floqit në lëvrimin e fjalës shqipe, kemi parasysh sidomos krijimtarinë e tij në fushën e komedisë, duke qenë korçari i dytë që e lëvront këtë lloj dramatik (pas Mihal Gramenos me “Mallkimi i gjuhës shqipe”, 1905).

Kristo Floqi e kapi në kohë nevojën e shoqërisë dhe letërsisë shqiptare që kërkonte të emancipohej duke shprehur mendimin e vet të lirë mbi një sërë dukurish që e shqetësonin gjatë kohës kur jetoi. Ai mprehu penën e satirës dhe humorit duke dhënë një numër të konsiderueshëm veprash komike. Kështu, gjatë periudhës 1912-1927 ai shkruan: “Vllazni e interesë” – 1920; “Ministri kandidat” – 1921; “Kundërshtarët e prikës” – 1922; “E bija bankjerit” – 1922; “Dhëndër me përdhuni” – 1922; “Merre ta marrim” – 1922; “Zi e më zi” – 1923; “Pësimet, mësimet” – 1923; “Rrogat e nëpunësve” – 1923; “Akraballëket” – 1925; “E mbesa e krahinarit” – 1926; “Reklamë e blofë” – 1926; “Doktorllëqet” – 1927 etj.

Në kohën kur shkroi komeditë që trajtonin probleme të rëndësishme të jetës politike e shoqërore, ai satirizonte edhe politikën e mbrapshta, që e bënin jetën e qeverive të kohës afatshkurtër dhe për pasojë ndërrimin e shpeshtë të tyre. Asokohe, ai ishte edhe vetë në krye të pushtetit. Pikërisht këtu vlen të çmohet guximi i tij. Por në komeditë e Floqit gjejmë dhe vlera universale, pasi rrethanat, personazhet dhe mjedisi shqiptar i tyre, mund t’i përshtaten çdo mjedisi, çdo populli, çdo kohe, çdo

vendi. Në komeditë e tij, Kristo Floqi del si një farë kronisti i disa dukurive të jetës shoqërore të përditshme të Korçës, Vlorës, Tiranës, Shkodrës, duke sjellë shfaqje të ndryshme shoqërore. Aty ai ruan fizionominë e ambientit oriental dhe psikologjinë e karakterin mikroborgjez vendas. Përpiqet gjithashtu të futet në trajtat e jetës shoqërore moderne, në tempin dinamik të ditëve të përjetuara, duke thurur struktura funksionale në komeditë e tij.

## **2. Pse pikërisht komedi dhe pse pikërisht “Vllazni e interesë”?**

Veprat dramatike kanë një privilegj: ato jetojnë përmes skenës dhe kapen drejtpërdrejt nga spektatori, i cili e ndien dhe e lidh ngjarjen skenike me përvojat e veta. Kjo ndodh edhe me komeditë dhe dramat e Kristo Floqit. Ato u pëlqyen dhe u pritën shumë mirë nga publiku, veçanërisht komeditë, pasi ishin të thjeshta e të këndshme; trajtonin mjedise dhe mendësi shqiptare; karakterizoheshin nga humori dhe e qeshura që buronin nga një sërë situatash komike; ishin të lehta për t'u perceptuar e për t'u vënë në skenë. Për këto arsye u shfaqën shumë herë pothuajse nga të gjitha teatrot amatore që u krijuan në Shqipëri në periudhën 1912-1939.

Komeditë e Kristo Floqit, kanë qenë padyshim jo vetëm argëtim, por edhe çlirim energjish të ndryshme. Përmes tyre ndiejmë edhe keqardhje. Ato vijnë njëkohësisht edhe si reflektim mbi personazhe dhe tipa që na bëjnë të qeshim me veset, gabimet e marrëzitë njerëzore, por që e kemi të vështirë ta pranojmë veten si bartës së tyre. Pra është efekti reflektues masiv që shërben si mundësi e madhe për të shpjeguar audiencën e gjerë të komedive të Floqit në kohën kur ato u shkruan e u vunë në skenë. Shumica e subjekteve të komedive të tij janë të ngjashme me materialin që nxjerr jeta. Për realizimin e karaktereve komike, K. Floqi ka shfrytëzuar me së shpeshti kontradiktën mes dukjes dhe thelbit, por në disa komedi ai ka shfrytëzuar me mjeshtëri dhe kontradiktën mes së vjetrës dhe së resë. Sipas Spahos: Te komedia “Vllazni dhe interesë”, konflikti ndodh mes së vjetrës dhe së resë. Ai krijohet mes Kolës dhe Nastës nga njëra anë, si përfaqësues të një ambienti tipik mikroborgjez, i cili i mbyt vlerat njerëzore dhe Olymbisë, vajzës së tyre, veprimet e së cilës bien ndesh me ato të prindërve. Olymbia përfaqëson gjithçka të mirë dhe të bukur që i kundërvihet dukshëm anakronizmit dhe mënyrës primitive të arsyetimit të prindërve të saj, sepse ajo është një vajzë e re dhe çmon më shumë njeriun se paranë.<sup>8</sup>

Përsëri sipas studiueses së jetës dhe veprës së këtij autori, Jonela Spaho, *komeditë e K. Floqit shquhen gjithashtu për mjeshtërinë e realizimit të gjuhës së personazheve, me anë të së cilës ai arrin t'i individualizojë ato. Gjuha e personazheve të tij është në përputhje me shtresën, mjedisin, botëkuptimin dhe kulturën që ata përfaqësojnë, pra me thelbin shoqëror të tyre. Shpesh, nëpërmjet gjuhës ai zbulon te personazhet injorancën, lakminë, pafytyrësinë, hipokrizinë dhe budallallëkun, duke shfrytëzuar me mjeshtëri mundësitë e frazës për të zbuluar kontradiktën komike dhe për t'u pozicionuar ideoemocionalisht. Lidhur me realizimin e gjuhës së komedive, duhet theksuar se autori ka ditur të shfrytëzojë me mjeshtëri mundësitë e pakufizuara të fjalës, për të krijuar efekte komike<sup>9</sup>.*

Duke studiuar dhe analizuar leksikon e komedive të Floqit, vihet re se më të përdorurat janë fjalët e huaja, kryesisht turqizmat dhe greqizmat, por edhe huazime latine, duke qenë fakte gjuhësore dhe historike njëherazi. Bien në sy shprehjet frazeologjike, të cilat kanë përdorim të dendur, fjalët e urta, që i përzgjedh me

<sup>8</sup> J. Spaho, Kristo Floqi- (Koha dhe vepra e tij letrare), Studim monografik, Ombra GVG, Tiranë, 2020, f. 264.

<sup>9</sup> J. Spaho, Kristo Floqi- (Koha dhe vepra e tij letrare), Studim monografik, Ombra GVG, Tiranë, 2020, f. 612.

## **“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

ngjyrimet të dukshme komizmi, trajtat dialektore të fjalëve, krahasimet komike, lojëra fjalësh, tonalitetet përqeshëse, togëfjalësh me kundërshti kuptimore etj. *Larmia e mjeteve gjuhësore të përdorura dhe shfrytëzimi me art i mundësive që jep fjala, u jep komedive të tij vlera të spikatura artistike. Një pasuri e tillë e përdorimit të mjeteve të gjuhës, për realizimin e veprave komike, sjell një përvojë të veçantë lidhur me strukturimin dhe realizimin e këtij zhanri*<sup>10</sup>. Kurse Mato cilëson: “Në veprat artistike satirike e humoristike, përpunimi i mjeteve të gjuhës së personazhit merr rëndësi të veçantë në zbulimin e komizmit. Si në çdo vepër letrare edhe në atë humoristike e satirike, krijuesi synon të karakterizojë gjuhën e personazhit, të japë tiparet e ligjëritimit dhe veçoritë e së folurës së tij”<sup>11</sup>.

Duke iu referuar komedive të Kristo Floqit shohim se në to, gjuha e personazhit është në përputhje me thelbin e tij dhe një mjet i rëndësishëm i realizimit të strukturës komike të veprës. Përmes gjuhës shkrimtari zbulon me mjeshtëri paaftësinë, injorancën, fodullëkun, mungesën e logjikës dhe arsyetimit normal të disa karaktereve komike. Kjo vërehet më qartë kur personazhet janë në pozitë të vështirë dhe qesharake dhe në fjalët e tyre ata shprehin thelbin dhe paaftësinë për t’i bërë ballë situatës. Lidhur me komeditë e Kristo Floqit dhe vënien e tyre në skenë te gazeta “Zëri i Korçës” shkruhet: “Më 14 shkurt të dielë mbrëmja, shoqëria mirëbërëse “Bashkimi” me anë të djelmoshave të grupit prezantoi në sallën e klubit komedinë “Vllazni dhe interes”, ku kishin mbledhur shumicë populli. Komedia u lojtë bukur sa të gjithë u kërdisnë së qeshuri”<sup>12</sup>

Pothuaj një shekull më pas, në gazetën “Metropol” të vitit 2004 jepet gjithashtu njoftimi mbi vënien në skenë të komedisë “Vllazni e interes” nga trupa e teatrit “Bylis” të Fierit: “Molieri shqiptar, siç është cilësuar nga kritika shqiptare, Kristo Floqi është ngjitur mbrëmë në skenën e Fierit me “Vllazni dhe interes” nën interpretimin e mrekullueshëm të aktorëve Luftëtar Paja, Fatmir Xheli dhe gjithë trupës së teatrit fierak. Pas një censurimi të gjatë të krijimtarisë së tij, komedia e Kristo Floqit është parë në skenën fierake, duke ngjallur interes të veçantë”<sup>13</sup>

Zgjedhja e komedisë “Vllazni e interesë” e Kristo Floqit nuk vjen në këtë punim në mënyrë rastësore. E shkruar nga figura e spikatur e Kristo Floqit, ajo realizon më së miri synimet e autorit për të edukuar shoqërinë shqiptare të kohës me vlera ideore, artistike e estetike, përmes të qeshurës. Edhe përzgjedhja e personazheve karaktere: Kola, Miti, Olymbja, Nastja etj, janë bërë mjeti i duhur për të arritur qëllimin final: **Vllaznija qenka interesi e kurr gjâ tjetër.**

**E shkruar dhe botuar në 1920, në Shkodër, te Shtypshkronja “Nikaj”,** autori, si një qytetar i miredukuar korçar, si një atdhetar shqiptar, banor i toskërisë dhe i gegërisë njëkohësisht, sikur kërkon të vërë në dukje vesin njerëzor të etjes për pasuri dhe xhelozinë në vëllazëri, që me dy emrat homogjenë të titullit: **“Vllazni e interesë”**. E megjithatë: Gegëri e Toskëri jemi një, pavarësisht ndasive territoriale. Ai pranëvë patronimet gege e toske në një familje, në një vëllazëri: Kolë (shkodrani) dhe Miti (korçari).

Personazhet e komedisë, autori i liston e i cilëson në paskopertinë:

*Vehtjet:*

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> J. Mato, *Paradokset e satirës dhe humorit*, Tiranë, 2000, f. 3

<sup>12</sup> Gazeta, *Zëri i Korçës*, 20 shkurt, 1926, Nr. 63.

<sup>13</sup> Irena Mërtiri, *Gazeta “Metropol”, Molieri shqiptar “qesh” pas censurës*, Tiranë, 4 dhjetor, 2004.

**Kolë Rrumbullaku. Nastja, e shoqja e tij. Olymbija, e bija e Kolës. Miti Rrumbullaku, i vllaj i Kolës. Ballauri, nji tregtar. Nji ixhrá – memûr. Nji mubashír. Dy gjendërmâ.**

Duket se autori e mishëron më së miri rolin e diasporës së kohës. Përmes Mitit, emigrantit ekonomik të kthyer në atdhe, tregon se këta shqiptarë po sjellin vlerat më të mira duke nisur nga e shtrenjta dhe e shenjta familje: **pará**, për të cilat derdhën djersë e gjak në dhe të huaj; **mall dashurie** grumbulluar nga largësia në hapësirë dhe kohë; **vlera qytetare** të kultivuara në emigracion e që me durim të kalitur për shkak të nevojës, zgjidhin qetësisht probleme të familjes dhe shoqërisë së padalë e të paemancipuar shqiptare.

Përveç këtyre vlerave, më madhorja ngelet ideja për interesa të mëdha si ajo e bashkimit dhe jo ndarjes për interesa të ngushta. Këtë qasje mendimesh të shprehura në përmbajtje e formë, Floqi e sjell në komedi përmes fjalës shqipe në dy dialekte, sikundër Kristoforidhi prej Elbasani që i sillte punimet e tij po ashtu në të dyja dialektet, për të evidentuar bukur pasurinë e shqipes nga veriu në jug, nga lindja në perëndim.

Për të, varietetet gjeografike të të njëjtit sistem, integrohen më së miri përmes kuptueshmërisë, njëjtësisë së strukturave dhe përdorimit nga e njëjta bashkësi shoqërore. K. Floqi në këtë komedi i sjell të integruara në një familje shqiptare të gjitha dallimet e të folmeve dialektore të toskërishtes veriore me gegërishten veriperëndimore (Korçë e Shkodër).

Po të bëjmë një analizë krahasuese të disa prej tipareve gjuhësore-dialektore në rrafshin fonetikor, leksikor e gramatikor do të kishim:

#### **Në rrafshin fonetikor:**

- Prandinë e serisë së fonemave zanore hundore të gegërishtes veriperëndimore dhe mungesë të tyre në toskërishten veriore: s’andejmi, kundrejt, andej
- Prandinë e serisë së zanoreve të gjata të gegërishtes veriperëndimore dhe atyre të shkurtra të toskërishtes veriore: *em vllaa /em vëlla; kam paa, thae/the*
- Zanorja a hundore e gegërishtes veriperëndimore kundrejt ë-së së theksuar të toskërishtes veriore: *nana – nënë, asht – është, ka banun- ka bërë, ban-bën, gja-gjë, ma tepër- më tepër*
- Togu zanor **ue** (ose zanorja **u**) i gegërishtes veriperëndimore kundrejt togjeve **ua, ye, ie** të toskërishtes veriore: *i gëzue, i gëzushëm, ngarkuen, grue, thue, fitue, mohue, mue, ftuesi*
- Mungesa e rotacizmit të gegërishtes veriperëndimore kundrejt pranisë në toskërishten veriore: *Vllazni- vëllazëri, vneshta-vreshta*

#### **Në rrafshin leksikor:**

- **Gegërisht:** *ajy, jem, ka-dale, bjerr, qe, krye, tue, mica, rrej, qit, uzdajë, hala* etj.
- **Toskërisht:** *ai, im, ngadalë, humb, ja, kokë, duke, macja, gënjej, nxjerr, shpresë, ende* etj.

**Huazime:** *burazeri, mysafir, dynjaja, ortaknija, henge(ahengje), neveri, nga, japi, rraqe, besdiz, axhë, xhaxha, çini, gjellë, taksirat, strajstë, navllov, kacidhë, tesha, ixhra- menur, xhandar, kasap. Veni, vidi, adveni* etj.

**Njësi frazeologjike në gegërishten veriperëndimore janë më të shumta:** *shkoj fill(menjëherë), skish të metelikut(asgjë), me lshue pare me dever (borxhe), të mbamën*

## “Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”

here (e fundit), s'pret hollë (I trashë), kam me të lanë në rrugën e madhe (do të braktis), a një punë bosh (kot, pa vlerë), s'të bana me ditë (nuk të njoftova), I hidhet ndrykë (e përqafton), me besdisë kënd (të shqetësoj), kena me ia thye kryet gjithiallit (ta vrasim) etj.

**Fjalë e urtë:** si e ka kokën le të venë festën

### Në rrafshin gramatikor <sup>14</sup>

-Bie në sy në GVP, kategoria e pashquarsisë e **emrave mashkullorë njëjës**, me temë në zanoren I, me **theks fundor**, kundrejt shquarsisë së tyre me mbaresën **-ja**, duke sjellë ndërrimin e gjinisë: *vllazni, shtëpi, Olymbi, Nasti, zotni, ortakni, në përkatësisht: vllaznija, shtëpija, Olymbija, Nastija, zotnija, ortaknija*

- Rasa rrjedhore e shquar del me mbaresë **-t**, në grupe emërore si: *fe metelikut; punë boshit, prej Ameriket, prej Monastirit; vllau prej vllajt;*

-Gjithashtu tek mbiemrat bien në sy formimet me **ue + shëm:** *i gëzueshëm; i ftueshëm,*

- Ka formime të tilla përemërore si: *çka, ç'ka kurrkush, kurrnja, gjithandej, gjithsicilli, dishka;*

-Format me bashkëtingëllore fundore të zëshme geqe, kundrejt të shurdhëtave toske (jo të shurdhët): *i madh – i math, qind – qint; mend-ment; mendohet-mentohet;*

-Prania e grupeve bashkëtingëllore **mb. nd, ng, ngj:** *Olymbija; të mbramen; andaj; ka ndollë; këndej, ndrykë, s'andejmi; henge (ahengje), hangër; franga;*

- Bie në sy në GVP shumica e formave dhe mënyrave në sistemin foljor: *kam paa; kam fitue; ka bamun; tue marrë; tue kërcyje; me lshue; kena me ble; kam me të lanë; kena me ja thye; ka me m'mohue; shifena; fitojshe; harxhojshe; t'i shtije; din me thanë;*

- Paskajorja e gegërishtes me pjesëzën **me:** *me lshue; me ble; me të lanë; me ja thye; me m'mohue; me thanë;* Etj...

### Përfundime

Kristo Floqi ishte një njeri fisnik në pamje, erudit në kulturën e vet, personalitet shumëplanësh, me botëkuptim të formuar nën ndikimin e disa kulturave, burrë i vërtetë shteti, orator dhe organizator i përkryer. Ai i bënte vend vetes në të gjitha mjediset, shoqëritë dhe vendet ku jetoi pjesën më dinamike të jetës së tij. Duke patur aktivitet të rëndësishëm politik dhe patriotik dhe gjeografi të pasur vendndodhjesh, emri i tij do të përmendej e analizohej në organe të tilla si “Dielli” i Bostonit, “Dielli e Flamuri”- Boston, “Atdheu”- Kostancë, “Shtypi”- Tiranë, “Gazeta e re”- Tiranë, “Demokracia”- Gjirokastër, “Kalendari Kombiar”- Sofje, “Posta e Shqypnisë”- Shkodër, “Populli”- Vlorë, “Besa shqiptare”- Shkodër, “Gazeta e Korçës”- Korçë etj. Në to analizohet jeta dhe aktiviteti i tij politik në periudha të ndryshme. Ai sigurisht që tërheq vëmendjen me një krijimtari kaq të pasur, aq të receptuar dhe të mirëpritur nga lexuesi dhe spektatori i kohës. Jo vetëm jeta e tij, porë në aspektet më të rëndësishme të saj me kontributin që i dha çështjes kombëtare, por dhe vepra letrare do të zgjojë vazhdimisht vëmendjen e studiesve. Duke qenë një figurë e spikatur jo vetëm në aspektin politik, por dhe atë letrar dhe publicistik, emri i Kristo Floqit është studiuar e analizuar shumë, kur dominoi në jetën politike dhe shoqërore.

<sup>14</sup>Këtu do të vëmë në dukje kryesisht tipare gramatikore të dukshme të gegërishtes veriperëndimore (GVP)



## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Ai botoi një numër të konsiderueshëm komedish dhe dramash, të cilat publiku i ndoqi me kënaqësi në skenat e teatrove amatore dhe kritika vuri në dukje suksesin e tyre. Komeditë dhe dramat e Kristo Floqit u pëlqyen dhe u pritën shumë mirë nga publiku.

Në përgjithësi, në komeditë e K. Floqit spikat dukshëm përdorimi i trajtave dialektore të toskërishtes veriore, specifikisht të së folmes së Korçës, kur ngjarjet zhvillohen në Korçë, si te “Vllazni e interesë” dhe të së folmes së gegërishtes veriperëndimore, kur ngjarjet zhvillohen në Shkodër, si te “Reklamë e blofë” dhe “E bija e bankierit”. Autori pati mundësinë të jetonte në këto qytete dhe të njihte deri në detaje këto të folme, që do t’i përdorte me mjeshtëri në komeditë e tij, për të spikatur e karakterizuar personazhin dhe ambientin, por kjo përfaqëson deri në një farë mase dhe të folmen e kohës kur jetoi autori, kur ende nuk ishte njehësuar norma letrare. Të folmen e Shkodrës autori e përdor në vepër me mjeshtëri për të karakterizuar gjuhën e personazheve, kur ngjarjet zhvillohen në këtë qytet, duke përdorur **forma të tilla foljesh** si: *bamun, bahet, pru, asht, don, len, kena, kqyr, mejtue, kuptue, harrue, hangër* etj., **emrash, mbiemrash, përemrash, ndajfoljesh** si: *baba, vëllazën, grue, kryet, axha, hallku, dashni, kangë, muej, punëtuer, lumzojë, plegni, i gëzuem, të lumtun, i kënaqun, i unshëm, i besuem, i mallkuem, të huej, këtyne, mue, jem, kët, aj, një tash, gadi, kurgja, hala, masi* etj

Kristo Floqi gati në të gjitha komeditë e tij përdor një pasuri të madhe frazeologjike shprehjesh të ngurosur, Me qëllim që t’i japë frazës intonacionin dhe komizmin e kërkuar. Emri dhe vepra e tij u la gjatë në heshtje, por ai duhet të zërë vendin që i takon në çdo fushë ku spikati, sidomos në radhën e autorëve të traditës që sollën kontributin e tyre duke pasuruar letrat shqipe. Në fillim të shekullit XXI, ai u përfshi edhe në “Fjalorin enciklopedik shqiptar”, 2008, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke u renditur denjësisht në radhën e autorëve të letërsisë shqiptare të periudhës 1912-1939. Edhe Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë, ka zhvilluar një sesion shkencor për evidentimin e kësaj figure poliedrike, të cilit i ka ardhur më në fund koha të studiohet, të çmohet e vlerësohet në të gjitha aspektet, duke qenë ndër ata intelektualë, atdhetarë, veprimtarë e krijues që Korçës lavdi i dhanë, sikundër edhe Mihal Grameno, Ilo Mitkë Qafëzezi, Dhori Koti etj.

Figura e tij u promovua bindshëm falë monografisë “*Kristo Floqi- (Koha dhe vepra e tij letrare)*”, nga prof. as. dr. Jonela Spaho, e cila e ka promovuar në disa institucione publike të qytetit të Korçës, duke filluar në skenën e Teatrit “Çajupi”, tetor 2021, për ta vazhduar në mjediset e Prefekturës, më 24 nëntor 2023, ku nga Këshilli i Bashkisë Korçë, iu dha titulli “Qytetar Nderi”, (pas vdekjes) i qytetit të Korçës. Më 24 mars 2022, në Boston, në mjediset e “Vatrës” dhe në faqet e gazetës së saj “Dielli”, Floqi iu dhanë meritat që i takonin jo vetëm nga autorja e monografisë, por edhe nga anëtarët e të pranishmit. Kjo u realizua edhe në Kishën e Shën Trinisë, Boston, më 26 mars 2022, si dhe në mjediset e kishës së Shën Sotirit të arumunëve të qytetit, më 7 prill 2024.

Vepra e tij duket se është burim i vyer studimesh në fusha të ndryshme jetësore. Koha do e tregojë.

### **Referenca**

AQSH, *Fondi Kristo Floqi, D.1.*

**“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”**

- Floqi. K., (1920). *Vllaznia e interesit*, Shkodër.
- Floqi. K., (1926). *Akraballëket*, Tiranë.
- Floqi. K., (1926). *Reklamë e blofë*, Tiranë.
- Gjinari. J., Shkurtaç, Gj., (2000). *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë.
- Gazeta “Zëri i Korçës”, 20 shkurt, 1926, Nr. 63.
- Gazeta “Gazeta Shqiptare”, I anatemuari Kristo Floqi, Tiranë, 20 tetor, Nr. 4377.
- Papagjoni. J., (2009). Enciklopedia “Teatri dhe Kinematografia shqiptare”, Tiranë.
- Mërtiri. I., (2004). *Molieri shqiptar “qesh” pas censurës*, Gazeta “Metropol”, Tiranë, 4 dhjetor.
- Spaho. J., (2005). *Kristo Floqi, përçuesi dhe pasuruesi i traditës së komedisë shqiptare*, Buletini Shkencor, nr 10, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.
- Spaho. J., (2010). *Kristo Floqi dhe komeditë e tij*, Tempulli, Korçë.
- Spaho. J., (2020). *Kristo Floqi- (Koha dhe vepra e tij letrare)*, Studim monografik, Ombra GVG, Tiranë.

**KOHERENCA E PUBLICISTIKËS DHE PROZËS SË MIHAL GRAMENOS-SIMBOLIKË KOMBËTARE DHE PATRIOTIKE**

**Dr. Ilir SHYTA**

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë

Universiteti “Fan S. Noli”

ilirshyta@yahoo.com

**Abstrakt**

Artikulli përmes koherencës trajton shkrimësinë e patriotit Mihal Grameno në publicistikën dhe prozën e tij letrare që ai shkroi. Përmes tij përcjellim atmosferën atdhetare e patriotike, veçanërisht të përshkrimin e Luftës së Mashkullorës apo ngjarjesh të tjera, të asaj periudhe, që pasuan simbolikën tonë kombëtare edhe përgjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Përshkruhet, trimëria e djalërisë shqiptare e palëkundur për të luftuar për fatin e atdheut, të pushtuar nga Porta e Lartë apo fuqi të tjera të huaja armike. Këto veprime, ndërmarrin vdekjen në sy dhe të shënojnë përfundimisht në histori, në anën e atyre njerëzve të kombit, që zgjedhin rrugën e duhur të saj, rrugën e çlirimit kombëtar nga pushtuesi i huaj.

Heroizmi vijon të shoqërojë prozën dokumenatre letrare të Gramenos me përshkrime të tjera faktike, sikurse janë portretet e luftëtarëve që ndërtohen nga vetë rrëfimet e nënëve të tyre, të cilat janë krenare, që djemtë japin jetën për lirinë e Shqipërisë. Ato, vijnë, si dëshmi epokale në gjirin e asaj lufte trimërore. Ky moment dokumentohet në faqet e kësaj proze nga vetë goja e tyre, figura e së cilave fiton dimensione madhështore, teksa Grameno i skalit në memorien e kujtimeve të tij. Kryefigurë mes tyre është nënë Hasoja, nëna e patriotëve Çerçiz dhe Bajo Topulli.

**Fjalë çelsa:** atdhe, flamur, gjashtore, komb, kryengritje, liri, nëna, prozë, publicistikë

**THE COHERENCE OF THE PUBLICISM AND PROSE OF MIHAL GRAMENO, NATIONAL AND PATRIOTIC SYMBOLISM**

**Abstract**

The article, through coherence, addresses the writings of the patriot Mihal Grameno in his publicism and literary prose. It conveys the patriotic atmosphere, particularly in the descriptions of the Battle of Mashkullorë or other events from that period, which followed our national symbolism even during the years of World War I. It describes the bravery of the Albanian youth, unwavering in their fight for the fate of their homeland, occupied by the Ottoman Empire or other foreign hostile powers. These actions face death in the eye and ultimately mark the history of those people of the nation who chose the right path, the path of national liberation from foreign conquerors.

Heroism continues to accompany the literary documentary prose of Grameno, with further factual descriptions, such as the portraits of the warriors created through the stories of their mothers, who are proud that their sons gave their lives for the freedom of Albania. These come as monumental testimonies in the heart of that heroic war. This moment is documented on the pages of this prose through their own words, and their figures take on magnificent dimensions as Grameno engraves them in the memory of his recollections. A leading figure among them is Mother Hasoja,

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

*the mother of patriots Çerçiz and Bajo Topulli.*

**Keywords:** *flag, freedom, homeland, mother, nation, pistol, prose, publicism, uprising*

“Për nder të Shqipërisë dhe të lirisë” këtë fjali do të vendoste Mihal Grameno në gojën e Hajredin Trimishtit kur e përshkruan vdekjen e tij heroike në prozën eseistike “Kryengritja shqiptare”, e cila në pjesën e parë të saj i kushtohet luftës së lavdishme të Mashkullorës. Përmes saj Grameno përmbledh shënimet e tij mbi lëvizjen kombëtare çlirimtare të popullit tonë kundër Turqisë. “Kryengritja shqiptare” është një prozë prej 204 faqesh, e cila ndahet në dy pjesë. Vëllimi i parë është ideuar në vitin 1908, atëherë kur i kishte në meorien personale kujtimet me komandantin e tij Çerçiz Topullin apo ngjarjet e tjera historike të asaj periudhe. Teksti është i ndarë në nëntë kapituj të ndryshëm. Kjo prozë dokumentaro-letrare mbetet mbi të gjitha një vepër me vlerë ideo-artistike e përpjekjeve të patriotëve shqiptarë për lirinë e Shqipërisë.

Me tej ajo në mënyrë letrare dhe artistike përcjell mall dhe ndjenjë atdhedashurie, Theksojmë se që në hyrje të saj përshkruhet nisja e çetës për Shqipëri. “Të shtunë pas dreke, më 16 maj, përhapin pëlhurat e anijes edhe Ahmeti, kapiteni ynë, urdhëron: djema gati! Përnjëherësh anija mori udhën dhe neve ja krismë këngës për mëmëdhenë, për mëmëdhenë, të cilën e kisha bërë unë edhe ja kisha dedikaur Bajos. Megjithatë ishim kaqë të pakët, zemrat tona ishin shumë të gëzuara e plot shpersa, duke pandehur që gjithë kjo botë ishte krujuar vetë dhe vetëm për neve! Kur zuri të ngriset, na thotë Ahmeti: Do të kemi furtunë, o djema, e kësisoj do të mos mundim të dalëm në stere, siç e pandehnim.”<sup>1</sup>

Pjesëza kulmore e saj është vrasja e Bimbashit të Gjirokastërs, tablo e cila skicohet artistikisht në prozën e Gramenos kur ai tregon: “Ishte e hënë, 25 shkurt 1908, ditë tregu, kur u nisnë Hitoja me Bajramin për në Gjirokastër, si u veshnë me rroba tregtari. Pas pllanit, që kishim bërë, ato rynë m’orën 8 në qytet, Selfua me Haredinë vanë më orën 9, ndanë qytetit dhe Qenani me Asllanë vanë në qimtir e krishterëve për të mprojtur shokët kur të delnin nga qyteti. Çerçizi, unë, Abdylly, Myftari dhe Pirrua qëndruam në breg që të mpronim shokët nga ushtëria kur t’i ndiqte. Haredini me Selfon, me të parë shokët të shpëtuar edhe lajmërohen për vrasjen të Bimbashit, u qëndrojnë dritareve të Hyqmetit dhe i bëjnë copë-copë. Pastaj marrin rrugën që të vijnë tek neve. Zemani me Asllanin qëllonin dhe ata, nga qimtri, përmbi Hyqmet, duke shtenguar të mjerët nëpunës që të kërkonin vriam për t’u mbrojtur nga ndonjë plumb!”<sup>2</sup>

Në të njejtën linjë patriotike, Grameno shkruan duke përcjellë jehonën e përhapjes së lajmit ndër popullsi për vrasjen e Bimbashit të Gjirokastërs.

“Vrasja e Bimbashit u prit me një gëzim të patreguar, nga ana e gjithë popullit, i cili na uronte, nga thelbi i zemrës, se muntmë ta shpëtojmë prej një turku të lik edhe tiran, që tmerronte popullin me faj soe pa faj, meqenë që ishte një Shqiptarman i madh”<sup>3</sup>.

<sup>1</sup>Mihal Grameno. Kryengritja Shqiptare, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1959, f. 150

<sup>2</sup>Po aty, f. 188

<sup>3</sup>Po aty, f. 189

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Vëllimi i dytë është shkruar në vitin 1925. Në formë kronologjike Grameno përshkruan lëvizjen e viteve 1909-1911, shpalljen Shqipërisë të Pavarur, grindjen mes Ismail Qemalit dhe Esat Pashë Toptanit, ardhjen e Princ Vidit në vendin tonë, Lëvizjen e Haxhi Qamilit, formimin e Qeverisë së Durrësit, Kongresin e Lushnjës, Kryengritjen e Revolucionit Demokratik të Qershorit, rënien e Qeverisë së Fan Nolit dhe rikthimin e Ahmet Zogut në pushtet. Në shënimet e tij shkrimtari Sterio Spasse vëren se në këtë vëllim na dalin në dritë të gjitha dallaveret e “politikanëve shqiptarë”, ku merr pjesë herë pas here edhe vetë autori.<sup>4</sup>

Në vëllimin e parë me heroizëm përshkruhet edhe Lufta e Mashkullorës. Përshkruhet trimëria e djalërisë shqiptare e palëkundur për të luftuar për fatin e atdheut të pushtuar nga Porta e Lartë. Një veprim ky, që ndërmerr vdekjen në sy dhe të shënon përfundimisht në histori, në anën e atyre njerëzve të kombit, që zgjedhin rrugën e duhur të historisë, atë të çlirimit kombëtar nga pushtuesi i huaj.

“Duheshe të mos ndodhesha unë që të mirrënja anë në Luftën e Mashkullorës, se fuqia ime është e dobët për ta përshkruar e zografisur ashtu sikundër ngajti. Duheshe pendë histografii, të sosur, duheshe penda e një mjeshtëri të vërtetë, duheshe të ndodheshe një shkencëtor ushtëriak dhe duheshe që të ndodheshe një kqyrës i luftës, se vetëm atëhere do të përshkruanin të vërtetën. Vetëm e vetëm këta do të muntnin që të përshkronin edhe zografisnin hollësisht këtë luftë, e cila meriton një histori të tërë, se vetëm atëhere do të mësonte dhe kuptonte pritmja e kombit tënë, që qysh dinin të mbushin detyrën tyre për atdhenë, duke lëftuar si qëmoti, për t’u lënë bijëvet të tyre lirinë me flamurin e shenjtë që të valonjë përmbi Shqipërinë! Fati, pra, e kishte rojtur për mua që të ndodhema atje dhe të marr pjesë në këtë luftë për liri, prandaj u kërkonj ndjesë këndonjësvet që nuk mund të mbush këtë barrë, me gjith hollësitë, duke u lënë të tjerëve, të zotrit për këtë që ta përshkruajnë dhe rrëfejnë të gjallë, siç meriton dhe qysh ngajti Lufta e Mashkullorës. Do të përpiqem, mesa është e mundur që të përbleth me pak fjalë ngjarjet e kësaj lufte, e cila ka për të mbetur e pahuarë dhe historike, në historinë e ringjalljes së Shqipërisë, se trimëri e kësaj lufte shëmbëll për pritmjen, se u ndruan armët e Shqipërisë si në kohët e Skënderbeut”<sup>5</sup>.

Mihal Grameno nuk tregohet aspak emotiv, por tepër i vërtetë edhe në përshkrimin fizik që i bën komandant Çerçiz Topullit. Tiparet e tij skalisin dinjitet burror dhe atdhetar njëherazi: “Çerçizi u tregua një dragua në këtë luftë. Ai replikonte me ushtarët. Jemi bijtë e Skënderbeut dhe nuk jepemi, por do të luftojmë gjer në orën e fundit. Shqiptari di të vdes sipas zakonit e nderit. Vetëm dhe vetëm atëherë munda të besoj historinë e kombit tonë. Atëherë munda të njoh burrin dhe trimërinë e stërgjyshërve tanë, të kuptoj e të çmoj vlefën e këtij djali trim se megjithëqë u rrit i perkëdhelur, nuk i trembej vdekjes. Zbathur, lakuriq, karos, me leshra përpjetë, vërtiteshe më gjithë anët si një kumandant i madh, me pushkën në dorë e gjashtoren në dhëmbë, duke na mburrur neve edhe duke qëlluar mbi ushtarët. Fytyra e tij, këtë ditë, ishte më e çelur se kurdoherë, edhe jo sikur lëftonte, po sikur kërcente”<sup>6</sup>.

Më tej Grameno shkruan me ndjenjë evokimi: Thirrja “O burrani, shokë, se na rrethojti ushtria”<sup>7</sup>, të kujton dhe të rrënjos thirrjet e arbërit në kohën e motit të të madh të Gjergj Kastriot Skënderbeut, njëlloj si në poemat e Jeronim De Radës.

<sup>4</sup>Po aty, f. 39

<sup>5</sup>Po aty, f. 191

<sup>6</sup>Po aty, f. 193-194

<sup>7</sup>Po aty, f. 191

*“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Epopeja e lavdishme e përshkrimit të një beteje të pavdekshme është thurrur bukur në rrëfimin e Gramenos. Ai po kaq interesant mbetet jo vetëm në përshkrimin që i bën figurës së kapedan Çerçiz Topullit, por edhe trimave të tjerë të çetës së tij historike. “...kapitan Çerçizi me gjashtoren prej 10, si ndonjë luan i qëndronte që të mos afroreshin, duke na thënë edhe neve që të shtijem, verbërisht, për t’i frikësuar edhe mos guxojnë që të afrohen pranë nesh”.<sup>8</sup>

Ky mendim heroik i luftës së Mashkullorës del edhe në paragrafin e mëposhtëm. “Kjo luftë, kaqë e rreptë, mbajti gjer më orën 4-5 ...”<sup>9</sup> Heroizmi vijon të shoqërojë prozën dokumentare letrare me përshkrime të tjera faktike. Ato vijnë si dëshmi e një dëshmitari okulant në gjirin e asaj lufte trimërore. I tillë është edhe përshkrimi portretit real të Myftarit, i cili lëftojti kaq trimërisht sa na habiti të gjithëve. ...pa u trembur aspak lëftojti si një dragua! Kur u plagos, u hoq pak mënjane edhe, duke qeshur, na thotë: -më gërvishnë pak të liqtë. Unë u trëmba edhe me vrap i shtërngojta plagën me një brez, pa e xhveshur, edhe duke i dhënë guxim, i thom që s’a gjësendi, po Myftari më përgjigjet burrërisht: e çdo ketë mor Mihal, më tepër se një vdekje për nder të Shqipërisë.<sup>10</sup>

Veçmas, ajo, dokumentohet në faqet e kësaj proze edhe nga goja e nënave shqiptare, figura e së cilave fiton dimension madhështor, teksa Grameno i skalit në shkrimësinë e kujtimeve. Në shtëpinë e Topullenjvet, figurë madhështore është nënë Hasoja. “Kur ishin të rrethuar në Mashkullorë vanë në shtëpi gjithë farefisi..., për të ngushëlluar plakën. -Ju lutem tepër, moj motra, të jini të çelura se unë nuk kam nevojë forcimi dhe ngushëllimi, meqenëqë trimi po më lëfton si burrat për Shqipërinë! Vetëm atëhere, që Zoti mos e dhëntë kurrë, nëqoftëqë Çerçizi bie i gjallë në duar të ushtrisë, ejani, edhe, në më doni mua, tregojeni, jo të më ngushëlloni, po të më vrisni që të mos rroj e gjallë, midis shoqevet, si një faqezezë! Po siç e di unë Çerçizin, ay do të bjerë i vlarë me nder edhe atëherë ejani, ju motra, që të dëfrejmë edhe kërcejmë, së bashku se atëhere vdes e gëzuar që na le emrin të pafëlliqur”.<sup>11</sup> Kështu kuvendonte Hasoja, ajo trimëreshë plakë e ndërë, ajo kardhiqote që kish nxjerrë nga barku i saj, luanët e Shqipërisë, Bajon edhe Çerçiz Topullin shkruan Mihal Grameno thuhet në dëshmitë e kohës.

“Nëna e Zeman Mashkullorit, duke përgjojtur Luftën në Mashkullorë, thotë se po t’i vritej i biri “me këngë e me valle do ta mbulonte”. E ëma e dëshmorit Hajredin Trimishti, sa mori vesh vrasjen e të birit nuk derdhi asnjë pikë loti, por i këndoi këngë trimërie edhe çfaqë keqardhjen se nuk ishte vlarë bashkë me të edhe djali tjetër, Rizaj, që rrinte i burgosur me t’anë në Gjirokastër”<sup>12</sup>. Dhe më tej vijon Grameno: “Burrrat tanë, që treguam më sipër, nuk ishin të tjerë përveç të parët kryengritës (komita) shqiptarë, të cilët ishin mbledhur në Brindis që të hidheshin në Shqipëri dhe të përpiqeshin për lirinë. Këta burra ishin: Bajua dhe Çerçiz Topulli, Veli be Klysyra, Zeman Mashkullori, Idriz Jakova, Thanas Nasto, Naum Trabicka, Hasan Toleri dhe Mihal Gramenua”.<sup>13</sup>

<sup>8</sup>Po aty, f. 195

<sup>9</sup>Po aty, f. 195

<sup>10</sup>Po aty, f. 195

<sup>11</sup>Po aty, f. 199

<sup>12</sup>Po aty, f. 39-39

<sup>13</sup> Po aty, f. 142

### *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

Nënvizojmë se Mihal Grameno është inauguruuesi i prozës së gjatë shqipe (nënlloji i gjinisë së novelës shqiptare). Shkroi novelat “Oxhaku”<sup>14</sup> (Selanik, 1909), 61 faqe; “Varr’ i pagëzimit”<sup>15</sup> (Selanik, 1909) 32 faqe; dhe “E puthura”<sup>16</sup> (1909) 31 faqe, në të cilat u prezantua me nota sentimentaliste jeta shqiptare, me vështirësitë dhe problemet e saj të përditshme. Theksojmë se si rrymë e nëndheshme brenda tyre qëndron linja e atdhedashurisë edhe pse notat sentimentaliste mbizotërojnë në koherencën artistike të së gjithë linjës së novelave. Pa një atdhe të lirë nuk ka lumturi të përgjithsme, devizë rilindase që përfocohet edhe më tepër nga aktualiteti përcjellës i mesazheve, për ta dashur në çdo kohë vendin tënd. Nuk duhet harruar që edhe besimi i mban të lidhur fort njerëzit, mban të lidhur familjet e tyre nën devizën tjetër rilindase: “feja e shqiptarit është shqiptaria”. Këtë e mishëroi më së miri jo vetëm proza e Gramenos, por edhe programi i gazetës që ai drejtoi atë kohë, “Lidhja ortodokse”.

“Programi i kësaj gazete ishte që të përpiqeshin me anë të fesë të mbushnin porosinë e shënjtëruara duke përhapur fjalët e Zotit, midis ortodoksëve shqiptarë e të mos bëhen vegla të të huajve, të cilët me anë të fesë, kërkojnë të na shkulin kombësinë dhe fenë”<sup>17</sup>.

Mihal Grameno kishte besim se shqiptarët do ta bënin Shqipërinë e tyre. “Nuk është lark dita kur populli shqiptar, ose më mirë opingat, do të zgjohen nga gjumi rëndë dhe, duke i këthyer me ndohtësi krahët parësisë, do ta marrin vetë udhën e përparimit edhe të qytetërimit”.<sup>18</sup> Me tej ai guxon dhe flet hapur, duke e vënë theksin se shtresa e vegjëlisë do ta bëjë vendin amë. Ai nuk kishte besim te onxho-bonxhot, por te populli i thjeshtë që mbështetste atdheun pa interesa përfituese. Të tillë janë edhe personazhet e novelave interesante që ai krijoi në vijimësi. “Kemi besim te varfanjakët. Edhe kjo opingë është shtylla edhe shpresa e kombit shqiptar. Kombi kurrë nuk e humbet shpresën”.<sup>19</sup>

Personazhe si Rushan bej Frashëri, Maloja, Vahideja, Arslan Hajduti, Rustemi, patriku Panarit, dhespot Qirili, prifti Kozma, Gjin Kaplëkurasi, Laska Veqilharxhi, Thana, Afërdita e Nunit, Risto Vanezi, Marka, Zaro, Miti dhe Kolo, të mbeten gjatë në kujtesë, si lexonjës i prozës së Mihal Gramenos. Këta personazhe të shtersave të varfra të popullit, qytetarë e fshatarë prezantojnë karakteristika pozitive, janë njerëz të mirë, guximtarë, trima dhe të mençur, të cilët luftojnë me pengesat që ju krijojnë antagonistët e tyre në prozë. Ata e duan familjen dhe atdheun e tyre.

Në të njejtën linjë janë edhe vargjet e këngëve patriotike të shkruara nga Grameno: “Për mëmëdhenë”, “Lamtumirë”, “Uratë për liri”, të cilat të veshin me tis patetik koherence. Grameno këto vjersha i botoi më 1912, të përmbledhura në librin me titull “Këngëtore shqipe-Plagët”. Poezia atdhetare e Gramenos u bëri jehonë të drejtpërdrejtë ngjarjeve të vullshme që do të sillnin shpalljen e Shqipërisë së pavarur. Vjersha “Për Mëmëdhenë” mbetet një këngë atdhetare, model krenarie për

<sup>14</sup>Mihal Grameno, Oxhaku në librin me novela dhe kujtime: Kryengritja Shqiptare, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1959, f. 105

<sup>15</sup>Po aty, f. 69

<sup>16</sup>Po aty, f. 48

<sup>17</sup>Gazeta “Lidhja ortodokse”, nr. 1, 10 korrik, 1909, f. 1

<sup>18</sup>Gazeta “Koha”, nr. 21, 1909, f. 2

<sup>19</sup>Gazeta “Lidhja ortodokse”, nr. 3, 17 gusht, 1909, f. 1

## *“Korça në Luftën e Parë Botërore: Vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike”*

çdo brez shqiptari.

Fusha ku spikati talenti i Mihal Gramenos është në tërësi publicistika e tij. Bashkëpunoi me disa organe, por shumicën e shkrimeve e botoi në gazetën “Lidhja ortodokse” (1909-1910) dhe “Koha” (1911-1926), të cilat i drejtoi vetë. Shkrimet e tij publicistike shquhen për idetë demokratike dhe frymën luftarake. Tek ato gjejmë përpjekje për të krijuar mjedise të besueshme shqiptare dhe personazhe nga klasat e shtresat e ndryshme të shoqërisë sonë të asaj kohe. Ka botuar dy vepra dramatike: komedinë në vargje me tri pamje, botuar në Bukuresht të Rumanisë më 1905 me 86 faqe, “Mallkimi i gjuhës shqipe” dhe dramën në katër akte “Vdekja e Pirros” (Sofie, 1906), të dyja të shkruara në vargje. Komedia “Mallkimi i gjuhës shqipe” trajton luftën e atdhetarëve shqiptarë kundër klerit reaksionar grek dhe elementëve grekomanë; të “Vdekja e Pirros” trajtohet kthimi i Pirros fitimtar nga Italia dhe vrasja e tij në mënyrë të pabesë. “Antikat Kombëtare”<sup>20</sup> me kujtime, pamflete dhe portrete merr ngjyrim kombëtar për të pavdekësuar imazhe që shërbyen dhe shërbejnë si vlerë komëbatre në kohezion. Shkrimet e tij publicistike i shërbyen duke i ardhur për shtat, drejtpërdrejtë shërbimit të çështjes kombëtare. Drejtoi gazetën “Lidhja orthodokse” (1909-1910), “Përlindja e Shqipërisë” në Vlorë dhe “Koha” në SHBA (1911-1926), me disa ndërprerje dhe “Drita” në Sofje, gazeta në të cilat botoi artikuj në prozë, poezi dhe drama. Shkrimet publicistike të Mihal Gramenos shquhen për frymën popullore, për patosin luftarak, ironinë e sarkazëm therrëse. Ai krijoi artistikisht personazhe të idejuara nga shtresat e varfëra të shoqërisë shqiptare, personazhe të cilët të mbeten gjatë në kokë. Në prozën e Gramenos shtresat e shoqërisë shqiptare na paraqiten në luftë me ambientin, shoqërinë dhe sistemin e kohës.

Mihal Grameno Lindi në Korçë, në vitin 1871, në një familje atdhetare nga shtresa zejtare dhe tregtare. Ishte luftëtar dhe intelektual i shquar i Rilindjes sonë Kombëtare. Vdiq në Korçë më 5 shkurt, 1931. Për meritat e shquara në dobi të atdheut, i është dhënë titulli “Hero i Popullit”<sup>21</sup>. Ndërkaq, theksojmë Mihal Grameno hyri në lëvizjen kombëtare në fund të shekullit të XIX-të. Botoi vjersha dhe artikuj në shtypin e kohës. Në vitet 1907-1908 luftoi në radhët e Çetës së Çerçiz Topullit, më 1908 mori pjesë në Kongresin e Manastirit. Për veprimtarinë e tij u dënua disa herë me burgim prej turqve. Pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore u detyrua të largohej në SHBA, ku vazhdoi të punojë për çështjen kombëtare deri më 1920, kohë kur u kthye në atdhe. Përfaqësoi shqiptarët e Amerikës në Konferencën e Paqes në Paris. Në vitet 1921-1924 ishte një nga veprimtarët në zë të lëvizjes demokratike shqiptare. Në vitet 1921-1924, si publicist mbrojti idealet demokratike. Pas dështimit të Revolucionit të Qershorit, i sëmurë, e i dëshpëruar, u tërhoq nga lëvizja shoqërore.<sup>22</sup>

<sup>20</sup>Mihal Grameno, Antika kombëtare, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1974, 216 f.

<sup>21</sup>[https://sq.wikipedia.org/wiki/Mihal\\_Grameno](https://sq.wikipedia.org/wiki/Mihal_Grameno)

<sup>22</sup>Po aty



**Bibliografi**

Mihal Grameno. Kryengritja Shqiptare, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1959, 232f.

Mihal Grameno, Oxhaku në librin me novela dhe kujtime: Kryengritja Shqiptare, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1959, 34f.

Mihal Grameno, Antika kombëtare, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1974, 216 f.

Thanas Gjika, Mihal Gramenoja publicist demokrat, Akademia e shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1980, 280 f.

Gazeta “Lidhja ortodokse”, nr. 1, 10 korrik, 1909, 4f.

Gazeta “Koha”, nr. 21, 1909, 4f.

Gazeta “Lidhja ortodokse”, nr. 3, 17 gusht, 1909, 4f.

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Mihal\\_Grameno](https://sq.wikipedia.org/wiki/Mihal_Grameno)

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**



Korça në Luftën e Parë Botërore: vetëqeverimi dhe zhvillimet social-ekonomike: (përmbledhja e artikujve të konferencës shkencore ndërkombëtare në përkujtim të 110-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe 108 – vjetorit të vetëqeverimit të Korçës): Korçë, 6-7 dhjetor 2024 / përgat. për bot. Eftiona Bylykbashi ; red. Lonora Hysolli. Tiranë : Vassi, 2025. ... f. ; ... cm.

**ISBN 9789928471352**

1.Historia 2.Studime sociale 3.Lufta Botërore, 1914-1918 4.Konferenca 5.Korçë

94(496.564) .086/.088 (062)

908(496.564) (062)



**ISBN 9789928471352**

1.Historia 2.Studime sociale 3.Lufta Botërore,  
1914-1918 4.Konferenca 5.Korçë

94(496.564) .086/.088 (062)

908(496.564) (062)